RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"Mbi përputhshmërinë"

TIRANË, korrik 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3.	Opinioni i auditimit	8
II.	**HYRJA**	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	11
2.	Identifikimi i çështjes	11
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
4.	Përgjegjësitë e audituesve	12
5.	Kriteret e vlerësimit	13
6.	Standardet e auditimit	13
7.	Metodat e auditimit	14
8.	Dokumentimi i auditimit	14
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16
2	Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i	16 - 28
2.2	Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë.	29 - 37
2.3	Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	37 - 54
2.4	Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).	54 - 66
2.5	Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.	66 - 87
2.6	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	87 - 147
2.7	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së auditit të brendshëm.	147 -155
2.8	Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.	155 - 159
2.9	Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit, për periudha jashtë periudhës së auditimit.	159 - 168
IV.	**REKOMANDIME**	**169 - 202**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i subjektit.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime (këtu e më poshtë SHRUK) Korçë SHA është themeluar më datë 17.07.2022 me objekt të veprimtarisë: a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; b) Mirëmbajtja e sistemit/ sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës se konsumatorëve; 9) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. [1]

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000,000 lekë dhe është i ndarë në 100,000 aksione me vlerë normale 100 lekë secili, dhe zotërohen nga aksionarët: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) 51%; Bashkia Korçë 28.29 %; Bashkia Maliq 8.67 %, Bashkia Devoll 7.76 %; Bashkia Kolonjë 3.64 % dhe Bashkia Pustec 0.63 %.

SHRUK Korçë SHA në strukturë organizative në organet drejtuese ka Asamblenë, Këshillin Mbikëqyrës dhe Administratorin. Ky i fundit ka një staf prej 10 punonjësish: kabineti (1), komunikimi me median (1), staf mbështetës (1), sektori i teknologjisë së informacionit (3) dhe Task Forca (4). Gjithashtu, ka edhe 1 auditues në varësi të Këshillit Mbikëqyrës.

SHRUK Korçë SHA është e organizuar në dy departamente: Departamenti tregtar dhe Departamenti teknik brenda të cilëve ka sektor dhe njësi, me një numër prej 278 punonjësish gjithsej, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" dhe statutit. Numri i punonjësve për 1 000 lidhje është mesatarisht 3.5 në vitin 2023 dhe 2.88 në vitin 2024.

SHRUK Korçë SHA ushtron aktivitetin në pesë bashki me një popullsi prej rreth 210 000 banorë duke furnizuar me ujë higjienikisht të pastër një popullsi prej rreth 84 % (pasi sipas raportimit ka një popullsi jo aktive pa konsum uji prej rreth 36 %), një numër mesatarisht prej rreth 55 300 klientësh, nga të cilët 43 % në zonat rurale (fshat) dhe 57 % ato urbane (qytet), me mbulim furnizimi me ujë të pijshëm rreth 98 % të popullsisë.

Sipas raporteve të SHRUK Korçë SHA ujë pa të ardhura lëviz nga 35.8 % në vitin 2023 në 33.5 % në vitin 2024; vlera totale e ujit të faturuar në vitin 2024 është 474,371,854 lekë dhe vlera e arkëtuar është 477,537,745 lekë ose 100.67 %, pra shlyerje edhe detyrimeve të prapambetura nga likuidimi me këste.

Sipas raporteve të SHRUK Korçë SHA, totali vjetor i të ardhurave për vitin 2024 është rreth 590,486 mijë lekë dhe totali vjetor i shpenzimeve për këtë vit është rreth 580,683 mijë lekë, nga të cilat rreth 35.3 % shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore; 26.7 % amortizim, 14.4 % shpenzime për energji elektrike, shpenzimet për interesa 9.7 %, për investime 5.1 % etj.

[1] Neni 2 i statutit të shoqërisë

SHRUK Korçë SHA klasifikohet si Njësi ekonomike e mesme, referuar nenit 4.1.3 të ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", bazuar në vlerën e aktivit, të ardhurave nga veprimtaria ekonomike dhe numri mesatar i punonjësve.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.
SHRUK Korçë SHA është shoqëri publike me rëndësi të veçantë, jo vetëm për shërbimin që ofron për furnizimin me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm; grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura e mirëmbajtjen e këtyre sistemeve, por edhe nga shtrirja territoriale duke mbuluar 5 bashki dhe numrin e konsiderueshëm të popullsisë, por edhe për kohën e furnizimit me ujë dhe cilësinë e ujit që ofron, krahas shpenzimeve për kryerjen e këtij aktiviteti.

Nga vetë rëndësia që ka SHRUK Korçë, të cilat rrjedhin prej detyrave dhe përgjegjësive që ka, rrjedh edhe rëndësia që ka auditimi i saj për Kontrollin e Lartë të Shtetit, me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së, me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, mbi të cilin zhvillon veprimtarinë, përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë, evidentimin e parregullsive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre etj. Për më tepër, që auditimi kryhet pas riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, me qëllim përmirësimin sigurimit të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për të plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve[2].

c. Qëllimi i auditimit.
Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.
Qëllimi i këtij auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore të SHRUK Korçë, për periudhën e aktivitetit 01.01.2023 deri më 30.09.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Auditimi është kryer mbi baze risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekNt si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem etj. Siguria e arsyeshme e auditimit ka ardhur kryesisht si rezultat i testeve thelbësore (punës mbi dokumentacion), edhe për arsye se shoqëria e riorganizuar auditohet për herë të parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe rrisku vlerësohet në nivelin mesatar.

e. **Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.** Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se SHRUK Korçë për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi

[2] VKM Nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", kreu I, pika 1

i auditimit ka konstatuar 34 gjetje për të cilat janë dhënë 45 rekomandime për masa organizative, 6 gjetje dhe rekomandime për shpërblim dëmi, 10 gjetje dhe rekomandime për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, si dhe 1 gjetje dhe rekomandimi për mungesë të ardhurash.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f- Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA në periudhën nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, konstatohet se:

- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 12 të statutit;
- Nuk ka ushtruar të drejtat e veta për të kryer verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij; nuk ka shqyrtuar e kontrolluar librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 dhe 3/d të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë nuk janë nënshkruar nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës, si dhe nuk ka bashkëlidhur një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar, për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme;
- Plani i biznesit të shoqërisë për vitet 2024 dhe 2025, nuk është nënshkruar nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe nuk i është paraqitur AKUM-it për miratim, duke ja përcjellë për miratim Asamblesë së Përgjithshme pa shqyrtimin e miratimin e AKUM-it, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/f të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Nuk ka miratuar planin e investimeve kapitale për vitin 2025, për t'ia dërguar për miratim AKUM-it në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/gj të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë thirrur nga Administratori i shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 11 të statutit;
- Njoftimi për thirrjen e mbledhjes nga ana e administratorit në 11 raste nga 34 gjithsej është bërë në më pak se 3 ditë, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 14 të statutit;
- Nga 34 mbledhje të zhvilluara gjithsej, në 50 % e tyre (pra në 17) nuk janë marrë vendime, duke i konsideruar diskutime, por në fakt në 21 mbledhje ka pasur vetëm fjalën e Kryetarit dhe të një anëtari ose nuk ka pasur fare diskutime; paraqitja e relacioneve për ecurinë e treguesve mujorë kryesisht në 10 ditshin e fundit të muajit për muajin paraardhës, si dhe mungesa e shqyrtimit me diskutime, i ka kthyer në veprimtari formale mbledhjet mujore të Këshillit Mbikëqyrës në drejtim të kontrollit e të mbikëqyrjes së zbatimit të politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- Në mbledhjen e datës 10.08.2023 është marrë vendimi nr. 5 "Për sponsorizimin e festës së birrës 2023" me 1,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994, i ndryshuar.

- Nga auditimi i organizimit, marrëdhënieve të punës dhe administrimit të tyre në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën 01.01.2023 deri më 30.09.2025 është konstatuar se:

- Struktura organizative e paraqet mangësi në aspektin e klasifikimit, emërtimit dhe funksionalitetit të njësive organizative, pasi ka sektorë të pa emërtuar ose pa përcaktim të qartë, për funksione që nuk menaxhohen nga shoqëria; mungon një njësi strukturore për shërbimet mbështetëse; ka

struktura të pa plotësuara me stafin dhe personelin përkatës; në Drejtorinë e shitjes dhe Drejtorinë juridike sektorët janë të plotësuar në numër me specialistë edhe për pozicionin e përgjegjësit të sektorit, në mospërputhje me Vendimin nr. 2, datë 11.04.2023 të Këshillit Mbikëqyrës; nuk ka një drejtues të dytë teknik në zbatim të kërkesave të nenit 18, pika 1, germa "c" e statutit etj.;
- Gjatë periudhës Janar 2023 - Prill 2024, janë lidhur kontrata pune vetëm për 276 punonjës nga 295 gjithsej të transferuar nga ish-shoqëritë dhe për pjesën tjetër janë nxjerrë urdhra ose vendime emërimi, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr.7691 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kontrata të cilat rezultojnë të pa protokolluara dhe të pa administruara në dosjet personale. gjatë kësaj periudhe nuk janë lidhur kontrata për punonjësit e rekrutuar në periudhë prove. Gjithashtu,
- Gjatë periudhës nën auditim numri i punonjësve ka pësuar luhatje të vazhdueshme mujore: në periudhën janar – korrik 2023 ka pasur 2 deri në 24 punonjës mbi organikë dhe në periudhën shtator 2023 –shtator 2025 ajo nuk është plotësuar me 4 deri në 34 punonjës, duke shfaqur mangësi planifikimi dhe/ose të performancës së shoqërisë.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 6,016,650 lekë, zhvilluar më datë 09.03.2023 dhe zbatuar me kontratën me nr. 100/23 prot., datë 23.03.2023 me vlerë 4,939,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F" dhe me afat 12 muaj, konstatohet se:
- Në procedurën e prokurimit është përfshirë Drejtori Ekonomik - Nëpunësi zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Në relacionin e llogaritjes së vlerës limit të kontratës, nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Njësia e prokurimi në kërkesat teknike për kualifikim në dokumentet e tenderit nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist;
- OE i vetëm pjesëmarrës dhe i shpallur fitues "D G/B.M P.F" për gomist nuk ka paraqitur asnjë dokument për dëshmi; si dhe disponimin e mjeteve dhe pajisjeve nuk e ka shoqëruar me të dhëna konkrete (faturë etj.) por vetëm me fotografi, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Në situacionin përmbyllës janë paguar sipas kontratës mallra në vlerën prej 290,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

- Programi ekonomik nuk është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për vitin 2023, si dhe për të gjithë periudhën objekt auditimi nga Ministria e Ekonomisë, në kundërshtim me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të lidhjes 2. Gjithashtu, rezulton se ky dokument nuk është mbështetur në SKEZHS, strategjinë sektoriale përkatëse, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli II, pika 2.
Gjatë vitit 2024 konstatohet se vendimet për investime nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Në buxhetin e vitit 2025 në kuadër të zbatimit të projekteve me fondet IPA nuk është marr vendimi që dy projektet nuk janë miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk është kërkuar ndryshim i programit ekonomik për buxhetin vjetor 2025 ashtu edhe për fondet e investimeve në buxhetin afatmesëm 2025-2027. Këto ndryshime nuk janë bërë as në dokumentin e Plan biznesit për periudhën 2024-2028.

- Nga auditimi rezulton se SHRUK Korçë për dy kreditë e marra nga BEI në vitin 2008 dhe nga KfW në vitin 2019 me vlerë totale 29,500,000 euro, nuk ka shlyer asnjë këst nga principali dhe interesi. Sipas komunikimeve shkresore të SHRUK Korçë me Ministrinë e Financave rezulton se për këto dy kredi deri në datën 30.09.2025 janë akumuluar dhe 4,469,365 euro principal dhe interesa të papaguara të cilat bien në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes midis tyre dhe kanë rënduar buxhetin e shtetit nga shlyerja e kryer nga Ministria e Financave.

- Nga auditimi konstatohet se detyrimet e klientëve (debitorëve) ndaj SHRUK Korçë në datën 30.09.2025 paraqiten në vlerë 422,069,532 lekë, i ndarë në 3 kategori: familjarë me vlerë 368,596,417 lekë, biznese me vlerë 28,068,937 lekë dhe institucione me vlerë 25,404,179 lekë. Gjithashtu, nga periudha fillestare e auditimit e deri në periudhën përmbyllëse të tij detyrimet e debitorëve janë rritur me një vlerë prej 39,549,757 lekë ose me 9 %. Për sa më sipër është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", Neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" e neni 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", si dhe Kodin Civil i Republikës të Shqipërisë, nenet 450, 455 dhe 481.

- Nga auditimi rezulton se Agjencia e Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) ka dhënë një subvencion me vlerë 30,000,000 lekë për "dhënie ndihme me rastin e krijimit të Shoqërive Rajonale të Ujësjellësve" përdorimi i të cilit i referohet zbatimit të Udhëzimit të MIE nr.20, datë 14.10.2022. Sipas udhëzimit ka prioritet likuidimi i detyrimeve të prapambetura të ish-njësive të ujësjellësve (paga, taksa, energji elektrike) dhe nëse shoqëria nuk ka detyrime të tilla atëherë mund ta përdorë subvencionin për investime. Nga ish-njësia e Ujësjellësit Maliq janë transferuar 29 kontrata me OSHEE-në me detyrim total në vlerë 113,360,845 lekë dhe konstatohet se SHRUK Korçë e ka përdorur subvencionin për investime, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 20 të MIE datë 14.10.2022, pikat 3 dhe 4 germa "d".

- Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë disponon 176 asete të pa luajtshme. Konstatohet se nga totali i aseteve, vetëm 5 prej tyre në qytetin e Korçës janë të pajisura me certifikata pronësie, por në emrin e ish-njësisë Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe 25 asete të tjera në rrethin e Devollit janë të pajisura me certifikata pronësie në emrin e Bashkisë, pjesa tjetër prej 146 asetesh nuk janë të pajisura me certifikata pronësie dhe nuk janë bërë aplikime nga SHRUK Korçë për regjistrimin e tyre.
Gjithashtu, konstatohet se 32 asete në rrethin e Korçës dhe 31 në rrethin e Kolonjës janë të pa kontabilizuara në pasqyrat financiare në llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione".
Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur", ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Kreu III, Neni 11, pika 1.

- SHRUK Korçë nuk ka bërë analiza dhe nuk ka hartuar plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme të ujit.
SHRUK Korçë nuk ka bërë bilancin e ujit një herë në muaj sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" për të identifikuar dhe përmirësuar situatën me humbjet.
Taks Forca në organigramën e miratuar me vendimin nr. 2, datë 11.04.2023 e përbërë nga një përgjegjës sektori dhe 3 punonjës por nuk është plotësuar me personelin përkatës dhe për pasojë

nuk ka funksionuar asnjëherë, duke ndikuar negativisht në parandalimin e humbjeve të dukshme të ujit të pijshëm.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.
Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

Nga Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimit e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,563,958 lekë pa TVSH** për punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zëra të ndryshme të punimeve në 5 kontrata për punime civile sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për të lidhur kontratat e punës me Asamblenë e Përgjithshme; të ushtrojë me korrektesë të drejtat e veta për kontroll dhe mbikëqyrje, shqyrtimin e pasqyrave financiare dhe të planit të biznesit; respektimin e kërkesave për dërgimin dhe miratimin e planit të investimeve në AKUM; thirrjen e mbledhjeve dhe respektimin e afatit të njoftimit, diskutimin dhe vendim-marrjen e duhur ligjore, përfshirë dhe sponsorizimet, për të rritur performancën kontrolluese dhe mbikëqyrëse të tij.

Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të analizojë skemën dhe funksionimin organizativ të shoqërisë dhe të marrë masa për hartimin, propozimin dhe miratimin e një strukture eficente, për kontrollin dhe rritjen e përgjegjësisë hierarkike, në funksion të rritjes së performancës individuale dhe të shoqërisë, të harmonizuar me kërkesat e statutit për Drejtuesin e Dytë Teknik, si dhe të një numri optimal të punonjësve.

Titullari i Autoritetit kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për përzgjedhjen dhe trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit, me qëllim që të respektohet radha e veprimtarisë dhe saktësia në llogaritjen e fondit limit dhe korrektesa në shqyrtimin e mostrave dhe vlerësimin e ofertave, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për respektimin e afateve për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik dhe të ndryshimeve në strukturat përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore dhe statutore, duke reflektuar në mënyrë të plotë vendimet për investime, projektet e financuara me fonde IPA, si dhe çdo ndryshim në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm (2025–2027). Paralelisht, të rishikohet dhe harmonizohet Plani i Biznesit 2024 - 2028 me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve të paautorizuara dhe forcimin e disiplinës financiare dhe të qeverisjes së shoqërisë.

3. Opinioni i auditimit

Opinion i modifikuar (kualifikuar) mbi auditimin e përputhshmërisë.
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve (SHRUK) Korçë, me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, për periudhën nga data 1.01.2023 deri më 30.09.2025 dhe në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar disa parregullsi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për

Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një **opinioni të modifikuar** (**kualifikuar)**[3]**.**

Baza për dhënien e opinionit:
Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesve", pjesë e Raportit të Auditimit.
Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinioni. Opinioni mbështetet mbi parregullsitë e konstatuara si vijon:
- Në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.4, datë 11.07.2025 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë", konstatohet se 5 anëtarë nuk plotësojnë kriteret lidhur me profesionin dhe/ose të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
- Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë; nuk ka ushtruar të drejtat e veta për të kryer verifikime dhe kontrolle në librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë; nga 34 mbledhje të zhvilluara gjithsej, në 50 % e tyre (pra në 17) nuk janë marrë vendime, duke i konsideruar diskutime etj.;
- Struktura organizative e paraqet mangësi në aspektin e klasifikimit, emërtimit dhe funksionalitetit të njësive organizative, pasi ka sektorë të pa emërtuar ose pa përcaktim të qartë, për funksione që nuk menaxhohen nga shoqëria; mungon një njësi strukturore për shërbimet mbështetëse; struktura të pa plotësuara me stafin dhe personelin përkatës etj.;
- Nga krahasimi i kategorizimit të punonjësve sipas eksperiencës në punë dhe nivelit të pagës së caktuar dhe llogaritur punonjësve ka mospërputhje, në kundërshtim me Vendimin nr.2 datë 09.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar, pasi nuk është bërë caktimi i nivelit të pagës bazuar në përvojën në punë, si dhe nuk është kryer kalimi nga një nivel në tjetrin me përmbushjen e viteve të përcaktuara për vjetërsinë;
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit janë konstatuar mangësi në krijimin e komisioneve/grupeve të punës në fazat e prokurimit; hartimin e specifikimeve teknike jo proporcionalisht me objektin e prokurimit; në procesin e llogaritjes së fondit limit duke mos marrë në konsideratë lindjen e nevojës, si dhe duke mos ezauruar plotësisht alternativën përkatëse të përzgjedhur; në shqyrtimin e vlerësimin e ofertave duke kualifikuar ofertues që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret në dokumentet e tenderit, në administrimin e mostrave në rastin e kontratave të mallrave, me pasojë dhe në përdorimin me efektivitet të fondeve publike të shoqërisë; disa prej inxhinierëve të SHRUK Korçë pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk janë pajisur me licencën e projektimit;

[3] SNA-705-Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Gjatë zbatimit të kontratave janë konstatuar mangësi në procedurën e marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, si dhe në zbatimin e kontratave për punime, me pasoja në efekte negative financiare në përdorimin e fondeve publike, si dhe pagesa për zëra të punimeve të pakryera;
- SHRUK Korçë kryen shpenzime dhe realizon analizat e ujit të pijshëm në laboratorë të pa akreditуar;
- Për të gjitha pajisjet nën presion dhe për menaxhimin e karburantit në funksion të veprimtarisë së SHRUK Korçë ka mungesa të verifikimeve fillestare dhe periodike për përmbushjen e kritereve të konformitetit;
- Për dy kredi të marra nga BEI në vitin 2008 dhe nga KfW në vitin 2019, rezulton se në datën 30.09.2025 janë akumuluar principal dhe interesa të papaguara në vlerën 4,469,365 euro;
- Detyrimet debitore në datën 30.09.2025 paraqiten në vlerën gjithsej 422,069,532 lekë, të cilat nga periudha fillestare janë rritur me një vlerë prej 39,549,757 lekë ose me 9 %;
- Nga auditimi i furnitorëve (kreditorëve) konstatohet se në datën 30.09.2025 janë 26 subjekte me vlerë totale 134,962,273 lekë që i ka kaluar afati i pagesës;
- SHRUK Korçë ka marrë 30,000 mijë lekë subvencione të cilin e ka përdorur për investime, i dhënë për likuidimin e detyrimeve me prioritet ndaj OSHEE, në një kohë që detyrimet ndaj saj për 29 kontrata janë në vlerën 113,361 mijë lekë;
- Janë konstatuar 32 lloje materialesh me qarkullim të ngadaltë dhe me vlerë gjithsej 4,009.5 mijë lekë;
- Nga 176 asete të pa luajtshme që disponon, vetëm 5 prej tyre janë të pajisura me certifikata pronësie, dhe 25 asete të tjera në rrethin e Devollit në emrin e Bashkisë, pjesa tjetër prej 146 asetesh nuk janë të pajisura me certifikata pronësie dhe nuk janë bërë aplikime nga SHRUK Korçë për regjistrimin e tyre;
- Nuk ka kryer analiza pranë ISHSH-së përpara fillimit të investimit në veprat e reja që ka investuar, përdorimi i klorit nuk ka regjistër të veçantë, marrja e analizave është e çrregullt, nuk ka komunikim të rregullt me strukturën rajonale të shëndetit publik, pas riparimit të defekteve në tubacionet e furnizimit me ujë të pijshëm nuk është kryer procesi i dezinfektimit etj.
- Ka shfaqur mangësi në ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Riskut dhe Grupin për Menaxhimin e Risqeve; nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm si dhe struktura e auditit të brendshëm funksionon me një auditues;
- Nuk ka kryer analiza dhe nuk ka hartuar plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme të ujit, hartimin e bilancit të ujit një here në muaj; ka në strukturën organizative task forcën, por nuk është ngritur dhe nuk funksionon për eliminimin e humbjeve të ujit;
- Janë konstatuar të ardhura të munguara në vlerën gjithsej 106,909 mijë lekë si rezultat i mos arkëtimit të sigurimit të një oferte dhe nga mos faturimi dhe mos arkëtimi i humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit për periudhën 01 janar 2023 – 30 qershor 2025;
- Është konstatuar keq menaxhim i shpenzimeve për shërbimin e automjeteve, kualifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, për komunikim me celular në administrimin e karburantit, në gjoba e dëmshpërblime etj., në vlerën gjithsej prej 27,033 mijë lekë;
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punime kanë rezultuar punime të pakryera në volumet e situacionuara, si dhe mos konfiskimi i sigurimit të ofertës në vlerën gjithsej prej 2,564 mijë lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1007/1 prot., datë 17.10.2025, të ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 17.10.2025 deri më datë 06.02.2026, në subjektin SHRUK Korçë u krye Auditimi i Përputhshmërisë, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2023 deri më 30.09.2025.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Gj. P. (Përgjegjës Grupi),
2. S. M., auditues,
3. E. Ç., auditues,
4. E. S., auditues,
5. A. S., audituese,
6. A. V., adituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi i auditimit është të vlerësohen dhe evidentohen shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Gjithashtu, synohet ndërmarrja e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve; dhënia e rekomandimeve për përmirësime të punës.

Gjithashtu, rëndësia e këtij auditimi qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese të fondeve dhe pasurisë publike, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e drejtuesve dhe stafeve të shoqërive publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Identifikimi i çështjes.

Sipas veprimtarisë së subjektit SHRUK Korçë, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.
- Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë.
- Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.
- Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).

- Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së auditit të brendshëm.
- Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Drejtimi i SHRUK Korçë është përgjegjës që të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj (shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, shërbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura etj.) brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Veç këtyre, është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e pasurisë publike dhe të burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, administrimi i vlerave materiale dhe monetare, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punimeve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi etj.

Gjithashtu, strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të shoqërisë së audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e SHRUK Korçë SHA është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion për këtë qëllim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional, si dhe kanë respektuar kërkesat etike gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të shoqërisë, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë që auditohet) dhe kryesisht:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 "Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura si titull ekzekutiv", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve;
- Ligji nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 "Për arkivat";
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura";
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK";
- VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar", i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" i ndryshuar;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit";
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e SHRUK Korçë";
- Akte të tjera ligjore/nënligjore mbi të cilat bazohet funksioni i shoqërisë.

6. Standardet e auditimit të aplikuara.

ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të*

përputhshmërisë", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si dhe manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH etj.

7. **Metodat e auditimit.**

Është përdorur metoda me auditim me zgjedhje sipas vlerësimit të audituesit dhe çështjes së audituar. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale sasiore dhe cilësore dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zëra të ndryshëm të aktivitetit ekonomik dhe financiar të subjektit.

Për arritjen e konkluzionit dhe opinionit vlerësues, janë përdorur tekNt e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë gabime. Gjithashtu, kjo teknikë u përdor dhe në rastet e tjera të çështjeve të auditimit ku ka lindur e nevojshme;
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*, konstaton nëse shifrat e shpenzimeve kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj., duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive të ndryshme. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij, në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 07, datë 17.01.2024, të ndryshuar; në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit",

i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, sipas Akt - konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe të shqyrtuara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve pasqyruar në Projektraportin e Auditimit, është përgatitur ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

SHRUK Korçë është themeluar në zbatim të VKM nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", nëpërmjet marrëveshjes së datës 28.06.2022 midis Bashkive Korçë, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonjë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me nr. 1 prot., datë 02.09.2022.
Shoqëria funksionon e organizuar me sistemin e administrimit me dy nivele: këshilli mbikëqyrës dhe një administrator, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre dy organeve.
Statuti i Shoqërisë me nr.1/1 prot. është miratuar datë 02.09.2022, ku janë përcaktuar objekti i veprimtarisë, kapitali, organet drejtuese të shoqërisë, kompetencat e Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, drejtuesve të shoqërisë etj.
Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me Vendim nr.1, datë 12.07.2022 ka emëruar 7 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.
Këshilli Mbikëqyrës me Vendim nr.3, datë 27.09.2022 administruar në SHRUKK me nr.16/5 prot., të po kësaj date ka miratuar strukturën e shoqërisë me 271 punonjës. Struktura e re dhe ndryshimi i numrit të punonjësve është miratuar me Vendimin nr.2, datë 11.04.2023, sipas të cilit shoqëria përbëhet nga 278 punonjës.
Veprimtaria e SHRUK Korçë rregullohet nga ligji bazë nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të funksionimit të shoqërive publike në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

2- Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit.

Si pjesa më e rëndësishme e raportimit të auditimit, në të përfshihen përshkrimet narrative dhe gjetjet e auditimit të vlerësuara për sa i përket materialitetit, ligjshmërisë dhe evidencës faktike të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim.

2.1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

a) Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimin dhe funksionimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Për trajtimin e këtij drejtimi të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni si më poshtë:
1. Thirrjet e Asamblesë;
2. Relacionet e paraqitura në Asamble;
3. Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë;
4. Vendimet e marra nga Asambleja.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se veprimtaria e Asamblesë në periudhën 1.01.2023 deri më 30.09.2025 është si më poshtë:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA është themeluar më datë 17.07.2022 me objekt të veprimtarisë: a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

b) Mirëmbajtja e sistemit/ sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës se konsumatorëve; ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000,000 lekë dhe është i ndarë në 100,000 aksione me vlerë normale 100 lekë secili, dhe zotërohen nga aksionarët: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) 51%; Bashkia Korçë 28.29 %; Bashkia Maliq 8.67 %, Bashkia Devoll 7.76 %; Bashkia Kolonjë 3.64 % dhe Bashkia Pustec 0.63 %.

Në nenin 3 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme është cilësuar si organi më i lartë vendim - marrës i Shoqërisë (pika 1 e nenit 6).

Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet në mbledhjet e saj nga Përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak respektiv i pajisur me autorizim specifik dhe nga përfaqësuesi i AKUM-it, si enti shtetëror i ngarkuar me përfaqësimin e aksionarit MIE.

Sipas nenit 7 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;
b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;
ç) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;
d) Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
dh) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe në statut.

Sipas pikës 4 të nenit 6 të statutit, Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

- Për vitin 2023, Asambleja e Përgjithshme ka zhvilluar 4 mbledhje në të cilën janë marrë 11 vendime:
1. Më datë 24.02.2023, njoftimi 14 ditë para zhvillimit të mbledhjes, në të cilën janë marrë 2 vendime: Vendimi Nr.1: Miratimin e Raportit të Ekspertit dhe Marrëveshjeve të Transferimit të Veprimtarisë Ekonomike; si dhe të marrëveshjeve noteriale të bashkive të Korçës, Devollit, Maliqit, Kolonjë, Pustec, si dhe ngarkimin e administratorit z. P. T. për nënshkrim dhe finalizim e transferimit.
Vendimi Nr.2: Emërimin e Sekretares të Asamblesë së Përgjithshme të SHRUK Korçë SHA;
2. Më datë 26.06.2023, njoftimi 11 ditë para zhvillimit të mbledhjes në të cilën janë marrë 2 vendime: Vendimi Nr.3: Miratimi i Normave të Amortizimit 2022 të SHRUK Korçë SHA;
Vendimi Nr.4: Miratimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA
3. Më datë 17.10.2023, thirrja 5 ditë para mbledhjes në të cilën janë marrë 3 vendime: Vendimi Nr.5: Emërimin e Sekretares të Asamblesë së Përgjithshme të SHRUK Korçë SHA; K. D. në vend të I. P.;

Vendimi Nr.6: Lirimin nga detyra të Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të SHRUK Korçë SHA z. J. Gj. për shkak të dorëheqjes;
Vendimi Nr.7: Emërimin në detyrë të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të SHRUK Korçë SHA; J. Gj..
4. Më datë 28.12.2023, në të cilën janë marrë 4 vendime:
Vendimi Nr.8: Miratimin e buxhetit për vitin 2024;
Vendimi Nr.9: Miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik 2024 – 2026;
Vendimi Nr.10: Për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar të SHRUK Korçë SHA;
Vendimi Nr.11: Miratimin e Planit të biznesit për vitin 2024 – 2028.

Vendimi nr.9 dhe nr. 11 nuk janë në përputhje me germën "a", pika 1 të nenit 7 të statutit, pasi janë për periudha 3 dhe 5 vjeçare, duke mos siguruar harmonizim të plotë me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore (Asamble – Administrator dhe Asamble – Këshill Mbikëqyrës). Gjithashtu, nuk janë në përputhje me pikën 2 të kreut I të Udhëzimit të MFE nr.18, datë 2.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" që "Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik të këtyre shoqërive bëhet për periudha 1-vjeçare, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre".

- Për vitin 2024 janë zhvilluar 4 mbledhje dhe janë marrë 8 vendime:
1. Më datë 29.01.2024, njoftimi 5 ditë para mbledhjes, në të cilën janë marrë 2 vendime:
Vendimi Nr.1: Prioritizimi për menaxhimin e likuiditetit dhe pagesave të SHRUK Korçë, për 2024;
Vendimi Nr.2: Miratimin e Normave te Amortizimit 2023 të SHRUK SHA;
2. Më datë 10.06.2024, thirrur 13 ditë para mbledhjes, në të cilën janë marrë 4 vendime:
Vendimi Nr.3: Miratimi e Pasqyrave financiare të SHRUK Korçë SHA për vitin 2023;
Vendimi Nr.4: Miratimin e Raportit të ecurisë së veprimtarisë 2023 të SHRUK Korçë SHA;
Vendimi Nr.5: Miratimin e Tarifave të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit te Përpunimit te Ujerave te Ndotura për Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA;
Vendimi Nr.6: Emërimin e Sekretares së Asamblesë së Përgjithshme të SHRUK Korçë SHA.
3. Më datë 25.09.2024, thirrur 5 ditë para mbledhjes, në të cilën janë marrë 2 vendime:
Vendimi Nr.7: Për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar për fillimin e procedurës së zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA
Vendimi Nr.8: Për emërimin e eksperteve kontabël të autorizuar të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA. për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2024.
4. Më datë 27.12.2024, në të cilën është marrë 1 vendim:
Vendimi Nr.9: Miratimin e buxhetit për vitin 2025.

- Për vitin 2025, deri më 30.09.2025 janë zhvilluar 4 mbledhje dhe janë marrë 5 vendime gjithsej:
1. Më datë 19.02.2025, në të cilën janë marrë 2 vendime:
Vendimi Nr.1: Miratimi i Normave të Amortizimit për vitin 2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA
Vendimi Nr.2: Për emërim në detyrë të Administratorit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA. (Nga administratori është bërë njoftim për rendin e ditës për riemërimin e Administratorit të shoqërisë) Në këtë vendim, Asambleja e Përgjithshme në pikën 1 ka vendosur që Z. P. T. riemërohet Administrator i shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve SHA, dhe pika 2: Administratori Z. P. T. emërohet në detyrë për një periudhë 3 vjeçare. Pra, Asambleja e

Përgjithshme nuk ka përcaktuar pagën e administratorit në aktin e emërimit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 17 të Statutit.
Asambleja e aksionarëve e ka marrë këtë vendim 5 muaj para se të plotësohej afati 3 vjeçar i emërimit të parë që ka qenë më datë 12.07.2022, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 17 të statutit.
2. Më datë 30.06.2025, thirrur 10 ditë para mbledhjes në të cilën është marrë 1 vendim:
Vendimi Nr.3: Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA për vitin 2024.
3. Më datë 11.07.2025, thirrur 3 ditë para mbledhjes në të cilën është marrë 1 vendim:
Vendimi Nr.4: Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA: E. Ç., A. Xh., F. B., A. Ç., E. D., B. H. dhe E. A..

Nga shqyrtimi CV të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, konstatohet se, nuk plotësojnë kriteret e emërimit:
a. - Znj. E. D. është me profesionin "Infermier i përgjithshëm" dhe me eksperiencë pune pedagoge në Universitetin "Fan S. Noli" që nga muaji tetor 1998, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 12 të statutit, pasi nuk është me profesionin inxhinierë i fushës, ekonomist ose jurist, si dhe eksperienca në punë nuk është në fusha të njëjta (shërbim i furnizimit me ujë etj.) ose të përafërta me objektin e veprimtarisë;
b.- Znj. E. A. është me profesionin "Juriste", e punësuar specialiste e prokurimeve në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike të Bashkisë Devoll; ka qenë Kryetare e Këshillit të Administrimit të Ujësjellës - Kanalizimeve Devoll SHA në periudhën qershor 2019 - tetor 2022, pasi në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 12 të statutit nuk ka eksperiencë mbi 5 vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë;
c. - Znj. A. Ç., diplomuar për "Kontabilitet- Financë", me detyrë Përgjegjëse Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, KPP, MIE (buxheti) Bashkia Tiranë (specialiste finance) etj., në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 12 të statutit, pasi nuk ka eksperiencë në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së ujësjellës - kanalizimeve;
d. - Znj. B. S., me profesion "Inxhiniere ndërtimi" dhe eksperiencë në punë zv/kryetare e bashkisë, Qendra e kadastrës digjitale, Drejtoria Vendore e ASHK, ALUIZNI Tirana 3; përfaqësuese biznesi etj., në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 12 të statutit, pasi nuk ka eksperiencë në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së ujësjellës - kanalizimeve;
e. - Z. B. H., me profesion "Inxhinier mekanik", dega transport bujqësi me eksperiencë pune: pedagog; menaxher dhe drejtor në kompani sigurimesh, vetëpunësim, specialist investimesh në Këshillin e Qarkut (1 vit), Drejtor i DRSHTRR Korçë etj., në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 12 të statutit, pasi nuk është inxhinier i fushës, si dhe nuk ka eksperiencë në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së ujësjellës - kanalizimeve;
4. Më datë 02.10.2025, në të cilën është marrë 1 vendim:
Vendimi Nr.5: Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA.

Nga sa më sipër konstatohet se veprimtaria e asamblesë në periudhën 1.01.2023 - 30.09.2023 ka përfshirë miratimin e Raportit të Ekspertit dhe Marrëveshjeve të Transferimit të Veprimtarisë Ekonomike, si dhe të marrëveshjeve noteriale të bashkive; emërimin e sekretares së asamblesë; miratimin e normave të amortizimit; miratimin e pasqyrave financiare; emërim dhe lirim nga detyra të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës; miratimin e buxhetit vjetor; miratimin e Programit të

Zhvillimit Ekonomik për periudha tre vjeçare; emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar; miratimin e Planit të biznesit për periudha 5-vjeçare; ri-emërimin e administratorit; prioritizimi për menaxhimin e likuiditetit dhe pagesave; miratimin e raportit të ecurisë vjetore 2023; miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura etj.

Si konkluzion, nga auditimi i veprimtarisë së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA në periudhën 01.01.2023 deri më 30.09.2025, konstatohet se:
- Asambleja e Përgjithshme, më datë 12.07.2022 ka miratuar statutin e shoqërisë, në nenin 25-Inventari-Llogaritë vjetore, pikat 1 dhe 2 të të cilit i referohen ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi më datën 01.01.2019 të ligjit 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
Gjithashtu, në pikën 6 të nenit 6 të statutit është përcaktuar që njoftimi duhet t'i shkojë çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtari, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes, në një kohë që sipas pikës 1 të nenit 137 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar kërkohet që njoftimi dhe rendi i ditës t'u dërgohet të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë;
- Asambleje e përgjithshme është përfaqësuar në mbledhjet e saj nga përfaqësuesi i këshillit bashkiak respektiv i pajisur me një vendim për miratim marrëveshje në SHRUK Korçë SHA të vitit 2022, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 6 të statutit, pasi nuk janë pajisur me një autorizim specifik;
- Nga 12 mbledhje të zhvilluara gjithsej nga asambleja, në 8 prej tyre nuk është respektuar afati i njoftimit të anëtarëve të asamblesë të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 6 të statutit të shoqërisë;
- Të gjitha thirrjet për mbledhjen e Asamblesë janë bërë nga Administratori, në një kohë që sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 6 të statutit në renditje janë: Kryetari i Asamblesë, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori, pra nuk janë thirrur as nga Kryetari i Asamblesë dhe as nga Këshilli Mbikëqyrës;
- Asambleja e Përgjithshme me vendimin nr.2, datë 19.02.2025 "Për emërim në detyrë të Administratorit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA" nuk ka përcaktuar pagën e administratorit në aktin e emërimit, si dhe nuk ka respektuar afatin 3 vjeçar të emërimit të mëparshëm, pasi e ka riemëruar 5 muaj para këtij afati, në kundërshtim me pikën 3 dhe 2 të nenit 17 të statutit;
- Asambleja e Përgjithshme në vendimet nr. 9 dhe nr.11 të datës 28.12.2023 ka miratuar përkatësisht Programin e Zhvillimit Ekonomik 2024 - 2026 dhe Planin e biznesit për vitin 2024 – 2028, pa i miratuar ato më parë në nivel vjetor, gjë e cila nuk është në përputhje me kërkesat e germës "a", të pikës 1 të nenit 7 të statutit, si dhe Udhëzimin e MF nr. 18, datë 2.5.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", pika 2, kreu I;
- Në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.4, datë 11.07.2025 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA", konstatohet se anëtarët: Znj. E. D., Znj. E. A., Znj. A. Ç. dhe Z. B. H., nuk plotësojnë e kriteret lidhur me profesionin inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist dhe/ose të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 12 të statutit.

b) Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës.

Për trajtimin e këtij drejtimi të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Thirrjet e Këshillit Mbikëqyrës;
2. Relacionet e paraqitura në Këshillin Mbikëqyrës;
3. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës;
4. Vendimet e marra nga Këshillit Mbikëqyrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Referuar ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 134, pika 1/c, në organet e shoqërisë aksionare është këshilli mbikëqyrës, me funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes, përcaktuar dhe në statutin e shoqërisë aksionare "Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-kanalizimeve Korçë SHA", neni 5 pika 1.

Ngritja, përbërja dhe funksionimi i këshillit mbikëqyrës janë të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në nenet 167 - 168, si dhe në statut në nenet 11 deri 16.

Këshilli Mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të politikave tregtare dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin (neni 11 i statutit, pika 1), përbëhet nga 7 anëtarë (neni 12, pika 2, e statutit) të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin nr.1, datë 12.07.2022, me një mandat 3 vjeçar si në vijim: z. J. Gj., liruar më pas nga detyra me vendimin e Asamblesë nr. 6, datë 17.10.2023; zëvendësuar me vendimin nr.7 të po kësaj date me z. J. Gj., znj. A. Xh.; znj. F. B.; B. S., A. Ç.; E. A.; B. H.; me vendimin e Asamblesë nr.4, datë 11.07.2025 janë emëruar: E. Ç., A. Xh., F. B., A. Ç., E. D., B. H. dhe E. A.. Në periudhën e auditimit, në plotësim të pikës 3, të nenit 11 të statutit Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës ka qenë J. Gj. deri më 23.10.2023, J. Gj. deri më 22.07.2025 dhe nga kjo datë E. Ç. (zgjedhja e Kryetarit sipas pikës 3 të nenit 11 të statutit).

Sipas pikës 1 të nenit 16 të statutit, shpërblimi i anëtarëve të Këshilli Mbikëqyrës është caktuar nga Asambleja e Përgjithshme, me vendimin nr.2, datë 22.08.2022, duke vendosur pagën bruto 35,294 lekë për Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës; 23,529 lekë për anëtarët dhe 17,647 lekë për sekretarin.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 12 të statutit, ku përcaktohet anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në momentin e emërimit lidhin një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë në terma vjetorë, indikatorë që duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes-planet e shoqërisë.

Sipas pikës 4 të nenit 11 të Statutit, Këshilli mbikëqyrës ka emëruar sekretar jashtë anëtarëve të tij znj. K. D. deri më datë 28.06.2024 dhe pas kësaj date znj. I. P..

Sipas pikës 1 të nenit 14, të statutit, Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit ose të Administratorit.

Sipas dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, Këshilli Mbikëqyrës i mbledhur për herë të parë më 27.09.2022 dhe në periudhën nga data 1.01.2023 deri më 30.09.2025 është mbledhur si më poshtë, në të cilat janë marrë vendimet sipas tabelës në aneks, tabela nr.1, të këtij Raporti Auditimi.

I. Aktiviteti i Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar gjithsej 13 mbledhje, në 6 nga të cilat janë marrë 13 vendime, ndërsa në 7 të tjera janë konsideruar me diskutime.

- Më datë 20.01.2023, për zgjedhjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) të shoqërisë, ku pjesa me e madhe e anëtarëve nuk kanë qenë pro miratimit të GMS duke konsideruar mungesë të kompetencës ligjore, ka pasur vetëm diskutime.
- Më datë 23.02.2023, për analizën e rezultatit financiar janar 2023, bashkëlidhur relacioni i datës 20.02.2023, sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se ka pasur vetëm diskutime.
- Më datë 15.03.2023, për analizën e rezultatit financiar shkurt 2023, bashkëlidhur relacioni i datës 12.03.2023, sipas procesverbalit të mbledhjes ka pasur vetëm diskutime.
- Më datë 11.04.2023 për rishikimin e projekt-buxhetit 2023, si rezultat i rritjes së pagës minimale dhe miratimin e strukturës organizative. Sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se ka pasur vetëm diskutime, dhe janë marrë dy vendime: miratimin e ndryshimeve në projektbuxhet si shkak i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike dhe rritjes së pagës minimale, si dhe miratimi i strukturës organizative për 278 punonjës, duke cilësuar në pikë të veçantë që gjatë procesit të ristrukturimit punonjësve që iu shkurtohet vendi i punës apo për shkak të kualifikimeve nuk mund të përshtaten me strukturën e shoqërisë, u ndërpriten marrëdhëniet e punës, duke respektuar afatet dhe procedurat e njoftimit sipas kodit të punës.

Janë marrë dy vendime: Miratimi e vendimit për disa ndryshime në vendimin nr. 8, datë 07.12.2022 "Për miratimin e projekt buxhetit 2023" dhe "Për miratimin e strukturës së re organizative të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA".

- Më datë 16.05.2023 për analizën e rezultatit financiar – teknik muaji mars 2023, për muajin prill 2023; njoftimi mban datën 11.04.2023, relacioni për muajin mars mban datën 15.04.2023, pra një ditë para mbledhjes. Ka pasur vetëm një diskutim nga A. Xh.: *lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit*. pra nuk ka pasur vendim-marrje dhe as diskutime të tjera.
- Më datë 12.06.2023 për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2022, miratimi i raportit të ecurisë së veprimtarisë për vitin 2022, në të cilin janë marrë dy vendime: Miratimin e Pasqyrave Financiare te Shoqërisë për vitin 2022 dhe Miratimin e Raportit të ecurisë së veprimtarisë 2022 të SHRUK Korçë SHA. Sipas procesverbalit të mbledhjes ka pasur vetëm një diskutim nga z. J. Gj. i cili ka vlerësuar ecurinë e treguesve.
- Më datë 30.06.2023 për relacion mbi realizimin e buxhetit të muajit maj 2023, thirrja datë 26.06.2023. Sipas Procesverbalit të mbledhjes ka pasur vetëm një diskutim nga z. J. Gj.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit. pra nuk ka pasur vendim-marrje dhe as diskutime të tjera.
- Më datë 20.07.2023 për analizë të rezultatit financiar – teknik muaji qershor 2023, dhe të rezultatit për gjashtë mujorin e parë 2023. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka pasur vetëm një diskutim nga z. J. Gj.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit, pra nuk ka pasur vendim-marrje dhe as diskutime të tjera.
- Më datë 10.08.2023, relacion mbi realizimin e buxhetit të muajit korrik 2023, si dhe miratim sponsorizimesh. Relacioni për miratimin e sponsorizimit (dhe relacioni për realizimin e buxhetit) mban datën 08.08.2023, pra datën e mbledhjes), për klubin shumë sportesh "S" Korçë në vlerën 400,000 lekë; sponsorizimin e aktivitetit "Mokra N'fest 2023" me 200,000 lekë, "Festa e birrës 2023" për 1,000,000 lekë; Festivali mbarëkombëtar i komedisë, KokoFest 2023 për 100,000 lekë, duke iu referuar ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", i ndryshuar, mbi bazën e të cilit është marrë vendimi nr.5 "Për sponsorizimin e festës së birrës 2023".

Ka pasur vetëm një diskutim nga z. J. Gj. për rezultatet e aksionit kundër paligjshmërisë, dhe ka pyetur mbi gjendjen e shoqërisë pas rajonizimit, si dhe ka cilësuar se do të mbështesë vetëm për festën e birrës.
- Më datë 27.09.2023, për miratimin e investimeve në rrjetin ujësjellës për vitin 2024; emërimin e sekretares së këshillit mbikëqyrës, miratimin e planit vjetor dhe strategjik të auditimit 2024 - 2026, analizë ecurisë së buxhetit për muajin gusht 2023. Relacioni për miratimin e investimeve të rijetëzimit të skemës së furnizimit me ujë të fshatit Podgorie, Bashkia Maliq, në vlerën 316,405,031 lekë; Kuç i zi dhe Belorta 68,340,000 lekë, Polske dhe Kuç 74,663,635. Ka diskutuar vetëm z. J. Gj.. Janë marrë vendimet për të emëruar K. D. sekretare; miratimin e investimeve; miratimin e planit vjetor dhe strategjik të auditimit 2024-2026.
- Më datë 23.10.2023 për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin shtator 2023, dhe zgjedhja e Kryetarit të Këshillit mbikëqyrës, dhe është marrë vendimi nr. 9 datë për z. J. Gj., pas dorëheqjes së z. J. Gj. dhe emërimit nga asambleja e aksionarëve të anëtarit të ri. Sipas Procesverbalit të mbledhjes ka diskutuar z. J. Gj., duke vlerësuar ecurinë dhe problematikat që mbeten në njësitë administrative, si dhe A. Xh.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësim të rezultatit
- Më datë 12.12.2023, për miratimin e Projektbuxhetit 2024 dhe planit të investimeve; miratimin e akt-marrëveshjes me konsumatorët debitorë për kategorinë privat dhe familjar; miratimin e programit të zhvillimit ekonomik 2024-2026, për të cilat janë marrë vendimet: Raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për nëntëmujorin e vitit 2023. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka pasur vetëm Miratimin e Buxhetit për vitin 2024, Miratimin e Planit të Investimeve 2024, Miratimin e Akt-Marrëveshjes me konsumatorët debitorë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA. për kategoritë Privat dhe Familjar dhe Miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik 2024 - 2026.

II. Aktiviteti i Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar gjithsej 12 mbledhje, në 7 prej tyre janë marrë 16 vendime.
- Më datë 30.01.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin dhjetor 2023, sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se ka pasur një diskutim (fjalë) nga znj. A. Xh.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit, megjithëse shoqëria rezulton me performancë negative prej - 25 milion lekë.
- Më datë 29.02.2024, për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin Janar 2024, sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se ka pasur dy diskutime: z. J. Gj., humbjet veçanërisht tek njësitë administrative priten të përmirësohen, si dhe znj. A. Xh.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit, pra njëlloj si një muaj më parë.
- Më datë 28.03.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin Shkurt 2024 dhe sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se ka pasur dy diskutime: z. J. Gj., humbjet veçanërisht tek njësitë administrative priten të përmirësohen, si dhe znj. A. Xh.: Lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit, pra njëlloj si dy muaj më parë.
- Më datë 09.04.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin mars 2024; Miratimin e skemës të re të akt-marrëveshjeve për likuidimin me këste të detyrimeve të prapambetura të klientëve debitorë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA; Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të UKRK SHA; Miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA; Dhënie ndihme punonjësit P. Q., për të cilat janë marrë vendimet përkatëse. Edhe në këtë mbledhje, sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se kanë diskutuar z. J. Gj., humbjet

veçanërisht tek njësitë administrative priten të përmirësohen, si dhe znj. A. Xh.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit, për raportin e ecurisë.
- Më datë 22.05.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin prill 2024; për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2023; Për miratimin e metodologjisë në lidhje me zbatimin e skemës së subvencionimit për kategoritë në nevojë; për miratimin e fondit të investimeve 2024 në Njësinë Maliq; relacion për shërbimin e ruajtjes së objekteve me punonjës shërbimi, sistem alarmi, kamera dhe ruajtja e shoqërimi i vlerave monetare.
Në relacionin për rishikimin e planit të miratuar të investimeve cilësohet se për rikonstruksionin e skemës së furnizimit me ujë të fshatit Podgorie ishte parashikuar 570 milion lekë dhe pas ndryshimeve në projekt nga Këshilli teknik ka rezultuar 384.4 milion lekë (M. K.), gjë që tregon mangësi planifikimi të fondit të investimeve nga ana e shoqërisë.
- Më datë 28.06.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin maj 2024 dhe miratimin e mbikëqyrjes së objektit "Investime në ujësjellësit e fshatrave Sheqeras, Plasë, Libonik, Drithas, Symiz, Pirg dhe Kolanec në Njësinë Maliq të Ujësjellës Kanalizime Rajoni Korçë".
Në këtë mbledhje është emëruar sekretare I. P., në vend të K. D..
Sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se nuk ka pasur asnjë diskutim.
- Më datë 26.07.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin qershor 2024 dhe për miratimin e raportit të ecurisë për veprimtarinë 6-mujore 2024. Sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se nuk ka pasur asnjë diskutim.
- Më datë 02.08.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin korrik 2024 dhe për miratimin e sponsorizimit për eventin "Festa e birrës 2024" (konsumi i ujit gjatë festës së birrës). Ka pasur një diskutim: znj. A. Xh.: lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet presim në vijim përmirësimin e rezultatit".
- Më datë 13.09.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin Gusht 2024, si dhe miratimin e rritjes së pagave prej 10 % për shoqërinë.
Në këtë mbledhje është marrë vendimi nr.11, për miratimin e procedurës së standardizimit të shërbimeve ndaj klientit, dokument që mban muajin janar të përgatitjes, si dhe nuk ka qenë në rendin e ditës.
- Më datës 17.10.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin shtator 2024, për periudhën 9 mujore, si dhe miratimin e raportit për ristrukturimin e stacioneve të pompimit në njësitë Maliq, Devoll, Korçë.
Në këtë mbledhje është marrë vendimi nr.13 Miratimin e fondit në lidhje me meremetimin e stacioneve të pompave në fshatrat: Kakac, Bregas, Sovjan (për Sheqerasin), Plasë Rajonal, Zvirinë (për Vreshtasin), Shëngjergj, Kishnik, Burimas, Progër dhe Trestenik, me fond gjithsej 19,845 mijë lekë që nuk ka qenë në rendin e ditës. i pa firmosur nga F. B..
- Më datë 21.11.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin tetor 2024, sipas procesverbalit të mbledhjes konstatohet se nuk ka pasur asnjë diskutim.
- Më datë 12.12.2024 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin nëntor 2024; Miratimin e projektbuxhetit për vitin 2025, si dhe planit vjetor dhe strategjik të auditimit 2025-2027, për të cilat janë marrë vendimet përkatëse.

III. Aktiviteti i Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.01.2025 deri më 30.09.2025.
Janë zhvilluar gjithsej 9 mbledhje, në 4 prej të cilave janë marrë 8 vendime.
- Më datë 27.01.2025 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin dhjetor 2024. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., nuk ka patur vendim marrje.

- Më datë 26.02.2025 për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin janar 2025. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe një pyetje A. Xh., nuk ka patur vendim marrje.
- Më datë 28.03.2025, për miratimin e raportit të ecurisë së shoqërisë për muajin shkurt 2025. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe një pyetje F. B., nuk ka patur vendim marrje.
- Më datë 24.04.2025 për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin mars 2025. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe nga një pyetje A. Xh. dhe F. B., nuk ka patur vendim marrje.
- Më datë 23.05.2025, për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin prill 2025. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe një pyetje A. Xh., nuk ka patur vendim marrje.
- Më datë 19.06.2025, për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin maj 2025; miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2024, për të cilën është marrë vendimi për miratimin e pasqyrave financiare. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe një pyetje A. Xh..
- Më datë 22.07.2025, për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin qershor 2025; relacion mbi rezultatin e 6-mujorit të parë të SHRUK Korçë. Sipas procesverbalit të mbledhjes, ka diskutuar vetëm z. J. Gj., dhe një pyetje A. Xh.. Me vendimin nr. 2, znj. E. Ç. zgjidhet Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës, me vendimin nr.3 znj. I. P. caktohet Sekretare e Këshillit Mbikëqyrës.
Sipas procesverbalit të mbledhjes z. P. T. është shprehur për zgjedhjen e kryetarit të këshillit mbikëqyrës dhe sekretarin. A. Xh. ka propozuar E. Ç., ndërsa skeretaren e ka propozuar z. P. T., I. P..
- Më datë 29.08.2025, për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin korrik 2025; rishikimi i buxhetit pas miratimit të tarifave të reja për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura; relacion mbi aprovimin e projektit Ŵatertrap; relacion mbi aprovimin e projektit SDS LeaD. Janë marrë vendimet: Për disa ndryshime në vendimin nr. 15, datë 12.12.2024 "Për miratimin e projekt buxhetit për vitin 2025" Për aprovimin e projektit Ŵatertrap me objekt "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Tren, bashkia Devoll, Shqipëri" sipas programit INTERREG IPA CBC 2021-2027 Shqipëri-Greqi dhe miratimin e fondit të bashkëfinancimit në këtë projekt; Për aprovimin e projektit "SDS LeaD" me objekt "Blerje matësa uji elektronik dhe krijimi i zonave të monitorimit (DMA-ve)" sipas programit INTERREG IPA CBC 2021-2027 Shqipëri-Greqi dhe miratimin e fondit të bashkëfinancimit në këtë projekt. Ka diskutuar E. Ç. dhe një pyetje A. Xh..
- Më datë 26.09.2025 për miratimin e raportit të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë për muajin gusht 2025; miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë; Miratimin e planit vjetor dhe strategjik 2026-2028. Janë marrë vendimet përkatëse: nr. .7, Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë, si dhe nr.8 "Për miratimin e planit vjetor 2026 dhe strategjik 2027-2028" të Auditit të brendshëm.

Nga sa më sipër Këshilli Mbikëqyrës ka ushtruar kompetencat dhe funksionet e veta mbikëqyrëse të veprimtarisë së shoqërisë, të drejtat dhe përgjegjësit lidhur me: kontrollin e mbikëqyrjen zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët; është kujdesur që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit; auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël një

herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, miratimin e planit të investimeve kapitale dhe buxhetin vjetor të shoqërisë dhe çështje të tjera.

Si konkluzion, nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA në periudhën nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, konstatohet se:

- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 12 të statutit, ku përcaktohet që: "anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në momentin e emërimit lidhin një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë në term vjetorë, indikatorë që duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes-planet e shoqërisë
- Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ushtruar të drejtat e veta për të kryer verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij; nuk ka shqyrtuar e kontrolluar librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 dhe 3/d të nenit 13 të statutit të shoqërisë.
- Pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, si dhe nuk ka bashkëlidhur një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar, për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, jo në përputhje me kërkesat e pikës 3/dh të nenit 13 të statutit të shoqërisë; Raporti i këshillit për auditimin e librave dhe regjistrave kontabël drejtuar asamblesë nuk përmban mendimin për raportin e auditimit, jo në përputhje me pikën 3/e të nenit 13 të statutit të shoqërisë.
- Plani i biznesit të shoqërisë për vitet 2024 dhe 2025, nuk është nënshkruar nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe nuk i është paraqitur AKUM-it për miratim, duke ja përcjellë për miratim Asamblesë se Përgjithshme pa shqyrtimin e miratimin e AKUM-it, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/f të nenit 13 të statutit të shoqërisë.
- Nuk ka miratuar planin e investimeve kapitale për vitin 2025, për t'ia dërguar për miratim AKUM-it në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/gj të nenit 13 të statutit të shoqërisë.
- Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë thirrur nga Administratori i shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 11 të statutit: "Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar, i cili thërret mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet", dhe me pikën 1 e 2 të nenit 14 të statutit.
- Njoftimi për thirrjen e mbledhjes nga ana e administratorit në 11 raste nga 34 gjithsej është bërë në më pak se 3 ditë, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 14 të statutit që përcakton se "Njoftimi për thirrjen e mbledhjes behet me shkrim jo më vonë se 3 ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike".
- Nga 34 mbledhje të zhvilluara gjithsej, në 50 % e tyre (pra në 17) nuk janë marrë vendime, duke i konsideruar diskutime, por në fakt në 21 mbledhje ka pasur vetëm fjalën e Kryetarit dhe të një anëtari ose nuk ka pasur fare diskutime; paraqitja e relacioneve për ecurinë e treguesve mujorë kryesisht në 10 ditshin e fundit të muajit për muajin paraardhës, si dhe mungesa e shqyrtimit me diskutime, i ka kthyer në veprimtari formale mbledhjet mujore të Këshillit Mbikëqyrës në drejtim të kontrollit e të mbikëqyrjes së zbatimit të politikave tregtare të shoqërisë nga administratori.
- Në mbledhjen e datës 10.08.2023 është marrë vendimi nr.5 "Për sponsorizimin e festës së birrës 2023" me 1,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994, i ndryshuar, pasi SHRUK Korçë është subjekt që merr financime buxhetore për investime.

b) Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimin dhe veprimtarinë e Administratorit.
Në trajtimin e këtij drejtimi të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Urdhrat e nxjerra nga Administratori;
2. Relacione të Administratorit;
3. Dokumentacion tjetër që ka të bëjë me veprimtarinë e Administratorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në referencë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 134, pika 1/c, në organet e shoqërisë aksionare është Administratori, me funksionet e administrimit, e përcaktuar kjo dhe në statutin e "Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-kanalizimeve Korçë SHA", neni 5 pika 1.

Për periudhën e auditimit 01.01.2023 deri më 30.09.2025 Administrator i shoqërisë është z. P. T., emëruar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 1 datë 12.07.2022, me pagë në vlerën 200,000 lekë bruto, si dhe riemëruar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.2, datë 19.02.2025 për një periudhë kohore prej 3 vitesh.

Nga shqyrtimi i dosjes personale të Administratorit konstatohet se plotëson kërkesat e pikës 1 të nenit 17 të statutit, pasi ka përfunduar studimet e larta universitare në degën Inxhinieri Hidroteknike; duke i bërë të mundur barazimin me diplomën "Master shkencor" dhe ka eksperiencë të gjatë pune në sektorin publik, kryesisht në ujësjellës dhe kanalizime.

Administratori disponon kontrata të rinovueshme me Asamblenë e përgjithshme: për vitin 2023 nënshkruar më datë 23.05.2023, pasi ka kaluar pothuajse gjysma e vitit; për vitin 2024 më datë 18.01.2024 dhe për vitin 2025 më datë 15.09.2025, e cila rezulton se nuk ka qenë mbi baza vjetore, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 17 të statutit.

Gjatë veprimtarisë së tij, Administratori ka nxjerrë urdhra të brendshëm dhe ka marre vendime të ndryshme për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë, lidhur me caktimin e zyrtarëve të autorizuar për prokurimet; caktimin e nëpunësit autorizues; caktimin e personit të autorizuar sipas njësive për vënien e gjobave; dhënie ndihme; emërim në detyrë; hartimin e strategjisë së riskut; për procesin e inventarizimit; marrje në punë dhe marrje në punë kohë prove; ndërprerjen e marrëdhënieve të punës; Ndryshim pozicioni e kategorie; për lëvizje paralele; rritje page; krijimin e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin; miratimi i kartës së auditit të brendshëm; miratimi i kodit etik; Miratimin e programit të sigurimit të cilësisë së Auditimit të Brendshëm; Miratimin e rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave në shtrimin e funksioneve publike; miratimin e rregulloreve për sinjalizimin; miratimin e strategjisë së riskut; ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS) dhe të menaxhimit të risqeve (GMR); ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve me investimet e kryera nga AKUM; Urdhër për ngritjen e grupit të punës për debitorët; zëvendësim administratori, drejtori, menaxheri, zyrtari etj.

Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën e audituar, Administratori i shoqërisë ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në nenin 158 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në lidhje me të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; përgatitjen dhe të nënshkrimin e bilancit vjetor, dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë, raportimin në këshill mbikëqyrës dhe Asamble për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me

rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë etj.
Gjithashtu, ka hartuar planet e biznesit dhe ia ka paraqitur këshillit mbikëqyrëse (pika 4/b, neni 17 i statutit); ka hartuar strukturën organizative dhe ia ka paraqitur për miratim Këshillit mbikëqyrës në prill të vitit 2023, në krahasim me nisjen e aktivitetit në nëntor 2022; i ka paraqitur Këshillit mbikëqyrës një herë në muaj raport për ecurinë e shoqërisë; ka paraqitur në Asamble çdo vit raportin e veprimtarisë së shoqërisë; ka raportuar në këshill mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare; nuk ka lidhur kontratat për punime civile, mallra dhe shërbime (pika 4/h, neni 17 i statutit); ka zgjedhur personelin e shoqërisë etj.

Sipas dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se rreth 76 % e aktivitetit të Administratorit ka të bëjë me menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës: emërime, marrje në punë, rritje page, punonjës definitiv, dhënie ndihme dhe ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Si konkluzion, nga auditimi i veprimtarisë së Administratorit të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA z. P. T., në periudhën e audituar nga data 1.01.2023 deri më 30.09.2025 konstatohet se:
- Nuk ka kryer të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, për të zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 95, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- Kontratat e rinovueshme me Asamblenë e përgjithshme nuk kanë qenë të gjitha mbi baza vjetore, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 17 të statutit;
- Ka hartuar me 36 muaj vonesë Rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë dhe e ka dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, sipas përcaktimeve të pikës 4/c, neni 17 i statutit;
- Nuk i ka paraqitur Këshillit mbikëqyrës brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli, në kundërshtim me kërkesat e pikës 4/d të nenit 17 të statutit;
- Nuk ka përfaqësuar dhe vepruar në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palët e treta për kontratat e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, megjithëse është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj, në kundërshtim me pikën 4/e, neni 17 i statutit.
- Nuk ka paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës planet e biznesit të shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e Lidhjes 2 të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 dhe nenit 17 të Statutit të SHRUK Korçë, si dhe nuk është paraqitur as në Asamble, në kundërshtim me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të Lidhjes 2 të vendimit të mësipërm.

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.
Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T..

2.2 Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni për periudhën janar 2023 deri më datën 30.09.2025 që ka shërbyer për hartimin, miratimin e planit të biznesit dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë (SHRUKK) si më poshtë:

- Marrëveshja për krijimin e SHRUK Korçë datë 28.06.2022;
- Urdhri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Gjurmë auditimi për proceset kryesore të veprimtarisë etj.;
- Plan biznesi të miratuar dhe me ndryshime;
- Programet ekonomiko financiare të miratuara dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit ushtrimor;
- Zbatimi i kritereve në programim, mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" etj.;
- Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.

Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK) është krijuar nga një marrëveshje specifike më datën 28.06.2022 për krijimi e një shoqërie me kapital aksionar 100% shtetëror, referuar reformës së ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

SHRUKK identifikohet me NUIS M24431001N, në zbatim të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, me dispozitat e pikës 5, të nenit 14, Ligji Nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, dhe në mbështetje të VKM nr.302, datë 11.05.2022 ku autorizohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për hyrjen në fuqi të një marrëveshje specifike të Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) dhe ka për qëllim kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ me Bashkitë Korçë, Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë përkatësisht në mbështetje dhe zbatim të Vendimeve Nr.36, datë 24.02.2022 të Këshillit Bashkiak Korçë; Nr. 37 datë 20.05.2022 të Këshillit Bashkiak Devoll; Nr. 24 datë 25.02.2022 të Këshillit Bashkiak Maliq, Nr. 25, date 02.06.2022 te Këshillit Bashkiak Pustec dhe Nr.57 date 19.05.2022 të Këshillit Bashkiak Kolonjë, pjesë e të cilës është edhe AKUM Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton se, në zbatim të VKM 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", më datën 28.06.2022 është krijuar Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA me nënshkrimin e Marrëveshjes midis shoqërive të ujësjellës kanalizimeve të Korçës, Ersekës, Maliqit, Devollit dhe Pustecit.
Konstatohet se, në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, regjistrimi pranë QKB-së është bërë më datën 31.08.2022 pra me 2 muaj vonesë, në kundërshtim me nenin 22, pika 3 germa "b" ku citohet "Personat juridikë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por në çdo rast, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë", megjithëse ushtrimi efektiv i veprimtarisë ka nisur më 01.11.2022, pra pas kryerjes së regjistrimit në QKB. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., pasi nuk ka ushtruar kompetencat e veta në përputhje me nenin 17, pika 4, germa "m" në të cilën përcaktohet: "*Administratori ekzekutiv ka këto kompetenca:* "*Kryen regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhanëve të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjeve të tjera në fuqi*".

Objekti i veprimtarisë i pasqyruar në QKB përfshin furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjen e tij, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimin dhe/ose blerjen e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, si dhe shërbimin e grumbullimit,

largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, përfshirë mirëmbajtjen e sistemeve dhe impianteve përkatëse. në përputhje me objektin e veprimtarisë të përcaktuar në statut.

Konstatohet se, planifikimi i shpenzimeve për kostot operative për kryerjen e analizave laboratorike të ujit të pijshëm, përkatësisht për blerjen e reagentëve bëhet në kushtet që laboratorët janë të pa akredituar dhe nga ana e shoqërisë nuk janë marrë masa për akreditimin e laboratorëve të ujit.
Të gjitha licencat që kanë qenë të marra nga shoqëritë e vjetra nuk janë transferuar dhe nuk janë aplikuar kërkesa të reja në institucionet përgjegjëse për rimarrjen e tyre, për rrjedhojë parashikimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e sistemeve është i pajustifikuar.
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., i cili nuk ka vepruar në përputhje me pikën 4, germa "a" të Statutit, në të cilën përcaktohet: "*Administratori ekzekutiv ka këto kompetenca: Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e përgjithsme*"

SHRUK Korçë ka kryer planifikimin e shpenzimeve për shërbimin e kalibrimit të pajisjeve por kostot e trajnimit të stafit për certifikim nuk ishin planifikuar dhe përcaktuar, edhe pse procedurat për punën laboratorike ishin të përfshira në rregulloren e brendshme. Kjo metodë e mbajtjes së të dhënave bën që rezultatet të mos jenë të besueshme dhe të mos jenë sipas standardeve kombëtare apo ndërkombëtare dhe njëkohësisht cenohet gjurmueshmëria dhe vlefshmëria e analizave, duke rritur rrezikun për vendimmarrje të papërshtatshme mbi sigurinë e ujit, rrezikun për gabime ose humbje të të dhënave dhe rrjedhimisht dobësohet efikasiteti i shërbimit laboratorik, pavarësisht se në VKM nr.379, datë 25.5.2016, neni 18 ka përcaktuar kryerjen e analizave laboratorike me metodat standarde sipas përcaktimeve ISO. Nisur nga ky fakt konstatohet se analizat laboratorike në SHRUK Korçë janë pa vlerësim konformiteti për të cilat duhet marrë akreditim i laboratorëve të ujit.

Të gjitha licencat që kanë qenë të marra nga shoqëritë e vjetra nuk janë transferuar dhe nuk janë aplikuar kërkesa të reja në institucionet përgjegjëse për rimarrjen e tyre, për rrjedhojë parashikimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e sistemeve nuk ka qenë i justifikuar.
Nga data 1 nëntor 2022, pesë njësitë ekzistuese UK Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec kanë transferuar aktivitetin e tyre ekonomik tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA. Në lidhje me vendimet e Këshillave Bashkiakë për miratimin e "Marrëveshjes për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta", datë 28.06.2022, të lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Korçë, Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë, është marrë miratimi edhe nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë nëpërmjet shkresave si më poshtë vijon:
- Shkresa Nr. 701/1 prot., datë 25.7.2022 drejtuar Këshillit Bashkiak Kolonjë,
- Shkresa Nr. 727/1 prot., datë 1.8.2022 drejtuar Këshillit Bashkiak Korçë,
- Shkresa Nr. 731/1 prot., datë 2.8.2022 drejtuar Këshillit Bashkiak Pustec,
- Shkresa Nr. 739/1 prot., datë 05.08.2022 drejtuar Këshillit Bashkiak Devoll,
- Shkresa Nr. 741/1 prot datë05.08.2022 drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq

Referuar zbatimit të VKM nr.302, datë 11.05.2022 Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", janë konstatuar shkeljet si vijon:

Konstatohet se, lidhur me strukturën e kompetencave të Përbashkëta (SKP) e krijuar sipas marrëveshjes së datës 28.06.2022 midis 5 bashkive (Korçë, Devoll, Ersekë, Maliq, Pustec) dhe me Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë (MIE), nuk është plotësuar kriteri dhe detyrimi për shprehjen e ligjshmërisë nga ana e Prefektit, në kundërshtim me nenin 10 "Hyrja në fuqi" lidhja 1, në të cilën citohet se "*Marrëveshja hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut/prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar*". Gjithashtu, SKP nuk ka bërë njoftimin brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit, tek Prefekti në kundërshtim me pikën 6, neni 14, të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar" ku citohet se SPK se "*....Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, subjekti i kompetencave të përbashkëta (SPK) njofton zyrtarisht prefektin*" .
Për sa citohet më lart konstatohet se Prefekti i Qarkut kishte marrë dijeni për krijimin e SKP-së e krijuar më datën 28.06.2022 midis 5 bashkive dhe MIE, referuar njoftimeve të bëra lidhur me Vendimet e marra nga Bashkitë për largimin e shoqërive të Ujësjellës Kanalizimeve, por jo nga vet SKP si një njësi e re e krijuar, kjo në kundërshtim me nenin 14, pika 6 të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Konstatohet se, për periudhën 2023 - 2028, plan biznesi nuk ishte hartuar dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
Referuar Lidhjes 2 të VKM nr. 302, datë 11.05.2022, si dhe Statutit të SHRUK Korçë është përcaktuar në nenin 17 -Administratori, pika 4 , germa "b": "Administratori "harton planet e biznesit të shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Mbikëqyrës për miratim", gjë e cila nuk kishte ndodhur. Veç kësaj plan biznesi nuk ishte miratuar as nga Asambleja, në kundërshtim edhe me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të lidhjes 2 ku citohet se "Asambleja e shoqërisë përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Administratori dhe miratuar paraprakisht nga Këshilli i Mbikëqyrës i shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore".
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T. si dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar, e cila nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "a" të statutit të shoqërisë në të cilën përcaktohet: "*Drejtori tregtar ka këto kompetenca: Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të shoqërisë*".

Programi vjetor ekonomik miratuar dhe parashikimi afatmesëm 2023-2025

<u>Për vitin 2023</u>
Programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Mbikëqyrjes me nr. 8, datë 7.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2023".
Konstatohet se, Programi ekonomik nuk është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga Ministria e Ekonomisë.
Programi ekonomiko financiar për vitin 2023 nuk ishte miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë në kundërshtim me pikën 1, germa a) të nenit 7 të lidhjes 2 ku citohet se "Asambleja e shoqërisë përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Administratori dhe miratuar paraprakisht nga Këshilli i Mbikëqyrës i shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe

treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore". **Për sa më sipër të gjitha shpenzimet quhen të paautorizuara për likuidim.**
Konstatohet se ky program ekonomik nuk ka miratim as nga Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës dhe është në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli II, "Përkatësisht në pikat 2 ku citohet se Administratori është përgjegjës për "Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, në strategjitë sektoriale përkatëse si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Për vitet 2024 dhe vitet 2025 dokumenti i Plan biznesit për periudhën 2024 - 2028 është miratuar me Vendimin nr. 11 datë 28.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme, por jo nga Ministria e Ekonomisë, duke u ngarkuar me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., si dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar, e cila nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "b" të statutit të shoqërisë në të cilën përcaktohet: "*Drejtori tregtar ka këto kompetenca: Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj*.".

Po kështu Programi ekonomik **<u>për vitin 2024</u>** është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 10, datë 12.12.2023 dhe me Vendimin nr.11, datë 12.12.2023 për planin e Investimeve kurse nga Asambleja e Përgjithshme miratimi ishte bërë me Vendimin nr. 8, datë 28.12.2023 dhe miratimi i programit ekonomik afatmesëm 2024 - 2026 ishte miratuar me Vendimin nr. 9, datë 28.12.2023 por përsëri pa miratimin nga Ministria e Ekonomisë. Gjatë vitit 2024 me Vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr. 6 datë 22.05.2024 "Për miratimin e metodologjisë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA, në lidhje me zbatimin e skemës së subvencionimit për kategoritë në nevojë në sektorin e ujësjellës kanalizime, sipas Udhëzimit nr.2, datë 26.03.2024" ishte miratuar dokumenti i metodologjisë për subvencionin dhe me Vendimin nr.7, datë 22.05.2024" Për miratimin e fondit të investimeve 2024, në Njësinë Maliq" ishin miratuar shpenzimet për investimet. Konstatohet se këto vendime nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe as nga Ministria e Ekonomisë, duke u ngarkuar me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., si dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar, e cila nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "a" të statutit të shoqërisë.

Për miratimin e buxhetit **<u>të vitit 2025</u>** nga ana e Këshillit Mbikëqyrës ishte i miratuar Vendimi nr. 15, datë 12.12.2024 kurse ndryshimet ishin miratuar me Vendimin nr. 4, datë 29.08.2025. Programi ekonomik fillestar që kishte të miratuar edhe buxhetin e vitit 2024 është bërë me Vendimin nr. 9, datë 27.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme. Gjithashtu konstatohet se në kuadër të zbatimit të projekteve me fondet IPA ishte marrë vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës për planifikimin dhe zbatimin e 2 projekteve përkatësisht: Vendimi nr. 5, datë 29.08.2025 "Për aprovimin e projektit ŵaertrap me objekt "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Tren, Bashkia Devoll, Shqipëri" sipas programit Interreg IPA CBC 2021-2027 Shqipëri-Greqi dhe miratimi fondi bashkëfinancimi" me vlerë 16,288,401 lekë si dhe Vendimi nr.6, datë 29.08.2025 "Për aprovimin e projektit "SDS LEAD" me objekt "Blerje matësa uji elektronik dhe krijimi i zonave të monitorimit (DMA-VE)" sipas programit INTERREG IPA CBC 2021-2027 Shqipëri-Greqi dhe miratimin e fondit të bashkëfinancimit në këtë projekt" me fond 4,265,546 lekë.
Konstatohet se të dy projektet nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe as nuk është kërkuar ndryshim i programit ekonomik si për buxhetin vjetor 2025 ashtu edhe për fondet e investimeve në buxhetin afatmesëm 2025-2027. Këto ndryshime nuk ishin pasqyruar as në

dokumentin e Plan biznesit për periudhën 2024 – 2028, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., si dhe znj. F. F.me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar, e cila nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "a" të statutit të shoqërisë

Referuar evidencave të dhëna nga SHRUK Korçë realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe planifikimi i tyre, me ndryshimet e bëra gjatë vitit, jepen si vijon:

Tabela nr. 1 Plani dhe realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve 2023 - shtator 2025

Në lekë

Nr	Emërtimi	Plan 2023	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Plan 2025	Fakt 2025
1	Të ardhura Faturimi Ujë i pijshëm	327,600,000	285,268,149	226,242,000	230,447,442	236,400,231	251,034,960
2	Të ardhura faturimi ujë i ndotur (kanalizime)	112,300,000	**101,315,439**	80,190,000	81,992,341	84,657,594	90,270,655
3	Të ardhura faturim tarifa e shërbimit	63,400,000	66,767,416	52,875,000	50,085,598	57,741,493	61,916,582
	Total të ardhura nga aktiviteti kryesor (1+2+3)	503,300,000	453,351,004	359,307,000	362,525,381	378,799,318	403,222,197
4	Të ardhura nga pikat e reja të lidhjeve	11,600,000	9,258,874	8,879,400	5,383,954	8,887,500	6,288,982
5	Te ardhura operative të tjera (shitje materiale, qira, etj)	4,550,000	4,523,330	4,137,300	3,422,619	4,162,500	4,112,402
6	Të ardhura nga investime	23,800,000	21,293,696	18,442,800	1,803,844	18,450,000	2,978,514
	Të ardhura nga prodhimi i energjisë elektrike i pa rregjistruar			7,500,000	2,809,814	7,500,000	3,847,604
	Totali I te ardhurave operative	543,250,000	488,426,904	398266500	375,945,612 -	417,799,318	420,449,698
II	**Kosto operative**			-	-	-	-
1	Kosto materiale mirëmbajtje dhe investime	(27,120,000)	(31,917,545)	(36,819,000)	(17,000,192)	(29,250,000)	(18,491,520)
2	Kosto energji elektrike + ujë	(46,830,000)	(37,005,474)	(54,117,000)	**(55,643,373)**	(60,150,000)	(50,378,306)
3	Kosto e punës	(133,850,000)	(91,577,672)	(186,687,000)	(149,226,695)	(202,500,000)	(171,008,628)
4	Kosto shërbime	(48,080,000)	(36,640,405)	(48,717,000)	(34,799,593)	(47,625,000)	(31,815,201)
5	Tarifat dhe taksa	(3,675,000)	(2,810,433)	(5,247,000)	(3,751,777)	(5,325,000)	(3,717,441)
	Total kotso operimi (pa amortizimin) (1+2+3+4+5)	(259,555,000)	(199,951,530)	(331,587,000)	(260,421,630)	(344,850,000)	(275,411,096)
III	**Fitimi operativ (te ardhura operative-kosto operative)**	283,695,000	288,475,374	66,679,500	**115,523,982**	72,949,318	145,038,603

Burimi: SHRUK Korçë, përpunuar nga Grupi i Auditimit të KLSH

Referuar tabelës rezulton se planifikimi është bërë jo mbi baza reale. Konstatohet se në disa raste totali i shpenzimeve të realizuara ishte më i lartë se fondet e planifikuara dhe anasjelltas realizimi i shpenzimeve kundrejt planifikimit ishte i ulët. Për vitin 2023 nuk është ngritur GMS i cili do të menaxhonte dhe hartonte në mënyrë reale planifikimin e nevojave dhe të fondeve si për të ardhurat edhe për shpenzimet. Në asnjë relacion nuk ishin detajuar detyrimet për palët e trete dhe nuk ishte bërë një analizë për debitorët dhe kreditorët por vetëm është bërë një analizë e planifikimit për arkëtimin e ujit pa të ardhura (UPA) gjë që e cila ngarkon me përgjegjësi nëpunësin autorizues dhe nëpunësin zbatues të SHRUK Korçë.

Gjithashtu referuar relacioneve të paraqitura për miratimin e planit të programit ekonomik rezulton se nuk ishte bërë një analizë kosto përfitim sidomos për zërat e investimeve. Po kështu planifikohen prokurime duke bërë copëtim fondi në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat

e prokurimit publik" i ndryshuar. Plani i miratuar i buxhetit në programin ekonomik për vitin 2023 është më i ulët se sa nevojat për prokurimet e shërbimeve dhe të mirëmbajtjes.
Për situatën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T., i cili nuk ka vperuar në përputhje me kërkesat e pikes 4/a të nenit 17 të statutit si dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar, e cila nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "a" të statutit të shoqërisë.

Për investimet e realizuara në vitin 2023 në relacionin e datës 06.12.2023 konstatohet se investimet ishin realizuar 37,262,970 lekë ndërkohë që në relacionin që i ishte paraqitur grupit të auditimit ishte një vlerë tjetër me shumën totale 78,382,344 lekë. Gjithashtu të dhënat që i ishin pasqyruar grupit ishin jo të sakta pasi evidenca për investimet, paraqitet në vlerën 53,370,189 lekë . Të dhënat jepen në tabelën nr. 2 dhe 3 si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Investimet e realizuara për vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Vlera me TVSH (në lekë)	Burimi i Financimit
1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujërat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan	20,559,687	UKRK
2	Asfaltim i rrugës hyrëse të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura (ITUN) pranë Impiantit Fotovoltaik Korçë	3,087,000	UKRK
3	Investime të kryera me materialet e UKRK	19,984,097	UKRK
a	Investime ne rrjetin ujësjellës njësia Korçë	44,862	
b	Investime ne rrjetin e kanalizimeve njësia Korçë	16,934,854	
c	Investime ne rrjetin ujësjellës njësia Maliq	1,296,622	
d	Investime ne rrjetin ujësjellës njësia Devoll	1,707,759	
	Total investimet e realizuara në vitin 2023 (1+2+3)	43,630,784	
4	Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në Stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në Stacionet Rajonale Plasë (Nj.A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)."	31,164,000	AKUM
5	Punime ndërtimi për rikonstruksionin e godinave të stacioneve të pompave në fshatrat Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj dhe Plasë	3,587,560	AKUM
	Total investimet e realizuara në vitin 2023 (4+5)	34,751,560	
	Totali	78,382,344	

Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit

Tabela nr.3 Investimet e planifikuara dhe të realizauara në vitin 2023

Në lekë

Programi Ekonomik investime		**Njësia Korçë**		**Njësia Maliq**		**Njësia Devoll**		**Njësia Kolonjë**		**Njësia Pustec**		**SHRUK Korçë (Rajoni)**	
Nr	Objekti	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Investime në Projekte Furnizimi me Ujë	26,500,000		1,045,000,000								1,071,500,000	-
2	Invetime ne rrjetin e kanalizime Turan Melcan	27,880,000	20,556,315									27,880,000	20,556,315

3	Asfaltimi i rruges se hyrjes ne ITUN prane impiantit Fotovoltaik Korçë	3,480,000	3,087,000									3,480,000	3,087,000
4	Mbikëqyrje dhe Kolaudim	780,000	767,240	33,500,000								34,280,000	767,240
5	St/Pompash dhe panele elektrike (rehabilitim mekanik dhe elektrik)			54,720,000	28,959,634	32,760,000						87,480,000	28,959,634
6	Zhvillim i Sistemit Skada, Stacioni i pompave Turan	72,000,000										72,000,000	-
7	Vendosje Matesash dhe Lidhje me Objektet.	18,000,000		30,000,000								48,000,000	-
8	Impiant Fotovoltaik i prodhimit te energjise elektrike	288,000,000		288,000,000								576,000,000	-
9	Makineri Pajisje	75,888,000		60,912,000		40,896,000		57,312,000		8,208,000		243,216,000	-
10	Investime per zyra ZMK dhe zyra administrative	22,000,000		60,000,000		20,000,000						102,000,000	-
	Totali me TVSH	534,528,000	24,410,555	1,572,132,000	28,959,634	93,656,000	-	57,312,000	-	8,208,000	-	2,265,836,000	53,370,189

Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

- Referuar relacioneve që i janë paraqitur Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme rezulton se nuk ishte bërë planifikim real i dietave jashtë vendit dhe Mungon planifikimi i kalendarit për udhëtimet jashtë vendit, në kundërshtim me udhëzimin nr.22 10.07.2013 "Mbi zbatimin e VKM nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" ku citohet se "...*Në çdo rast, (pra edhe në rastet kur titullari i institucionit qendror e delegon këtë kompetencë), miratimi i programit paraprak vjetor të shërbimeve jashtë vendit kryhet nga titullari në fillim të çdo viti, në përputhje me fondet e miratuara për këtë qëllim. Edhe në rastet kur gjatë zbatimit të tij ky program ndryshon, miratimi i ndryshimeve kryhet vetëm nga titullari*". Ky fakt ka sjellë rritjen e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit pasi pjesa më e madhe e blerjeve të biletave është bërë shumë afër ditës së udhëtimit dhe kjo gjë kishte rritur kostot e tyre. Për udhëtimet brenda vendit nuk ishte bërë planifikim real të bazuar në praktikën e ndjekur referuar VKM nr.997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar. Gjithashtu planifikimet për prokurimet që në hartimin e programit ekonomik ishin në mospërputhje me buxhetin e planifikuar, i hartuar pa u bazuar në nevojat reale të SHRUK Korçë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Administratori i shoqërisë z. P. T..

1. Analiza e të ardhurave

a) Të ardhura nga aktiviteti kryesor

- **Viti 2023**: Realizimi ishte **90.1%** (453.4 milion lekë fakt / 503.3 milion plan) kishte realizim të ndjeshëm, kryesisht nga faturimi i ujit të pijshëm dhe kanalizimeve.
- **Viti 2024**: Realizimi ishte **100.9% -**planifikimi jo mbi baza reale dhe të ardhurat faktike tejkalonin lehtë planin.
- **2025 (deri shtator)**: Realizimi ishte **106.4%-**përmirësim i dukshëm i arkëtimeve dhe/ose rritje e bazës së faturimit.

Për sa më lart u konstatua se në realizimin e të ardhurave në periudhën 2024–2025 kishte një tendencë pozitive të rritjes së tyre, por planifikimi ishte bërë jo mbi baza reale krahasuar me vitin 2023.

b) Të ardhura nga investime dhe energjia elektrike

- **Të ardhurat nga investime**:
  - ✓ Viti 2024: realizimi ishte rreth **10%**
  - ✓ Viti 2025: realizim ishte **rreth 16%**
- **Viti 2023** Energjia elektrike e paregjistruar saktë dhe u konstatua se realizimi ishte shumë më i ulët se plani rreth 37–51%, pra rezultoi se planifikimi ishte formal, pa baza reale kontraktuale ose teknike dhe nuk ishin mbajtur evidenca për konsumin real nga sistemi fotovoltaik.

c) Totali i të ardhurave operative

Konstatohet se për periudhën objekt auditimi (2023- shtator 2025) realizimi i të ardhurave kishte ecuri përmirësuese, por me strukturë të paqëndrueshme. Gjithashtu në relacionin e realizimit të të ardhurave në vitin 2023, nuk jepej informacion për fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si subvencion për detyrimet e pakryera nga shoqëritë e mëparshme. Të dhënat jepen në tabelën 4.

Tabela nr. 4. Të ardhurat operative për periudhën 2023 - shtator 2025

Në milion lekë

Viti	Plani i te ardhurave	Realizimi faktik	% e realizimit
2023	543.2	488.4	89.9%
2024	398.3	375.9	94.4%
2025	417.8	420.8	100.6%

Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit

2. Analiza e kostove operative (pa amortizim)

a) Analiza e kostove-

Konstatohet se në të tre vitet objekt auditimi, kostot faktike të realizuara në përqindje ishin **ndjeshëm më të ulëta se planifikimi**, përkatësisht si vijon:

- ✓ 2023: realizim **77%**
- ✓ 2024: realizim **79%**
- ✓ 2025: realizim **80%**

b) Kosto e punës

Gjithashtu konstatohet se kishte një diferencë shumë të madhe midis fondeve të Planifikuara dhe kostove faktike të kryera:

- ✓ 2023: –42 milion lekë
- ✓ 2024: –37 milion lekë
- ✓ 2025: –31 milion lekë

Konstatohet se planifikimi ka qenë jo realist bazuar në strukturën organizative si dhe se kategorizimi i pagave, me grupe sipas vjetërsisë nuk ishte përcaktuar mbi një planifikim real edhe të fondit të pagave.

3. Fitimi operativ

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se fitimi operativ, ka devijime midis planifikimeve dhe realizimeve është artificialisht i lartë, për shkak kjo nga rritja reale e performancës, por kryesisht nga nënrealizimi i kostove, dhe jo nga rritja e qëndrueshme e të ardhurave, por nga mosrealizimi i shpenzimeve, veçanërisht kostos së punës dhe shërbimeve. Në tabelën nr. 5 jepen të dhënat si vijon:

Tabela nr. 5: Plani dhe realizimi i fitimit operativ 2023 - shtator 2025

Në milion lekë

Viti	Planifikimi	Realizimi Faktik	Devijimi
2023	283.7	288.5	+4.8
2024	66.7	115.5	+48.8
2025	72.9	145.0	+72.1

Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit

Nga verifikimi i evidencave dhe informacioneve të kërkuara rezulton se plan i të ardhurave dhe i shpenzimeve në paga, kostot e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve si dhe të investimeve paraqitet sipas viteve në tabelën si vijon:

Tabela nr. 6 Plani dhe realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve 2023 - 2025 (9 mujor)

	viti 2023			viti 2024			viti 2025-9 mujor		
Të ardhurat	Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
Te ardhura nga aktiviteti kryesor	546,865,500	488,426,909	89%	535,650,000	500,337,750	93%	606,045,905	582,647,121	96%
Te ardhura financiare	77,124,000	59,057,607	77%	*15,000,000*	4,954,286	33%	15,000,000	3,847,604	26%
Te ardhura nga thesari investimet	44,841,713	42,640,647	95%	75,600,000	75,087,600	99%	61,200,000	61,200,000	100%
Totali	668,831,213	590,125,162	88%	626,250,000	580,379,636	93%	682,245,905	647,694,725	95%
Shpenzimet									
Kosto operative	200,798,000	183,505,876	91%	193,200,000	150,989,113	78%	189,800,000	144,406,901	76%
Kosto stafi	226,020,000	214,184,957	95%	249,000,000	201,038,362	81%	270,000,000	229,138,698	85%
Investime	2,265,836,000	53,370,189	2%	1,825,404,000	123,647,536	7%	1,251,203,500	70,288,452	6%
Totali	2,692,654,000	451,061,022	17%	2,267,604,000	475,675,011	21%	1,711,003,500	443,834,050	26%

Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Si konkluzion, Planifikimi financiar nuk reflekton kapacitetet reale operative të shoqërisë pasi të ardhurat nga investimet dhe energjia mbeten të parealizuara. Fitimi operativ është artificialisht i lartë, kryesisht si rezultat i nënrealizimit të shpenzimeve, veçanërisht të kostove të punës dhe shërbimeve, dhe jo si pasojë e një rritjeje të qëndrueshme të të ardhurave apo përmirësimit të performancës operative.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar.


Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.3 Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë është themeluar në zbatim të VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" përmes marrëveshjes së datës 28.06.2022 midis Bashkive Korçë, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonjë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar në SHRUKK me nr. 1 prot., datë 02.09.2022. Shoqëria funksionon e organizuar me sistemin e administrimit me dy nivele. Në statutin e shoqërisë me nr.1/1 prot., datë 02.09.2022 janë përcaktuar objekti, kapitali, organet drejtuese të shoqërisë, kompetencat e Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, drejtuesve etj.

Struktura Organizative e Shoqërisë. Asambleja e Aksionarëve me Vendim nr.1 datë 12.07.2022 ka emëruar 7 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.
Këshilli Mbikëqyrës me Vendim nr. 3 datë 27.09.2022 administruar në SHRUKK me nr. 16/5 prot., datë 27.09.2022, në vijim të relacionit të administratorit, ka miratuar me nr.16/2 datë 19.09.2022 strukturën e shoqërisë me 271 punonjës, e cila ka funksionuar deri në mars të vitit 2023. Struktura e re është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me propozim të Administratorit të Shoqërisë me Vendim nr.2 datë 11.04.2023, sipas të cilit shoqëria përbëhet nga 278 punonjës dhe me një strukturë organizative të përbërë nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës, Auditi i Brendshëm dhe Administratori i cili ka në varësi të tij Kabinetin, Task-forcën, Departamentin Tregtar dhe Departamentin Teknik, me sektorët përkatës brenda tyre.

Skema nr.1 Struktura organizative e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë



Burimi: SHRUK Korçë

Konstatohet se struktura ka në përbërjen e saj njësi pa një klasifikim specifik, sektorë apo drejtori të pa emërtuara, si më poshtë vijon:

- Njësia e auditit të brendshëm është parashikuar me një punonjës gjë e cila bie në kundërshtim VKM nr.83 date 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", si dhe nuk është përcaktuar pozicionin i punonjësit nëse bëhet fjalë për nivel ekzekutues apo drejtues në kundërshtim me parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës publike. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Shoqërisë z. P. T. i cili nuk ka vepruar sipas kërkesave të nenit 17, pika 4, germa "c", për të hartuar strukturën e organizimit të shoqërisë dhe miratuar më pas në këshill mbikëqyrës njësi të auditit të brendshëm.
- Sektori i Taskforcës me varësi nga administratori i shoqërisë, në strukturën e planifikuar është i përbërë nga 4 punonjës, një përgjegjës sektori dhe 3 specialistë, por konstatohet se gjatë periudhës nën auditim nuk është rekrutuar asnjë punonjës në këtë strukturë duke penguar funksionimin praktik të kësaj strukture, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Shoqërisë z. P. T. i cili nuk ka vepruar sipas kërkesave të nenit 17, pika 4, germa "p": "*Administratori ekzekutiv ka këto kompetenca: Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr perosnelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e perosnelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, kodin e punës, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga këshilli mbikëqyrës*"
- Drejtoria e Shitjes dhe Marrëdhënieve me Klientin sipas strukturës parashikohet një njësi me 2 punonjës, por nuk ka të përcaktuar sa janë nivel specialisti dhe sa janë nivel drejtues.
- Në Drejtorinë e ITUN është Laboratori, njësia e të cilit përbëhet nga 2 punonjës specialistë/laborantë, duke rënë në kundërshtim me parimet e organizimit funksional të strukturës, sipas të cilave njësitë organizative duhet të kenë hierarki të përshtatshme që justifikon krijimin e tyre si njësi më vete. Laboratori i Njësisë Devoll varet nga Menaxheri i Njësisë duke humbur lidhjen e drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimin midis dy laboratorëve të shoqërisë.

- Struktura parashikon sektorë për mirëmbajtjen e kanalizimeve në Njësitë Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë, kur faktikisht konstatohet se në këto njësi kanalizimet nuk janë aset dhe nuk menaxhohen nga SHRUKK, por nga bashkitë respektive. Punonjësit e punësuar në këta sektorë praktikisht përmban të njëjtat detyra si punonjësit e sektorëve të ujësjellësit. Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, struktura organizative e shoqërisë nuk parashikon një pozicion pune për rolin e Drejtuesit të Dytë Teknik.
- SHRUKK është një shoqëri që furnizon ujë për konsum publik, si dhe përpunon ujërat e ndotura, dhe në zbatim të statutit të shoqërisë, neni 18, germa "c" 1, shoqëria duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, i cili duhet të ketë përfunduar studimet e larta në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të përafërta.
- Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në strukturën organizative të SHRUKK mungon Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, funksionet përkatëse të së cilës janë shpërndarë në drejtoritë e tjera, duke mos garantuar një ndarje të qartë funksionale dhe hierarkike të shërbimeve mbështetëse. Si pasojë, funksionet mbështetëse, përfshirë personelin sanitar, shoferët, administrimin e automjeteve janë përfshirë në drejtoritë e tjera duke sjellë mungesë koordinimi dhe mangësi në administrimin e tyre.
- Gjithashtu konstatohet se, nga ana e SHRUKK numri faktik i specialistëve të punësuar është më i lartë se numri i planifikuar në strukturë konkretisht Sektori i Arkëtimit në Drejtorinë e Shitjes dhe Marrëdhënien me Klientin përbëhet nga 6 punonjës specialistë; Drejtoria Juridike përbëhet nga 7 punonjës nivel specialisti, jo përputhje me *Vendimin nr.2, datë 11.04.2023 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e strukturës së re të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë", Lidhja 2, ku parashikohet përbërja e këtyre drejtorive të organizuara në sektorë të cilët drejtohen nga Përgjegjësi i sektorit.*
Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Shoqërisë z. P. T. i cili nuk ka vepruar sipas kërkesave të nenit 17, pika 4, germa "p".

Me themelimin e shoqërisë së re është kryer transferimi i gjithë punonjësve të ish-shoqërive. Marrëdhëniet e punës janë bazuar në nenin 12 të Ligjit nr.7691 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Grupi i auditimit konstaton se janë lidhur kontrata për 276 punonjës nga 295 punonjës gjithsej që janë transferuar nga ish-shoqëritë, ndërsa për pjesën tjetër janë nxjerrë vetëm urdhra apo vendime emërimi. Gjithashtu konstatohet se, këto kontrata janë të pa protokolluara dhe të pa administruara në dosjet personale të punonjësve, në kundërshtim me Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 21 pika 1 ku citohet: "*Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë"* dhe pikën 4 "*Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit",* si dhe me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12 ku cilësohet se dokumentet zyrtare duhet të përmbajnë elementët bazë identifikues dhe formalë, të nënshkruhen nga titullari dhe të protokollohen pas firmosjes, ndërsa kopja që ruhet në sekretari siglohet nga përpiluesi dhe përgjegjësi.

Pas miratimit të strukturës së Shoqërisë, nga Këshilli Mbikëqyrës, me Urdhër nr.2 datë 31.10.2022 "Për transferimin e stafit të UK Korçë, UK Maliq, UK Bilisht, UK Kolonjë dhe UK Pustec" administratori ka urdhëruar transferimin e 291 punonjësve me të njëjtën pagesë bruto.
Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se në muajin janar figurojnë të punësuar 295 punonjës, pra 24 punonjës më tepër nga sa parashikon struktura e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe 5 punonjës më tepër nga numri i punonjësve të transferuar nga ish-shoqëritë. Gjatë periudhës 2024–2025, numri i punonjësve ka vijuar të mbetet mbi kufijtë e strukturës së miratuar, duke reflektuar mospërputhje të vazhdueshme ndërmjet strukturës organizative të miratuar dhe gjendjes faktike të punësimit.

Tabela nr. 7 Të dhëna për numrin e punonjësve sipas muajve në periudhën 2023 – shtator 2025

Numër

	janar		**shkurt**		**mars**		**prill**		**maj**		**qershor**		**korrik**		**gusht**		**shtator**		**tetor**		**nentor**		**dhjetor**	
	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
2023	271	295	271	291	271	290	271	286	278	285	278	283	278	280	278	278	278	274	278	273	278	270	278	268
2024	278	263	278	258	278	255	278	253	278	254	278	249	278	247	278	244	278	250	278	244	278	245	278	246
2025	278	245	278	244	278	243	278	242	278	246	278	244	278	247	278	249	278	250						

Burimi: Të dhëna të SHRUK Korçë të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Rregullorja e Brendshme e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Korçë. Rregullorja e Brendshme e SHRUKK është miratuar me Vendim nr. 7 datë 26.09.2025 të Këshillit Mbikëqyrës. Rregullorja ka për qëllim mirë organizimin e punës dhe raportet ndërmjet shkallëve të ndryshme hierarkike. Në këtë rregullore janë përcaktuar detyrat e çdo drejtorie, sektori dhe çdo pozicioni pune. Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se Rregullorja e funksionimit të shoqërisë është miratuar 36 muaj më vonë nga data e krijimit të saj.

Gjithashtu konstatohet se pjesë përbërëse e rregullores janë edhe 7 anekse, të cilat faktikisht janë akte nënligjore të miratuara para miratimit të saj konkretisht:

- Përshkrimet Punës (miratuar me Urdhër nr.18 datë 29.02.2024 të administratorit).
- Rregullore për përdorimin e postës dhe komunikimin elektronik (miratuar nga Administratori me nr.388 prot., datë 02.05.2025).
- Politika për menaxhimin e aseteve të teknologjisë së informacionit (miratuar nga administratori me nr. 387 prot., datë 02.05.2025).
- Rregullat e Sigurisë Teknike (miratuar me Urdhër të Administratorit nr.126 datë 04.09.2025).
- Kodi i Etikës (miratuar me Urdhër të Administratorit nr.95 datë 15.12.2023).
- Procedura për përdorimin e aktiveve afatshkurtra (miratuar nga Drejtori Tregtar dhe Administratori i shoqërisë më datë 04.01.2023).
- Rregulla dhe procedura për përdorimin e aktiveve (miratuar me Urdhër të Administratorit nr.2 datë 04.01.2023).

Këto dokumente nuk mund të trajtohen si anekse të Rregullores, pasi nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga parimet e hierarkisë së akteve, një aneks konsiderohet pjesë përbërëse e aktit kryesor vetëm nëse miratohet njëkohësisht me të, ose kur miratohet posaçërisht në funksion të tij dhe formalizohet me të njëjtat elemente procedurale. Dokumentet e mësipërme janë akte autonome nënligjore, të miratuara në periudha dhe kontekste të ndryshme, me qëllime dhe fusha veprimi të

veçanta për këtë arsye, ato nuk mund të konsiderohen anekse të Rregullores së Brendshme. Përfshirja e tyre si anekse të një akti të mëvonshëm mund të krijojë konfuzion juridik dhe bie ndesh me Kodin e Procedurave Administrative.

Në lidhje me "*Përshkrimet e Punës"*, ato janë të miratuara me Urdhër të Administratorit nr.18, datë 29.02.2024, pasi janë hartuar për të gjitha pozicionet e punës sipas strukturës të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
Nga verifikimi i dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se për pozicionet e punës: Audit i Brendshëm, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit për të Ardhurat, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit për Shpenzimet, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Buxhetor, Specialist për Protokollin, Specialist për Arkivin dhe Operator Sistemi në ZKM nuk është përcaktuar rubrika "*Kualifikimet e Nevojshme"*.

Për pozicionin Drejtor i Departamentit Teknik, në rubrikën *"Kualifikimet e Nevojshme"* nga ana e SHRUKK është vendosur si kriter i nevojshëm që të ketë mbaruar studimet universitare në Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Hidroteknike, Mekanike, Elektrike ose të ngjashme duke mos u specifikuar që duhet të zotërojë Master Shkencor gjë e cila është në mospërputhje me Statutin e Shoqërisë Neni 18, germa a) e pikës 1 ku citohet se "*Drejtori Teknik duhet të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë Master shkencor në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike dhe shkenca të ngjashme',* Gjithashtu në kundërshtim me germën "ç" të këtij neni nuk është vendosur kriteri ku theksohet se: "*ç) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mos pajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij".* Për sa më sipër konstatohet se Drejtori Teknik aktual i emëruar më datë 06.01.2025, znj. M. K. plotëson kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr.18 datë 29.02.2024 të administratorit (Përshkrimi i punës), por në mospërputhje me Statutin e Shoqërisë pasi nuk zotëron Certifikatë të Aftësimit Profesional, duke ngarkuar me përgjegjësi Administratorin e Shoqërisë z. P. T..

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se përshkrimet e punës janë të njëjta për pozicione punë të barabarta, duke pasqyruar objektiva dhe detyra të përgjithshme, por nuk reflektojnë ndarje reale të detyrave dhe përgjegjësive.

Administratori i SHRUKK me Urdhër nr. 7 datë 05.01.2023 "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave" ka caktuar Autoritetin Përgjegjës dhe me Urdhrin nr. 8, datë 05.01.2023, ka miratuar Rregulloren "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA" me qëllim garantimin e një vendim-marrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA.
Sipas nenit 4 të rregullores, "zyrtar" konsiderohet çdo person që ushtron funksione publike në shoqëri, ndërsa "epror i zyrtarit" janë, sipas hierarkisë, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit dhe Menaxheri/Përgjegjësi i Sektorit.

Neni 5 i Rregullores përcakton norma të detyrueshme për zyrtarët e SHRUKK, personat me kompetenca vendimmarrëse, si dhe personat e lidhur, në përputhje me Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe Statutin e Shoqërisë.
Neni 11 i *Rregullores "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA",* parashikon detyrimin e zyrtarëve të Shoqërisë që të plotësojnë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar. Modeli i këtij autorizimi është miratuar në Aneksin nr. 1 të rregullores.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se ky autorizim është plotësuar vetëm nga administratori. Zyrtarët e tjerë të SHRUKK SHA nuk kanë plotësuar Autorizimin sipas Aneksit nr.1 të Rregullores "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
Gjithashtu konstatohet se kundërshtim me nenin 13 të Rregullores, Autoriteti Përgjegjës nuk ka shpërndarë autorizimet e detyrueshme nga zyrtarët e SHRUKK SHA, sipas nenit 10 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 dhe nenit 11 të Rregullores, nuk ka mbledhur të dhëna për konfliktin e interesit dhe nuk ka kryer verifikime mbi konfliktin e interesit. Konstatohet se nuk ka evidentuar të dhëna mbi ekzistencën ose jo të konfliktit të interesit (në dukje apo faktik), në të gjitha nivelet e hierarkisë së SHRUK Korçë, duke ngarkuar me përgjegjësi Administratorin e Shoqërisë z. P. T..

Rekrutimet e Stafit të SHRUKK. Në periudhën Janar 2023-Shtator 2025 janë rekrutuar 52 punonjës, nga të cilët 7 punonjës janë rekrutuar në vitin 2023, 22 punonjës janë rekrutuar në vitin 2024 dhe 23 punonjës janë rekrutuar në vitin 2025.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se asnjë nga rekrutimet nuk është kryer sipas procedurës e cila fillon me shpalljen e pozicioneve të lira dhe publikimin në faqen e ŵeb-it të Shoqërisë apo në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për konkurrim si edhe dokumentacioni i mbajtur nga komisioni për vlerësimin e dokumentacionit dhe kritereve të punësimit deri në shpalljen e fituesit etj. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 5 të Kodit të Procedurave Administrative (Parimi i Transparencës Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të).
Gjithashtu konstatohet se gjatë periudhës nën auditim të gjitha kërkesat për punësim janë të pa protokolluara, në kundërshtim kjo me Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (neni 8). Këtyre kërkesave ju mungojnë elementet e vërtetësisë e për më tepër administrohen kërkesa vetëm nga kandidatë fitues gjë që krijon dyshimin se kërkesat kanë qenë formale.
- Në vitin 2024 janë plotësuar formularë interviste për personat të cilët janë punësuar pranë SHRUKK. Formularët nuk janë të nënshkruar nga palët, nuk kanë të shënuar kush janë intervistuesit, nuk pasqyrojnë çfarë është komunikuar gjatë procesit si dhe janë të pa protokolluara, veprime këto në kundërshtim me nenin 18 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë .

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në vitin 2023 janë rekrutuar 7 punonjës për të cilët nga verifikimi rezulton se nuk janë lidhur kontrata individuale pune, por janë

punësuar vetëm me urdhrin ose vendimin e administratorit për periudhën e provës dhe kontratat janë nënshkruar vetëm pas përfundimit të periudhës së provës. Mos lidhja e kontratës individuale të punës për punonjësit në periudhë prove është në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë (neni 11, 12 dhe neni 21, pika 4 sipas të cilës*: Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit).*

Në vitin 2024 janë rekrutuar 22 punonjës nga të cilët, 1 punonjës është i përkohshëm, 18 punonjës janë emëruar në periudhë prove dhe 3 punonjës janë emëruar në mënyrë definitive. Nga verifikimi rezulton se kontrata individuale të punës janë lidhur vetëm për punonjësin e emëruar si të përkohshëm dhe ata në mënyrë definitive gjithashtu nuk ka argumentim pse 3 punonjës janë emëruar në mënyrë definitive pa kaluar periudhën e provës, kjo në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë Neni 142 pika 1 Koha e provës ku thuhet "*Konsiderohet si kohë prove 3 muajt e parë të punës, me përjashtim të rasteve kur palët kanë lidhur një kontratë për kryerjen e së njëjtës pune".*
Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Shoqërisë z. P. T..

Administrimi i dosjeve të personelit. Gjatë auditimit me përzgjedhje të dosjeve të personelit konstatohet se në 16 raste, dosja nuk përmban inventar të dosjes, dosjet e tjera përmbajnë inventarë të pa firmosur nga punonjësit, në 6 raste nuk administrohet dëshmia e penalitetit, në 25 raste mungon certifikata familjare, në 5 raste mungon kontrata dhe emërimi aktual në vendin e punës. Në dosje mungojnë edhe dokumente si librezat e punës, raporte të rifreskuara të aftësisë për punë. Në të gjitha rastet nuk administrohen në dosje dokumentet e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, urdhrat e transferimit si dhe Kontratat me SHRUKK deri më 30.04.2024. Në dosjen personale të administratorit të shoqërisë diploma universitare është administruar fotokopje e pa noterizuar, nuk administrohet Inventari dhe fleta prezantuese e dosjes, lista e notave, certifikata personale dhe familjare, dëshmi penaliteti dhe raport mjekësor, në kundërshtim me VKM nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të regjistrit qendror të personelit", lidhja 2.

Trajnimi i punonjësve të SHRUKK. Në lidhje me trajnimin e punonjësve të SHRUKK referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se gjatë vitit 2023 nuk janë kryer trajnime me qëllim rritjen profesionale të stafit kurse gjatë vitit 2024 dhe 2025 janë kryer respektivisht 9 dhe 23 trajnime.. Lidhur me rritjen profesionale të stafit nëpërmjet shkresës nr.177 prot., datë 21.02.2025 është kërkuar nga Drejtori Tregtar të paraqiten brenda datës 07.03.2025 nevojat për trajnim nga gjithsecila drejtori, megjithatë konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është hartuar një plan trajnimesh që të përfshijë të gjithë punonjësit e SHRUKK, veprim ky në kundërshtim më Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhër nr. 4 datë 26.01.2024 të Ministrisë së Financave, në të cilin thuhet se *Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat përkatëse përfshijnë zbatimin e një sistemi trajnimi dhe kualifikimi që synon përgatitjen e punonjësve për përmbushjen e detyrave në nivelin e kërkuar.*

Në lidhje me punonjësit e mirëmbajtjes dhe shërbimit të kanalizimeve duhet të jenë të instruktuar për rregullat e sigurisë në punë. Punonjësit e sektorit të prodhimit dhe rezervimit të ujit, që bëjnë veprime operative në impiantet elektrike duhet të kenë kualifikim të grupit të tretë e lartë të sigurimit teknik. Punonjësit e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura para se të nisin punën në këtë sektor, para se të fillojnë punën duhet të trajnohen dhe ti nënshtrohet trajnimit për Rregulloren

e Shfrytëzimit Teknik, Teknikës së Sigurimit, Njohuritë mbi shfrytëzimin e pajisjeve. Ata testohen të paktën një herë në vit nga një komision në drejtimin e të cilit janë 2 vetë.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se punonjësit e sektorit të kanalizimeve janë trajnuar 1 herë në vit nga drejtuesi i njësisë si dhe nuk është ngritur komisioni i marrjes në testim, nga ana e administratorit, kjo në kundërshtim me Rregulloren e Sigurisë Teknike (miratuar me urdhër të administratorit nr.126 datë 04.09.2025) Kapitulli 2, pika 19 faqe 20 ku thuhet: *Përgjegjësi i sektorit çdo muaj bën instruktimin e punonjësve, duke lexuar dhe shpjeguar këtë rregullore, ai hap regjistrin ku firmosin punonjësit e tij. Punonjësi një herë në vit del në provë për njohuritë mbi sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, para një komisioni të miratuar nga titullari i shoqërisë. Dalja në provë është e detyrueshme për çdo punonjës* .

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion punonjësit e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të ndotura, janë trajnuar një herë në vit, Punonjësit nuk janë testuar nga një komision i ngritur nga titullari, veprim ky në kundërshtim me Rregulloren e Sigurisë Teknike (miratuar me urdhër të administratorit nr.126 datë 04.09.2025) Kapitulli 8 faqe 33 ku thuhet: *Provimi i përgatitjes teknike të punonjësve bëhet me komision, në drejtimin e të cilit duhet të ketë jo më pak 2 vetë.*
Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se punonjësit e sektorit të prodhimit dhe magazinimit të ujit nuk disponojnë kualifikim të sigurimit teknik sipas Rregullores se Sigurisë Teknike (miratuar me urdhër të administratorit nr.126, datë 04.09.2025), kapitulli 3.8 faqe 25 ku thuhet "*Personeli që kryen shërbim operativ duhet të kenë kualifikim të grupit të tretë e lartë të sigurimit teknik".*

Vlerësimi i performancës së Punonjësve. Vlerësimi i performancës përbën një instrument thelbësor për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, duke nxitur zhvillimin profesional të punonjësve, identifikuar nevojat për trajnim dhe krijimin e mundësive për ngritje të merituar në detyrë. Administratori i SHRUKK ka nënshkruar kontratë performance me Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorët e Drejtorive. Gjithashtu me nr. 181 prot., datë 24.02.2025 Administratori i SHRUK SHA ka miratuar "Procedurë për vlerësimin periodik të performancës së punonjësve". Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se, Kontratat e Performancës se Drejtorëve të Drejtorive janë në mospërputhje linjën e hierarkisë sipas strukturës së shoqërisë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe me Përshkrimet e Punës të miratuara nga vetë administratori. Sipas kontratave të performancës linja e raportimit është vertikale, drejtorët raportojnë direkt tek administratori i shoqërisë kjo në kundërshtim me strukturën, rregulloren e brendshme dhe përshkrimet e punës, në të cilat linja e raportimit kalon nga drejtorët e departamenteve duke krijuar mbivendosje të përgjegjësive. Gjithashtu konstatohet se lidhur me këto kontrata nuk është bërë një vlerësim periodik mbi arritjen e objektivave të gjithsecilit.
Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se edhe pse është miratuar procedura për vlerësimin periodik të punonjësve faktikisht nuk është kryer vlerësimi 6-mujor apo vjetor i punonjësve të shoqërisë. Këto veprime bien në kundërshtim me Parimin 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit sipas të cilit *Titullari/NA/Menaxheri i njësisë publike duhet të zhvillojë dhe të realizojë procedurat e mëposhtme: Mbikëqyrja- Të japë reagime mbi performancën individuale, bazuar në rregullat e etikës dhe realizimin e kompetencave, të harmonizojë aftësitë individuale me objektivat e njësisë publike dhe të ndihmojë personelin të përshtatet në mjedisin në zhvillim të njësisë.*

Procedurat disiplinore. Masat disiplinore përfaqësojnë një mekanizëm të domosdoshëm për garantimin e respektimit të rregullave, etikës dhe detyrimeve në marrëdhëniet e punës. Zbatimi i masave disiplinore kontribuon në ruajtjen e disiplinës, rendit dhe funksionimit normal të institucionit. Në zbatim të nenit 37 të Kodit të Punës: *Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës, ndërsa kontrata individuale duhet t'u referohet akteve përkatëse. Procedura e shqyrtimit nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur fakte e prova, brenda një afati të arsyeshëm*. Duke qenë se Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë nuk ka Kontratë Kolektive të Punës, masat disiplinore detajohen në Kontratën Individuale të Punës kjo në zbatim të Nenit 21 pika 3 germa h të Kodit të Punës ku citohet: *Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos: llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive;*

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në konstatohet se gjatë periudhës nën auditim ka pasur 5 procedura disiplinore nga të cilat 4 raste në vitin 2024 dhe 1 rast në vitin 2025, të cilat kanë përfunduar të gjitha me masën "Vërejtje dhe paralajmërim për largim nga puna". Në lidhje me këto masa nuk është ndjekur një procedurë e unifikuar për trajtimin dhe dhënien e masave disiplinore. Në disa raste punonjësit janë thirrur në takim nga eprori direkt dhe më pas i është propozuar administratorit dhënia e masës disiplinore, dhe në një rast është organizuar takimi nga vetë administratori, kjo në kundërshtim me Nenin 41 të Kontratës Individuale të Punës-*Procedura e masës disiplinore* ku thuhet: *Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t'u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm.*
Gjithashtu konstatohet se në përfundim të të gjitha procedurave disiplinore është dhënë masë disiplinore e njëjtë, duke mos ruajtur proporcionalitetin e shkeljes në raport me masën e dhënë. Kontrata individuale e punonjësit në nenet 39,40,41 dhe 42 ku trajtohen shkeljet disiplinore nuk parashikon një ndarje të qartë të shkeljes disiplinore dhe masës së dhënë për secilën prej tyre, duke krijuar mundësinë e trajtimit me subjektivitet. Masat disiplinore nuk janë të pasqyruara në një regjistër apo në librezën e punës së punonjësit.

Largimet nga puna. Gjatë periudhës nën auditim kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me SHRUKK, 100 punonjës konkretisht në vitin 2023 janë larguar 39 punonjës, nga të cilët 20 kanë arritur moshën e pensionit, 17 kanë dhënë dorëheqje dhe 2 punonjës janë larguar me procedurë. Në vitin 2024 janë larguar 40 punonjës nga të cilët 13 kanë arritur moshën e pensionit, 14 kanë dhënë dorëheqje, 12 punonjës janë larguar me procedurë dhe një ndarje nga jeta. Në vitin 2025 janë larguar 23 punonjës nga të cilët 13 dalje në pension, 9 kanë dhënë dorëheqje, dhe një mbarim kontrate.
Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se punonjësve që janë larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë nuk ju është ofruar një vend tjetër i barabartë apo i përafërt në të gjithë shoqërinë, por vetëm brenda njësisë ku ata ushtronin detyrën e tyre, duke theksuar këtu se gjatë kësaj periudhe janë rekrutuar punonjës të rinj në pozicione të përafërta dhe më të njëjtin nivel arsimor, në kundërshtim me nenin 149/2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Pozicionet e punës vakante. Plotësimi i pozicioneve të punës përbën një element kyç në mirëfunksionimin e institucionit, duke siguruar shpërndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësive.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion gjatë periudhës nën auditim konstatohen 32 pozicione pune vakante, konkretisht 3 pozicione vakante ne nivel *"Drejtor",* 9 pozicione *"Përgjegjës Sektori"*, 12 pozicione *"Specialist"*, 3 pozicione të lira *"Teknik"*, 4 pozicione *"Operator"* dhe 1 pozicion "*Sanitar".*
Këto vakanca, veçanërisht ato të pozicioneve *"Drejtor"* apo "*Përgjegjës Sektori*" të cilat konstatohen se kanë qenë vakante për një kohë të gjatë, ka sjellë vështirësi në organizimin e punës dhe njësi strukturore jofunksionale, duke ngarkuar me përgjegjësi Administratorin e Shoqërisë z. P. T..

Proceset gjyqësore për marrëdhëniet e punës. Gjatë periudhës nën auditim, referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se SHRUKK ka vetëm një proces gjyqësor, në lidhje me mosnjohjen e vjetërsisë për punonjësin Xh. G.në momentin e largimit nga puna. Lidhur me këtë çështje SHRUKK ka humbur çështjen duke u penalizuar me shpenzime gjyqësore në vlerën 63,260 lekë dhe 28,800 shpenzime përmbarimore, gjithsej në shumën ***92,060 lekë e cila përbën efekt financiar negativ*** në buxhetin e shoqërisë.

Niveli i pagave të punonjësve të SHRUKK. Pagat e punonjësve të SHRUKK janë përcaktuar me Vendimin nr. 2 datë 09.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar me vendim nr.12 datë 13.09.2024. Në periudhën Janar 2023 - Prill 2024 paga e punonjësve të SHRUKK ka qenë e pandryshuar, kjo në zbatim të pikës 2 të Vendimit nr. 3 datë 27.09.2022 "Për miratimin e strukturës të organizimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA".
Vendimi nr.2 datë 09.04.2024 "Për miratimin e nivelit të paga të punonjësve të Shoqërisë" parashikon 3 nivele page për gjithsecilin pozicion pune. Sipas relacionit të administratorit nr.240/3 datë 05.04.2024 niveli i pagës për secilin punonjës do të vendoset në bazë të performancës në punë dhe eksperiencës. Kategoria *a (e ulët)* për punonjësit me 0 deri 5 vite eksperiencë pune, kategoria *b (e mesme)* për punonjësit me eksperiencë pune 5 deri në 10 vite dhe *kategoria c (e lartë)* për punonjësit me më shumë së 10 vite eksperiencë. Vlerësim performance në periudhën 2023-2024 nuk ka pasur, rrjedhimisht niveli i pagës është vendosur në bazë të eksperiencës në punë. Në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit, nuk është bërë unifikimi i pagave për punonjësit, të cilët kanë pozicione të barabarta por paga të ndryshme. Punonjësit që vijnë nga ish-UKKO janë trajtuar me pagat që trajtoheshin para themelimit të shoqërisë së re, punonjësit që vijnë nga ish-shoqëritë Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec janë trajtuar në shumicën e rasteve me pagë të kategorisë a (e ulët), vetëm në 5 raste është vendosur pagë e kategorisë b (e mesme). Nga ana e SHRUKK konstatohet se nuk është bërë një analizë lidhur me kriteret që përmbush dhe kategorinë e pagës që duhet të ketë gjithsecili punonjës, <u>duke diskriminuar kështu punonjësit që nuk vijnë nga ish-UKKO</u> kjo në kundërshtim me Nenin 115 *Barazia në shpërblim* i Kodit të Punës, Nenin 17 *Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit,* të Kodit të Procedurave Administrative, Neni 9 *Ndalimi i Diskriminimit,* i Kodit të Punës dhe me Nenin 12 të Ligjit nr.10221 datë 04.02.2010, i ndryshuar, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
Procedura e ndryshimit të kategorisë së pagës (a, b, c), referuar komunikimit me punonjës të SHRUKK kryhet në momentin kur kalon kufirin e vjetërsisë në punë ose në rastin kur, me kërkesë të punonjësit, kryhet vlerësimi i performancës në punë. Në vijim të këtij vlerësimi merret vendimi përkatës për rritjen pagës.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion niveli i pagave në SHRUKK është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, gjë që bie në kundërshtim me ligjin nr. 35/2023 "Për

Kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", neni 6, ku shprehet: *Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, sipas përkatësisë: a) Kuvendi; b) Këshilli i Ministrave; c) këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore; ç) organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale; d) organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror; dh) organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera, të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit, dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit, organizimit dhe funksionimit të tyre.*

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se janë miratuar 37 rritje page, të gjitha të bazuara në kërkesa individuale nga të cilat konstatohet se 7 prej tyre janë në periudhën Janar 2023 - Prill 2024, para se të miratohej Vendimi nr. 2 datë 09.04.2024 "Për miratimin e nivelit të paga të punonjësve të Shoqërisë" i Këshillit Mbikëqyrës, gjë që bie në kundërshtim me Vendimin nr.3 të Këshillit Mbikëqyrës datë 27.09.2022 pika 3 ku thuhet: *Pagat mujore bruto të punonjësve të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, gjatë procesit të ristrukturimit do të jenë të pandryshuara me pagat ekzistuese të punonjësve të Shoqërive UK-Korçë SHA, UK-Devoll SHA, UK-Kolonjë SHA, UK Maliq SHA, UK Pustec SHA.*
Gjatë periudhës Prill 2024- Shtator 2025 janë miratuar 29 Urdhra "Për rritje Page" nga të cilat 14 plotësojnë kriteret, 6 urdhra nuk plotësojnë kriterin e eksperiencës dhe në 9 raste duhet të ishte bërë kalimi nga kategoria a (e ulët) në kategorinë c (e lartë) sepse punonjësi ka më shumë se 10 vite eksperiencë pune, duke ngarkuar me përgjegjësi znj F. F.me detyrë Drejtore e Departamentit Tregtar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.
Në të gjitha rastet procedura për rritjen e pagës ka nisur me kërkesë nga punonjësi. Nga ana e SHRUKK, kërkesat e administruara në të gjitha rastet janë protokolluar dhe janë miratuar brenda ditës ose brenda një afati një ditor, si dhe kanë qenë kërkesa të bëra nga disa punonjës brenda të njëjtës ditë, gjë që krijon dyshimin se kërkesat mund të jenë paraqitur vetëm formalisht, për të justifikuar vendim-marrjen.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion në muajin shtator 2025 numri i punonjësve me vjetërsi nga 0 – 5 vite eksperiencë punë është 59 punonjës. Nga të cilët 47 punonjës trajtohen me pagë të kategorisë a (e ulët). 11 punonjës trajtohen me pagë të kategorisë b (e mesme) dhe 1 punonjës trajtohet me kategorinë c (e lartë).
Numri i punonjësve me eksperiencë pune 6-10 vite është 73 punonjës nga të cilët: 55 punonjës trajtohen me pagë të Kategorisë a (e ulët), 9 punonjës trajtohen me pagë të kategorisë b (e mesme) dhe 9 punonjës trajtohen me pagë të kategorisë c (e lartë).
Punonjës me më shumë së 10 vite eksperiencë pune janë 117 punonjës nga të cilët 54 punonjës trajtohen me pagë të kategorisë a (e ulët), 22 punonjës trajtohen me page të kategorisë b (e mesme) dhe 41 punonjës me pagë të kategorisë c (e lartë).

Për sa më sipër konstatohet se në kundërshtim me Vendimin nr.2 datë 09.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar me Vendim nr.12 datë 13.09.2024 nuk është bërë caktimi i nivelit të pagës bazuar në përvojën në punë. Gjithashtu nuk është kryer kalimi nga një nivel në tjetrin me përmbushjen e viteve të përcaktuara për vjetërsinë.

Në lidhje me shpërblimet e dhëna gjatë periudhës nën auditim, janë dhënë 36 raste shpërblimi me motivacioni 1 rast Dhënie Ndihme nga fondi i veçantë për rast fatkeqësie dhe 35 raste Shpërblim me rastin e daljes në pension për të cilat janë përllogaritur sipas legjislacioni në fuqi.
Në rastin e daljes në pension referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion përfitues nuk kanë qenë të gjithë punonjësit, por vetëm ata të cilët kanë depozituar kërkesë.

Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Shoqërisë z. P. T..

Për sa i përket dokumentacionit të listë-pagesave mujore të pagave në të pasqyrohen elementet që shërbejnë për llogaritjen e pagës bruto dhe pagës neto mujore, me qëllim gjenerimin e pagës neto mujore në llogarinë rrjedhëse të të punësuarit, si dhe kryerjen nga punëdhënësi të pagesave të detyrimeve përkatëse (mbajtjeve) për llogari të buxhetit të shtetit.

Listë-pagesat mujore janë hartuar në përputhje me rubrikat e miratuara në Udhëzimin nr.1 datë 21.05.2021 "Për formën, elementët dhe plotësimin e listë-pagesës mujore të pagave dhe të urdhër-shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Nga auditimi i listë-pagesave konstatohet se në rubrikën "*Nëpunësi Autorizues*" janë nënshkruar sipas rastit nga administratori ose nga Drejtori i Departamentit Tregtar. Nënshkrimi i listë-pagesave nga Drejtori i Departamentit Tregtar është kryer, sipas autorizimeve të delegimit të miratuara nga administratori ku lejohet Znj. F. F. të firmosë transfertat për secilën bankë, por këto delegime janë hartuar pa afat të përcaktuar kohor në mospërputhje më Udhëzimin nr.4 datë 29.01.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe të detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Gjithashtu bashkëlidhur dokumentacionit të listë-pagesave nuk janë administruar dokumente origjinalë të Urdhër emërimeve apo largimeve të punonjësve. Gjithashtu, bashkëlidhur dokumentacionit të listë-pagesave janë administruar vetëm listë-prezencat e drejtorive përkatëse nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore nuk është hartuar një listë-prezencë totale mujore, e përmbledhur dhe e unifikuar, e cila të pasqyrojë të gjithë punonjësit sipas Regjistrit Themeltar të Personelit.

Kompensimi ushqimor. Kompensimi ushqimor është një e drejtë që i njihet punëmarrësit në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore" dhe në pikën 1 përcakton kushtet kur punëmarrësi e përfiton këtë të drejtë. Konkretisht: *"Punëdhënësit, të cilët, për arsye të kushteve apo të organizimit të punës, nuk mund të sigurojnë lokal për ngrënie, me kushte higjienike të pranueshme (sipas lejes së punës, dhënë nga Inspektorati Shtetëror i Punës), duhet t'i shpërblejnë punëmarrësit për ushqimin që konsumohet gjatë pushimit në ndërmarrje. Masa e shpërblimit është e barabartë me diferencën e çmimit të ushqimit, kur ushqimi përgatitet nga i punësuari ose në kuzhina të përbashkëta me çmimet me pakicë në restorante".*

Kompensimi ushqimor për punonjësit e SHRUKK është kërkuar nga ana e administratorit të shoqërisë z. P. T. në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës në datën 22.10.2022 gjë e cila është kundërshtuar nga ana e këshillit dhe në procesverbalit e mbledhjes theksohet se do të caktohet në kontratën e punës. Përfitimi i kompensimit ushqimor për punonjësit e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Korçë është miratuar në Shtator 2024. Me vendim nr.12 datë 13.09.2024 Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë ka miratuar rritjen e pagës në kufirin 10% për të gjithë punonjësit e Shoqërisë. Me urdhër nr.307 datë 24.09.2024 "Për zbatimin e vendimit nr.12, nr.761/5 prot., të Këshillit Mbikëqyrës "Për rritjen e pagave në masën 10% për punonjësit e Shoqërisë Rajonale të

Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA" administratori në pikën 2 të këtij urdhri, në ndryshim nga vendimi i Këshillit Mbikëqyrës ka urdhëruar edhe kompensimin ushqimor për punonjësit në masën 200 lekë/ditë, kjo pa u miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe pa pasur leje nga Inspektorati Shtetëror i Punës, në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr.68 datë 07.12.2018 ku përcaktohet *Punëdhënësit, të cilët, për arsye të kushteve apo të organizimit të punës, nuk mund të sigurojnë lokal për ngrënie, me kushte higjienike të pranueshme (sipas lejes së punës, dhënë nga Inspektorati Shtetëror i Punës), duhet t'i shpërblejnë punëmarrësit për ushqimin që konsumohet gjatë pushimit në ndërmarrje. Masa e shpërblimit është e barabartë me diferencën e çmimit të ushqimit, kur ushqimi përgatitet nga i punësuari ose në kuzhina të përbashkëta me çmimet me pakicë në restorante*.

Referuar dokumentacionit të Kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se:
- Gjatë periudhës nën auditim pagesa e kompensimit ushqimit për periudhën Janar 2023 -Tetor 2024 si pjesë e pagës bruto vetëm për punonjësit e transferuar nga ish-shoqëria UKKO, kjo në zbatim të vendimit nr.5 datë 10.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të ish-UKKO janë trajtuar me vlerën 200 lekë/ditë pune për kompensimin e ushqimit. Ky arsyetim ka sjellë që kompensimi ushqimor të përfitohet vetëm nga 125 punonjës nga 295 punonjës që kishte shoqëria në muajin Janar 2023.
- Në periudhën Janar 2023- Tetor 2024 (momenti kur u miratua kompensimi për të gjithë punonjësit) janë rekrutuar 22 punonjës nga të cilët 4 prej tyre nuk përfitojnë kompensim ushqimor. (*shembull:* Nëse një punonjës është rekrutuar në administratën e SHRUKK apo në Njësinë Korçë e ka përfituar të drejtën e kompensimit të ushqimit, ndërsa nëse një punonjës do të rekrutohej në Njësitë e ish shoqërive Maliq, Devoll, Kolonjë apo Pustec nuk e përfiton të drejtën e kompensimit ushqimor.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin. 115 -të Kodit të Punës (*Barazia në shpërblim), Nenin 17 (Parimi i Barazisë dhe mosdiskriminimit) të Kodit të Procedurave Administrative dhe me nenin 12 (Ndalimi i diskriminimit) të Ligjit nr.10221 datë 04.02.2010, i ndryshuar, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"*.
Në periudhën Tetor 2024- 30 Shtator 2025 të gjithë punonjësit e SHRUKK janë përfitues të pagesës për kompensimin e ushqimit. Kompensimi për ushqimin nuk mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e pagës bruto, sepse *Paga* sipas nenit 111 të Kodit të Punës është një shpërblim i qëndrueshëm dhe i garantuar që i takon punonjësit pavarësisht nëse gjendet apo jo fizikisht në vendin e punës. Ndryshe nga kjo, kompensimi ushqimor është një pagesë me karakter kompensues i cili jepet vetëm nëse punonjësi është i pranishëm fizikisht në punë dhe ndërpritet në rast të çdo mungese.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit janë konstatuar parregullsi në mënyrën e përllogaritjes të shtesës, duke paguar kështu kompensimin e ushqimit edhe në ditët kur punonjësit mund të kenë qenë me leje. Në periudhën Janar 2023-Shtator 2025 ka rezultuar se 700 raste janë përllogaritur në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr.68 datë 07.12.2018 ku thuhet: *Për efekt të llogaritjes së pagës për rastin e pushimeve vjetore, shpërblimi që i përgjigjet pjesës së pagës së përfituar në natyrë përllogaritet si raport i ditëve të punës, gjatë të cilave punëmarrësi ka përfituar pagë në natyrë me numrin e përgjithshëm të ditëve gjatë të cilave ka punuar, shumëzuar me ditët e punës që përfshihen në periudhën e pushimeve vjetore dhe pagën ditore në natyrë, të përcaktuara në kontratën kolektive apo individuale të punës*, duke llogaritur gabim vlera prej **957,000 lekë**, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Shtesa për antidotë. Shtesa për antidot përfaqëson një kompensim financiar për punonjësit që, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekspozohen ndaj rreziqeve të vazhdueshme për shëndetin. Ajo synon të balancojë pasojat e mundshme të këtyre kushteve dhe të njohë vështirësinë e punës së kryer në mjedise të dëmshme ose të rrezikshme. Lidhur me këtë, Këshilli Mbikëqyrës i SHRUKK ka miratuar me Vendim nr.7 datë 28.10.2022 "Për miratimin e masës së shpërblimit me antidotë për shkak të llojit të punës", se punonjësit e kanalizimeve dhe punonjësit e Impiantit të Përpunimit të Ujërave të ndotura do të trajtohen për antidotë, në masën 70 lekë për ditë pune.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion trajtohen me antidotë 19 punonjës, konkretisht punonjësit e Drejtorisë së Kanalizimeve dhe të Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, gjë që bie në mospërputhje me Vendimin nr.2 datë 11.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës (lidhja 2) sipas së cilës sektorë kanalizimesh kanë edhe njësitë Devoll, Maliq, Kolonjë dhe Pustec. Duke qene se nuk është bërë një ndarje e qartë e detyrave të operatorëve në Grupet Operative, për pasojë është e pamundur që të bëhet identifikimi i të gjithë punonjësve të cilët mund të kenë të drejtë të përfitojnë shtesën për antidot.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe vënë në dispozicion konstatohet se llogaritja e pagesës për antidotë është llogaritur edhe për ditët e lejeve, jo vetëm për ditë pune në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit nr.7 datë 28.10.2022, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Si konkluzion, *nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna për periudhën 01.01.2023 deri me 30.09.2025 konstatohet se:*

- Struktura organizative e miratuar dhe e nënshkruar nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës paraqet mangësi në aspektin e klasifikimit, emërtimit dhe funksionalitetit të njësive organizative. Konstatohen njësi dhe sektorë të paemërtuar ose pa përcaktim të qartë të niveleve hierarkike, si dhe struktura të parashikuara por të paplotësuara me personel, duke cenuar funksionimin praktik të tyre. Gjithashtu, evidentohen njësi të krijuara pa hierarki funksionale të justifikuar, dhe sektorë të parashikuar për funksione që faktikisht nuk menaxhohen nga shoqëria.

- Në strukturën organizative të SHRUKK mungon Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, funksionet përkatëse të së cilës janë shpërndarë në drejtoritë e tjera, duke mos garantuar një ndarje të qartë funksionale dhe hierarkike të shërbimeve mbështetëse, funksionet mbështetëse, përfshirë personelin sanitar, shoferët, administrimin e automjeteve janë përfshirë në drejtoritë e tjera funksionale, janë përfshirë në drejtoritë e tjera duke sjellë mos koordinim dhe mangësi në administrimin e shërbimeve mbështetëse.

- Numri faktik i specialistëve të punësuar rezulton më i lartë se ai i planifikuar në strukturën e miratuar. Konkretisht, Sektori i Arkëtimit në Drejtorinë e Shitjes dhe Marrëdhënieve me Klientin përbëhet nga 6 punonjës, të gjithë në nivel specialisti, ndërsa Drejtoria Juridike përbëhet nga 7 punonjës, gjithashtu në nivel specialisti, kjo në mospërputhje me Vendimin nr. 2, datë 11.04.2023 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e Strukturës së Re të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës

Kanalizime Korçë", Lidhja 2, ku parashikohet që këto drejtori të jenë të organizuara në sektorë të drejtuar nga Përgjegjësi i Sektorit.

- Konstatohet se për punonjësit e transferuar nga ish-shoqëritë, kontrata pune janë lidhur vetëm për 276 nga 295 punonjës, ndërsa për pjesën tjetër janë nxjerrë vetëm urdhra ose vendime emërimi. Po ashtu, kontratat rezultojnë të pa protokolluara dhe të pa administruara në dosjet personale, në kundërshtim me kërkesat e nenit 21 të Kodit të Punës dhe me normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor, të cilat parashikojnë lidhjen me shkrim, protokollimin dhe administrimin e rregullt të dokumentacionit.

- Gjatë periudhës nën auditim numri i punonjësve është mbi kufijtë e strukturës së miratuar, duke reflektuar mospërputhje të vazhdueshme ndërmjet strukturës organizative të miratuar dhe gjendjes faktike të punësimit.

-Rregullorja e Brendshme, në përbërjen e saj, përfshin dokumente të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar anekse, pasi janë miratuar si akte nënligjore autonome, në periudha dhe kontekste të ndryshme. Përfshirja e tyre si pjesë përbërëse e një akti të mëvonshëm bie ndesh me parimet e hierarkisë së akteve dhe krijon paqartësi në zbatimin e kuadrit rregullator të brendshëm.

- Për pozicionet e punës: Audit i Brendshëm, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit për të Ardhurat, Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit për Shpenzimet, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Buxhetor, Specialist për Protokollin, Specialist për Arkivin dhe Operator Sistemi në ZKM nuk është përcaktuar rubrika "*Kualifikimet e Nevojshme".*

- Për pozicionin drejtor i departamentit teknik, në rubrikën "*Kualifikimet e Nevojshme*" nga ana e SHRUKK është vendosur si kriter i nevojshëm të ketë mbaruar studimet universitare në Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Hidroteknike, Mekanike, Elektrike ose të ngjashme duke mos u specifikuar që duhet të zotërojë Master Shkencor gjë e cila është në mospërputhje me Statutin e Shoqërisë Neni 18, germa a) e pikës 1 ku citohet se "*Drejtori Teknik duhet të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë Master shkencor në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike dhe shkenca të ngjashme',* Gjithashtu në kundërshtim me germën ç të këtij neni nuk është vendosur kriteri ku theksohet se: "*ç) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mos pajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij".* Për sa më sipër konstatohet se Drejtori Teknik aktual i emëruar në datë 06.01.2025, Znj. M. K. plotëson kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr.18 datë 29.02.2024 të administratorit (Përshkrimi i punës), por në mospërputhje me Statutin e Shoqërisë ka përfunduar studimet e larta në nivelin Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike dhe nuk zotëron Certifikatë të Aftësimit Profesional.

- Përshkrimet punës janë të njëjta për pozicione punë të barabarta, duke pasqyruar objektiva dhe detyra të përgjithshme, por nuk reflektojnë ndarje reale të detyrave dhe përgjegjësive.

- Autoriteti Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave nuk ka kryer verifikime, nuk ka mbledhur të dhëna për konfliktin e interesit dhe nuk ka shpërndarë autorizimet e detyrueshme për zyrtarët e SHRUKK SHA., sipas nenit 10 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 dhe nenit 11 të Rregullores "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave". Konstatohet se nuk ka evidentuar të dhëna mbi ekzistencën ose jo të konfliktit të interesit (në dukje apo faktik), në të gjitha nivelet e hierarkisë

- Konstatohet se asnjë nga rekrutimet nuk është kryer sipas procedurave ligjore, të cilat parashikojnë shpalljen e pozicioneve të lira dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të shoqërisë ose në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe administrimin e dokumentacionit të konkurrimit dhe vlerësimit deri në shpalljen e fituesit. Kjo praktikë bie ndesh me parimin e transparencës të parashikuar në nenin 5 të Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, gjatë periudhës nën auditim, të gjitha kërkesat për punësim rezultojnë të pa protokolluara, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor, duke munguar elementët e vërtetësisë dhe duke u administruar vetëm kërkesat e kandidatëve fitues, çka tregon karakter formal të procesit.
Në vitin 2024 janë evidentuar formularë interviste të paplotësuar sipas kërkesave ligjore, të panënshkruara, pa identifikim të intervistuesve, pa pasqyrim të procesit të intervistimit dhe të pa protokolluara, duke vënë në dyshim besueshmërinë dhe rregullsinë e procesit.

- Në vitin 2023 janë rekrutuar 7 punonjës, për të cilët nga verifikimi rezulton se nuk janë lidhur kontrata individuale pune, por janë punësuar vetëm me urdhrin ose vendimin e administratorit për periudhën e provës dhe kontratat janë nënshkruar vetëm pas përfundimit të periudhës së provës. Moslidhja e kontratës individuale të punës për punonjësit në periudhë prove në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë (neni 11, neni 12, neni 21, pika 4 sipas të cilës*: 4. Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit).*
- Gjatë vitit 2024, 3 punonjës janë emëruar në mënyrë definitive pa kaluar periudhën e provës kjo në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë neni 142 pika 1 Koha e provës ku thuhet *Konsiderohet si kohë prove 3 muajt e parë të punës, me përjashtim të rasteve kur palët kanë lidhur një kontratë për kryerjen e së njëjtës pune.*

- Gjatë auditimit të dosjeve të personelit u konstatuan mangësi të shumta në administrim, përfshirë mungesën e inventarit, dokumenteve bazë si certifikata familjare, aktet e emërimit në detyrë, kontratat punës, dëshmitë e penalitetit, si dhe dokumentet e shkëputjes dhe transferimit të punonjësve në shoqërinë e re apo dokumente të tjera që lidhen me pozicionin e punës.
Në rastin e administratorit mungonin dokumente të rëndësishme si diploma e noterizuar, lista e notave, certifikata personale dhe raporti mjekësor.

- Nuk është hartuar një plan trajnimesh që të përfshijë të gjithë punonjësit e SHRUKK në kundërshtim më Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me urdhër nr. 4 datë, në të cilin thuhet se *Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat përkatëse përfshijnë zbatimin e një sistemi trajnimi dhe kualifikimi që synon përgatitjen e punonjësve për përmbushjen e detyrave në nivelin e kërkuar.*

- Punonjësit e kanalizimeve nuk janë testuar nga një komision i ngritur nga titulli në kundërshtim me Rregulloren e Sigurisë Teknike (miratuar me Urdhër të Administratorit nr.126 datë 04.09.2025)

Kapitulli 8 faqe 33 ku thuhet: *Provimi i përgatitjes teknike të punonjësve bëhet me komision, në drejtimin e të cilit duhet të ketë jo më pak 2 vetë.*

- Punonjësit e sektorit të prodhimit dhe magazinimit të ujit nuk disponojnë kualifikim të sigurimit teknik sipas Rregullores se Sigurisë Teknike (miratuar me urdhër të administratorit nr.126 datë 04.09.2025), kapitulli 3.8, faqe 25 ku thuhet "*Personeli që kryen shërbim operativ duhet të kenë kualifikim të grupit të tretë e lartë të sigurimit teknik".*

- "Kontratat e Performancës" të lidhura nga administratori, në rastin e Drejtorëve të Drejtorive nuk përputhen me linjën e hierarkisë së shoqërisë dhe përshkrimet e punës të miratuara, pasi drejtorët raportojnë direkt tek administratori, duke krijuar mbivendosje të përgjegjësive dhe duke shkelur strukturën dhe rregulloren e brendshme. Për më tepër, nuk është kryer vlerësimi periodik i performancës për Drejtorët.

- Shoqëria ka miratuar procedurën për vlerësimin periodik të punonjësve faktikisht nuk është kryer vlerësimi 6-mujor apo vjetor i punonjësve të shoqërisë gjë që në kundërshtim me Parimin 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit sipas të cilit *Titullari/NA/Menaxheri i njësisë publike duhet të zhvillojë dhe të realizojë procedurat e mëposhtme: Mbikëqyrja- Të japë reagime mbi performancën individuale, bazuar në rregullat e etikës dhe realizimin e kompetencave, të harmonizojë aftësitë individuale me objektivat e njësisë publike dhe të ndihmojë personelin të përshtatet në mjedisin në zhvillim të njësisë.*

- Në përfundim të të gjitha procedurave disiplinore është dhënë masë disiplinore e njëjtë, duke mos ruajtur proporcionalitetin e shkeljes në raport me masën e dhënë. Kontrata individuale e punonjësit në nenet 39, 40, 41 dhe 42 ku trajtohen shkeljet disiplinore nuk parashikon një ndarje të qartë të shkeljes disiplinore dhe masës së dhënë për secilën prej tyre, duke krijuar mundësinë e trajtimit me subjektivitet. Masat disiplinore nuk janë të pasqyruara në një regjistër apo në librezën e punës së punonjësit.

- Punonjësve që janë larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë nuk ju është ofruar një vend tjetër i barabartë apo i përafërt në të gjithë shoqërinë, por vetëm brenda njësisë ku ata ushtronin detyrën e tyre, duke theksuar këtu se gjatë kësaj periudhe janë rekrutuar punonjës të rinj në pozicione të përafërta dhe më të njëjtin nivel arsimor.

- Gjatë periudhës nën auditim konstatohen 32 pozicione pune vakante, konkretisht 3 pozicione vakante ne nivel Drejtor, 9 pozicione Përgjegjës Sektori, 12 pozicione Specialist, 3 pozicione të lira Teknik, 4 pozicione operator dhe 1 sanitar. Këto vakanca, veçanërisht ato të pozicioneve drejtuese ka sjellë vështirësi në organizimin e punës dhe njësi strukturore jofunksionale.

- Gjatë periudhës së auditimit konstatohet se SHRUKK ka vetëm një proces gjyqësor lidhur me mosnjohjen e vjetërsisë për punonjësin Xh. G., për të cilin ka humbur shpenzime gjyqësore në vlerë 63,260 lekë dhe shpenzime përmbarimore 28,800 lekë, duke krijuar një efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë prej 92,060 lekë.

- Në periudhën Janar 2023- Prill 2024, janë miratuar rritje page për 7 punonjës, para hyrjes në fuqi të Vendimit nr.2 datë 09.04.2024 "Për miratimin e nivelit të paga të punonjësve të Shoqërisë" i Këshillit Mbikëqyrës , gjë që bie në kundërshtim me Vendimin nr.3 të Këshillit Mbikëqyrës datë 27.09.2022 pika 3 ku thuhet: *Pagat mujore bruto të punonjësve të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës*

Kanalizime Korçë SHA, gjatë procesit të ristrukturimit do të jenë të pandryshuara me pagat ekzistuese të punonjësve të Shoqërive UK-Korçë SHA, UK-Devoll SHA, UK-Kolonjë SHA, UK Maliq SHA, UK Pustec SHA.

- Në të gjitha rastet, procedura për rritjen e pagës ka nisur me kërkesë nga punonjësi. Nga ana e SHRUKK nuk administrohen kërkesa të refuzuara, kërkesat e administruara në të gjitha rastet janë protokolluar, dhe janë miratuar brenda ditës ose brenda një afati 1 ditor, si dhe kanë qenë kërkesa të bëra nga disa punonjës brenda të njëjtës ditë, situatë e cila evidenton mungesën e shqyrtimit dhe të analizimit të kërkesave, duke i dhënë karakter formal vendim-marrjeve të tilla.

- Gjatë periudhës nën auditim nuk është bërë caktimi i nivelit të pagës bazuar në përvojën në punë, gjithashtu nuk është kryer kalimi nga një nivel ne tjetrin me përmbushjen e viteve të përcaktuara për vjetërsinë.

-Administrimit i dokumentacionit të listë-pagesave të pagave shoqërohet me mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe në respektimin e plotë të rregullave për delegimin e kompetencave, si dhe me mungesë të një listë-prezence totale mujore të unifikuar nga Burimet Njerëzore, çka dobëson kontrollin e brendshëm dhe gjurmueshmërinë e procesit të pagave.

- Pagesa për kompensimit ushqimor gjatë periudhës Janar 2023 – Tetor 2024 kanë rezultuar në trajtim jo të barabartë midis punonjësve. Kompensimi është dhënë vetëm për punonjësit e transferuar nga ish-shoqëria UKKO dhe për disa punonjës të rekrutuar në administratë ose në Njësinë Korçë, duke lënë jashtë të tjerë punonjës, pavarësisht statusit ose vendit të punës. Ky trajtim i pjesshëm dhe diskriminues bie në kundërshtim me parimet e barazisë në shpërblim dhe mos diskriminimit të parashikuara në Nenin 115 të Kodit të Punës, Nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative dhe Nenin 12 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

- Konstatohen parregullsi në mënyrën e përllogaritjes të shtesës, duke paguar kështu kompensimin e ushqimit edhe në ditët kur punonjësit mund të kenë qenë me leje. Në periudhën Janar 2023-Shtator 2025 ka rezultuar se 700 raste janë përllogaritur në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr.68 datë 07.12.2018 duke llogaritur gabim vlera prej 957,000.00 lekë.

- Trajtohen me antidotë 19 punonjës, konkretisht punonjësit e Drejtorisë së kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, gjë që bie në mospërputhje me Vendimin nr.2 datë 11.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës (lidhja 2) sipas së cilës sektorë kanalizimesh kanë edhe njësitë Devoll, Maliq, Kolonjë dhe Pustec.
Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe vënë në dispozicion konstatohet se llogaritja e pagesës për antidotë është llogaritur edhe për ditët e lejeve, jo vetëm për ditë pune në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit nr.7 datë 28.10.2022.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme mban përgjegjësi:
- z. P. T., me detyrë Administrator i shoqërisë,
- znj. F. F., me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar,
- znj.E. F., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.
- znj.A. K., me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore,

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.4 Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Marrëveshja për krijimin e SHRUK Korçë, datë 28.06.2022;
- Urdhri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Gjurmë auditimi për proceset kryesore të veprimtarisë;
- Dokumentacioni i pagesave të bankës, arkës;
- Ditarët e magazinës, bankës, arkës dhe llogaritë përkatëse;
- Dokumentacioni për marrjen në dorëzim të furnizimeve;
- Dokumentacioni justifikues për pagesat e kryera etj.

Zbatimi i ligjshmërisë se kryerjes së shpenzimeve operative, kapitale, administrative etj.

Gjatë procesit të auditimit të dokumentacionit mbështetës për realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, një ndër objektivat kryesore ishte vlerësimi i rregullshmërisë së kryerjes së shpenzimeve operative. Kjo analizë është ndërmarrë me qëllim të sigurimit të informacionit që transaksionet e lidhura me shpenzimet e zakonshme të aktivitetit (si: shpenzime personeli, furnizimet dhe mirëmbajtja e sistemeve të ndryshme, e pajisjeve, automjeteve, të energjisë etj.) janë pasqyruar saktë në librat kontabël dhe janë raportuar saktë në dokumentet financiare në përputhje me planifikimin e fondeve në programin ekonomik miratuar për funksionin e aktivitetit të shoqërisë dhe parimet e kontabilitetit të miratuara për raportimin financiar.

- Analiza është mbështetur në dokumentacionin financiar përkatës, përfshirë regjistrimet kontabël, faturat tatimore, urdhër-pagesat, kontratat me furnitorë dhe procedurat e brendshme të shoqërisë për realizimin dhe miratimin e shpenzimeve;
- Krahasimi analitik i shpenzimeve me vitet e mëparshme, testimin me përzgjedhje të transaksioneve sipas analizës së riskut dhe vlerësimin e klasifikimit kontabël të shpenzimeve sipas natyrës së tyre;

- Ditarët e bankave, arkave në lekë Ditarët e Magazinave;
- Akt rakordimet me bashkitë Korçë dhe Devoll;
- Akt rakordimet me shoqëritë jo financiare.

Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK) është krijuar nga një marrëveshje specifike më datën 28.06.2022 për krijimi e një shoqërie me kapital aksionar 100% shtetëror referuar reformës së ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

SHRUKK identifikohet me NUIS M²4431001N, në zbatim të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; me dispozitat e pikës 5, të nenit 14, të Ligjit Nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar; të Ligjit Nr.9901,

datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në mbështetje të VKM Nr. 302 datë 11.05.2022 ku autorizohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për hyrjen në fuqi të një marrëveshje specifike të Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) dhe ka për qëllim kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ me Bashkitë Korçë, Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që kontabiliteti mbahet me programin “Financa 5” dhe për arkëtimet të dhënat administrohen me sistemin “AL Billing”. Nga shqyrtimi i pagesave konstatohet se ato nuk administroheshin bashkë me pagesat por mbaheshin në dosje më vete, transfertat sipas bankave nuk kishin numra kronologjik që t`i referoheshin ditarit të bankave. Nga auditimi i dokumenteve të bankave, për periudhën e 4 mujorit të parë, viti 2023 konstatohet se transfertat e kryera në disa banka të nivelit të dytë (B C dhe BXX) janë realizuar vetëm me nënshkrimin nga nëpunësi autorizues (Administratori) në kundërshtim me nenin 22 “Aktivitetet e kontrollit” germa ç) ku përcaktohet se “*sistemi i dy nënshkrimeve, nuk lejon që pagesat të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre*”, në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.
Dokumentacioni i nevojshëm për praktikat e likuidimit në bankat e nivelit të dytë kryhej me urdhër pagesën e nënshkruar nga Administratori ose nga i deleguari prej tij dhe nga Nëpunësi Zbatues. Për likuidimet me fondet buxhetore në degën e Thesarit Korçë, nënshkrimi kryhej elektronikisht nga Punonjësit e thesarit dhe për SHRUK Korçë nga Administratori ose nga i deleguari prej tij Drejtori i departamentit tregtar si dhe nga nëpunësi zbatues.
Dokumentet mbështetëse për likuidimin e pagesave nga SHRUK Korçë ishin urdhri i transfertës bashkëlidhur me mandat pagesën e bankës, listë-pagesat për pagat me listë-prezencën në punë, urdhrat e emërimit ose të shkarkimit të punonjësve, listë-pagesat për pagesat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, fletë udhëtimet dhe faturat elektronike të hoteleve, faturat elektronike dhe kontratat e furnitorëve.
Nga SHRUK nuk ka pasur kundërshtime dhe është pranuar që administrimi i dokumenteve të mbahej së bashku me transfertat bankare në dokumentet e çdo banke.

- Pagat dhe kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Konstatohet se gjatë auditimit të listë-pagesave, për llogaritjen e shpenzimeve të pagave *nuk administroheshin urdhrat për miratimin e lejeve vjetore* dhe ditët e kryera me leje vjetore, merreshin të mirëqena vetëm nga listë prezenca në punë.
Për periudhën objekt auditimi, listë-pagesat e audituara me zgjedhje u konstatua se llogaritja e ditëve me raport mjekësor ishte bërë mbi vlerën neto në bazë të vjetërsisë përkatësisht nën 10 vite 70% dhe mbi 10 vite 80% të bazës ditore të vlerësuar për 6 muajt e fundit. Nga ditari pagave rezulton se vlerat bruto të llogaritura nga borderotë përputheshin me vlerat e deklaruara sipas deklaratave tatimore të sistemit e-filling ku ishte kryer edhe llogaritja e sigurimeve shëndetësore, shoqërore dhe tatimin mbi pagë dhe likuidimi i tyre me bankat e nivelit të dytë.

- **Veprimet me arkë.** Ditari i arkës është i lidhur me arkëtime që bëhen nga abonentët familjarë dhe biznese kurse abonentë e institucioneve i arkëtojnë detyrimet e tyre me bankë. Për mbledhjen e të ardhurave SHRUK Korçë ka lidhur marrëveshje me disa operatorë të cilët kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, agjent për mbledhje të arkëtimeve.

Konstatohet se janë lidhur kontrata me agjentët tatimor për mbledhjen e të ardhurave nga faturimet me abonentët familjarë dhe bizneset pa procedurë. Për periudhën audituese 2023- 2025 (shtator), në asnjë program ekonomik apo në plan biznesin për periudhën 2024-2028 nuk i është paraqitur kërkesa Këshillit Mbikëqyrës për nevojën dhe domosdoshmërinë e lidhjes së një marrëveshjeje për arkëtimin e faturave nga abonentët me agjentët.
Në tabelën si vijon jepen të dhënat për subjektet që kanë lidhur marrëveshjet.

Tabela nr.8 Kontratat e lidhura me agjentët


Nr. prot.	Data	Subjekti	NUIS	Shënime
392	03.11.2022	A I Sha	K.D	Data e lidhjes 01.01.2022 e ndryshme nga data e protokollimit Aneksi 5, i është referuar NUIS të një subjekti tjetër
367	01.01.2022	E SHPK	KP	
360	01.01.2022	Posta Shqiptare Sha	J.N	Kontrata ka penalitete për vonesa ne derdhjen e pagesave prej 0.05% në ditë gjatë 10 ditëve të para të vlerës së faturuar gjithsej për një muaj dhe për ditët e tjera 0.1% në ditë të po të njëjtës faturë dhe shuma e përgjithshme e penalitetit nuk duhet të kalojë 10% të vlerës totale të faturës përkatëse.
360/3	02.12.2022	Posta Shqiptare Sha	J.N	Amendim kontrate për derdhjet në bankë brenda muajit pasardhës dhe jo ditën e nesërme si në kontratën e lidhur
362	01.11.2022	R F S SHPK	L.H	Aneksi 5 , nuk ka datë të lidhjes që duhet të hyjë në fuqi
565	10.08.2023	R Sha	M.T	Aneksi 5 , nuk ka date te lidhjes që duhet të hyjë në fuqi
366	01.11.2022	U F T Sha	J.G	Aneksi 5 , nuk ka date te lidhjes që duhet të hyjë në fuqi

Burimi: Të dhëna të SHRUK Korçë, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se kontratat me subjektet e sipërcituara janë lidhur pa u paraprirë nga një proces i dokumentuar administrativ, konkretisht:
Konstatohet se mungon akti i brendshëm (Urdhër/Vendim) që justifikon nevojën për marrjen e shërbimit nga palë të treta, në asnjë nga dokumentet e programeve ekonomike nuk është paraqitur kërkesa për nevojën e lidhjes së këtyre kontratave me operator privat, pra nuk ka miratim nga Këshilli Mbikëqyrës dhe nga Asambleja e Përgjithshme (neni 81) a) *përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë* të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar:
- mungon përcaktimi paraprak i kushteve teknike dhe operacionale që duhet të përmbushte subjekti/subjektet përpara lidhjes së kontratës;
- nuk rezulton analizë e riskut dhe as vlerësim i ndikimit financiar;
- kontrata është njohur administrativisht vetëm në datën e protokollimit, ndërkohë që shërbimi ka filluar të zbatohet më herët duke dhënë efekt prapaveprues.
- Kontratat nuk parashikojnë penalitete për vonesat në arkëtime, ndërkohë që me Postën Shqiptare janë të parashikuara.

Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë.

Grafiku 1: Arkëtimet në vite nga Operatorët Agjentet



Burimi: SHRUK Korçë dhe përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat lidhur me të ardhurat e arkëtuara nga faturimet e abonentëve dhe të derdhura në llogaritë bankare të SHRUK Korçë pranë bankave të nivelit të dytë, rezultoi se të ardhurat më të larta janë arkëtuar nga Posta Shqiptare në shumën 370,175,135 lekë rreth 44% kundrejt totalit të arkëtimeve nga gjithë operatorët e tjerë agjentë.

Konstatohet se arkëtimet më të larta janë arkëtuar nga Posta Shqiptare rreth 44% dhe pastaj vijnë W U me 18% me të njëjtin nivel prej rreth 15% secila, janë arkëtuar nga M g dhe nga E P.

Për të gjitha këto subjekte janë mbajtur akt rakordimet duke i tejkaluar afatet e përcaktuar në marrëveshjet e lidhura dhe nuk janë llogaritur penalitet për vonesat e arkëtimeve, përjashtohet vetëm kontrata e lidhur me Postën Shqiptare, e cila ka të llogaritur penalitetet dhe ka patur amendim në kohë për periudhën e likuidimit të arkëtimeve nga ana e tyre. Mangësitë e sipërcituara tregojnë shkelje të parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke cenuar sigurinë juridike dhe mbrojtjen e interesit financiar të shoqërisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 2 ku citohet se "*Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë*" dhe në nenin 12 pika 3, germa a) ku citohet "*...garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit*".

Gjithashtu, përveç të ardhurave nga veprimtaria kryesore e furnizimit me ujë dhe largimit ujërave të ndotura, SHRUK Korçë realizon të ardhura si agjent taksash me komision prej 2% me Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Devoll me të cilat ka lidhur edhe marrëveshje. Me Bashkinë Korçë, kontrata është amenduar dhe arkëtimi i të ardhurave, nga komisioni prej 2%, realizohej pas transferimit të vlerës së plotë në Bashki, duke dokumentuar veprimin, me faturë elektronike fiskale mujore lëshuar nga SHRUK Korçë ndërsa për Bashkinë Devoll vlera e komisionit mbahej në burim kundrejt faturës elektronike fiskale mujore por pa transfertë bankare në Bashkinë Devoll, pasi veprimi për mbledhjen e të ardhurave ishte kryer në avancë.

- Konstatohet se, nga auditimi i dokumenteve të bankës, kontrata e lidhur me kompaninë O A SHA për qiramarrje të zyrave në Maliq Korçë me sipërfaqe 40.5 m² me vlerë mujore 46,000 lekë,

rezulton pa datë referuese lidhjeje, por vetëm me numër protokolli hyrës 239, datë 04.04.2024 me efekt parapaveprues, efekti në kohë është 15 muaj duke dhënë një efekt financiar prej **690,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, përkatësisht neni 2, neni 4 nenin 12 pika 3, germa a) për të cilat nuk janë *respektuar parimet e ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit të fondeve publike.* Për këtë ngarkohen me përgjegjësi znj. F. F.me detyrë Drejtore e Departamentit Tregetar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

- Kontrata e lidhur me subjektin Sigma Interalbanian Viena Insurance Group SHA më datën 27.03.2023 për vlerën e primit 789,520 lekë me nr. serie 00080227 rezulton se është për aksidentet në punë për të gjithë punonjësit, ndërkohë që punonjësit e administratës nuk kanë shkallë rreziku në punë dhe është e pajustifikuar sigurimi i tyre në punë, duke ngarkuar me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë.
Urdhri me nr.139/19 prot., datë 27.03.2023 "Për përcaktimin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës është në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe me Vendimin 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e "rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH" shtojca 1, është në kundërshtim me pikën 43, të UMF 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar pasi komisioni i ngritur është me dy anëtarë, ndërkohë që duhet të jetë me tre anëtarë, në kundërshtim me nenin 22, germa "b" ku citohet se:*" ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.* të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar" i ndryshuar. Për sa më sipër SHRUK Korçë nuk ka ngritur grupin e punës për evidentimin dhe grupimin e punonjësve të cilët justifikojnë përfitimin e primit të sigurimit referuar rrezikut për aksident në punë dhe kufizimeve në moshë, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar.

- Nga dokumentacioni i shpenzimeve për likuidimin e kontratës së lidhur më datë 14.10.2022 me Operatorin ekonomike K SHPK, LB me objekt për zhvillimit e faturimit "Al-Billing" dhe transferimin e gjithë sistemeve rajonale në një sistem të vetëm duke kryer migrimin e të dhënave dhe në dokumentacion rezulton se nuk ka urdhër të ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim. Këto shpenzime ishin në shumën 3,304,800 lekë me TVSH dhe kontrata e shërbimit e lidhur me nr.15 prot., datë 14.0.9.2022 "Për mbikëqyrjen e procedurave të transferimit të aktivitetit të shoqërive për përgatitjen e raportit të transferimit të aktivitetit" me ekspertin ligjor Toska me vlerë totale 4,752,000 lekë me TVSH, duhej të ishin likuiduar me fondet buxhetore, veprime të cilat janë në kundërshtim me VKM 302, datë 11.05.2022 "Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura pika 5, neni 7 ku citohet "*Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës se themelimit të shoqërive të reja SKP-UK, shpenzimet e nevojshme për caktimin e eksperteve, si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë te shoqëritë e reja do të përballohen nga buxheti i shtetit.*" Ky shpenzim ka prekur fondet e SHRUKK dhe ka rritur kostot e operimit për vitin 2023 për të cilat duhet të bëhej një rakordim për stornimin e vlerave nga të ardhurat e SHRUK dhe të bëhej kërkesën për rimbursim nga fondet e buxhetit, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

- Në dokumentet e bankës, për shpenzimet e ndryshme si për investime, mirëmbajtje dhe shërbime nuk administroheshin procesverbalet e marrjeve në dorëzim. Kjo mangësi ishte edhe tek dokumentet e magazinës. Këto dokumente ishin në dosjen e prokurimit.

- Në dokumentet e dietave nuk administroheshin autorizimet për aktivitetin për të cilin ishte kryer shërbimi. Nga shqyrtimi i të dhënave për vitin 2023 u evidentua se vlera totale faktike e tyre ishte 255,420 lekë si në Aneksin 1, Për vitin 2024 Aneksi 2 me vlerën totale 445,114 lekë, Aneksi 3 viti 2025 (shtator) me vlerën 487,303 lekë.

- Për investimet me fondet e buxhetit të shtetit janë parë të gjithë dokumentet për kontratat si vijon dhe likuidimet janë kryer në përputhje me strukturën buxhetore të miratuar në Degën e Thesarit Korçë për institucionin e SHRUK Korçë.

- Dokumentet e magazinës për administrimin e konsumit të karburantit. SHRUK Korçë ka blerë me prokurim për nevoja të institucionit për kryerjen e shërbimeve me automjete dhe pajisje pune tre tipe hidrokarburesh: Naftë (blu diesel, diesel 10 pm), benzinë dhe gaz GLN dhe përdor tre forma furnizimi të automjeteve dhe pajisjeve që konsumojnë karburant paralelisht karta elektronike, tollona dhe me pompë nga depozita.
Nga dokumentacioni i magazinës dhe ai i administruar në departamentet e tij konstatohet se, për vitet 2023 dhe 2024 nuk ka të përcaktuara normat e konsumit të miratuara nga një komision i ngritur me urdhër të administratorit. Ky komision ishte ngritur vetëm në vitin 2025 me urdhrin nr. 42, datë 12.02.2025 "Për përcaktimin e normave të konsumit të karburanteve të makinave në pronësi të SHRUK Korçë". Konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nga komisioni, janë vënë në dispozicion vetëm 27 automjete kurse makineritë e tjera si motomatrapiku, motokompresori, gjeneratori për motosaldatricen, gjeneratorët e tjerë, kaldajat dhe veglat e punës që konsumojnë karburant nuk janë përfshirë. Referuar listës së paraqitur, nuk evidentohen se cilat automjete konsumojnë benzinë, naftë apo gaz dhe ky fakt ka sjell në magazinë edhe keq menaxhim dhe mos kontroll të konsumit real të karburantit. Në asnjë prej drejtorive të SHRUK Korçë nuk mbaheshin dhe administroheshin ditarët e lëvizjeve të automjeteve të tilla si Ekskavator, traktor, të pirunëve, të autoboteve, të kamionçinave me vinç, të veglave të punës si: motomatrapik, motokompresor, gjenerator për motosaldatrice, korrëse të barit. Nuk mbahej akt rakordimi për lëvizjet km-litër–faturë apo orë pune/litër-faturë, kjo për shkak të mungesës së ndarjes së detyrave dhe të një rregulloreje të brendshme. Nuk ishin përcaktuar qartë periudhat e kryerjes së riparimeve dhe shërbimeve. Po ashtu, nuk ishte përcaktuar mënyra e administrimit të dokumenteve autorizuese dhe justifikuese, si pasojë, nuk kryhej rakordimi i tyre me preventivat, konsumin përkatës dhe fletë-daljet e karburantit. Në pjesën më të madhe të fletë-udhëtimeve konstatohen se janë formale, pa nënshkrim kundërfirmues dhe për tërheqjet me tollona nuk ka kupona tatimorë që të vërtetojnë tërheqjet.
Ky informacion reflekton edhe në inventarët e fund vitit ku nuk paraqitet gjendja faktike reale e stokut pasi është e pamatshme, pra dokumentet nuk paraqesin me vërtetësi nevojat reale për konsum, për blerje me prokurim, planifikim real të sasisë së karburantit për periudhat pasardhëse dhe të fondeve për periudhën afatmesme dhe vjetore të shoqërisë. Kjo mënyrë e menaxhimit dhe e kontrollit e ndjekur për vënien në funksion të pajisjeve ka përcaktuar një rritje të konsiderueshme të riskut, cenim të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës të menaxhimit të fondeve. Për shkak të mungesës së gjurmueshmërisë së auditit, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar

përkatësisht neni 2" ku citohet Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë", neni 4 *"Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin... dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve"* në nenin 12 pika 3, germa a) ku citohet "*garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit.*
Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar.

Për vitin 2023 konstatohet se nga magazina për automjetin me targa AA6xxZC TOYOTA RAV4 me benzinë dhe elektrike konstatohet se duhej të furnizohej me benzinë por sipas dokumentacionit të paraqitur është tërhequr naftë me tollona me sasinë 1660 litra dhe me vlerë 279,337.2 lekë, e cila nuk përputhet me specifikimet teknike të automjetit ku në lejen e qarkullimit të tij është specifikuar benzine + elektrike.
Për vitin 2024 janë tërhequr 2350 litra naftë me vlerën 353,875 lekë për 9 mujorin e vitit 2025 janë tërhequr 360 litra nafte 51,830.4 lekë dhe 960 litra benzine me vlerë 129,820.8 lekë.
Për vitin 2023 nga magazine për automjetin me targa AA72xxF TOYOTA RAV4 që konsumon benzinë konstatohet se duhej të furnizohej me benzinë por faktikisht është tërhequr naftë me tollona për të tërheqja është në sasinë 1300 litra dhe me vlerë 218,136.9 lekë, kjo tërheqje nuk përputhet me specifikimet teknike të automjetit ku në lejen e qarkullimit të tij është specifikuar benzinë. Për vitin 2024 janë tërhequr 1294.42 litra naftë me vlerën 193,150.5 lekë dhe për 9 mujorin e vitit 2025 janë tërhequr 130 litra naftë 18,541.3 lekë dhe 1190 litra benzine me vlerë 160,923.7 lekë gjithsej vlera sipas magazinës.

Nga verifikimi i dokumenteve të automjeteve rezulton se automjeti NISAN PATROL me targa KU31xxA rezulton pa leje qarkullimi dhe pa certifikatën e kontrollit teknik. Ky automjet përdoret nga njësia Kolonjë dhe rezulton se ka patur konsum 1940 litra me një vlerë prej 316,434 lekë për vitin 2023 dhe për vitin 2024 ka konsumuar 2610 litra. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se çdo automjet ka autorizimin për përdorim me afat 1 vjeçar të miratuar nga administratori kurse për automjetin e vet autorizimi është miratuar nga drejtori tregtar i cili është edhe nëpunësi autorizues.
Rezulton se nga dokumentet e fletë udhëtimeve automjeti me targa KO28xxA tip TOYOTA kamiocina Hilux e vitit 2000 dhe me kapacitet serboratori 75 litra rezulton se në datën 23.12.2024 ka tërhequr 130 litra, në datë 25.11 2024 ka tërhequr 80 litra, datë 25.10.2024 ka tërhequr 100 litra, datë 27.09.2024 ka tërhequr 80 litra ku në të gjitha rastet rezulton se tërheqja është më shumë se kapaciteti i rezervuarit të tij. Gjithashtu rezulton se kamionçina Hilux e cila ka ndërruar targën dhe aktualisht është me targën AB31xxB për vitin 2024 fletët e udhëtimit janë të pa nënshkruara nga punonjësi përdorues dhe nuk ka nënshkrimin kundër firmues.
Automjeti MERCEDES MODEL 124 me targa AA4xxGR rezulton që në dt 01.01.2024 është i prishur por për vitin 2023 ka tërhequr 1190 litra por fletë udhëtimi apo ditar të lëvizjeve të tij nuk administroheshin.

Automjeti me tip FORD RANGER me targa AA 6xxTR në vitin 2025 kishte pësuar aksident për faj të palëve të treta dhe ishte në servis dhe në proces gjyqësor për rimbursimin e shpenzimeve dhe nuk kishte konsum të karburantit.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë; znj F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.
Konstatohet se në ambientet e oborrit të SHRUK Korçë ekziston një depozitë e pajisur me pompë furnizuese për naftën. Kjo pompë shërben për furnizimin mjeteve të rënda ekskavator, autoboteve, traktorit etj., për të cilën nuk ka asnjë dokument që vërteton furnizimin e tyre me këtë pajisje apo ndonjë ditar për lëvizjen e karburantit madje nuk ka asnjë gjurmë dokumentare për gjendjen e karburantit në inventarin e aseteve të SHRUK Korçë. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për pompën e naftës nuk ka gjurmë dokumentare që të jetë verifikuar dhe kalibruar periodikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si autoriteti kompetent për kontrollin ligjor të mjeteve matëse.
Gjithashtu rezulton se nuk ka gjurmë të verifikimeve fillestare apo periodike të kryerjes së inspektimeve teknike dhe të sigurisë nga Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik dhe Industrial (ISHTI) për instalimin e saj duke krijuar risk të lartë për përdorimin e saj si pajisje jashtë standardeve të sigurisë. Nuk ka librezë apo kartelë teknike, si dhe nuk është e regjistruar në një regjistër për pajisjet nën presion. Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e saj nuk ka një Urdhër të brendshëm që të jetë caktuar personi teknik përgjegjës që do të menaxhojë përdorimin e saj dhe të dokumentojë daljen e karburantit me këtë pajisje. Nuk rezulton të ketë një kontratë mirëmbajtjeje si dhe procesverbale që vërtetojnë mirëmbajtjen periodike të saj. Për këtë pajisje nuk rezulton një rregullore për masat e sigurinë në punë që të bëjë vlerësimin e rrezishmërisë. Nuk rezulton të ketë udhëzime përdorimi dhe trajnime të personelit. Nuk u gjet asnjë pajisje antizjarr pranë saj duke shtuar më shumë nivelin e pasigurisë.
Për shkak të mungesës së gjurmueshmërisë së auditit, veprimet dhe mosveprimet nga ana e SHRUK Korçë janë në kundërshtim të ligjit nr. 32„datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” i ndryshuar, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 ”Për metrologjinë” i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010”Për menaxhimin e fondeve dhe kontrollin”, i ndryshuar përkatësisht neni 2” ku citohet Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”, neni 4 *“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin... dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”* në nenin 12 pika 3, germa a) ku citohet “*garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit.*
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë; znj F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar.
Referuar evidencës së deklaruar nga SHRUK Korçë rezulton se disa nga mjetet e punës konsumojnë benzinë dhe dalja iu është bërë me naftë përkatësisht 2 korrëse bari dhe 1 sharrë prerje për vitin 2023 me 40 litra naftë me vlerë 6,531.9 lekë.

Për administrimin dhe funksionimin e kaldajave. Në ambientet e zyrave qendrore janë të instaluara dy kaldaja për një kapacitet prodhues 81 - 115 Kë/orë dhe 123 - 175 Kw/orë. Llogaritja

e konsumit të gazit GLN për njërën nga kaldajat me kapacitet max 115 Kŵ/orë është rreth 6.38 kg/orë. Pavarësisht llogaritjes nuk janë mbajtur ditarët e konsumit të saj. Sipas përllogaritjeve rezulton faktikisht se për vitin 2023 janë konsumuar në total 3500 litra, ku ITUN 600 litra, ZMK 700 litra, dhe administrata 2200 litra.
Për vitin 2024 janë konsumuar në total 2000 litra ku administrata ka konsumuar 1500 litra, në ITUN 250 litra dhe në ZMK 250 litra.
SHRUK nuk posedon gjurmë të auditimit për konsumin e lëndës djegëse, pasi nuk ka dokumentet e nevojshme që të justifikojnë konsumin real të karburantit (gaz), as regjistrin teknik ku janë përcaktuar rregullat teknike dhe kushtet thelbësore të sigurisë, rregullat e mirëmbajtjes së tyre, orarin e punës pra fashën orare ditore të punës, të jenë certifikatat e konformitetit të pajisjeve nën presion. Të dhënat që administrohen në Regjistrin teknik, duhet të jenë në përputhje me kriteret e ligjit nr.32, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" i ndryshuar, ku janë përcaktuar se për kaldajën si pajisje nën presion është detyrim të mbahet "Libri i pajisjes". Ky është dokumenti bazë, në të cilin pasqyrohen të dhënat në lidhje me parametrat teknikë, kohën e prodhimit, subjektin që e ka në pronësi ose në përdorim kaldajën, rezultatet teknike të inspektimeve periodike të pajisjes nën presion. Ky dokument administrohet dhe duhet t`i vihet në dispozicion ISHTI apo edhe Organeve të tjera, *për vlerësimin e konformitetit*. SHRUK KORÇË nuk ka të dokumentuar raportin e funksionimit të pajisjes nën presion ***për vlerësimin e konformitetit dhe përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të sigurisë***, sipas rregullit teknik të vlerësimit të konformitetit në mënyrë periodike. Referuar kritereve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 11 thuhet se *"Ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve nën presion në rast se ka përfunduar afati i vlefshmërisë së përcaktuar në certifikatën e konformitetit. dhe ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve nën presion, (Kaldajës) nëse, nga kontrolli teknik periodik ose i veçantë, rezulton se ato nuk plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik"*. Pra referuar kritereve të këtij ligji nuk duhej të vihej në funksion pasi ndalohet shfrytëzimi pa certifikatën e konformitetit.

Përcaktimet teknike për furnizimin dhe ruajtjen e karburantit në depozitën e gjendur në mjediset e SHRUK Korçë. Grupi i auditimit thekson se procedurat e magazinimit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi depozitat e karburantit që gjenden në mjediset e saj, nuk posedojnë pajisje për matjen e nivelit të tyre. Pajisjet matëse duhet të jenë të kalibruara dhe të kontrolluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo nga subjektet e autorizuara prej saj. Veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr.126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë" i ndryshuar, përkatësisht me në nenin 2 "Objekti", me nenin 4 "Vënia në dispozicion e rezultateve të matjeve" ku përcaktohet se rezultatet e matjeve u shërbejnë nevojave të institucioneve shtetërore lidhur me transaksionet zyrtare, dhe u vihen në dispozicion kërkuesve sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit". Detyrimin për kontrollin e pajisjeve matëse nga ISHTI përcaktuar në nenin 8 "Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë", në kundërshtim me nenin 19 "Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara", me nenin 20 "Detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim".
Për sa vijon ligji e ka mirë përcaktuar se mbajtja e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në pompën e naftës për depozitat, është i detyrueshëm. Mbi bazën e këtij përcaktimi informacioni i dhënë nga SHRUK Korçë për hyrje daljet, konsumin dhe gjendjen stokut të lëndës djegëse dhe në depozitat, është jo i besueshme dhe jo transparent.
Ky informacion reflekton edhe gjendjen në inventarët e fund vitit ku nuk paraqitet gjendja faktike reale e stokut si në depozitat e kaldajës ashtu edhe në depozitën e gjendur në mjediset e SHRUK Korçë, pasi është e pamatshme, rrjedhimisht nuk paraqiten me vërtetësi dhe transparencë nevojat

reale për prokurim, planifikim real të sasisë së karburantit (të lëngshëm/të gaztë) si dhe të planifikimit të fondeve buxhetore për periudhën afatmesme dhe vjetore.
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.
Kjo mënyrë e menaxhimit dhe e kontrollit përcakton një rritje të konsiderueshme të riskut, cenim të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës së menaxhimit të fondeve tuaja. Veprimet dhe mosveprimet për mirëadministrimin e karburantit dhe të pajisjeve nën presion, me pasojë mungesën e gjurmueshmërisë së auditimit, janë në kundërshtim me ligjin nr. 32, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" i ndryshuar, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020"Për metrologjinë" i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010"Për menaxhimin e fondeve dhe kontrollin", i ndryshuar përkatësisht neni 2" ku citohet Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efecient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë", neni 4 *"Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin... dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve"* në nenin 12 pika 3, germa a) thuhet se "*garantimi para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit.*

Dokumentacioni i magazinës. Konstatohet se për dokumentet e fletë-hyrjeve administrohet fatura tatimore fiskale për blerjet e materialeve, por në asnjë rast nuk ka të bashkëlidhur procesverbalin e marrjes në dorëzim për pranimin e tyre nga procedura e blerjes sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti kontraktor. Për fletë-daljet rezulton se të gjitha kërkesat janë të nënshkruara vetëm nga përgjegjësi i grupit të punës dhe nga drejtuesi i departamentit teknik apo dhe nga drejtuesi i departamentit tregtar për administratën, pa iu referuar një rregulloreje se kush do të jenë personat përgjegjës për tërheqjen e materialeve nga magazina. Për periudhën audituese 2023-shtator 2025, rezulton se fletë kërkesat janë pa numër rendor por kanë të plotësuar vetëm datën, artikullin dhe sasinë dhe zonën e rajonit kujt i shkojnë materialet. Nuk ka një dokument për parashikimin e materialeve sipas një preventive para punimeve apo dhe procesverbalit për punimet e kryera, ku të paraqitet me vërtetësi dhe besueshmëri gjurma e auditimit.
Të gjitha veprimet e mësipërme tregojnë dobësi serioze të kontrollit të brendshëm dhe me risk për të cilën mbajnë përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues. Mos mbajtja e dokumentacionit është në kundërshtim me pikën 34,35 dhe 36 të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ku citohet "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve*", si dhe në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar , në kundërshtim me pikën 2.1 të Manualit të menaxhimit financiar si dhe pikën 2.3". Gjithashtu, mbajnë përgjegjësi Titullari dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (i ngritur me Urdhrin nr. 61 me nr,146 prot., datë 12.02.2025), pasi kanë role gjithëpërfshirëse në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Blerjet me vlerë të vogël. Konstatohet se nga ana e Autoritetit Kontraktor të SHRUK Korçë janë ngritur urdhri nr.1,datë 11.01,2023 "Për krijimin e komisionit të prokurimin me vlerë të vogël, si dhe komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar" dhe urdhri 99, datë 21.12.2023 "Për caktimin e personit përgjegjës" kur në fakt duhej të caktohej që në fillim të vitit, në kundërshtim me nenin 3 "Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik" të VKM 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Referuar regjistrit të realizimit të prokurimeve për vitin 2023, 2024 dhe 2025 (shtator) konstatohet se për vitin 2023 janë aplikuar gjithsej 38 procedura, të realizuara 31 dhe të anuluara 7 procedura, me fond limit gjithsej të llogaritur 773,000 lekë pa TVSH dhe vlerë totale për kontratat fituese 523,000 lekë pa TVSH. Për vitin 2024 janë aplikuar gjithsej 37 procedura, të realizuara janë 31 dhe të anuluara 11 procedura, me fond limit gjithsej të llogaritur 13,192,090 lekë pa TVSH dhe me vlerë totale për kontratat fituese 9,136,550 lekë pa TVSH. Për vitin 2025 janë aplikuar gjithsej 27 procedura, të realizuara janë 20 dhe të anuluara 7 procedura, me fond limit gjithësej të llogaritur **7,286,603·69** lekë pa TVSH dhe me vlerë totale për kontratat fituese **5,825,158.02** lekë pa TVSH. Të dhënat statistikore jepen në tabelën më poshtë:

Nr	Periudha e audituar	Numri i Procedurave prokuruar me me vlerë të vogël	Numri i Procedura të anuluara	Procedura të audituara	Procedura të prokuruara për Blerjet me emergjencë	Procedura të audituara
1	2023	31	7	5	10	4
2	2024	26	11	4	4	4
3	2025	20	7	5	S'ka patur	S'ka patur

Referuar procedurave të kryera në të gjitha rastet konstatohet se nuk janë administruar kërkesat dhe nevojat mbi bazën e të cilave duhet të fillojë procedura e prokurimit. Gjithashtu fondi limit është llogaritur pa u bazuar në specifikimet teknike, duke sjellë për pasojë rriskun e përdorimit pa ekonomicitet, efikasitet dhe eficencë të fondeve publike. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se se janë 2 raste në vitin 2023 ka pasur copëtim të fondit. Të tilla janë blerjet e kancelarive, blerja e karburantit. Edhe pse procedurat janë zhvilluar në zbatim të udhëzimit nr. 07 datë 30.07.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike" rezulton se grupi i marrjes në dorëzim ose nuk është ngritur ose është vetëm me 2 persona kontrata e lidhur me subjektin "E S S" me referencë REF-76835-08-04-2023 "Blerje servera për sistemin ŴAMR të matësve on line" është marr në dorëzim nga 2 vetë.

- Për procedurën e blerjes së letër A4 me reference REF-63720-03-27-2024 me vlerë 937,501 lekë e cila duhej të prokurohej së bashku me procedurën me REF-89538-12-04-2023 me objekt Blerje dosje dhe zarfe për dokumentacion" me Urdhër Prokurimi nr.37, datë 04.12.2023 me fond limit të llogaritur 283,000 lekë dhe me vlerë kontrate 208,000 lekë, në total vlera është 1,145,784 lekë kalon kufirin prej 1,000,000 lekë.
- Gjithashtu janë kryer procedura e emergjencës, për të cilat rezulton se nuk janë bërë hyrje dalje përkatësisht për aparatin e tahometrit i cili rezultoi edhe i përdorur në kundërshtim me nenin 2 të ligjit 10296, datë 08.07.2020 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
- Gjithashtu gjatë marrjes në dorëzim dhe hyrjen në magazinë, rezulton se në grupin e marrjes në dorëzim nuk është pjesë personi me përgjegjësi materiale në kundërshtim me pikën 43, të UMF 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik "ku citohet "Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të

jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale". Tahometri duhet të kalibrohet në përputhje me kriteret e ligjit 126, datë 11.05.2020 "Për metrologjinë" i ndryshuar , por nuk e ka kryer.
Nga verifikimi i dokumenteve konstatohet se edhe për vitin 2024 të njëjtat probleme kanë vazhduar si në vitin 2023 ku për kancelaritë janë copëtuar fondet përsëri që kalojnë kufirin prej 1,000,000 lekë referuar procedurës REF-01627-04-17-2024 Vlera 946,500 lekë, dhe blerje materiale publicitare REF-99868-04-02-2024 me fond limit 250,000 lekë në total 1,196,500 lekë. Gjithashtu njësia e matjes e prokuruar për blerjen me vlerë të vogël me objekt Blerje Letër A4" është me kg në kundërshtim me nenin 11 Kufijtë monetarë, neni 56 Procedura e prokurimit me vlere të vogël". Edhe pse laboratori është i pa akreditуar në kundërshtim me nenin 5" procesi i akreditimit" të ligjit nr.116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, për funksionimin e analizave laboratorike, janë lidhur kontrata me prokurim me blerje të vogël të reagentëve dhe të hipokloritit. Kjo procedurë nuk duhej te bëhej, pasi kalojnë kufirin monetar në kundërshtim me nenin 11 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar duke dhënë efekt financiar negative.

Dokumentacioni mbështetës për fillimin e një procedure prokurimi nuk është i dokumentuar dhe të paraqesë nevojat reale për fillimin e procedurave. Justifikimi se kërkesat janë të njëjta me parashikimet mbi të cilat realizohet planifikimi i buxhetit janë të përafërta dhe nuk mund të jenë të njëjta, pasi ato nuk paraqesin gjendjen e stokut në magazinë për mallrat që do të prokurohen. Për periudhën objekt auditimi përkatësisht për vitin 2023, nuk është vënë në dispozicion dokumentacion për asnjë kërkesë ku të argumentohet fillimin e procedurave. Dokumentet paraqitur shtesë për vitin 2024 janë të pa protokolluara dhe nuk kanë miratimin e Titullarit të autoritetit kontraktor për fillimin e procedurës, duke mos lënë gjurmë auditimi dhe nuk paraqesin me besueshmëri kërkesat reale për prokurim. Konstatohet se, nuk është dokumentuar procesi i hartimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 77 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe me nenin 78 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Specifikimet teknike duhet të përgatiten për të përshkruajnë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit dhe duhet të përcaktojnë të gjitha detajet e nevojshme, si p.sh: përmasat, sipërfaqen , peshën, densitetin, certifikatat ndërkombëtare të cilësisë ISO si dhe kriteret e tjera të veçanta përkatëse për zërat e produkteve që i përkasin objektit të prokurimit. Dokumenti i paraqitur është kërkesa nga një person dhe jo nga komisioni i ngritur për blerjet e vogla specifikisht për vitin 2023 dhe vitin 2024 nuk keni asnjë dokument mbështetës, kurse për vitin 2025 keni disa kërkesa me specifikime por jo të miratuara nga komisioni i sipërcituar.

Po kështu dokumentacioni i paraqitur në dosjet e prokurimit për hartimin e fondit limit nuk ishte hartuar në përputhje me kërkesat e neneve 34 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe 76 të VKM 285, datë 19.05.2021"Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, duke argumentuar dhe dokumentuar mënyrën e përllogaritjes, si dhe të pasqyrohen treguesit përkatës të çmimeve. Treguesit e çmimeve të marra në kuadër të testimit të tregut, si një nga mënyrat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës të parashikuar në nenin 76 të VKM 285, datë 19.05.2021"Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, duhet të evidentohen në procesverbalin e mbajtur për këtë proces, së bashku me të dhënat e operatorëve, nga të cilët janë marrë çmimet përkatëse. Në rastin e përllogaritjes së fondit limit bazuar në çmimet e tregut, nuk ishte mbajtur në konsideratë llogaritja e mesatares së ofertave, për të qenë sa më afër çmimeve reale të tregut dhe

në rastet kur i ishin referuar kontratave të mëparshme nuk kishte asnjë të dhënë për referencat e tyre dhe objektin e prokurimit për të cilat ato kishin lidhur kontratat. Për sa vijon rezulton si pasojë e llogaritjes gabim të fondit limit ku njësia matëse ishte marrë në kg, ndërkohë që në treg njësia matëse është rizma (paketim me 500 fletë dhe me peshë 2.49 kg/rizëm). Mos përcaktimi i saktë i njësisë matëse ka rritur riskun për të ulur transparencën dhe besueshmërinë e procedurës së prokurimit. Për sa më sipër nga ana e APP janë paraqitur rekomandime dhe njoftime lidhur me procedurat e prokurimit që paraqiten në faqen ŵeb të saj.

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.5. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit Nr.1007/1 prot., datë 17.10.2025 i ndryshuar, "Auditimi i Përputhshmërie", në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë: lidhur me *"Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit".*

Nga auditimi konstatohet se:

▪ Shoqëria Rajonale e Ujësjellësit Korçë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2024, mbështetur në Ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe SKK-të.

▪ Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2024 janë:
- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e lëvizjeve në kapitalin neto (F4);
- Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

▪ Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të Ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku është dhënë informacion mbi:
- Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A. me NIPT MN;
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare te vitit 2024, 31.03.2025;
- Përgatitur nga znj. E. F.
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Titullari i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Korçë z. P. T..

Paraqitja e Pasqyrave Financiare të bashkuara në Rajonin Korçë

Në rajonin Korçë deri në momentin e riorganizimit në datën 31.12.2022, shërbimi i ujësjellës kanalizime është kryer nga shoqëritë

-Ujësjellës Kanalizime Korçë (me NIPT JO)
-Ujësjellës Kanalizime Devoll (me NIPT JK)
-Ujësjellës Kanalizime Ersekë (me NIPT KO)
-Ujësjellës Kanalizime Maliq (me NIPT JD)
-Ujësjellës Kanalizime Pustec (me NIPT LB)
Pas datës 31.12.2022, aktiviteti i këtyre njësive ekonomike është ndërprerë dhe e drejta e ushtrimit të aktivitetit u transferua në favor të një shoqërie të re të themeluar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime SHA" me NIPT "MN".
Transferimi i veprimtarive ekonomike është kryer në kuadrin e riorganizimit kombëtar të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"*

Për procedurën e transferimit dhe bashkimit të aktiveve dhe detyrimeve së bashku me kapitalin e secilës njësie ekonomike, është angazhuar audituesi ligjor i caktuar nga MIE.

Auditimi i Kredive. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë ka 4 kredi aktive të cilat janë:
1. Kredia e marrë tek KfŴ në datën 16.05.1997 me objekt kontrate *"Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë Korçë"* me vlerë 3,323,397 euro e konvertuar në lekë, sipas kontratës 452,364,338 lekë. Kohëzgjatja e kësaj kredie sipas kontratës do të jetë deri në vitin 2037 (40 vite). Nga auditimi rezulton se detyrimi i pashlyer për këtë kredi në datën 01.01.2023 është 1,612,031 euro. Në periudhën e auditimit janë paguar 276,098 euro principal dhe detyrimi i pashlyer në datën 30.09.2025 mbetet 1,335,933 euro. Në periudhën e auditimit janë paguar dhe 28,147 euro interesa. Nga auditimi rezulton se SHRUK Korçë deri në datën 30.09.2025 ka shlyer 60 % të kësaj kredie, pagesat janë bërë në mënyrë të rregullt sipas korrespodencës me Ministrinë e Financës.

Pasqyra nr. 9 Kredia me KfŴ, datë 16.05.1997

Institucioni	Principali Euro	Principali Lek	Detyrimi në Euro 01.01.2023	Principali periudha auditimit Euro	Interesat periudha auditimit Euro	Vlera totale e shlyer Euro deri 30.09.2025	Vlera e mbetur Euro 30.09.2025	Vlera e mbetur Lekë 31.12.2023	Pagesa e Kredive në % 30.09.2025
KfŴ	€ 3,323,397	452,364,338	€ 1,612,031	€ 276,098	€ 28,147.0	€ 1,987,464	€ 1,335,933	181,840,570	60%

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

2. Kredia e marrë tek KfŴ në datën 16.03.2000 me objekt kontrate *"Rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë Korçë"* me vlerë 6,646,794 euro e konvertuar në lekë sipas kontratës 838,147,193 lekë. Kohëzgjatja e kësaj kredie sipas kontratës do të jetë deri në vitin 2042 (42 vite). Nga auditimi rezulton se detyrimi i pashlyer për këtë kredi në datën 01.01.2023 është 5,994,794 euro. Në periudhën e auditimit janë paguar 545,000 euro principal dhe detyrimi i pashlyer në datën 30.09.2025 mbetet 5,449,794 euro. Në periudhën e auditimit janë paguar dhe 110,294 euro interesa. Nga auditimi rezulton se SHRUK Korçë deri në datën 30.09.2025 ka shlyer 18% të kësaj kredie, pagesat janë bërë në mënyrë të rregullt sipas korrespodencës me Ministrinë e Financës.

Pasqyra nr. 10 Kredia me KŴ , datë 16.03.2000

Institucioni	Principali Euro	Principali Lek	Detyrimi në Euro 01.01.2023	Principali periudha auditimit Euro	Interesat periudha auditimit Euro	Vlera totale e shlyer Euro deri 30.09.2025	Vlera e mbetur Euro 30.09.2025	Vlera e mbetur Lekë 31.12.2023	Pagesa e Kredive në % 30.09.2025
KfŴ	€ 6,646,794	838,147,193	€ 5,994,794	€ 545,000	€ 110,294.0	€ 1,197,000	€ 5,449,794	687,207,930	18%

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

3. Kredia e marrë tek BEI në vitin 2008 me objekt kontrate *"Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe ndërtimi i Impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura Korça III"* me vlerë 14,500,000 euro e konvertuar në lekë sipas kontratës 1,987,429,197 lekë. Kohëzgjatja e kësaj kredie sipas kontratës do të jetë deri në vitin 2039 (31 vite). Nga auditimi rezulton se për këtë kredi nuk është paguar asnjë këst nga principali dhe interesat.

Pasqyra nr. 11 Kredia me BEI, 2008

Institucioni	Principali Euro	Principali Lek	Detyrimi në Euro 01.01.2023	Principali periudha auditimit Euro	Interesat periudha auditimit Euro	Vlera totale e shlyer Euro deri 30.09.2025	Vlera e mbetur Euro 30.09.2025	Vlera e mbetur Lekë 30.09.2025	Pagesa e Kredive në % 30.09.2025
BEI	€ 14,500,000	1,987,429,197	€ 14,500,000	€ -	€ -	€ -	€ 14,500,000	1,987,429,197	0%

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për periudhën e auditimit Ministria e Financave ka dërguar shkresat duke i përcaktuar këstet e principalit në shumën totale 2,589,286 euro dhe interesat në shumën totale 613,521euro që duhen paguar.

Data	**Pricipali**	**Interesat**
15.13.2023	€ 517,857	€ 122,704
13.09.2023	€ 517,857	€ 122,704
19.03.2024	€ 517,857	€ 122,704
13.09.2025	€ 517,857	€ 122,704
25.03.2025	€ 517,857	€ 122,704
Totali	**€ 2,589,286**	**€ 613,521**

4. Kredia e marrë tek KfŴ në vitin 2019 më objekt kontrate *"Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve Korça IV"* me vlerë 15,000,000 euro e konvertuar në lekë sipas kontratës 2,074,011,449 lekë. Kohëzgjatja e kësaj kredie sipas kontratës do të jetë deri në vitin 2038 (19 vite). Nga auditimi rezulton se për këtë kredi nuk është paguar asnjë këst nga principali dhe interesat.

Pasqyra nr. 12 Kredia me KfŴ, 2019

Institucioni	Principali Euro	Principali Lek	Detyrimi në Euro 01.01.2023	Principali periudha auditimit Euro	Interesat periudha auditimit Euro	Vlera totale e shlyer Euro deri 30.09.2025	Vlera e mbetur Euro 30.09.2025	Vlera e mbetur Lekë 30.09.2025	Pagesa e Kredive në % 30.09.2025
KfŴ	€ 15,000,000	2,074,011,449	€ 15,000,000	€ -	€ -	€ -	€ 15,000,000	2,074,011,449	0%

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për periudhën e auditimit Ministria e Financave ka dërguar shkresat duke i përcaktuar këstet e principalit në shumën totale 1,875,000 euro dhe interesave në shumën totale 664,985 euro që duhen paguar.

Data	Pricipali	Interesat
24.05.2023	€ 375,000	€ 125,421
22.11.2023	€ 375,000	€ 129,320
21.05.2024	€ 375,000	€ 133,112
21.11.2024	€ 375,000	€ 136,789
11.06.2025	€ 375,000	€ 140,344
Totali	€ 1,875,000	€ 664,985

Për 2 kreditë, të cilat SHRUK Korçë nuk ka paguar asnjë këst, në datën 05.04.2024 "Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera" ka dërguar nga një shkresë për secilën kredi të pashlyer, shkresën me nr.1053 prot. drejtuar SHRUK Korçë dhe për dijeni kryetarit të bashkisë Korçë z. S. F., duke i kërkuar të shlyejnë shumën 1,966,855.95 euro si principal dhe interesa të papaguara të grumbulluara deri në datën 31.12.2023, dhe shkresën me nr.1054 prot. ku kërkon të shlyhet vlera 4,856,851.47 euro si principal dhe interesa të grumbulluara deri në datën 31.12.2023. SHRUK Korçë ka kthyer përgjigje "Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera" nëpërmjet shkresës nr.534/1 prot. datë 23.05.2024 duke i sqaruar së "për arsyen se nuk është miratuar rritja e tarifave nga ERRU, SHRUK Korçë ka 20.6 mil. euro mungesë mjetesh monetare". Në muajin dhjetor 2025 që është jashtë periudhës audituese ka filluar komunikimi me Ministrinë e Financave, për lidhjen e një marrëveshje.

Konkluzion i përgjithshëm mbi 4 kreditë: Nga auditimi rezulton se SHRUK Korçë ka marrë 4 kredi në vlerën totale 39,470,191 euro, detyrimi i pa shlyer në datën 01.01.2023 është në shumën 37,106,825 euro, në periudhën e auditimit janë shlyer 821,098 euro pricipal dhe detyrim total i pashlyer për kreditë në datën 30.09.2025 mbetet 36,285,727 euro. SHRUK Korçë ka shlyer vetëm 8% të totalit të kredive. SHRUK Korçë për periudhën e auditimit ka paguar dhe 138,441 euro interesa. Nga totali i pashlyer në datën përmbyllëse të auditimit 30.09.2025 i cili është në shumën 36,285,727 euro, shuma 29,500,000 euro i përket 2 kredive për të cilat SHRUK Korçë nuk ka paguar asnjë këst pricipali dhe interesa, shuma 6,785,727 euro i përket dy kredive që paguhen në mënyrë të rregullt. Për dy kreditë që SHRUK Korçë nuk ka paguar asnjë këst në datën 30.09.2025 janë akumuluar interesa totale të papaguara 4,469,365 euro, nga të cilat shuma 1,278,505 euro janë interesa të papaguara të periudhës së auditimit.
Për sa më sipër mban përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë.

Pasqyra nr. 12 Të dhëna përmbledhëse për katër kreditë

Institucioni	Principali Euro	Principali Lek	Detyrimi në Euro 01.01.2023	Principali periudha auditimit Euro	Interesat periudha auditimit Euro	Vlera totale e shlyer Euro deri 30.09.2025	Vlera e mbetur Euro 30.09.2025	Vlera e mbetur Lekë 31.12.2023	Pagesa e Kredive në % 30.09.2025
KfŴ	€ 3,323,397	452,364,338	€ 1,612,031	€ 276,098	€ 28,147.0	€ 1,987,464	€ 1,335,933	181,840,570	60%
KfŴ	€ 6,646,794	838,147,193	€ 5,994,794	€ 545,000	€ 110,294.0	€ 1,197,000	€ 5,449,794	687,207,930	18%
BEI	€ 14,500,000	1,987,429,197	€ 14,500,000	€ -	€ -	€ -	€ 14,500,000	1,987,429,197	0%

KfŴ	€ 15,000,000	2,074,011,449	€ 15,000,000	€ -	€ -	€ -	€ 15,000,000	2,074,011,449	0%
Totali	**€ 39,470,191**	**5,351,952,177**	**€ 37,106,825**	**€ 821,098**	**€ 138,441**	**€ 3,184,464**	**€ 36,285,727**	**4,930,489,146**	**8%**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Debitorët (klientët). Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën e fillimit të auditimit në datën 01.01.2023, shuma totale e detyrimeve të papaguara nga klientët paraqitet në vlerë 382,519,776 lekë.

Debitorët ndahen në tre kategori:

- Familjarë me vlerë 340,286,829 lekë;
- Biznese me vlerë 25,241,512 lekë;
- Institucione me vlerë 16,991,435 lekë.

Paraqitura në tabelën më poshtë sipas rajoneve:

Kategoria	Korçë	Maliq	Devoll	Kolonjë	Pustec	Totali
Familjare	298,586,368	18,318,704	9,704,498	12,866,802	810,455	340,286,829
Biznese	19,375,794	1,320,018	1,729,052	2,806,358	10,290	25,241,512
Institucione	13,193,461	353,554	441,046	2,815,904	187,470	16,991,435
Totali	331,155,624	19,992,276	11,874,596	18,489,064	1,008,215	382,519,776

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën përmbyllëse të auditimit në muajin shtator 2025, shuma totale e detyrimeve të papaguara nga klientët paraqitet në vlerë 422,069,532 lekë.

Debitorët ndahen në tre kategori:

-Familjarë me vlerë 368,596,417 lekë;
-Biznese me vlerë 28,068,937 lekë;
-Institucione me vlerë 25,404,179 lekë.

Paraqitura në tabelën më poshtë sipas rajoneve:

Kategoria	**Korçë**	**Maliq**	**Devoll**	**Kolonjë**	**Pustec**	**Totali**
Familjare	316,087,914	22,314,766	13,979,714	15,252,846	961,177	**368,596,417**
Biznese	22,853,341	1,397,548	1,148,157	2,606,511	63,380	**28,068,937**
Institucione	19,534,084	335,134	774,572	4,485,800	274,589	**25,404,179**
Totali	**358,475,339**	**24,047,448**	**15,902,443**	**22,345,157**	**1,299,145**	**422,069,532**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi konstatohet se detyrimet e klientëve ndaj SHRUK Korçë nga periudha fillestare e auditimit e deri në periudhën përmbyllëse janë rritur me një vlerë prej 39,549,757 lekë ose me 9 %, e ndarë sipas kategorive:

-Familjarët janë rritur me vlerë 28,309,588 lekë ose 8 %;
-Bizneset janë rritur me vlerë 2,827,425 lekë ose 10 %;
-Institucionet janë rritur me vlerë 8,412,744 lekë ose 33 %.

Kategoria	Detyrimet 01.01.2023	Detyrimet 30.09.2025	Totali	Totali %
Familjare	340,286,829	368,596,417	28,309,588	8%
Biznese	25,241,512	28,068,937	2,827,425	10%
Institucione	16,991,435	25,404,179	8,412,744	33%
Totali	382,519,776	422,069,532	39,549,757	9%

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për abonentët të cilët nuk kryejnë pagesën e furnizimit me ujë të pijshëm SHRUK Korçë përdor metodën e ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm, e vërtetuar nga dokumentet e vëna në diponzicion (procesverbalet e ndërprerjes dhe procesverbalet e rilidhjes për abonentët që paguajnë debinë).
Për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura Titullari me anë të urdhrit nr.107 datë 29.07.2025 ka ngritur grupet e punës për ndjekjen dhe kontrollin e debitorëve për bashkitë Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec. Bashkëlidhur këtij urdhri është dhe plani i punës që përcakton detyrat e grupeve që do merren me mbledhjen e detyrimeve nga klientët debitorë.
Konstatohet se grupet e ndjekjes së debitorëve kanë lidhur disa Akt marrëveshje me klientë të vjetër debitorë, por nuk kanë arritur të sjellin një rezultat pozitiv në mbledhjen e këtyre detyrimeve.
SHRUK Korçë nuk ka ndjekur asnjë procedurë tjetër për mbledhjen e detyrimeve të klientëve debitorë në kundërshtim me Ligjin 10296, MF "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit"*, Neni 9 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues"*, neni 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues".
Për situatën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë dhe znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregetar.

Kreditorët (furnitorët). SHRUK Korçë detyrimin për ofruesit e mallrave dhe shërbimeve në datën përmbyllëse të auditimit 30.09.2025 e ka në vlerën 13,210,440 lekë. Nga ky detyrim vlera 5,111,161 lekë i përket 9 subjekteve të cilët në datën 30.09.2025 rezultojnë brenda afateve të pagesës. Konstatohet se pjesa tjetër e detyrimit që është në vlerë 6,785,279 lekë i përket 21 subjekteve që i ka kaluar afati i pagesës. Gjithashtu, konstatohet se janë bërë shkëmbime mallrash midis SHRUK Korçë dhe UK Pogradecit sipas marrëveshjes midis tyre, SHRUK Korçë nëpërmjet faturës së shitjes nr. 165666/2024 datë 21.03.2024 me vlerë 1,314,000 i ka shitur "saraçineska ¾ DN 25", dhe ka blerë nga UK Pogradeci nëpërmjet faturës së blerjes nr.55191/2024 me vlerë 1,314,000 lekë "matësa uji elektrikë", por nuk kanë bërë çedimin e llogarive kontabël midis tyre. Rezultojnë se nga data 01.01.2025 deri në datën 30.09.2025, 3 subjekte të furnizimit me mallra dhe shërbime, janë likuiduar por jashtë afatave të pagesës. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin 10296, MF "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 1 "Objekti i ligjit", neni 2 "Qëllimi i ligjit", neni 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit"*, neni 9 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues"*.

Gjithashtu, konstatohet se kur u transferuan ish-njësitë në SHRUK Korçë sollën dhe detyrimet e furnitorëve të pa likuiduar nga ana e tyre të cilët janë në shumën 129,490,994 lekë. Ky detyrim përbëhet nga detyrimet e furnitorëve të ish-njësisë Maliq në vlerë 124,232,840 lekë ku nga kjo vlerë shuma 123,712,840 lekë është detyrim për OSHEE, detyrimet e furnitorëve të ish-njësisë Pustec në vlerë 3,903,477 lekë dhe detyrimet e furnitorëve të ish-njësisë Korçë në vlerë 40,677 lekë. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin 10296, MF "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 1 "Objekti i ligjit", neni 2 "Qëllimi i ligjit", neni 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit"*, neni 9 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues"*.

Nr.	Emri furnitorit	Gjendja 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Gjendje 30.09.2025	Data e blerjes	Data e pagesës	Shënime
1	OSHEE e transferuar Maliqi	123,712,840	-	-	123,712,840	01.01.2025	-	ka kaluar afati

2	Transferimi Furnitore Pustec	3,460,977	-	-	3,460,977	01.01.2025	-	ka kaluar afati
3	Transferimi Furnitore Maliq	520,000	-	-	520,000	01.01.2025	-	ka kaluar afati
4	V B Fur Pustec	442,500	-	-	442,500	01.01.2025	-	ka kaluar afati
5	UK Korçë	40,677	-	-	40,677	01.01.2025	-	ka kaluar afati
Totali		**128,176,994**	**-**	**-**	**128,176,994**			

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Vlera 10,623,390 lekë është detyrimi i pa mbyllur për 3 subjekte të cilët kanë kryer punime në objektet e reja të investimit. Kjo shumë përfaqëson garancinë e punimeve në objektet e reja të investimit, e cila është në përputhje me kontratat.

Nr.	Emri	Gjendja 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Gjendje 30.09.2025	Shënime
1	A	2,709,685	0	0	2,709,685	Brenda afatit të garancisë
2	E A	999,168	50,999,318	48,449,353	3,549,133	Brenda afatit të garancisë
3	N	3,496,567	10,831,936	9,963,931	4,364,572	Brenda afatit të garancisë
4	N SHPK	1,027,816	0	1,027,816	0	-
Totali		**8,233,235**	**61,831,254**	**59,441,099**	**10,623,390**	

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Subvencioni i dhënë nga AKUM. *Info e përgjithshme:* Agjencia e Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) ka dërguar shkresën me nr. 2288/7prot. datë 25.10.2022 me lëndë "Njoftim për zbatimin e Udhëzimit Nr.20 datë 14.10.2022" për dhënien e një subvencioni 30,000,000 lekë "dhënie ndihme me rastin e krijimit të Shoqërive Rajonale të Ujësjellësve".

Nëpërmjet vendimit nr. 9 datë 07.12.2022 me nr. 408/3 prot. Këshilli Mbikëqyrës miraton përdorimin e subvencionit 30,000,000 lekë sipas relacionit, "Për blerje pajisje pompash, panele elektrike dhe ristrukturimin e stacioneve të pompimit në Maliq".

Nëpërmjet shkresës nr.434 prot. datë 07.12.2022 Titullari mbledh Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve për miratimin e përdorimit të subvencionit.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nëpërmjet vendimit nr. 3 datë 08.12.2022 me nr. 434/2 prot. miraton përdorimin e këtij fondi sipas pikës 5 të Udhëzimit nr. 20. Titullari nëpërmjet shkresës nr. 361/1 datë 08.12.2022 drejtuar AKUM paraqet kërkesën për mënyrën e përdorimit të subvencionit prej 30,000,000 lekë bazuar në udhëzimin nr. 20 datë 25.10.2022 pika 5 germa b.

AKUM kaloi në llogarinë e SHRUK Korçë Subvencionin në vlerë 30,000,000 lekë në datën 16.12.2022.

Zbatimi i Subvencionit: Për "*blerje pajisje pompash, panele elektrike dhe ristrukturimin e stacioneve të pompimit në Maliq"*, SHRUK Korçë ka lidhur 2 kontrata për kryerjen e këtyre punimeve:

1. Kontrata me nr.60/25 prot. datë 20.03.2023 me subjektin sipërmarrës "I" SHPK me objekt kontrate "punime ndërtimi për rikonstruktimin e godinave të stacioneve të pompave në fshatërat Vreshtas, Velitërnë, Kishnik, Shëngjergj dhe Plasë.
2. Kontrata me nr.61/25 prot. datë 20.04.2023 me subjektin sipërmarrës "M G" SHPK me objekt kontrate "furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elekto-mekanike në stacionet fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik, Shëngjergj dhe Plasë.

Nr.	Subjekti	Vlera e tatueshme	Vlera me TVSH	Totali
1	I SHPK	2,989,634	597,927	3,587,561
2	M G	25,970,000	5,194,000	31,164,000
Totali		28,959,634	5,791,927	34,751,561

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për sa më sipër përdorimi i subvencionit bie në kundërshtim me pikën 3, 4 germën d të Udhëzimit 20 të MIE datë 14.10.2022 "Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve për vitin buxhetor 2022", në të cilin citohet: *"Prioritet për përdorimin e fondit nga Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale është likuidimi i detyrimeve emergjente, të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë, sipas pikës 4 të kësaj metodologjie", "Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale përdorin subvencionin për likuidimin e detyrimeve emergjente, të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë",* "*Pagesat e prapambetura ndaj OSHEE-së, të shoqërive ujësjellës-kanalizime të përthithura, të cilat janë transferuar te Shoqëria Rajonale"* pasi konstatohet se nga ish-njësia Maliq janë transferuar 29 kontrata me OSHEE-në, me detyrime të prapambetura në vlerën totale neto (principal) 113,360,845 lekë.
SHRUK Korçë për detyrimet e prapambetura të transferuara nga ish-njësia Maliq ka lidhur vetëm 2 akt marrëveshje me OSHEE-në për kontratat nr. KR0B020002047777 dhe nr. KR0D080026093435.

Nr.	Nr. Kontrate Oshee	Adresa	Debia
1	KR0A050004029559	pompa Drithas i vjeter	577,500
2	KR0A050015029569	depo uji Maliq	246,307
3	KR0A050016029563	pompa Symiz kom Libonik	1,522,187
4	KR0B020001047775	pompa Bregas	5,836,808
5	KR0B020002047777	pompa Kishnik	17,181,695
6	KR0B020006047779	pompa Zvirine	7,211,885
7	KR0B020009047743	pompa Kupole kom Vreshtas	266,264
8	KR0B020010039835	pompa ujit Kakac	1,083,860
9	KR0B020015041594	pompa ujit Veliterne	823,922
10	KR0B020016047744	pompa ujit Pirg kom Pirg	982,306
11	KR0B020023047778	pompa Sovjan	4,270,985
12	KR0B050023047770	pompa Vlocisht	3,197,376
13	KR0B030016047745	pompa Marjan kom Lozhan	318,782
14	KR0B060162051777	pompa ujit Bulgarec	3,833,578
15	KR0B060163047772	pompa Bulgarec	42,206,715
16	KR0B060292047785	pompa Plase	605,810
17	KR0B060524627480	pompave Plase	6,722,266
18	KR0B110009047776	pompa Sheqeras	1,619,906
19	KR0D080021093277	stac uji pijshem 2 Shengjergj	5,654,074
20	KR0D080026093435	Uk Maliq mancur 2	5,549,145
21	AL0020756	Zyrat Maliq	219,558
22	KR0B050023629738	pompa Sovjan	142,536

23	KR0B060170047769	pompa Vashtmi	1,581,648
24	KR0B060135047771	pompa Lumalas	15,360
25	KR0B020013041042	pompa ujit Leminot	9,840
26	KR0B020009628324	pompe uji nder ujesj fshat	26,030
27	KR0A050042029565	pompa Drithas I ri	1,641,542
28	KR0D080020093272	pompa uji Zvezde 1	6,480
29	KR0D080020093274	pompa uji Zvezde 2	6,480
Total detyrimi			113,360,845

Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Auditimi i pagave. - Nga auditimi i pagave për vitin 2023 në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet e pagave), konstatohet se paga neto është paguar 13,790 lekë më tepër, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Paga neto sipas Esig-25	Paga neto e paguar ne bankë	Ndalesa Telefon/Përmbarim	Diferenca
Janar	12,963,894	12,898,422	65,496	(24)
Shkurt	12,767,885	12,722,337	45,598	(50)
Mars	12,703,129	12,657,122	45,946	61
Prill	13,328,132	13,283,856	44,405	(129)
Maj	13,140,730	13,084,813	55,930	(13)
Qershor	13,084,016	13,057,561	30,900	(4,445)
Korrik	12,948,540	12,859,865	93,121	(4,446)
Gusht	12,744,811	12,689,030	60,472	(4,691)
Shtator	12,622,109	12,552,993	69,127	(12)
Tetor	12,673,033	12,613,737	59,306	(10)
Nentor	12,697,302	12,641,248	56,067	(13)
Dhjetor	12,486,860	12,430,045	56,830	(15)
Total	154,160,438	153,491,029	683,198	(13,790)

Pagesa më tepër e pagave në vlerë 13,790 lekë për vitin 2023 vjen nga llogaritja gabim e pagës së tre punonjësve, e cila është evidentuar nga subjekti dhe i është ndaluar punonjësve në pagë muajin e ardhshëm.

- Nga auditimi i Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimit mbi Pagën (TAP) në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet për sigurime), për vitin 2023 nuk konstatohet kamatë vonesa ose mos likuidime, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Kontributet sipas Esig25	Pagesa e Kontributeve	Diferenca
Janar	5,027,331	5,027,331	-
Shkurt	4,952,982	4,952,982	-
Mars	4,933,165	4,933,165	-
Prill	5,143,873	5,143,873	-
Maj	5,064,747	5,064,747	-
Qershor	4,992,489	4,992,489	-
Korrik	4,946,972	4,946,972	-

Gusht	4,864,376	4,864,376	-
Shtator	4,798,640	4,798,640	-
Tetor	4,819,601	4,819,601	-
Nëntor	4,855,063	4,855,063	-
Dhjetor	4,776,632	4,776,632	-
Totali	59,175,871	59,175,871	-

-Nga auditimi i pagave për vitin 2024 në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet e pagave), konstatohet se paga neto është paguar 40,206 lekë më tepër, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Paga neto sipas Esig-25	Paga neto e paguar ne bankë	Ndalesa Telefon/Përmbarim	Diferenca
Janar	12,249,250	12,196,124	53,139	(13)
Shkurt	11,993,835	11,943,090	50,757	(13)
Mars	11,943,070	11,893,552	51,364	(1,846)
Prill	12,016,953	11,961,262	55,703	(13)
Maj	12,030,235	11,978,458	51,784	(8)
Qershor	11,900,674	11,845,691	54,993	(11)
Korrik	11,933,697	11,885,247	53,522	(5,072)
Gusht	11,825,250	11,773,148	57,582	(5,480)
Shtator	11,696,306	11,637,711	58,606	(11)
Tetor	13,117,087	13,051,509	65,570	8
Nentor	13,012,894	12,979,509	61,128	(27,743)
Dhjetor	13,261,875	13,177,770	84,110	(6)
Total	146,981,123	146,323,071	698,257	(40,206)

Pagesa më tepër e pagave në vlerë 40,206 lekë për vitin 2024 vjen nga llogaritja gabim e pagave për disa punonjës. Kjo pagesë më tepër është evidentuar nga subjekti dhe i është ndaluar punonjësve në pagë muajin e ardhshëm.

-Nga auditimi i Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimit mbi Pagën (TAP) në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet për sigurime), për vitin 2024 konstatohet se SHRUK Korçë ka paguar 3,183 lekë kamatë vonesa, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Konrtibutet sipas Esig25	Pagesa e Kontributeve	Diferenca
Janar	4,690,332	4,690,332	-
Shkurt	4,601,529	4,602,529	(1,000)
Mars	4,595,697	4,595,697	-
Prill	4,655,403	4,655,403	-
Maj	4,665,017	4,665,017	-
Qershor	4,610,350	4,610,350	-
Korrik	4,667,020	4,667,020	-
Gusht	4,615,507	4,617,690	(2,183)
Shtator	4,535,731	4,535,731	-
Tetor	5,188,225	5,188,225	-

Nentor	5,148,347	5,148,347	-
Dhjetor	5,225,200	5,225,200	-
Totali	57,198,358	57,201,541	(3,183)

-Nga auditimi i pagave për periudhën janar-shtator 2025 në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet e pagave), konstatohet se paga neto është paguar 9,229 lekë më tepër, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Paga neto sipas Esig-25	Paga neto e paguar ne bankë	Ndalesa Telefon/Përmbarim	Diferenca
Janar	13,282,285	13,229,296	54,725	(1,737)
Shkurt	13,354,171	13,299,847	54,326	(3)
Mars	13,449,693	13,395,059	54,640	(6)
Prill	13,469,837	13,413,699	56,142	(4)
Maj	13,564,728	13,512,628	56,007	(3,908)
Qershor	13,550,774	13,492,603	58,181	(10)
Korrik	13,740,975	13,685,932	55,054	(11)
Gusht	13,852,475	13,783,481	69,573	(579)
Shtator	13,772,550	13,717,678	57,844	(2,972)
Total	122,037,486	121,530,223	516,492	(9,229)

Pagesa më tepër e pagave në vlerë 9,229 lekë për periudhën janar-shtator 2025 vjen nga llogaritja gabim e pagave për disa punonjës. Kjo pagesë më tepër është evidentuar nga subjekti dhe i është ndaluar punonjësve në pagë.

-Nga auditimi i Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimit mbi Pagën (TAP) në sistemin e tatimeve (e-filling) dhe dokumenteve të bankës (urdhër shpenzimet për sigurime), për periudhën janar-shtator 2025 konstatohet se SHRUK Korçë ka paguar 4,818 lekë kamtë vonesa, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Konrtibutet sipas Esig25	Pagesa e Kontributeve	Diferenca
Janar	5,248,097	5,248,097	-
Shkurt	5,332,346	5,332,346	-
Mars	5,419,885	5,419,885	-
Prill	5,426,461	5,426,461	-
Maj	5,463,598	5,463,598	-
Qershor	5,440,530	5,440,530	-
Korrik	5,526,082	5,526,082	-
Gusht	5,573,052	5,573,052	-
Shtator	5,541,895	5,546,713	(4,818)
Totali	48,971,946	48,976,764	(4,818)

Auditimi i likuidimit të TVSH. Nga kontrolli i dokumentacionit për likuidimin e TVSH-së për periudhën e auditimit, u analizuan librat e shitjes dhe librat e blerjes të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë, ku rezulton se pagesa totale e TVSH-së duhet të jetë 148,174,517 lekë.

Ish-njësitë e Ujësjellësve kur janë bashkuar dhe kanë formuar Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë, kanë sjellë në shoqërinë e re "SHRUK Korçë" dhe detyrimet për TVSH-në,

gjithashtu dhe gjendjen kreditore të TVSH-së. Totali i gjendjes së TVSH-së e mbartur nga ish-njësitë rezulton kreditore dhe është në vlerë 40,540,006 lekë, e konfirmuar dhe e sistemuar në sistemin e tatimeve (e-filling) të SHRUK Korçë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, sipas tabelës më poshtë:

Shteti-TVSH për tu paguar/Sektori Bilisht	(341,232)
Shteti-TVSH për tu paguar/Sektori Maliq	(369,252)
Shteti-TVSH për tu marre/Sektori Kolonje	33,975,147
Shteti-TVSH për tu marre/Sektori Korçe	7,275,343
Total gjendje e grumbulluar nga bashkimi	**40,540,006**

Gjithashtu, përveç gjendjes kreditore që është mbartur nga ish-njësitë, SHRUK Korçë ka paguar dhe 107,301,978 lekë TVSH për periudhën e auditimit.
Detyrimet për TVSH-në dhe likuidimi i TVSH-së për periudhën e auditimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Periudha	TVSH që duhet të paguhet	TVSH e paguar	
Mbartur nga Transferimi	710,484	41,250,490	Detyrim i papaguar
Viti 2023	45,171,046	51,438,543	
Viti 2024	49,227,692	11,686,441	
Janar-Shtator 2025	53,775,779	44,176,994	
Totali	148,885,001	148,552,468	332,533

-Si përfundim, konstatohet se sipas librave të shitjes dhe librave të blerjeve rezulton se SHRUK Korçë është debitore për TVSH-në në vlerë 332,533 lekë, por nga auditimi i faqes së tatimeve (e-filling) nuk rezulton të ketë detyrime të prapambetura për TVSH-në.
-Konstatohet se të gjitha këstet e likuidimit të TVSH-së janë bërë në mënyrën të çrregullt dhe jo sipas datave të caktuara, ato në të gjitha rastet e pagesës janë bërë parapagim dhe subjekti nuk disponon ndonjë arsye ose marrëveshje përkatëse me Drejtorinë e Tatimeve Korçë për të paguar TVSH-në përpara se të bëhet deklarimi i periudhës tatimore.
Gjithashtu, konstatohet se kur është bërë transferimi i ish-njësive në SHRUK Korçë nga audituesi ligjor S T PF me nr. NIPT LA që ka bërë transferimin nuk ka bërë rakordim me Drejtorinë e Tatimeve Korçë për TVSH-në, e cila rezulton me diferencë nga Ujësjellës Kanalizime Kolonjë. Ku në pasqyrat financiare të vitit 2023 është transferuar nga ish-njësia Kolonjë vlera kreditore 31,656,888 lekë, ndërsa gjendja kreditore e ish-njësisë Kolonjë në sistemin e tatimeve rezulton 33,975,147 lekë. Pra në pasqyrat financiare të vitit 2023 të SHRUK Korçë është transferuar si gjendje kreditore TVSH-ja në vlerë 2,318,259 lekë më pak se sa është reale në sistemin e tatimeve.
Në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* Kreu III "*Përbërësit e pasqyrave financiare"* Neni 11 *"Qëllimi i pasqyrave financiare"* pika 1 *"Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*".
Për situatën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Shpenzime telefoni. Nga Titullari kanë dalë urdhrat nr.101 datë 28.12.2023 dhe nr.86 datë 28.05.2025 për *"Pajisjen me numëra telefoni celular punonjësit e shoqërisë"* dhe bashkëlidhur këtyre urdhrave janë listat me emra dhe numra të punonjësve. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë ka lidhur kontratë me shoqërinë "O A" për t'i pajisur me numra telefoni celular punonjësit e saj dhe për numëra që përdoren për pajisjet e leximit të matësave. SHRUK Korça për periudhën e auditimit ka shpenzuar për këto shërbime vlerën totale prej 5,067,231 lekë, sipas tabelës më poshtë:

Muaji/Viti	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Total faturuar
Janar	127,757	156,594	159,434	443,784
Shkurt	125,381	162,346	157,695	445,423
Mars	147,120	154,638	161,462	463,220
Prill	130,843	148,416	174,025	453,283
Maj	139,605	155,187	178,902	473,694
Qershor	136,613	153,960	178,386	468,959
Korrik	140,166	160,147	146,850	447,163
Gusht	145,948	165,684	173,522	485,153
Shtator	140,206	167,478	175,786	483,470
Tetor	154,332	157,893	-	312,225
Nentor	140,381	158,214	0	298,595
Dhjetor	133,991	158,271	0	292,263
Totali				5,067,231

Nga kjo vlerë përjashtohen: 1. Ndalesat në pagë për ata punonjës që kanë tejkaluar vlerën e kontratës;
2. Numërat e telefonit celular të administratorit, drejtorit të drejtorisë së shitjes dhe marrëdhënieve me klientin, drejtorit të drejtorisë ekonomike, drejtorit të departamentit teknik, drejtorit të drejtorisë ITUN, drejtorit të departamentit tregtar, drejtorit të drejtorisë së kanalizimeve;
3. Numërat që përdoren për pajisjet e leximit të matësave të ujit.

Konstatohet se për periudhën e auditimit, pjesa tjetër e numrave të telefonit celular që i përkasin punëmarrësve të SHRUK Korçë me vlerë totale prej 3,213,713 lekë, është në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 i ndryshuar *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 4 *"Parimet e funksionit të sistemit buxhetor",* dhe VKM nr. 673 datë 02.09.2020 pika 12 "*Drejtuesit e shoqërisë tregtare, me kapital 100 % shtetëror, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme...",* pika 3 e lidhjes nr. 5 "*Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme si dhe çdo funksionar në nivel drejtues i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfituesish përfshihen edhe funksionet "këshilltar në kabinetin e titullarit" apo "zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit", që kanë pagë të këtij niveli".*
Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë.

Auditimi i Shpenzimeve viti 2023
- Pasqyra e performancës 2023

Të Ardhura dhe Shpenzime 2023, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë			
Nr. Llog.	**Përshkrimi i llogarisë**	**Vlera debi**	**Vlera Kredi**
702	Shitje e produkteve te ndermjetem		101,315,439
703	Shitje e nenprodukteve		66,767,416
7041	Te ardhura pike lidhje vendosje ujesjelles		7,928,444
7042	Te ardhura pike lidhje vendosje kanalizime		647,818
705	Shitje mallrash		1,140,649
7088	Te tjera		4,065,293
722	Prodhimi i AA materiale		21,293,697
754	Dhurata e ndihma te marra		44,324,753
757	Penalitete dhe gjoba te arketuara		15,000
767	Te ardhura nga interesat		102,766
7671	Te ardhura nga kamatat		9,246,743
768	Te ardhura te tjera financiare		1,926,069
769	Fitim nga kembimet valutore		3,437,967
Totali të ardhura			**547,480,208**
601	Blerje /shpenzime te materialeve	8,227,678	
6031	Ndrysh.gjend.mater.para	34,534,000	
604	Bl.energji,avull,uje	72,471,750	
608	Blerje /shpenzime te tjera	1,526,877	
615	Mirembajtje dhe riparime	6,401,926	
616	Sigurime	1,688,328	
618	Te tjera	29,629,517	
619	Te tjera	4,107,652	
621	Personel nga jashte ndermarjes	7,200,016	
623	Shpenzime per licensa dhe te ngjashme	4,590,065	
624	Publicitet,reklama	1,377,817	
625	Transferime, udhetim, dieta	1,390,846	
626	Shpz.postare e telekom.	1,554,161	
628	Sherbime bankare	379,905	
634	Taksa dhe tarifa vendore	20,221	
635	Taksa e regjistrimit	721,283	
638	Tatime te tjera	278,832	
641	Pagat dhe shperblimet e personelit	175,895,927	
644	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	30,511,287	
648	Shpenzime te tjera per personelin	7,777,743	
653	Subvencione te dhena	1,000,000	
657	Gjoba dhe demshperblime	5,743,224	
658	Shpenzime te tjera	509,633	
667	Shpenzime per interesa	57,796,850	
668	Shpenzime financiare te tjera	1,275,336	
669	Humbje nga kembimet valutore	4,602,373	
675	Gabime te lejueshme nga ushtrime te kaluara	(285,731)	
6811	amortizim i AQ afatgjate	162,960,273	
Total Shpenzime		**623,887,788**	
	Fitimi para tatimit		**(76,407,579)**
	Tatimi mbi fitimin		-
	Fitimi Neto i periudhës 2023		**(76,407,579)**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga llogaritë e shpenzimeve në pasqyrën e performancës të vitit 2023 u analizuan llogaritë si më poshtë:

Llogaria 615 “Mirëmbajtje dhe riparime” në pasqyrën e performancës të vitit 2023 paraqitet në vlerë 6,401,926 lekë, e cila përbëhet nga shpenzime “mirëmbajtje sistemesh” në vlerë 1,504,026 lekë dhe shpenzime për mjetet e transportit në vlerë 4,897,900 lekë.
Auditimi për këtë llogari u fokusua tek shpenzimet e bëra në vitin 2023 për mjetet e transportit me vlerë 4,897,900 lekë.
Konstatohet se në këtë vlerë që është shpenzuar për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, përveç kostos së shpenzimeve të mirëmbajtjes periodike të mjeteve (vaj, antifrizë, filtra, ferrota frenimi, goma etj.), në këtë llogari janë përfshirë edhe investimet e bëra për këto mjete me pjesë ndërrimi me vlera të konsiderueshme, duke pasur parasysh vlerën kontabël dhe gjendjen fizike të mjeteve. Vlera e investimit për këto mjete është në vlerën 1,417,600 lekë e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.29/2023 i ndryshuar “*Për tatimin mbi të ardhurat*” neni 51 “*Amortizimi*” pika nr.10 “*Baza e amortizimit është e barabartë me koston e blerjes ose krijimit të aktivit, duke shtuar koston e rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë përkatëse gjatë vitit tatimor*” Gjithashtu, kësaj vlere duke ia zbritur amortizimin e llogaritur sipas periudhave të blerjeve mbetet 1,282,600 lekë. Kjo vlerë ka shtuar shpenzimet e periudhës, ka ulur fitimin para tatimit dhe njëkohësisht ka sjellë mungesën e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 192,396 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2023, në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* Kreu III “*Përbërësit e pasqyrave financiare”* Neni 11 *“Qëllimi i pasqyrave financiare”* pika 1 *“Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*” dhe Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar,* kreu III *“Tatim mbi Fitimin”,* Ligji nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, kreu III *“Tatimi mbi të ardhurat e korporatës”.*

Llogaria 635 “Subvencione të dhëna” në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 1,000,000 lekë e cila është sponsorizim i dhënë nga SHRUK Korça me kërkesën e Bashkisë Korçë për shoqërinë “R” SHPK e cila do të bëje publikime të ndryshme në kuadër të festës së birës në qytetin e Korçës për vitin 2023.

Konstatohet se dhënia e këtij sponsorizimi për shoqërinë “R” SHPK e cila do të bëje publikime të ndryshme në kuadër të festës së birës në qytetin e Korçës për vitin 2023 në vlerë 1,000,000 lekë është në kundërshtim me Ligjin nr.7892 datë 21.12.1994 *“Për sponsorizimet”* neni 3 *“...Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues”.*
Gjithashtu, konstatohet se kjo vlerë është futur dhe në shpenzimet e zbritëshme të vitit 2023 në pasqyrën e performancës, e cila ka rritur shpenzimet në mënyrë të padrejtë dhe njëkohësisht ka ulur fitimin para tatimit në vlerë 1,000,000 lekë, e cila është mungesë e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 150,000 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2023, në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* Kreu III “*Përbërësit e pasqyrave financiare”* Neni 11 *“Qëllimi i pasqyrave financiare”* pika 1 *“Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*” dhe Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar,* kreu III *“Tatim mbi Fitimin”,* Ligji nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, kreu III *“Tatimi mbi të ardhurat e korporatës”.*

Llogaria 6811 “Amortizimi i AQ afat-gjatë” në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 162,960,273 lekë e cila përfshin shumën totale të amortizimit të aktiveve afatgjata për vitin 2024, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Aktive afat gjata materiale	Gjendje 01.01.2023	Shtuar viti 2023	Pakesuar/Amortizuar viti 2023	Gjendje 31.12.2023
1	Toka, troje	22,033,652	-	-	22,033,652
2	Rruge dhe rrethime				-
3	Ndertesa	685,454,881		32,669,132	652,785,749
4	Instalime teknike specifike	6,899,968,150	56,835,325	89,003,743	6,867,799,732
5	Instalime teknike specifike KUZ				-
6	Instalime teknike makineri				-
7	Mjete transporti	15,858,978		3,514,725	12,344,253
8	Mobilje dhe pajisje zyre	377,276,453	2,308,475	34,583,285	345,001,643
9	Aktive afatgjata jo materiale	20,235,341	3,239,106	3,189,387	20,285,060
Total Aktive afatgjata materiale		**8,020,827,455**	**62,382,906**	**162,960,272**	**7,920,250,089**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Vlera totale e amortizimit në pasqyrën e performancës përputhet me vlerën e amortizimit në regjistrat e aktiveve, dhe normat e amortizimit që janë përdorur përputhen me mormat e amortizimit të miratuara nga Asambleja e Aksionerëve.

Llogaria 657 “Gjoba dhe dëmshpërblime” në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 5,743,224 lekë, e cila përbëhet nga detyrimet e ish-njësive:
1. kamatë vonesa për “Tatim mbi Fitimin dhe Tatimi në Burim” nga ish-njësitë Kolonjë, Pustec në vlerën 277,789 lekë;
2. kamatë vonesa për “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” nga ish-njësitë Kolonjë, Pustec, Maliq në vlerë 831,985 lekë;
3. kamatëvonesat për detyrimin e “Energjisë elektrike” nga ish-njësia Maliq në vlerë 4,633,450 lekë.
Nga auditimi konstatohet se vlera 5,743,224 lekë e gjobave është futur në shpenzimet e zbritëshme të periudhës, njëkohësisht ka ulur dhe fitimin para tatimit po në këtë vlerë, e cila është mungesë e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 861,484 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2023, në kundërshtim me Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar* kreu III *“Tatim mbi Fitimin”* neni 21 *“Shpenzime të panjohura”* shkronja f *“gjobat, kamatë-vonesat dhe kushtet e tjera penale”,* Ligji nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, kreu III *“Tatimi mbi të ardhurat e korporatës”* në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* Kreu III “*Përbërësit e pasqyrave financiare”* Neni 11 *“Qëllimi i pasqyrave financiare”* pika 1 *“Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. F. F. me detyrë Drejtore e Departamentit Tregëtar dhe znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

Auditimi i Shpenzimeve viti 2024
- Pasqyra e performancës 2024

Të Ardhura dhe Shpenzime 2024, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë			
Nr. Llog.	**Përshkrimi i llogarisë**	**Vlera debi**	**Vlera Kredi**
701	Shitje e produkteve te gatshem		299,802,053
702	Shitje e produkteve te ndermjetem		107,678,759
703	Shitje e nenprodukteve		66,891,047
7041	Te ardhura pike lidhje plan vendosje ujesjelles		5,646,917
7042	Te ardhura pike lidhje plan vendosje kanalizime		850,407
705	Shitje mallrash		1,892,365
7088	Te tjera		4,195,264
722	Prodhimi i AA materiale		3,179,793
754	Dhurata e ndihma te marra		70,164,672
757	Penalitete dhe gjoba te arketuara		148,000
767	Te ardhura nga interesat		16,151,800
7671	Te ardhura nga kamatat		2,286,997
768	Te ardhura te tjera financiare		1,598,276
769	Fitim nga kembimet valutore		9,999,495
Totali të ardhura			**590,485,845**
601	Blerje /shpenzime te materialeve	27,834,518	
6031	Ndrysh.gjend.mater.para	(3,712,158)	
604	Bl.energji,avull,uje	83,549,288	
608	Blerje /shpenzime te tjera	2,063,031	
613	Qira	1,224,000	
615	Mirembajtje dhe riparime	4,683,520	
616	Sigurime	1,626,548	
618	Te tjera	28,411,559	
619	Te tjera	4,767,592	
621	Personel nga jashte ndermarjes	3,617,616	
623	Shpenzime per licensa dhe te ngjashme	1,557,615	
624	Publicitet,reklama	1,166,634	
625	Transferime, udhetim, dieta	1,196,423	
626	Shpz.postare e telekom.	1,685,716	
628	Sherbime bankare	371,408	
634	Taksa dhe tarifa vendore	23,200	
635	Taksa e regjistrimit	733,855	
638	Tatime te tjera	276,590	
641	Pagat dhe shperblimet e personelit	166,486,620	
644	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	29,205,962	
648	Shpenzime te tjera per personelin	9,325,094	
653	Subvencione te dhena	1,000,000	
657	Gjoba dhe demshperblime	353,055	
658	Shpenzime te tjera	512,517	
667	Shpenzime per interesa	56,055,564	
669	Humbje nga kembimet valutore	1,523,339	
6811	amortizim i AQ afatgjate	155,143,969	
Total Shpenzime		**580,683,075**	
	Fitimi para tatimit		**9,802,770**
	Tatimi mbi fitimin		**0**
	Fitimi Neto i periudhës 2024		**9,802,770**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga llogaritë e shpenzimeve në pasqyrën e performancës të vitit 2024 u analizuan llogaritë si më poshtë:

Llogaria 615 “Mirëmbajtje dhe riparime” në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 4,683,520 lekë, e cila përbëhet nga shpenzime “mirëmbajtje sistemesh” në vlerë 1,056,720 lekë dhe shpenzime për mjetet e transportit në vlerë 3,626,800 lekë.
Auditimi për këtë llogari u fokusua tek shpenzimet e bëra në vitin 2024 për mjetet e transportit me vlerë 3,626,800 lekë.
Konstatohet se në këtë vlerë që është shpenzuar për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, pervç kostos së shpenzimeve të mirëmbajtjes periodike të mjeteve (vaj, antifrizë, filtra, ferota frenimi, goma etj.), në këtë llogari janë përfshirë edhe investimet e bëra për këto mjete me pjesë ndërimi me vlera të kosiderueshme, duke pasur parasysh vlerën kontabël dhe gjendjen fizike të mjeteve. Vlera e investimit për këto mjete është 1,547,000 lekë e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.29/2023 i ndryshuar “*Për tatimin mbi të ardhurat*” neni 51 “*Amortizimi*” pika nr.10 “*Baza e amortizimit është e barabartë me koston e blerjes ose krijimit të aktivit, duke shtuar koston e rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë përkatëse gjatë vitit tatimor*” Gjithashtu, kësaj vlere duke ia zbritur amortizimin sipas periudhave të blerjes mbetet 1,444,300 lekë. Kjo vlerë ka shtuar shpenzimet e periudhës, ka ulur fitimin para tatimit dhe njëkohësisht ka sjellë mungesën e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 216,645 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2024, në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* Kreu III “*Përbërësit e pasqyrave financiare”* Neni 11 *“Qëllimi i pasqyrave financiare”* pika 1 *“Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*” dhe Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”*kreu III *“Tatim mbi Fitimin”,* Ligji nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, kreu III *“Tatimi mbi të ardhurat e korporatës”.*

Llogaritë e shpenzimeve të pagave për vitin 2024 në pasqyrën e performancës, konkretisht llogaria 641 “Paga dhe shpërblime”, 644 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” dhe llogaria 648 “Shpenzime të tjera për personelin” kanë vlerën 205,017,676 lekë, ndërsa në sistemin e tatimeve (e-filling) pagat totale të vitit 2024 janë në vlerë 204,179,481 lekë. Diferenca prej 838,196 lekë i përket shpërblimeve të dhëna ndaj punonjësve, me raste dalje në pension dhe raste fatkeqësie.

Llogaria 6811 “Amortizimi i AQ afat gjatë” në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 155,143,969 lekë e cila përfshin shumën totale të amortizimit të aktiveve afatgjata për vitin 2024, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Aktive afat gjata materiale	Gjendje 01.01.2024	Shtuar viti 2024	Pakësuar/Amortizuar viti 2024	Gjendje 31.12.2024
1	Toka, troje	22,033,652	-	-	22,033,652
2	Rruge dhe rrethime				-
3	Ndertesa	652,785,749	114,550,660	38,724,483	728,611,926
4	Instalime teknike specifike	6,867,799,732	438,710,292	87,858,124	7,218,651,901
5	Mjete transporti	12,344,253	15,377,150	2,468,851	25,252,552
6	Mobilje dhe pajisje zyre	345,001,643	36,452,223	23,001,860	358,452,006
7	Aktive afatgjata jo materiale	20,285,058	1,226,026	3,090,652	18,420,432
Total Aktive afatgjata materiale		**7,920,250,087**	**606,316,351**	**155,143,969**	**8,371,422,469**

Burimi: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Vlera totale e amortizimit në pasqyrën e performancës përputhet me vlerën e amortizimit në regjistrat e aktiveve, dhe normat e amortizimit që janë përdorur përputhen me normat e amortizimit të miratuara nga Asambleja e Aksionerëve.

Llogaria 635 "Subvencione të dhëna" në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 1,000,000 lekë e cila është sponsorizim i dhënë nga SHRUK Korça me kërkesë të Bashkisë Korçë për shqërinë "M&P" SHPK e cila do të bëje publikime të ndryshme në kuadër të festës së birës në qytetin e Korçës për vitin 2024.
Konstatohet se dhënia e këtij sponsorizimi për shoqërinë "M&P" SHPK e cila do të bëje publikime të ndryshme në kuadër të festës së birës në qytetin e Korçës për vitin 2024 në vlerë 1,000,000 lekë është në kundërshtim me Ligjin nr.7892 datë 21.12.1994 *"Për sponsorizimet"* neni 3 *".....Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues".*
Gjithashtu, konstatohet se kjo vlerë është futur dhe në shpenzimet e zbritëshme të vitit 2024 në pasqyrën e performancës, e cila ka rritur shpenzimet në mënyrë të padrejtë dhe njëkohësisht ka ulur fitimin para tatimit në vlerë 1,000,000 lekë, e cila është mungesë e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 150,000 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2024, në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* Kreu III "*Përbërësit e pasqyrave financiare"* Neni 11 *"Qëllimi i pasqyrave financiare"* pika 1 *"Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*" dhe Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar* kreu III *"Tatim mbi Fitimin",* Ligji nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", kreu III *"Tatimi mbi të ardhurat e korporatës".*

Llogaria 657 "Gjoba dhe dëmshpërblime" në pasqyrën e performancës paraqitet në vlerë 353,055 lekë, e cila përbëhet nga kamatevonesa të ndryshme në vlerën 22,695 lekë dhe një gjobë e vendosur nga Agjensia e Kombëtare e Mjedisit në vlerë 330,360 lekë.
Nga auditimi konstatohet se vlera 353,055 lekë e gjobave është futur në shpenzimet e zbritëshme të periudhës, njëhohësisht ka ulur dhe fitimin para tatimit në po këtë vlerë, e cila është mungesë e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin për buxhetin e shtetit në vlerë 52,958 lekë, gjithashtu ka ulur dhe rezultatin e periudhës ushtrimore 2024,, në kundërshtim me Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar"*kreu III *"Tatim mbi fitimin"* neni 21 *"Shpenzime të panjohura"* shkronja f *"gjobat, kamatë-vonesat dhe kushtet e tjera penale",* Ligji nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", kreu III *"Tatimi mbi të ardhurat e korporatës"* në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* Kreu III "*Përbërësit e pasqyrave financiare"* Neni 11 *"Qëllimi i pasqyrave financiare"* pika 1 *"Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike*".

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Asambleja e Përgjithëshme e Aksionerëve, Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Administratori i SHRUK z. P. T., Drejtor Departamenti Tregëtar znj. F. F., Drejtoresha Ekonomike znj. E. F..

Inventarizimi i aktiveve për periudhën objekt auditimi, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë.

Gjatë procedurës së transferimit në fund të vitit 2022 të ish-njësive në shoqëri rajonale, sipas raportit të ekspertit ligjor, janë kryer edhe trasferimet e aktiveve të secilës ish-njësi me fatura tatimore, konkretisht:
-Me faturën nr.63/2022, datë 07.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Pustec (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 52,452,439 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë në vlerën 52,430,839 lekë dhe aktive afatshkurtra në vlerën 21,600 lekë).
-Me faturën nr.7/2022, datë 07.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Maliq (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 537,579,369 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë në vlerën 535,123,602 lekë dhe aktive afatshkurtra në vlerën 2,455,765 lekë).
-Me faturën nr.8/2022, datë 30.12.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Maliq (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën -1,570,476 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë shtuar në vlerën 132,800 lekë dhe aktive afatshkurtra janë pakësuar në vlerën -1,703,276 lekë).
-Me faturën nr.450/2022, datë 06.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Ersekë (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 349,252,354 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë në vlerën 349,248,039 lekë dhe aktive afatshkurtra në vlerën 4,315 lekë).
-Me faturën nr.2/2023, datë 16.06.2023, të ish-Ujësjellës Kanalizime Ersekë (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 234,200 lekë (aktive afatshkurtra në vlerën 234,200 lekë).
-Me faturën nr.76248/2022, datë 08.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Devoll (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 224,464,983 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë në vlerën 209,456,472 lekë dhe aktive afatshkurtra në vlerën 15,008,511 lekë).
-Me faturën nr.76249/2022, datë 30.12.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Devoll (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën -2,119,592 lekë (ku transferim aktive afatgjata materiale janë shtuar në vlerën 377,903 lekë dhe aktive afatshkurtra janë pakësuar në vlerën -2,497,495 lekë).
-Me faturën nr.149355/2022, datë 10.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Korçë (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 98,728,073 lekë (ktive afatshkurtra në vlerën 98,728,073 lekë).
-Me faturën nr.149356/2022, datë 10.11.2022, të ish-Ujësjellës Kanalizime Korçë (si shitës) drejt Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (si blerës) në shumën 7,220,981,325 lekë (aktive afatgjata materiale janë në vlerën 7,220,981,325 lekë).

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar që sanksionin se: *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës"*

Më konkretisht:
- Për vitin 2023, nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.69, datë 18.09.2023, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve "Vegla pune", "Mjete transporti", Mobilje dhe orendi", "Pajisje zyre dhe orendi" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë (2 prej të cilëve IT, 2 ekonomist dhe 1 ing elektrik), (zj.E. F., zj. E K, zj. K B, z. R Rr dhe zj.M K).
Nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.71, datë 18.09.2023, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve "Instalime teknike komplekse", "Instalime teknike specifike" dhe "Ndërtesa dhe toka" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 7 anëtarë (zj.E. F., z. I. P., zj.M. K., z. , z. V. M. , z. E. H. dhe zj.E K).
Nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.72, datë 18.09.2023, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit për "Aktivet monetare" dhe "Aktivet afatgjata jo materiale" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë (zj.E. F., zj. E. G. , zj.E K, zj. E. B. dhe zj.A. K.).
Nëpërmjet Urdhrit të Titullarit nr.101, datë 28.12.2023, është ngritur komisioni për nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjesimit të aktiveve të konstatuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit. Komisioni është i përbërë nga 7 anëtarë (zj. P. Znj. Kryetare, zj.E. B., z. E. J., zj.A. K., z.V. M. , zj. M. N. dhe z. V. P.).
Nga auditimi i dokumentave të inventarizimit dhe nga verifikimi fizik me përzgjedhje, në magazinën e materialeve u konstatuan disa materiale me qarkullim të ngadaltë. Pjesa më e madhe e materialeve me qarkullim të ngadaltë vjen nga periudha kur është investuar rrjeti i ri i ujësjellësit në vitet 2002/2003.
Njësia duhet të mbajë materiale gjendje në magazinë aq sa i nevojiten për kryerjen e objektivitetit të saj, nëse këto materiale kalojnë një periudhë të caktuar të magazinuara e humbin vlerën e materialitetit të tyre, sipas Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2018 i ndryshuar i MFE, seksionet "*Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë*", "*Menaxhimi i riskut të lidhur me aktivet*", *"Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme..."*pika 107, 108.
Nga auditimi konstatohet se komisioni i inventarizimit për vitin 2023 nuk ka mbajtur një raport mbi gjendjen e aktiveve ku të përshkruheshin verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve, të përpilohej një raport lidhur me inventarizimin fizik të tyre, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, e cila është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 të MFE datë 27.12.2011 pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: ... gërma c *"Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet",* për të cilën ngarkohet me përgjegjësi znj. E. F. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.
Konstatohet se aktivet të cilat Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit i ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në datën 17.01.2024 ka mbajtur një "Procesverbalit asgjësimi" ku ka asgjësuar me shkatërrim aktivet si (Vegla pune, Mobilie dhe Orendi, Pajisje zyre dhe informatike, Makineri dhe pajisje) të cilat janë dokumentuar me foto gjatë procesit të asgjësimit dhe i janë bashkëlidhur këtij procesverbali. - Aktivet e klasave "Vegla pune dhe Makineri e pajisje" të cilat janë shkatërruar nga Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit, ndodhen ende në ambientet e SHRUK Korçë të cilat janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 të MFE pika 109 *"Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen)...."*.
- Aktivet e klasave "Mobilje dhe orendi, Pajisje zyre dhe informatike" të cilat janë shkatërruar dhe janë hedhur si mbeturina nga Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit, janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10 463 datë 22.09.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", Vendimi Nr.418 datë

25.06.2014 *"Grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim",* pika II *"Objekt i këtij vendimi është realizimi i grumbullimit të diferencuar për këto rryma mbetjesh: Letër/Karton, Metal, Plastikë, Qelq"...* dhe Vendimi nr.957 datë 19.12.2012 *"Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"* Kreu III "Grumbullimi i diferencuar".

- Për vitin 2024, nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.304, datë 23.09.2024, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe për "Aktivet monetare" dhe "Aktivet afatgjata jo materiale" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë (zj.E. F., zj.E. G. , zj.E K, zj.E. B. dhe zj. B. B.)
Nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.305, datë 23.09.2024, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve "Vegla pune", "Mjete transporti", Mobilje dhe orendi", "Pajisje zyre dhe orendi" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë (zj.E. F., zj.E K, zj.K B, z. V. L. , znj. M. K.)
Nëpërmjet Urdhërit të Titullarit nr.306, datë 23.09.2024, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve "Instalime teknike komplekse", "Instalime teknike specifike" dhe "Ndërtesa dhe toka" të SHRUK Korçë. Komisioni është i përbërë nga 7 anëtarë (zj.E. F., z.I. P., z. M. G. , z.Th. K., z.V. M. , z.V. L. dhe zj.E K)
Para fillimit të inventarit, nga komisioni i inventarizimit nuk është mbajtur procesverbal, ku të fiksohej numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, sipas përcaktimit të paragrafit 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.
Nga auditimi konstatohet se komisioni i inventarizimit për vitin 2024 nuk ka mbajtur një raport mbi gjendjen e aktiveve ku të përshkruheshin verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve, të përpilohej një raport lidhur me inventarizimin fizik të tyre, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, e cila është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 te MFE pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: ... germa c *"Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet".*

Regjistrimi i Pronave. Nga auditimi rezulton se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë disponon 176 pasuri (prona). Konstatohet se nga totali i pronave të SHRUK Korçë vetëm 5 prona në qytetin e Korçës janë të pajisura me certifikata pronësie por janë në emrin e ish-njësisë Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe 25 prona në rrethin e Devollit janë të pajisura me certifikata pronësie por janë në emrin e Bashkisë Devoll, pjesa tjetër prej 146 prona nuk janë pajisur me certifikata pronësie dhe nuk janë bërë aplikime nga SHRUK Korçë për regjistrimin e tyre. Gjithashtu, konstatohet se nga totali i pronave prej 176 prona, 32 prona në rrethin e Korçës dhe 31 prona në rrethin e Kolonjës janë të pa kontabilizuara. Për sa më lart është në kundërshtim me VKM 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur", dhe Ligjin 20/2020 "Për Përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i SHRUK z. P. T., Drejtor Departamenti Tregëtar znj. F. F., Drejtoresha Ekonomike znj. E. F., Anëtarët e komisionit të inventarizimit, Anëtarët e komisionit të vlerësimit, Anëtarët e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve.

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Sipas të dhënave të SHRUK Korçë realizimi i procedurave të prokurimit sipas viteve, llojit të procedurës dhe atyre të audituara është si në vijim:

Në lekë

Viti 2023					
Lloji i procedurës	Realizuar			Audituar	
	Numri	Fondi limit	Fondi i kontraktuar	Numri	Fondi i kontraktuar
E hapur lokale	3	83,708,917	69,073,073		
E hapur e thjeshtuar	8	39,974,094	35,073,415	2	8,534,100
Blerje dinamike bileta	1	297,074	288,170		
Procedura gjithsej	12	123,980,085	104,434,658	2	8,534,100
Viti 2024					
E hapur nderkombetare	1	70,300,000	55,888,800		
E hapur lokale	6	289,713,135	186,837,948	1	76,338,690
E hapur e thjeshtuar	10	31,558,610	25,412,004	2	6,792,259
Blerje dinamike bileta	1	110,740	59,473,922		
Procedura gjithsej	18	391,682,485	327,612,674	3	83,130,949
viti 2025					
E hapur lokale	2	91,823,295	70,114,643	1	58,657,043
Ehapur e thjeshtuar	7	22,664,665	20,675,503	2	7,069,160
Blerje dinamike bileta	1	200,000	180,500		
Gjithsej	10	114,687,960	90,970,646	3	65,726,203

Burimi: SHRUK Korçë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023**

Procedurë e hapur të thjeshtuar, mallra, me objekt "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", me fond limit 4,883,000 lekë, zhvilluar më datë 03.04.2023.
Me Urdhrin e zyrtarit të autorizuar nr. 216 prot., datë 16.03.2023 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje: M. K. (ing. Hidroteknike) dhe O. H. (ekonomiste). Më datë 20.03.2023 është përgatitur relacioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mungesën e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme për arritjen e kërkesave operacionale me minimumin e riskut dhe të kostos për mbajtjen e këtyre aktiveve. Mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet "*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit,* ***duhet të argumentojë*** *dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*"

Për përllogaritjen e fondit limit, sipas këtij relacioni janë bazuar në marrjen e tre ofertave nga OE B. F. , 2 AT dhe A C, nga ku ka rezultuar oferta mesatare prej 4,883,000 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur këtij relacioni gjenden një tabelë me 14 artikuj e datës 18.03.2023 nga B. F. dhe 2 AT, si dhe e datës 17.03.2023 e A C, të pashoqëruara me specifikimet teknike. Fakti që specifikimet teknike janë përgatitur pas marrjes së ofertave (më datë 20.03.2023 kundrejt datave 17 e 18.03.2023 të marrjes së ofertave), mungesa e gjurmës së auditimit për mënyrën e kërkesës dhe të marrjes së ofertave, si dhe ofertat në mungesë të specifikimeve teknike e bën formal procesin e llogaritjes së fondit limit, jo në përputhje me pikën 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar: "*Autoriteti/enti kontraktor mund t΄i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*"

Më datë 20.03.2023 ka dalë urdhri nr.216/2 prot., datë 20.03.2023 për caktimin e personit përgjegjës që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet teknike si dhe çdo informacion tjetër të znj. M. K..

Urdhri i prokurimit nr.216/3 prot., datë 20.03.2023, për procedurën e hapur e thjeshtuar, me fond limit 4,883,000 lekë, ka përcaktuar Njësinë e Prokurimit me përbërje: K. D. (juriste), M. K. (inxhinere hidroteknike) dhe O. H. (ekonomiste).

Procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik datë 21.03.2023 nga M. K., dhe po në këtë datë procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, si dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike (M. K.) dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit.

Urdhri nr.216/8 prot., datë 21.03.2023 ka emëruar e KVO me përbërje: Ing. V. C. , Ing. I. P. dhe Ing. Th. K..

Sipas proces-verbalit të hapjes së ofertave datë 03.04.2023, kanë rezultuar pjesëmarrës tre OE me ofertat e mëposhtëm:

1. "A 2" SHPK, vlera 3,476,300 lekë;
2. "E Th" SHPK, vlera 3,594,300 lekë;
3. "A C " SHPK, vlera: 4,756,000 lekë.

Procesverbali i dorëzimit të mostrave nr. 1, datë 03.04.2025 i OE "A 2" SHPK, duke pasqyruar detajet që për mostrat e depozituara nuk jepet firma prodhuese dhe Procesverbali i dorëzimit të mostrave nr. 2, datë 03.04.2025 i OE "E Th" SHPK duke pasqyruar detajet që për mostrat e depozituara nuk jepet firma prodhuese. KVO, në kushtet e mungesës së emrit të firmës prodhuese dhe klasës së tubit, duhej të kishte refuzuar ofertat e këtyre dy OE, pasi mostrat e dorëzuara të 7 artikujve tubo nuk plotësojnë kriteret e Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike, që "*Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:*

- *Emrin e prodhuesit*
- *Klasën e tubit."*

KVO më datë 07.04.2023 i ka kërkuar sqarime OE "E Th" SHPK lidhur me tubot e brinjëzuara, pasi ka paraqitur katalog teknik të firmës prodhuese "K h " në të cilin përputhen te dhënat teknike me specifikimet teknike të DT dhe mostrat e kësaj firme; katalogu teknik i firmës prodhuese "F" SHPK në të cilin të dhënat teknike të tubove nuk përputhen me specifikimet teknike të DT, pasi diametrat e brendshëm nuk janë ato të kërkuara. Nëpërmjet kësaj kërkese, kërkohet sqarim me shkrim në mënyrë të qartë se cilat nga tubot e brinjëzuar merrni përsipër të ofroni.

Më datë 07.04.2023 është kthyer përgjigje nga subjekti, duke cilësuar se do të vërë në dispozicion tubot e brinjëzuar sipas katalogut teknik të firmës prodhuese "K h ". Një veprim i tillë i KVO nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, pasi OE "E Th" SHPK nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 2.2.3 të Kapaciteti teknik dhe profesional i operatorëve ekonomikë, të Shtojcës 7- Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit, ku përcaktohet: "*Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT, shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin* ***katalogë teknike për të gjithë*** *mallrat furnizues,* ***ku të jepet qartë*** *që mallrat, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara*.".

KVO më datë 07.04.2023 i ka kërkuar sqarime OE "E Th" SHPK lidhur me ofertën anomalisht të ulët, për të argumentuar dhe dokumentuar me prova shkresore sqarimet për elementë të veçantë të ofertës për të gjitha zërat në tërësi, dhe në veçanti për tubot PVC brenda 5 ditëve kalendarike. Vendosja e një afati të tillë është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 93 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar: "*Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë*".
Përgjigja nga subjekti është protokolluar më datë 11.04.2023, ku cilësohet se sipas ofertave të marra, ndërsa për tubot e brinjëzuar janë të llogaritura dhe shpenzimet dhe taksat të cilat shkojnë +25 % nga çmimi blerjes dhe firma ka vendosur të punojë me normë fitimi 25-35 %. Bashkëlidhur përgjigjes gjenden një listë çmimesh për dy artikuj tubo PVC nga "I g " e datës 30.03.2023, dhe ofertë nga "K h " e datës 17.03.2023 e vlefshme deri më datë 01.04.2023, pra kjo ofertë është pavlefshme më datë 11.04.2023.

Me vendimin nr.1, datë 11.04.2023, KVO ka skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. "A 2" SHPK, për arsye se mostrat e paraqitura për tubot e brinjëzuara, nuk përputhen me specifikimet teknike të DT sepse diametrat e brendshëm të tubove të brinjëzuara nuk janë ato të kërkuara; katalogu teknik i paraqitur i firmës "F" SHPK, në të cilin për tubot e brinjëzuara tregohet vetëm që janë Tubo të korruguar me dimensione: Ø 110 – Ø 1000, pa specifikuar nëse diametri i referohet diametrit të brendshëm të tubove (± 2 %), pra katalogu i paraqitur nuk dëshmon nëse tubot e ofruara kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.
2. "A C " SHPK, për arsye se, nuk paraqiti mostra për mallrat furnizues.

KVO ka kualifikuar dhe vendosur në vend të parë OE "E Th" SHPK me vlerë 3,594,300 lekë, po në këtë datë njoftuar për dorëzim dokumentesh dhe dorëzuar më datë 12.04.2023.

Nga shqyrtimi i kësaj procedure në SPE dhe i dosjes përkatëse konstatohet:
- Nga krahasimi i specifikimeve teknike (shtojca 5 e DT) sipas artikujve me katalogët e paraqitur nga OE "E Th" SHPK i shpallur fitues konstatohet se për artikullin "Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, sasia 696 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove (± 2%), sipas katalogut të subjektit "K h" , i deklaruar nga OE se i përket artikujve për tubot e brinjëzuar, nuk gjendet artikull i tillë në këtë katalog; nuk ka katalog për artikujt: "Element lidhës Y PVC D 100 mm", "Element lidhës T PVC D 100 mm" dhe "Gominë D 100 mm";
- Sipas Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike: "*Guarnicionet që lidhin tubot duhet të jenë në përshtatje me standardet e lartpërmendura. Prova e hermeticitetit duhet të jetë konform Standardit DIN EN 1610 ose sipas standardit shqiptar SSH ekuivalent i këtij standardi."*

Sipas katalogëve konstatohet se, katalogu "I" I g SHPK për rakorderi nuk ka të përcaktuara standarde DIN EN 1610 ose *SSH ekuivalent i këtij standardi;*
- Sipas Seksioni 5: Informacion shtesë: pika 5.2 të DT, përcaktohet se "*Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:*

- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike"*.

Për këtë OE "E Th" SHPK i shpallur fitues ka paraqitur certifikatë bilanc fiskal të datës 24.12.2020 dhe kontratë me kompaninë e certifikuar për shitjen dhe shërbimin e programit "Bilanc fiskal" datë 13.01.2023. Bazuar në natyrën e secilit prej dokumenteve të kërkuar dhe të paraqitur: Certifikata Elektronike e Fiskalizimit është mjet teknik - juridik (certifikatë sigurie / nënshkrim elektronik), që shërben për identifikim dhe nënshkrim elektronik të faturave dhe përdoret në kohë reale gjatë ushtrimit të aktivitetit të subjektit; ndërsa Bilanci fiskal është pasqyrë deklarative tatimore, që përgatitet periodikisht (vjetore) dhe shërben për llogaritjen e tatimit mbi fitimin.

Nga sa më sipër konstatohet se, OE "E Th" SHPK është kualifikuar dhe shpallur fitues nga ana e KVO në mungesë të plotësimit të kritereve dhe kushteve të përcaktuara në DT, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, i cili përcakton: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Kontrata e furnizimit me nr.216/23, datë 27.04.2023, me vlerë 3,594,300 lekë me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Njësia mbikëqyrëse me urdhrin nr.216/24 prot, datë 27.04.2023 me përbërje Ing. V. C. , Ing. Th. K. dhe O. H. .

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se furnizimi është kryer me fletë – hyrjet e mëposhtme: nr. 17, datë 08.05.2023; nr. 18, datë 09.05.2023; nr. 24, datë 10.05.2023; nr. 25, datë 12.05.2023; nr. 26, datë 15.05.2023 dhe nr. 27, datë 15.05.2023 të firmosura nga njësia mbikëqyrëse, si dhe nga magazinieri.
Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nga struktura e ndjekjes së kontratës, pa përfshirë punonjësin me përgjegjësi materiale është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 43. "*Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale*."
Në asnjë prej faturave nuk është shoqëruar me certifikatën e prodhuesit, në kundërshtim me përcaktimet në Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike, paragrafi i fundit: *"Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t'i shoqërojë me certifikatën e prodhuesit, që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara"*.

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", me fond limit 4,883,000 lekë, zhvilluar më datë 03.04.2023, dhe zbatuar me kontratën nr. 216/23, me kontraktorin "E Th" SHPK datë 27.04.2023, me vlerë 3,594,300 lekë me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike, konstatohet se:

- Gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mungesën e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme për realizimin e kërkesave operacionale me minimumin e riskut dhe të kostos për mbajtjen e këtyre aktiveve, jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Kryerja e procedurës së përllogaritjes së fondit limit nëpërmjet alternativës së tregut, në mungesë të specifikimeve teknike, pasi janë përgatitur më pas, si dhe mungesa e gjurmës se auditimit mbi mënyrën e marrjes së këtyre ofertave, e bën këtë proces jo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar;
- Mungesa e pasqyrimit të firmës prodhuese në mostrat e dorëzuara, për dy OE "A 2" SHPK dhe OE "E Th" SHPK, duhej të sillte automatikisht skualifikimin e tyre, pasi nuk plotësojnë specifikimet teknike, që çdo tub të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente emrin e prodhuesit dhe klasën e tubit;
- KVO duke i kërkuar sqarime OE "E Th" SHPK lidhur me tubot e brinjëzuara të ofruara, se cilit katalog i përkasin pasi OE ka paraqitur dy katalogë, ka tejkaluar kompetencat e veta, pasi OE nuk ka përmbushur kërkesat e pikës 2.2.3 të kritereve të kualifikimit, pasi katalogët teknikë duhet të japin qartë që mallrat, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara;
- KVO ka pranuar sqarime nga OE "E Th" SHPK lidhur me ofertën anomalisht të ulët, edhe pse bashkëlidhur përgjigjes gjendet një ofertë nga "K h " e datës 17.03.2023 e vlefshme deri më datë 01.04.2023, në një kohë që tenderi është zhvilluar më datë 11.04.2023.
- KVO ka kualifikuar dhe vendosur në vend të parë OE "E Th" SHPK, në kushtet kur nuk gjenden në katalog "Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë; sipas katalogëve konstatohet se, katalogu "I" I g SHPK për rakorderi nuk ka të përcaktuara standarde DIN EN 1610 ose SSH ekuivalent i këtij standardi;
- OE në vend të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit ka paraqitur certifikatë bilanci fiskal, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, pasi nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim;
- Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 43
- Në asnjë prej faturave mallrat nuk janë shoqëruar me certifikatën e prodhuesit, në kundërshtim me përcaktimet në Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike të DT.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Znj. F. F.me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. O. H. , në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. V. C. , në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Z. I. P., në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Z. Th. K., në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2024**

Procedura e prokurimit e llojit e hapur e thjeshtuar, mallra, me objekt “Blerje tubo për rrjetin e kanalizimeve”, me fond limit 1,682,409 lekë është zhvilluar më datë 08.04.2024.

Me Urdhrin nr. 167 prot., datë 28.02.2024 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje: M. K. (ing. Hidroteknike) dhe E. B. (ekonomiste).

Më datë 20.03.2024 është hartuar relacioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi. Një mangësi e tillë sjell për pasojë mbingarkesën e stokut të mallrave dhe/ose prokurime të panevojshme, veprime jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Për përllogaritjen e fondit limit, sipas këtij relacioni janë bazuar në marrjen e tre ofertave nga OE:
- A C, e datës 19.03.2024, e cila ka 10 artikuj nga 7 në specifikimet teknike: nuk ka në ofertë artikullin “tubo pvc 110 mm”, dhe struktura e posaçme e ka llogaritur me 361 lekë për ml; ndryshojnë sasitë në ofertë dhe ato në specifikimet teknike; të pashoqëruara me specifikimet teknike.
- S Q e datës 19.03.2024, oferta njëlloj si më sipër;
- “E Th” SHPK e datës 20.03.2024, oferta njëlloj si më sipër;

Mangësitë e mësipërme e bëjnë formal procesin e llogaritjes së fondit limit, jo në përputhje me pikën 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar: “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës,* ***me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë***”
Sipas kësaj strukture fondi limit si mesatare e tre ofertave ka rezultuar 1,682,409 lekë. Më datë 21.03.2024 ka dalë Urdhri nr.167/2 prot., për caktimin e personit përgjegjës që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet teknike si dhe çdo informacion tjetër znj. M. K., inxhiniere hidroteknike.

Urdhri i prokurimit nr.167/3 prot., datë 21.03.2024, ka përcaktuar procedurën me fond limit 1,682,409 lekë dhe Njësi Prokurimi me përbërje: K. D. (juriste), M. K. (inxhinere hidroteknike) dhe E. B. (ekonomiste).

Procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik datë 25.03.2024 nga M. K. dhe po në këtë datë procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, si dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike (M. K.) dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit.

Urdhri nr.167/8 prot., datë 25.03.2024 ka emëruar KVO me përbërje: Ing. V. C. , Ing. I. P. dhe Ing. Th. K..

Sipas proces-verbalit të KVO të hapjes së ofertave të datës 08.04.2024, kanë rezultuar pjesëmarrës dy OE me ofertat e mëposhtme:

1. ”Dh” SHPK, vlera 1,497,300 lekë,
2. “E Th” SHPK, vlera 1,656,000 lekë.

Procesverbali i dorëzimit të mostrave nr.1, datë 08.04.2024 i OE “E Th” SHPK, duke pasqyruar detajet që për mostrat e depozituara: për dy artikuj PVC nuk kanë përcaktuar firmën prodhuese, ndërsa për tubot e brinjëzuar është cilësuar firma prodhuese “K h ”.
KVO, në kushtet e mungesës së emrit të firmës prodhuese dhe rezistencës në presion (SDR) të dy tubave plastike, duhej të kishte refuzuar ofertën e këtij OE, pasi mostrat e dorëzuara të 2 artikujve tubo nuk plotësojnë kriteret e Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike, që “*Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:*
• *Emrin e prodhuesit*
• *Rezistencën në presion (SDR)*
Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente).
Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike”.

Me vendimin nr.1 të Komisionit të vlerësimit të ofertave, nr.167/11 prot., datë 08.04.2024 është s’kualifikuar ofertuesi ”Dh” SHPK për arsyet e mëposhtme:
1. Ofertuesi nuk përmbush kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.2, Shtojca 7 e DT, për arsye se nuk paraqiti mostra për tubot e ofruara.
2. Ofertuesi nuk përmbush kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.3, Shtojca 7 e DT, lidhur me tubot e brinjëzuara, për arsye se sipas katalog teknik të firmës “T.I” SHA, të paraqitur nga ofertuesi rezulton që:
- Tubot PE SN4 kanë diametër të jashtëm 200 mm, ndërsa diametri i brendshëm është 178 mm , duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN4 me diametër të brendshëm 200 mm (± 2%), me diferencë pra 11 % nga diametri i kërkuar;
- Tubot PE SN4 me diametër të brendshëm 300 mm (± 2%) nuk paraqiten fare;
- Tubot PE SN8 kanë diametër të jashtëm DN 500 mm, ndërsa diametri i brendshëm është 438 mm, duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN8 me diametër të brendshëm 500 mm (± 2%), me diferencë pra 12,4 % nga diametri i kërkuar;
- Tubot PE SN8 kanë diametër të jashtëm DN 200 mm, ndërsa diametri i brendshëm është 178 mm, duke mos përmbushur kërkesën e AK që kërkon tubo PE SN8 me diametër të brendshëm 200 mm (± 2%), me diferencë pra 11 % nga diametri i kërkuar.
Pra katalogu i paraqitur dëshmon se tubot e ofruara si më sipër nuk kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

- Nga shqyrtimi në SPE konstatohet se OE “E Th” SHPK me ofertë me vlerë 1,656,000 lekë kualifikuar dhe shpallur fitues nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2.2.3, Shtojca 7 e DT: “*Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT, shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues,* ***ku të jepet qartë që mallrat, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.*** *Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të jenë të përkthyera dhe të noterizuara në gjuhen shqipe*”.
- OE i kualifikuar dhe shpallur fitues “E Th” SHPK për artikujt e PVC ka paraqitur katalog nga “I” I g SHPK dhe për artikujt e korrigjuar katalog nga F SHPK, K h dhe për dy llojet T I Në asnjërin prej këtyre nuk jepet qartë se mallrat e ofertuara janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

- Nga krahasimi i specifikimeve teknike (shtojca 5 e DT) sipas artikujve me katalogët e paraqitur nga OE "E Th" SHPK i shpallur fitues konstatohet se për artikujt:
- 1.Tubo PVC OD 110 , *sasia 210 ml. Diametri OD i referohet diametrit të jashtëm të tubove (± 2%). Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për rezistencën në presion (SDR) -31.*
Sipas katalogut të "I", në tabelën e paraqitur SDR është 35, çka do të thotë se është më pak rezistent ndaj deformimit.
Sipas katalogut "I", për këtë është paraqitur një tabelë me titull ± 2 % – SDR 35, e ndarë në dy kolona: DN Ø dhe spensori, duke bërë të pamundur dhe të paqartë për të identifikuar, në se Ø i referohet diametrit të brendshëm dhe në se plotëson kërkesat e specifikimeve teknike, nga 100 - 160 mmm. Pra katalogu i paraqitur nuk dëshmon qartë nëse tubot e ofruara kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.
2. Tubo PVC OD 160, *sasia 420 ml, Diametri OD i referohet diametrit të jashtëm të tubove (± 2%) . Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për Rezistencën në presion (SDR) -35.*
Sipas katalogut "I", për këtë është paraqitur një tabelë me titull ± 2 % – SDR 35, e ndarë në dy kolona: DN Ø dhe spensori, duke bërë të pamundur dhe të paqartë për të identifikuar, në se Ø i referohet diametrit të brendshëm dhe në se plotëson kërkesat e specifikimeve teknike, nga 100-160 mmm. Pra katalogu i paraqitur nuk dëshmon nëse tubot e ofruara kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Tubo HDPE të brinjëzuar, *Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, sasia 180 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë.*
Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%) .
Në katalogun e subjektit "K h " për tubot e brinjëzuar nuk gjendet artikull i tillë në këtë katalog.
- Në DT Seksioni 5: Informacion shtesë: pika 5.2 përcakton që "*Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:*

- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike".*

OE ka paraqitur certifikatë bilanc fiskal të datës 24.12.2020 dhe kontratë me kompaninë e certifikuar për shitjen dhe shërbimin e programit "bilanc fiskal" datë 15.01.2024. Bazuar në natyrën e secilit prej dokumenteve: Certifikata Elektronike e Fiskalizimit është mjet teknik - juridik (certifikatë sigurie / nënshkrim elektronik), që shërben për identifikim dhe nënshkrim elektronik të faturave dhe përdoret në kohë reale gjatë ushtrimit të aktivitetit të subjektit; ndërsa Bilanci fiskal është pasqyrë deklarative tatimore, që përgatitet periodikisht (vjetore) dhe shërben për llogaritjen e tatimit mbi fitimin. Pra subjekti nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për nënshkrimin e një kontrate publike.

Nga sa më sipër konstatohet se, OE "E Th" SHPK është kualifikuar dhe shpallur fitues nga ana e KVO në mungesë të plotësimit të kritereve dhe kushteve të përcaktuara në DT, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, i cili përcakton: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Kontrata me nr.167/21 prot., datë 30.04.2024, me vlerë 1,656,000 lekë me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit, me strukturë të ndjekjes së kontratës Ing. V. C. , ing Th. K. dhe O. H. sipas Urdhrit nr.167/21 prot., datë 30.04.2023. Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara nga struktura e ndjekjes së kontratës, pa përfshirë punonjësin me përgjegjësi materiale është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011
"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 43. "*Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale*."

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se kontrata është realizuar në mënyrë pjesore nga data 27.05.2024 deri më datë 30.05.2024 nëpërmjet 4 fletë-hyrjeve, për të cilët nga njësia mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbalet përkatëse, duke cilësuar se, "*Gjatë kontrollit të furnizimit nuk është vërejtur asnjë mangësi dhe furnizimi është kryer në zbatim dhe konform të nenit 2, nenit 3 dhe nenit 4*".

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", me fond limit 1,682,409 lekë, zhvilluar më datë 08.04.2024, dhe zbatuar me kontratën me nr. 167/21, datë 30.04.2024, me vlerë 1,656,000 lekë me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike, konstatohet se:
- Gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mungesën e një balance të saktë midis mbajtjes së një gjendjeje të mjaftueshme për realizimin e kërkesave operacionale me minimumin e riskut dhe të kostos për mbajtjen e këtyre aktiveve, jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Kryerja e procedurës së përllogaritjes së fondit limit nëpërmjet alternativës së tregut, në mungesë të specifikimeve teknike, pasi janë përgatitur më pas, si dhe mungesa e gjurmës se auditimit mbi mënyrën e marrjes së këtyre ofertave, e bën këtë proces jo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar;
- Mungesa e pasqyrimit të firmës prodhuese në mostrat e dorëzuara për dy artikuj PVC, për OE "E Th" SHPK, duhej të sillte automatikisht s'kualifikimin e tyre, pasi nuk plotësojnë specifikimet teknike, që çdo tub të ketë të shënuar në mënyrë permanente emrin e prodhuesit dhe klasën e tubit;
- KVO ka kualifikuar dhe vendosur në vend të parë OE "E Th" SHPK, në kushtet kur nuk gjenden në katalog "Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë; Tubo PVC OD 110 , *sasia 210 ml. Diametri OD i referohet diametrit të jashtëm të tubove (± 2%). Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për rezistencën në presion (SDR) -31.*
Sipas katalogut të "I", në tabelën e paraqitur SDR është 35, çka do të thotë se është më pak rezistent ndaj deformimit.
Sipas katalogut "I", për këtë është paraqitur një tabelë me titull ± 2 % – SDR 35, e ndarë në dy kolona: DN Ø dhe spensori, duke bërë të pamundur dhe të paqartë për të identifikuar, në se Ø i referohet diametrit të brendshëm dhe në se plotëson kërkesat e specifikimeve teknike, nga 100 - 160 mmm. Pra katalogu i paraqitur nuk dëshmon qartë nëse tubot e ofruara kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

2. Tubo PVC OD 160, *sasia 420 ml, Diametri OD i referohet diametrit të jashtëm të tubove (± 2%) . Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për Rezistencën në presion (SDR) -35.* Sipas katalogut "I", për këtë është paraqitur një tabelë me titull ± 2 % – SDR 35, e ndarë në dy kolona: DN Ø dhe spensori, duke bërë të pamundur dhe të paqartë për të identifikuar, në se Ø i referohet diametrit të brendshëm dhe në se plotëson kërkesat e specifikimeve teknike, nga 100-160 mmm. Pra katalogu i paraqitur nuk dëshmon nëse tubot e ofruara kanë diametër të brendshëm sipas specifikimeve teknike të kërkuara.
3. Tubo HDPE të brinjëzuar, *Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, sasia 180 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%)* . Në katalogun e subjektit "K h " për tubot e brinjëzuar nuk gjendet artikull i tillë në këtë katalog.
Sipas katalogut të "I" I g SHPK dhe për artikujt e korriguar katalog nga "F" SHPK, "K h " dhe për dy llojet T.I dhe në asnjërin prej këtyre nuk jepet qartë se mallrat e ofertuara janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.; - OE në vend të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit ka paraqitur certifikatë bilanci fiskal, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, pasi nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim;
- Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 43.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:
- Znj. F. F.me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. E. B. , në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. V. C. , në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Z. I. P., në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Z. Th. K., në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

3. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2025.**

Me urdhrin nr. 45 prot., datë 16.01.2025 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje: Th. K. (ing. Hidroteknik) dhe E. B. (ekonomiste).
Më datë 22.01.2025 është hartuar relacioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit. Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, dhe elementi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi. Një mangësi e tillë sjell për pasojë mbingarkesën e stokut të mallrave dhe/ose prokurime të panevojshme, veprime jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet: "Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet".

Për llogaritjen e fondit limit, sipas këtij relacioni janë bazuar në marrjen e tre ofertave nga OE:

- Se datës 20.01.2025, e cila ka 10 artikuj me vlerë 4,625,706 lekë; të pashoqëruara me specifikimet teknike.
- S i Se datës 20.01.2025, me vlerë 3,464,408 lekë;
- LSHPK e datës 21.01.2024, me vlerë 3,624,466 lekë;
Mungesa e gjurmës se auditimit, për mënyrën se si janë kërkuar dhe marrë ofertat e mësipërme, mungesa e specifikimeve teknike, pasi janë hartuar më pas, si dhe mungesa e referimit në çmimet e kontratave të mëparshme e bëjnë formal procesin e llogaritjes së fondit limit, jo në përputhje me pikën 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar. Sipas kësaj strukture fondi limit si mesatare e tre ofertave ka rezultuar 3,904,860 lekë. Më datë 22.01.2025 ka dalë urdhri nr.45/1 prot., për caktimin e personit përgjegjës që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet teknike si dhe çdo informacion tjetër Th. K. (ing. Hidroteknike) dhe E. B. (ekonomiste). Urdhri i prokurimit nr.45/2 prot., datë 22.01.2025, procedura me fond limit 3,904,860 lekë dhe njësi prokurimi: A. L. (juriste), Th. K. (inxhiner hidroteknike) dhe E. B. (ekonomiste). Procesverbali për hartimin e kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik datë 24.01.2025 , dhe po në këtë datë proces-verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike (Th. K.) dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit.

Urdhri nr. 45/6 prot., datë 27.01.2025 për emërimin e KVO me përbërje: Ing. V. C. , Ing. I. P. dhe O. H. . Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave datë 07.02.2024, kanë rezultuar pjesëmarrës katër OE me ofertat e mëposhtëm me vlerat përkatëse:
1. “ A S G” SHPK, vlera 3,787,360 lekë pa TVSH;
2. “M” SHPK, vlera 3,695,056 lekë pa TVSH;
3. “S” SHPK, vlera 3,482,620 lekë pa TVSH;
4. “B B” SHPK vlera 0.00 lekë.

Procesverbali i dorëzimit të mostrave nr.1, datë 07.02.2025 i OE . “ A S G” SHPK, duke pasqyruar detajet që për mostrat e depozituara: për dy artikuj PVC dhe elementët e tjerë nuk kanë përcaktuar firmën prodhuese, ndërsa për tubot e brinjëzuar është cilësuar firma prodhuese “Pestan”. Procesverbali nuk është i shoqëruar me fotografi, si dhe as me procesverbalin e dorëzuesit nga personi i autorizuar i subjektit.

KVO me vendimin nr.1, datë 12.02.2025 ka s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. “M” SHPK për arsyet se, nuk ka sjellë mostra për mallrat furnizues, sikundër përcaktuar në shtojcën 8 të DST dhe tek Procesverbali Tip i Kontratës Mall të ngarkuar në SPE.
2. “S” SHPK pasi: - nuk ka sjellë mostra për mallrat furnizues; nuk ka paraqitur katalogët teknikë sikundër përcaktuar në shtojcën 6 të DST.
3. “B B” SHPK pasi ka ngarkuar ne SPE vetëm Ekstraktin e thjeshte të shoqërisë dhe mungon gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm teknik, ekonomik dhe ligjor.
Nga sa më sipër, OE “ A S G” SHPK, me vlerë të ofertës 3,787,360 lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Nga shqyrtimi në SPE, konstatohet se në plotësim të pikës 2.3- Kapaciteti teknik, Shtojca 8, në të cilën përcaktohet: “Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT shtojca 6 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë teknike për të gjithë mallrat furnizues, ku të jepet qartë që mallrat, janë në përputhje me

specifikimet teknike të kërkuara.” OE i shpallur fitues “ A S G” SHPK ka paraqitur katalogët HDPE Corugated OD Pipes të “P”.

Nga shqyrtimi i katalogut konstatohet se për artikujt e mëposhtëm:
1. Tubo PVC DN110 SDR33, sasia 690 ml. Diametri DN i referohet diametrit të jashtëm të tubove (± 2%). Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për rezistencën në presion (SDR) -33. Gjatësia e tubove duhet të jetë 3 ml.
Ky artikull nuk mund të identifikohet në katalog
2. Tubo PVC DN160 SDR33, sasia 2568 ml. Diametri DN i referohet diametrit të brendshmen të tubove (± 2%). Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për Rezistencën në presion (SDR) -33. Gjatësia e tubove duhet të jetë 3 ml.
Ky artikull nuk mund të identifikohet në katalog
3. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 200, sasia 804 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%). Për këtë artikull, sipas katalogut diametri i jashtëm OD është 227 mm, pra devijimi është +13.5% (227 – 200 = 27; 27/200 x 100 = 13.5 %) nga ± 2% përcaktuar në specifikimet teknike.
4. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 250, sasia 504 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%). Për këtë artikull, sipas katalogut diametri i jashtëm OD është 283 mm, pra devijimi është +13.2% (283 – 250 = 33; 33/250 x 100 = 13.2 %) nga ± 2% në specifikimet teknike.
8. Bashkues për tubot DN100(me tubin kryesor), Elementë lidhes plastik (gominë) DN100 .
Elementi lidhës vendoset për bashkimin e tubos PVC mbi tubon korrugato dhe i shërben shkarkimit të ujërave nga tubi me DN 100 mm në tub me dimensione ≥ DN 300mm për të realizuar një lidhje sa më hermetike.
Ky artikull nuk mund të identifikohet në katalog
9. Bashkues për tubot DN160 (me tubin kryesor), Elementë lidhes plastik (gominë) DN160 .
Elementi lidhës vendoset për bashkimin e tubos PVC mbi tubon korrugato dhe i shërben shkarkimit të ujërave nga tubi me DN 160 mm në tub me dimensione ≥ DN 300mm për të realizuar një lidhje sa më hermetike.
Ky artikull nuk mund të identifikohet në katalog
10. Element Y PVC për kanalizime DN160, Elementë lidhës PVC DN160 në formë Y.
Ky artikull nuk mund të identifikohet në katalog
Kontrata me nr.45/20 prot., datë 10.03.2025 me kontraktorin . “ A S G” SHPK me vlerë 3,787,360 lekë, me afat zbatimi 30 (tridhjete) ditë kalendarike, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, strukturë e ndjekjes së kontratës sipas urdhrit nr.45/21 prot., datë 10.03.2025 nga Ing. V. L. , R.M dhe O.M.
Sipas Procesverbalit të njësisë përfaqësuese për ndjekjen e kontratës të datës 18.03.2025, furnizimi sipas faturës nr. 06/2025, datë 18.03.2025 nga kontraktori “ A S G” SHPK i përgjigjet në sasi, cilësi, vlerë dhe afat kohore dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve”, me fond limit 3,904,860 lekë, zhvilluar më datë 07.02.2025, dhe zbatuar me kontratën me nr. 45/20, datë 10.03.2025 me kontraktorin. “ A S G” SHPK, me vlerë 3,787,360 lekë me kohëzgjatje 30 ditë kalendarike, konstatohet se:

- Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, dhe elementi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mbingarkesën e stokut të mallrave dhe/ose prokurime të panevojshme, veprime jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Mungesa e gjurmës se auditimit, për mënyrën se si janë kërkuar dhe marrë ofertat në studimin e tregut, mungesa e specifikimeve teknike pasi janë hartuar më pas, si dhe mungesa e referimit në çmimet e kontratave të mëparshme nuk janë përputhje me pikën 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar.
- Mungesa e pasqyrimit të firmës prodhuese në mostrat e dorëzuara për dy artikuj PVC, për OE " A S G" SHPK, duhej të sillte automatikisht skualifikimin e tyre, pasi nuk plotësojnë specifikimet teknike, që çdo tub të ketë të shënuar në mënyrë permanente emrin e prodhuesit dhe klasën e tubit, si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është i shoqëruar me fotografi, si dhe as me procesverbalin e dorëzuesit nga personi i autorizuar i subjektit;
Procesverbali i dorëzimit të mostrave nr.1, datë 07.02.2025 i OE . " A S G" SHPK, - OE i shpallur fitues " A S G" SHPK ka paraqitur katalogët HDPE Corugated OD Pipes të "P", në të cilët konstatohet se artikujt Tubo PVC DN110 SDR33; Tubo PVC DN160 SDR33 dhe Bashkues për tubot DN100 (me tubin kryesor), Elementë lidhes plastik (gominë) DN100, nuk mund të identifikohen në katalogë; për Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 200, sasia 804 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%) dhe Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 250, sasia 504 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë. Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të jashtëm (OD) të tubove (± 2%, devijimi është përkatësisht + 13.5 % dhe + 13.2 %;

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. Th. K., në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. E. B. , në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit;
- Znj. V. C. , në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Z. I. P., në cilësinë e anëtarit të KVO-së;
- Znj. O. H. , në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

4. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Riparim shërbim i automjeteve" 2023**

Me miratimin e buxhetit të vitit 2023, më datë 07.12.2022, Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.8 ka miratuar në nevojat për prokurime, midis të tjerave dhe "Riparim shërbim i automjeteve" me vlerë të parashikuar 6,130,400 lekë.
Me Urdhrin e Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor znj. F. F.nr.100, datë 02.02.2023 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje A. M. (inxhinier mekanik) dhe E. F. (ekonomiste), duke i argumentuar dhe dokumentuar këta tregues. Përfshirja e znj. E. F., me detyrë Drejtore Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, në procedurën e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili përcakton: "*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi: a)*

pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;", pasi ka për detyrë pranimin dhe kontrollin e dokumentacionit financiar dhe nuk ka kuptim kontrolli dhe pranimi i një dokumentacioni të prodhuar prej vetë nëpunësit zbatues. Në relacionin për hartimin specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, të datës 22.02.2023, me nr.100/1 prot., për shërbimet periodike për automjetet, shërbimet e riparimit dhe pjesët e këmbimit është cilësuar që për mbajtjen në funksion dhe në qarkullim mjetet sipas specifikave të tyre duhet të kryhen shërbimet e detajuar për çdo mjet; pjesët e ndërrimit duhet të jenë të gjitha origjinale; në rast të përsëritjes së të njëjtit defekt apo defekteve të reja si pasojë e riparimit me mangësi, riparimet do të bëhen nga OE pa pagesë; mbahet regjistri i mjeteve në riparim (targa, ndërhyrjet e realizuara, datën e marrjes në dorëzim, personin dorëzues dhe marrës); riparimi duhet të shoqërohet me garanci; si dhe shërbimet brenda 4 ditëve nga momenti i paraqitjes në servis. Vendi i dorëzimit të shërbimeve servisi i OE dhe kostot janë në ngarkim të OE, pavarësisht vend-ndodhjes; me afat 12 muaj me kryerje të shërbimeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparim- shërbimi i automjeteve"– Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, 2023</td></tr>
<tr><td colspan="3">Urdhër Prokurimi: nr. 100/2 prot., datë 22.02.2023</td></tr>
<tr><td>Lloji i procedurës së Prokurimit:
"Procedurë e hapur e thjeshtuar-Shërbime"</td><td>2. Njësia e Prokurimit
Nr.100/2 prot., datë 22.02.2023
K L,
A. M.
E. F.</td><td>3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdhër i brendshëm nr.100, datë 02.02.2023
Ing. A. M.
E. F.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi limit (pa TVSH):
6,016,650 lekë</td><td>5. Burimi i Financimit
Buxheti i shoqërisë</td><td>6. Data e hapjes së tenderit:
09.03.2023</td></tr>
<tr><td>7. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës:
- D G/B.M P.F
b) Kualifikuar:
- D G/B.M P.F</td><td>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: nr.100/8 prot., datë 24.02.2023
Ing. V. L. , Ing. A. A.
Ing. I. P..,</td><td>9. Oferta fituese (pa TVSH):
4,939,800 lekë</td></tr>
<tr><td>10. Data e lidhjes së kontratës
Kontratë nr.100/3prot., 23.03.2023</td><td>11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) :
1,076,850 lekë</td><td>12. Ankimime
Jo</td></tr>
<tr><td>13.Struktura për ndjekjen e kontratës:
ing. A. A.
E. F.</td><td>14. Fletë hyrja</td><td>15. Afati i kontratës
23.03.2023 – 23.03.2024.</td></tr>
</table>

Llogaritja e vlerës limit të kontratës, sipas kësaj strukture, është kryer duke marrë parasysh, studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, janë marrë me shkrim dy oferta dhe për fond limit çmimet mesatare. Ofertat janë origjinale të datës 17.02.2023 të subjektit B SHA Korçë me vlerë gjithsej 6,353,700 lekë pa TVSH dhe e subjektit D G/B.M P.F pa datë me vlerë 5,679,600 lekë. Përllogaritja është bërë për secilin mjet në veçanti dhe më pas është llogaritur fondi total i detajuar për afatin 12 muaj; fondi limit i pritshëm 6,016,650 lekë pa TVSH. Nga tabelat pjesë e këtij relacioni nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i nevojave për riparime dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., pra nëpërmjet dokumentimit dhe të revizionimit

të mjetit, në prani edhe të personit që ka në përdorim mjetin, krahas dokumentacionit teknik dhe atij ekonomik-financiar. Një mangësi e tillë sjell për pasojë pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit, me pasoja në efektivitetin e përdorimit fondeve të shoqërisë, si dhe në kontestimin mbi domosdoshmërinë e mbajtjes në funksion të automjeteve dhe mjeteve gjatë gjithë vitit me fondin limit të llogaritur. Nga sa më sipër, struktura e posaçme nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton: "*Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit* ***duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit***."

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje tabelat e specifikimeve teknike për secilin mjet, ku janë përcaktuar: emërtimi i mjetit, lloji, targa, viti i prodhimit dhe në një tabelë e ndarë në dy pjesë: në zërat e servisit dhe në zërat e shërbimeve periodike, duke përcaktuar njësinë dhe sasinë për secilin prej tyre. Në zërat e shërbimeve periodike (vaj motori/kambio, filtër vaji, nafte/benzine, filtër ajri, kondicioneri etj.) konstatohet se për vajin e motorit/kambios nuk është mbajtur në konsideratë kapacitetet teknik mbajtës i mjetit (sipas krahasimit të të dhënave teknike për disa automjete), duke vendosur shifra sasie të rrumbullakosura, si dhe të gjithë zërat e shërbimeve periodike janë llogaritur për t'u kryer dy herë në vit, pa marrë në konsideratë km e përshkuara një vit më parë, dhe për t'i bërë të krahasueshme dhe normat teknike të ndërrimit të vajit (motor dhe kambio), si dhe zëvendësimin e filtrave të ndryshëm, duke sjellë për pasojë kryerjen e shpenzimeve të panevojshme për të mbajtur në gatishmëri automjetet e shoqërisë.

Në relacion nuk cilësohet baza (kriteret) që kanë shërbyer për përcaktimin e zërave të shërbimit dhe atyre periodike, mënyra se si janë dërguar dhe janë marrë nga subjektet ofertuese të vlerave për secilin mjet dhe zë përkatës, duke e bërë formal procesin e llogaritjes së fondit limit., jo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*"

Me Urdhrin nr. 100/2 prot., datë 22.02.2023, është caktuar personi përgjegjës A. M. që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet e DT dhe çdo informacion tjetër specifik për këtë procedurë prokurimi, nga personi i autorizuar znj. F. F., por që nuk ka afate. Nga shqyrtimi i kërkesave teknike për kualifikimi në dokumentet e tenderit dokumentet, në pikën 10, nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat. Veç sa më sipër, në pikën 8 të kritereve të veçanta për kualifikim është përfshirë kërkesa që Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, b) 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017. Kjo sjell si pasojë vështirësi në përgatitjen e ofertave nga OE, si dhe vështirësi të KVO në vlerësimin e ofertave të paraqitura. Me Urdhrin nr. 100/2 prot., datë 22.02.2023 për procedurën me fond limit 6,016,650 lekë, marrëveshje kuadër, procedurë e hapur e thjeshtuar, me njësi prokurimi: K L (jurist), A. M. (inxhinier mekanik) dhe E. F. (ekonomiste). Përfshirja e znj. E. F., me detyrë Drejtore Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, në procedurën e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh"

dhe “e” të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
Më datë 23.02.2023 është mbajtur procesverbali i hartimit të kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik nga A M. Në argumentimin e pikës 7 që OE duhet të ketë një fuqi punëtore prej minimalisht 6 punonjësish, me argumentim që llogaritja është 1 drejtues ligjor, + 1 përgjegjës teknik + 4 specialistë = 6 persona, me analizë në pikën 6: që faktikisht janë vetëm 4 punonjës të specializuar, dhe në pikën 5 është a) një inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti që është përgjegjës teknik, duke evidentuar paqartësi në këtë argumentim. Më datë 24.02.2023 është mbajtur procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, për datë të zhvillimit të tenderit 09.03.2023, po në këtë datë procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit për kriteret e veçanta dhe kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe vetëm nga A. M. të aftësive tekniko profesionale dhe kërkesat për servis dhe shërbime periodike për secilin mjet. Më datë 24.02.2023 është nxjerrë urdhri i prokurimit nr.100/8 për emërimin e KVO: Ing. V. L. , Ing. A. A. dhe Ing. I. P.. Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 09.03.2023 të KVO dhe NJP dhe ishte paraqitur një OE: “D G/B.M P.F” me ofertë 4,939,800 lekë, po në këtë datë nga KVO është marrë vendimi nr.1 i vlerësimit të ofertave, ku është vendosur kualifikimi i OE të paraqitur, njoftuar OE për sjelljen e dokumentacionit. Më datë 13.03.2023 është mbajtur procesverbali i verifikimit të dokumentacionit, dhe konsiderohet i plotë dhe i rregullt nga KVO dhe me datë 17.03.2023 është hartuar Raporti përmbledhës dhe miratuar nga zyrtari i autorizuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e procedurës së prokurimit konstatohet se:
- Në plotësim të pikës 8 të Kritereve të veçanta të kualifikimit: “*Për personelin teknik të kualifikuar (katër specialistët e kërkuar: specialist xhenerik, motorist, elektroaut dhe gomist), operatori ekonomik duhet të paraqesë, dëshmitë e kualifikimit*”, OE i vetëm pjesëmarrës dhe i shpallur fitues; për xhenerik ka paraqitur certifikatë për mekanik automjetesh 2016; për motoristin certifikatë e përfundimit të kursit për autoservis, viti 2004; për elektroautin Certifikatë të formimit profesional se ka ndjekur kursin për automjete niveli 1, 2016, dhe për gomist nuk ka paraqitur asnjë dëshmi, vetëm kontratën e punës të datës 30.06.2022 me A Sh. KVO ka konsideruar të plotësuar këtë kriter edhe pse OE për një dokument të caktuar ka sjellë tjetër dokument, pa e konsideruar mungesë dokumentacioni. Përveç se për gomist nuk ka sjellë asnjë dokument dëshmi kualifikimi, pasi certifikatat e paraqitura vërtetojnë se ka marrë pjesë dhe ka përfunduar një kurs formimi profesional, pra jo domosdoshmërisht mund të konsiderohet kualifikim i plotë, për t’u pajisur me dëshmi kualifikimi. Kjo pasi, Certifikata e formimit profesional është dokument që vërteton ndjekjen dhe përfundimin e një kursi trajnimi/formimi profesional, ndërsa Dëshmia e kualifikimit është Dokument zyrtar që vërteton se personi ka fituar një kualifikim profesional të njohur zyrtarisht.
- Sipas pikës 10. të Kritereve të veçanta të kualifikimit, *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*
Ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, servis i cili duhet të ketë:
- *Repart xhenerik*
- *Repart motorik*
- *Repart elektroaut*
- *Repart llamarine e bojatisjeje*

dhe duhet të disponojë pajisjet dhe instrumentet e mëposhtme:

a) Gropë riparimi, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion , ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
b) Elektrokompresor;
c) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;
ç) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjencës së gomave;
d) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
dh) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave;
e) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;
f) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave;
g) Kompjuter për diagnostikimin e mjeteve
gj) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit;
h) Vegla matëse dhe të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik etj.;
Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka dorëzuar fotografi, si dokumentacion provues për vetë-deklarimet në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.
Megjithëse, në pjesën B të Deklaratës, OE i kualifikuar i pari cilëson se: "*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor*".
Deklarata për makineritë dhe mjetet ka të përcaktuar: "Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me **të dhënat konkrete"** dhe në fakt nuk ka paraqitur asnjë lloj të dhëne konkrete.

Nga sa më sipër konstatohet se KVO ka kualifikuar OE kur nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".
Draft kontrata e lidhur më datë 17.03.2023, sipas kërkesës së ripërcaktimit të saktë të shërbimeve dhe afatit të lëvrimit të po kësaj date nga zyrtari i autorizuar, po në këtë datë përgjigjur A.M. Sigurimi i kontratës në vlerën 592,776 lekë më datë 21.03.2023. Kontratat e nënshkruar nga F. F.dhe B M me nr100/23 prot., datë 23.03.2023, me vlerë 4,939,800 lekë, me afat 12 muaj nga data 23.03.2023 deri me 23.03.2024; neni 3 detyrimet e sipërmarrësit.

Zyrtari i autorizuar znj. F. F., me shkresën nr.139/19 prot., datë 23.03.2023 ka caktuar njësinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e kontratës me përbërje A. A. dhe E. F.. Përfshirja e znj. E. F. në njësinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e kontratës është në kundërshtim germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Përcaktimi i njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës më datë 23.03.2023 janë A. A. dhe E. F.. Përfshirja e znj. E. F., me detyrë Drejtore Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, në procedurën e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i zbatimit te kontratës nr.100/23 prot, datë 23.03.2023 me vlerë 4,939,800 lekë, me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës, realizuar në vlerën 4,987,900 lekë, me njësi përgjegjëse

për mbikëqyrjen A. A. dhe E. F., sipas shkresës nr.139/19 prot., datë 23.03.2023 të zyrtarit të autorizuar F. F., konstatohet se:
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 05.04.2023, fatura e po kësaj date në vlerën 1,278,300 lekë, për 28 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 08.05.2023, fatura e po kësaj date ne vlerën 1,216,900 lekë, për 21 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 05.07.2023, fatura e po kësaj date ne vlerën 815,200 lekë, për 10 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 06.09.2023, fatura e po kësaj date ne vlerën 674,400 lekë, për 11 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 07.11.2023 janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura e datës 07.11.2023 përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit), për 24 mjete
Në këtë situacion në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë.

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje realizimin e kësaj kontrate nga marrëveshja kuadër dhe konstatohet se në zërin e shërbimeve periodike për automjetet dhe mjete e ndryshme, nuk është mbajtur në konsideratë kapaciteti mbajtës i tyre për ndërrimin e vajit dhe as veprimtaria e tyre në bazë të km të përshkuara/orëve të punës dhe afateve teknike të ndërrimit të zërave të shërbimeve periodike.
Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës dhe të dhënave të plotësuara për automjetet për periudhën 2023 - 2025 nga Drejtoria Ekonomike (Departamenti Tregtar), konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës 05.04.2023 deri më 07.11.2023 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe mosveprimet e autoritetit kontraktor janë shpenzuar pa efektivitet 638,200 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shërbimet periodike të mjeteve dhe automjete të cilat, sipas km të përshkuara dhe/ose orëve të punës të punuara, përkatësisht sipas referencës teknike të elementëve të shërbimit të kryer, pasi nuk i kanë respektuar këto afate të kryerjes së shërbimeve periodike.

Gjithashtu, sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse A. A. dhe E. F. të datës 07.11.2023, shërbimet janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura e datës 07.11.2023 përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit) për 24 mjete. Në këtë situacion në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 290,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë. Kjo vlerë është paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar: "*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*".

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 6,016,650 lekë, zhvilluar më datë 09.03.2023 dhe zbatuar me kontratën me nr100/23 prot., datë 23.03.2023 me vlerë 4,939,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F" dhe me afat 12 muaj, konstatohet se:

- Nga Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor znj. F. F.në këtë procedurë prokurimi është përfshirë në strukturën e posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në strukturën e ndjekjes së zbatimit të kontratës, Drejtori Ekonomik znj. E. F.- Nëpunësi zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Në relacionin e llogaritjes së vlerës limit të kontratës, nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i saktë i nevojave për riparime dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Gjithashtu, njëra nga ofertat nuk ka datë, nuk ka gjurmë se si janë kërkuar dhe marrë ofertat për studim tregu, jo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Njësia e prokurimi në kërkesat teknike për kualifikim në dokumentet e tenderit nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar që duhet të ketë operatori ekonomik, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat; si dhe është përfshirë kërkesa për punonjës të specializuar/të kualifikuar 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017;
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e procedurës së prokurimit konstatohet se, OE i vetëm pjesëmarrës dhe i shpallur fitues "D G/B.M P.F" për personelin teknik të kualifikuar ka paraqitur certifikatë për dëshmi kualifikimi, dhe për gomist nuk ka paraqitur asnjë dokument për dëshmi; si dhe disponimin e mjeteve dhe pajisjeve nuk e ka shoqëruar me të dhëna konkrete (faturë etj.) por vetëm me fotografi. KVO ka kualifikuar OE kur nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të saj nga data 05.04.2023 deri më 07.11.2023 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe mosveprimet e autoritetit kontraktor janë shpenzuar në mënyrë të panevojshme 638,200 lekë;
- Në situacionin përmbyllës në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 290,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë. Kjo vlerë është paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Znj. F. F., me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- Znj. E. F., në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP; në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës;

- Z. A. M. , në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Znj. K L, në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Z. V. L. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Z. A. A. , në cilësinë e anëtarit të KVO; në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës;
- Z. I. P., në cilësinë e anëtarit të KVO;

5. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Riparim shërbim i automjeteve" 2024**

Me miratimin e buxhetit të vitit 2024, më datë 12.12.2023, Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.10 ka miratuar në nevojat për prokurime, midis të tjerave dhe "Riparim shërbim i automjeteve" parashikuar me vlerë 5,114,400 lekë.

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Riparim- shërbimi i automjeteve"– Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, 2024</td></tr>
<tr><td colspan="3">Urdhër Prokurimi: nr. 119/3 prot., datë 22.02.2024</td></tr>
<tr><td>Lloji i procedurës së Prokurimit:
"Procedurë e hapur e thjeshtuar-Shërbime"</td><td>2. Njësia e Prokurimit
Nr.119/3 prot., datë 22.02.2024
K L,
A. M.
E. F.</td><td>3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike: Urdhër i brendshëm nr.119, datë 14.02.2024
Ing. A. M.
E. F.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi limit (pa TVSH):
5,109,850 lekë</td><td>5. Burimi i Financimit
Buxheti i shoqërisë</td><td>6. Data e hapjes së tenderit:
11.03.2024</td></tr>
<tr><td>7. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës:
- D G/B.M P.F
b) Kualifikuar:
- D G/B.M P.F</td><td>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: nr.119/8 prot., datë 27.08.2024
Ing. V. L. , Ing. A. A.
Ing. I. P..,</td><td>9. Oferta fituese (pa TVSH):
4,021,800 lekë</td></tr>
<tr><td>10. Data e lidhjes së kontratës
Kontratë nr.119/23 prot., 26.03.2024</td><td>11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) :
1,088,050 lekë</td><td>12. Ankimime
Jo</td></tr>
<tr><td>13.Struktura për ndjekjen e kontratës:
ing. A. A.
E. F.</td><td>14. Fletë hyrja</td><td>15. Afati i kontratës
26.03.2024 – 26.03.2025.</td></tr>
</table>

Me Urdhrin e Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor znj. F. F.nr.119, datë 14.02.2024 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje A. M. (inxhinier mekanik dhe E. F. (ekonomiste), duke i argumentuar dhe dokumentuar. Përfshirja në këtë strukturë e znj. E. F., me detyrë Drejtore Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, në procedurën e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili përcakton: "*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi: a) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e*

legjislacionit në fuqi;", pasi ka për detyrë pranimin dhe kontrollin e dokumentacionit financiar dhe nuk ka kuptim kontrolli dhe pranimi i një dokumentacioni të prodhuar prej vetë nëpunësit zbatues.

Në relacionin për hartimin specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, të datës 23.02.2024, me nr.119/1 prot., për shërbimet periodike për automjetet, shërbimet e riparimit dhe pjesët e këmbimit është cilësuar që për mbajtjen në funksion dhe në qarkullim mjetet sipas specifikave të tyre duhet të kryhen shërbimet e detajuar për çdo mjet; pjesët e ndërrimit duhet të jenë të gjitha origjinale; në rast të përsëritjes së të njëjtit defekt apo defekteve të reja si pasojë e riparimit me mangësi, riparimet do të bëhen nga OE pa pagesë; mbahet regjistri i mjeteve në riparim (targa, ndërhyrjet e realizuara, datën e marrjes në dorëzim, personin dorëzues dhe marrës); riparimi duhet te shoqërohet me garanci; shërbimet brenda 4 ditëve nga momenti i paraqitjes në servis.
Vendi i dorëzimit të shërbimeve servisi i OE dhe kostot janë në ngarkim të OE, pavarësisht vendndodhjes; me afat 12 muaj me kryerje të shërbimeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.
Llogaritja e vlerës limit të kontratave është kryer duke marrë parasysh, studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, janë marrë me shkrim dy oferta dhe për fond limit çmimet mesatare. Ofertat janë kërkuar sipas shkresës datë 15.02.2024 për dy OE: origjinale të datës 21.02.2024 të subjektit B SHA Korçë me vlerë 5,282,700 lekë pa TVSH dhe të datës19.02.2024 e subjektit DBD Group, B M P.F me vlerë 4,940,000 lekë. Përllogaritja është bërë për secilin mjet në veçanti dhe më pas është llogaritur fondi total i detajuar për afatin 12 muaj; fondi limit i pritshëm 5,109,850 lekë pa TVSH.

Nga tabelat pjesë e këtij relacioni nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i nevojave për servise dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., pra nëpërmjet dokumentimit të revizionimit të mjetit, në prani edhe të personit që ka në përdorim mjetin, krahas dokumentacionit teknik dhe atij ekonomik-financiar. Një mangësi e tillë sjell për pasojë përllogaritjen e fondit limit mbi nevojat dhe domosdoshmërinë reale të mbajtjes në funksion të automjeteve dhe mjeteve gjatë gjithë vitit.
Nga sa më sipër, struktura e posaçme nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton: "*Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit* ***duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit***."

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje tabelat e specifikimeve teknike për secilin mjet, ku janë përcaktuar: emërtimi i mjetit, lloji, targa, viti i prodhimit dhe në një tabelë e ndarë në dy pjesë: në zërat e servisit dhe në zërat e shërbimeve periodike, duke përcaktuar njësinë dhe sasinë për secilin prej tyre. Në zërat e shërbimeve periodike (vaj motori/kambio, filtër vaji, nafte/benzine, filtër ajri, kondicioneri etj.) konstatohet se për vajin e motorit/kambios nuk është mbajtur në konsideratë kapacitetet teknik mbajtës i mjetit (sipas krahasimit të të dhënave teknike për disa automjete), duke vendosur shifra sasie të rrumbullakosura, si dhe të gjithë zërat e shërbimeve periodike janë llogaritur për t'u kryer dy herë në vit, pa marrë në konsideratë km e përshkuara një vit më parë, dhe për t'i bërë të krahasueshme dhe normat teknike të ndërrimit të vajit (motor dhe kambio), si dhe zëvendësimin e filtrave të ndryshëm, duke sjellë për pasojë kryerjen e shpenzimeve të panevojshme për të mbajtur në gatishmëri automjetet e shoqërisë.

Në relacion nuk cilësohet baza (kriteret) që kanë shërbyer për përcaktimin e zërave të shërbimit dhe atyre periodike, mënyra se si janë dërguar dhe janë marrë nga subjektet ofertuese të vlerave për secilin mjet dhe zë përkatës, duke e bërë formal procesin e llogaritjes së fondit limit, jo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Autoriteti/enti kontraktor mund t´i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*"

Me Urdhrin nr. 119/2 prot., datë 23.02.2023, është caktuar personi përgjegjës A. M. që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet e DT dhe çdo informacion tjetër specifik për këtë procedurë prokurimi, nga personi i autorizuar znj. F. F., por që nuk ka afate. Nga shqyrtimi i kërkesave teknike për kualifikimi në dokumentet e tenderit dokumentet, në pikën 10, nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat.
Veç sa më sipër, në pikën 8 të kritereve të veçanta për kualifikim është përfshirë kërkesa që Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, b) 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017. Kjo sjell si pasojë vështirësi në përgatitjen e ofertave nga OE, si dhe vështirësi të KVO në vlerësimin e ofertave të paraqitura.
Me Urdhrin e prokurimit nr. 119/3 prot., datë 22.02.2024 për procedurën me fond limit 5,109,850 lekë, marrëveshje kuadër, procedurë e hapur e thjeshtuar, me njësi prokurimi: K L (jurist), A. M. (inxhinier mekanik) dhe E. F. (ekonomiste). Caktimi i znj. E. F. në Njësinë e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Më datë 26.02.2024 është mbajtur procesverbali i hartimit të kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik nga A M. Në argumentimin e pikës 7 që OE duhet të ketë një fuqi punëtore prej minimalisht 6 punonjësish, me argumentim që llogaritja është 1 drejtues ligjor, + 1 përgjegjës teknik + 4 specialistë= 6 persona, me analizë në pikën 6: që faktikisht janë vetëm 4 punonjës të specializuar, dhe në pikën 5 është a) një inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti që është përgjegjës teknik, duke evidentuar paqartësi në këtë argumentim. Më datë 27.02.2024 është mbajtur procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, për datë të zhvillimit të tenderit 11.03.2024, po në këtë datë procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit për kriteret e veçanta dhe kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe vetëm nga A. M. të aftësive tekniko profesionale dhe kërkesat për servis dhe shërbime periodike për secilin mjet.

Më datë 27.02.2024 është nxjerrë urdhri i prokurimit nr.119/8 për emërimin e KVO: Ing. V. L. , Ing. A. A. dhe Ing. I. P..

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 11.03.2024 të KVO dhe NJP është paraqitur një OE: D G/B.M P.F me ofertë 4,021,800 lekë, po në këtë datë nga KVO është marrë vendimi nr.1 i vlerësimit të ofertave, ku është vendosur kualifikimi i OE të paraqitur, njoftuar OE për sjelljen e dokumentacionit.

Më datë 20.03.2024 është mbajtur procesverbali i verifikimit të dokumentacionit, duke e konsideruar të plotë dhe të rregullt nga KVO dhe me datë 21.03.2024 është hartuar Raporti përmbledhës dhe miratuar nga zyrtari i autorizuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e procedurës së prokurimit konstatohet se:
- OE i shpallur fitues "*Për personelin teknik të kualifikuar (katër specialistët e kërkuar: specialist xhenerik, motorist, elektroaut dhe gomist), operatori ekonomik duhet të paraqesë, dëshmitë e kualifikimit*", ka paraqitur certifikata të përfundimit të kursit dhe diplomë të formimit profesional dhe për specialistin gomist A Sh, nuk ka dokument për dëshmi.
Nga sa më sipër, konstatohet se mungon dëshmia e kualifikimit për specialistin gomist dhe gjithashtu nuk justifikohen tre specialistët e tjerë me dy certifikata dhe një diplomë profesionale për t'i zëvendësuar dëshmitë e kualifikimit. Kjo pasi dëshmia e kualifikimit është një dokument është dokument zyrtar që vërteton se personi ka fituar një kualifikim profesional të njohur zyrtarisht, ndërsa certifikatat janë dokument që vërteton ndjekjen dhe përfundimin e një kursi trajnimi/formimi profesional.
Bazuar në sa më sipër, OE "D G/B.M P.F" nuk e ka plotësuar pikën 8 të kritereve të veçanta të kualifikimit.

- Sipas pikës 10. të Kritereve të veçanta të kualifikimit, *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*
Ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, servis i cili duhet të ketë:
- *Repart xhenerik*
- *Repart motorik*
- *Repart elektroaut*
- *Repart llamarine e bojatisjeje*

dhe duhet të disponojë pajisjet dhe instrumentet e mëposhtme:
a) Gropë riparimi, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion , ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;
b) Elektrokompresor;
c) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;
ç) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjencës së gomave;
d) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
dh) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave;
e) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;
f) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave;
g) Kompjuter për diagnostikimin e mjeteve
gj) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit;
h) Vegla matëse dhe të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik etj.;
Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka dorëzuar fotografi, si dokumentacion provues për vetë-deklarimet në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.
Megjithëse, në pjesën B të Deklaratës, OE i kualifikuar i pari cilëson se: "*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e*

vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor".
Deklarata për makineritë dhe mjetet ka të përcaktuar: "Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me **të dhënat konkrete"** dhe në fakt nuk ka paraqitur asnjë lloj të dhëne konkrete.

Nga sa më sipër konstatohet se KVO ka kualifikuar OE kur nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmban kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Draft marrëveshja kuadër e lidhur më datë 21.03.2024, sipas kërkesës së ripërcaktimit të saktë të shërbimeve dhe afatit të lëvrimit të po kësaj date nga zyrtari i autorizuar, po në këtë datë përgjigjur A. M. . Sigurimi i kontratës në vlerën 4822,616 lekë më datë 25.03.2024.

Kontratat e nënshkruar nga F. F.dhe B M me nr.119/23 prot., datë 26.03.2024, me vlerë 4,021,800 lekë, me afat 12 muaj nga data 26.03.2024 deri me 26.03.2025; neni 3 detyrimet e sipërmarrësit.

Përcaktimi i njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës më datë 23.03.2023 janë A. A. dhe E. F.. Caktimi i znj.E. F. në strukturën përgjegjëse për zbatimin e kontratës është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i zbatimit te kontratës nr.119/23 prot, datë 26.03.2024 me vlerë 4,021,800 lekë, me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës, me njësi përgjegjëse për mbikëqyrjen A. A. dhe E. F., sipas shkresës nr.119/24 prot., datë 26.03.2024 të zyrtarit të autorizuar F. F., konstatohet se:
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 23.04.2024, fatura e po kësaj date ne vlerën 1,162,250 lekë;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 20.06.2024, fatura e po kësaj date ne vlerën 687,100 lekë, për 13 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 04.09.2024, fatura e po kësaj date ne vlerën 553,400 lekë, për 4 mjete, si dhe lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 13.11.2024, fatura e po kësaj date ne vlerën 1,224,050 lekë, për 22 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse, riparimet dhe shërbimet janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit),

Realizuar 4,352,160 lekë
Sipas kontratës 4,826,160

Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës dhe të dhënave të plotësuara për automjetet për periudhën 2023 - 2025 nga Drejtoria Ekonomike (Departamenti Tregtar), konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës 26.03.2024 deri më 13.11.2023 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe

mosveprimet e autoritetit kontraktor ja shpenzuar në mënyrë të panevojshme 651,150 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shërbimet periodike të mjeteve dhe automjete të cilat, sipas km të përshkuara dhe/ose orëve të punës të punuara nuk kanë plotësuar afatet e nevojshme të kryerjes së shërbimeve periodike.
Gjithashtu, sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse A. A. dhe E. F. të datës 04.09.2024, shërbimet janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura e po kësaj date përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit). për 24 mjete. Në këtë situacion në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 326,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë. Kjo vlerë është paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar: "*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*".

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 5,109,850 lekë, zhvilluar më datë 11.03.2024 dhe zbatuar me kontratën me nr. 119/23 prot., datë 26.03.2024, me vlerë 4,021,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F" dhe me afat 12 muaj, konstatohet se:
- Nga Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor znj. F. F.në këtë procedurë prokurimi është përfshirë në strukturën e posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në strukturën e ndjekjes së zbatimit të kontratës, Drejtori Ekonomik znj. E. F.- Nëpunësi zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Në relacionin e llogaritjes së vlerës limit të kontratës, nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i saktë i nevojave për riparime dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Njësia e prokurimi në kërkesat teknike për kualifikim në dokumentet e tenderit nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar që duhet të ketë operatori ekonomik, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat; si dhe është përfshirë kërkesa për punonjës të specializuar/të kualifikuar 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017;
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e procedurës së prokurimit konstatohet se, OE i vetëm pjesëmarrës dhe i shpallur fitues "D G/B.M P.F" për personelin teknik të kualifikuar ka paraqitur certifikatë për dëshmi kualifikimi, dhe për gomist nuk ka paraqitur asnjë dokument për dëshmi; si dhe disponimin e mjeteve dhe pajisjeve nuk e ka shoqëruar me të dhëna konkrete (faturë etj.) por vetëm me fotografi. KVO ka kualifikuar OE kur nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;

- Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës dhe të dhënave të plotësuara për automjetet për periudhën 2023 - 2025 nga Drejtoria Ekonomike (Departamenti Tregtar), konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës 26.03.2024 deri më 13.11.2023 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe mosveprimet e autoritetit kontraktor ja shpenzuar në mënyrë të panevojshme 651,150 lekë.
- Gjithashtu, sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 04.09.2024, shërbimet janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura e po kësaj date përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës, në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 326,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë, paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Znj. F. F., me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- Znj. E. F., në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP; në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës;
- Z. A. M. , në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Znj. K L, në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Z. V. L. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Z. A. A. , në cilësinë e anëtarit të KVO; në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës;
- Z. I. P., në cilësinë e anëtarit të KVO.

6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e kontratës **"Blerje shërbimi për riparimin dhe shërbimin e automjeteve" 2025**

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 12.12.2024 për miratimin e buxhetit për vitin 2025, midis të tjerave, është parashikuar "Blerje shërbimi për automjete" me vlerë 4,000,lekë.

Me Urdhrin nr.452 prot., datë 05.06.2025 është ngritur struktura e posaçme përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me përbërje V. L. (inxhinier mekanik) dhe E. F. (ekonomiste), duke i argumentuar dhe dokumentuar. Përfshirja në këtë strukturë e znj. E. F., me detyrë Drejtore Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, në procedurën e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili përcakton: "*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi: a) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;*", pasi ka për detyrë pranimin dhe kontrollin e dokumentacionit financiar dhe nuk ka kuptim kontrolli dhe pranimi i një dokumentacioni të prodhuar prej vetë nëpunësit zbatues.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje shërbimi për riparimin dhe shërbimin e automjeteve"- Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, 2025		
Urdhër Prokurimi: nr. 452/3 prot., datë 09.06.2025		
Lloji i procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar-Shërbime"	**2. Njësia e Prokurimit** Nr.452/3 prot., datë 09.06.2025 A. L. , V. L. E. F.	**3. Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike**: Urdhër i brendshëm nr.452, datë 05.06.2025 Ing. V. L. E. F.
4. Fondi limit (pa TVSH): 3,995,000 lekë	**5. Burimi i Financimit** Buxheti i shoqërisë	**6. Data e hapjes së tenderit:** 23.06.2025
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: - D G/B.M P.F b) Kualifikuar: - D G/B.M P.F	**8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:** nr.452/5 prot., datë 10.06.2025 V. M. , M. G. O. H. .	**9. Oferta fituese (pa TVSH):** 3,281,800 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë nr.452/28 prot., 14.07.2025	**11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) :** 713,200 lekë	**12. Ankimime** Jo
13.Struktura për ndjekjen e kontratës: ing. A. A. E. F.	**14. Fletë hyrja**	**15. Afati i kontratës** 14.07.2025 – 14.07.2026.

nr.452/28 prot, datë 14.07.2025

Në relacionin për hartimin specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, të datës 09.06.2025, me nr. 452/1 prot., për shërbimet periodike për automjetet, shërbimet e riparimit dhe pjesët e këmbimit është cilësuar që për mbajtjen në funksion dhe në qarkullim mjetet sipas specifikave të tyre duhet të kryhen shërbimet e detajuar për çdo mjet; pjesët e ndërrimit duhet të jenë të gjitha origjinale; në rast të përsëritjes së të njëjtit defekt apo defekteve të reja si pasojë e riparimit me mangësi, riparimet do të bëhen nga OE pa pagesë; mbahet regjistri i mjeteve në riparim (targa, ndërhyrjet e realizuara, datën e marrjes në dorëzim, personin dorëzues dhe marrës); riparimi duhet te shoqërohet me garanci; shërbimet brenda 4 ditëve nga momenti i paraqitjes në servis. Vendi i dorëzimit të shërbimeve servisi i OE dhe kostot janë në ngarkim të OE, pavarësisht vendndodhjes; me afat 12 muaj me kryerje të shërbimeve sipas nevojës dhe kërkesës së AK.

Llogaritja e vlerës limit të kontratave është kryer duke marrë parasysh, studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, janë marrë me shkrim dy oferta dhe për fond limit çmimet mesatare. Fondi limit i llogaritur (vlera e pritshme e kontratës iu ka rezultuar 3,995,000 lekë. Ofertat janë kërkuar sipas shkresës datë 25.03.2025 për OE O G, sjellë ofertën më datë 07.04.2025 në total për 4,119,555 lekë pa TVSH (Autoservis G); servis A G, sjellë më datë 10.04.2025 me vlerë oferte 3,875,445 lekë. Përllogaritja është bërë për secilin mjet në veçanti dhe më pas është llogaritur fondi total i detajuar për afatin 12 muaj; fondi limit i pritshëm 3,995,000 lekë pa TVSH. Duhet theksuar se nga 32 mjete dhe automjete për të cilat është kërkuar që të riparohen, në

Nga tabelat pjesë e këtij relacioni nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomik për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i nevojave për servise dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., pra nëpërmjet dokumentimit të revizionimit të mjetit, në prani edhe

të personit që ka në përdorim mjetin, krahas dokumentacionit teknik dhe atij ekonomik-financiar. Një mangësi e tillë sjell për pasojë përllogaritjen e fondit limit mbi nevojat dhe domosdoshmërinë reale të mbajtjes në funksion të automjeteve dhe mjeteve gjatë gjithë vitit. Për më tepër që ka 11 raste që është cilësuar: Mercedez Fugon, Mercedez Kamionçinë, Toyota Kamioncin Hilux (0.8 T) KO28xxA (pa vitin e prodhimit), Mercedes Furgon Severin, Toyota Rav4 (i ri), Automjeti Maliq, Automjeti Devoll, Automjeti Ersekë, Automjeti Sharrë prerje asfalti, Automjeti Bot i ri, duke mos pasur asnjë lloj mundësie për të dhënë oferta, në mungesë të specifikimeve teknike. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar: "*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*"

Në relacion nuk cilësohet baza (kriteret) që kanë shërbyer për përcaktimin e zërave të shërbimit dhe atyre periodike, mënyra se si janë dërguar dhe janë marrë nga subjektet ofertuese të vlerave për secilin mjet dhe zë përkatës, duke e bërë formal procesin e llogaritjes së fondit limit.

Me Urdhrin nr. 452/2 prot., datë 09.06.2025, është caktuar personi përgjegjës V. L. (inxhinier mekanik) që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit, specifikimet e DT dhe çdo informacion tjetër specifik për këtë procedurë prokurimi, nga personi i autorizuar znj. F. F., por që nuk kanë afate. Nga shqyrtimi i kërkesave teknike për kualifikimi në dokumentet e tenderit dokumentet, në pikën 10, nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat.
Veç sa më sipër, në pikën 8 të kritereve të veçanta për kualifikim është përfshirë kërkesa që Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, b) 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017. Kjo sjell si pasojë vështirësi në përgatitjen e ofertave nga OE, si dhe vështirësi të KVO në vlerësimin e ofertave të paraqitura.

Me Urdhrin e prokurimit nr. 452/3 prot., datë 09.06.2025 për procedurën me fond limit 5,109,850 lekë, marrëveshje kuadër, procedurë e hapur e thjeshtuar, me njësi prokurimi: A. L. (juriste), V. L. (inxhinier mekanik) dhe E. F. (ekonomiste). Caktimi i znj. E. F. në Njësinë e prokurimit është në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Më datë 10.06.2025 është mbajtur procesverbali i hartimit të kërkesave të veçanta teknike për kualifikim, kritereve të vlerësimit, specifikimeve dhe gjithë informacionit specifik nga A M. Në argumentimin e pikës 7 që OE duhet të ketë një fuqi punëtore prej minimalisht 6 punonjësish, me argumentim që llogaritja është 1 drejtues ligjor, + 1 përgjegjës teknik + 4 specialistë= 6 persona, me analizë në pikën 6: që faktikisht janë vetëm 4 punonjës të specializuar, dhe në pikën 5 është a) një inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti që është përgjegjës teknik, duke evidentuar paqartësi në këtë argumentim.

Më datë 10.06.2025, nr.452/5 është nxjerrë urdhri për emërimin e KVO: V. M. , M. G. dhe O. H.

Më datë 11.06.2025 është mbajtur procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, për datë të zhvillimit të tenderit 23.06.2025, po në këtë datë procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga njësia e prokurimit për

kriteret e veçanta dhe kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe vetëm nga Minerali të aftësive tekniko profesionale dhe kërkesat për servis dhe shërbime periodike për secilin mjet.

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 23.06.2025 të KVO dhe NJP dhe ishte paraqitur një OE: D G/B.M P.F me ofertë 3,281,800 lekë, po në këtë datë nga KVO është marrë vendimi nr.1 i vlerësimit të ofertave, ku është vendosur kualifikimi i OE të paraqitur, njoftuar OE për sjelljen e dokumentacionit.

Më datë 02.07.2025 është mbajtur procesverbali i verifikimit të dokumentacionit, dhe konsiderohet i plotë dhe i rregullt nga KVO dhe me datë 21.03.2024 është hartuar Raporti përmbledhës dhe miratuar nga zyrtari i autorizuar.

- Sipas dokumenteve të paraqitura në SPE dhe të dorëzuara në AK konstatohet se, OE i shpallur fitues "*Për personelin teknik të kualifikuar (katër specialistët e kërkuar: specialist xhenerik, motorist, elektroaut dhe gomist), operatori ekonomik duhet të paraqesë, dëshmitë e kualifikimit*", ka paraqitur:
- Për specialistin xhenerik K Ll, certifikatë 2016 mekanik automjetesh, në listë-pagesë me kod 7231.06- mekanik automjetesh; duhej të ishte me kod 7231.24 (mekanik, xhenerik, llamarinist etj,) kontrata 13.09.2024
- Për specialistin motorist O D, certifikatë 2020 autoservis, në listë-pagesë me kod 7231.06- mekanik automjetesh; (mekanik, xhenerik, llamarinist etj,) kontrata 02.09.2024
- Për specialistin elektroauto A K , diplomë profesionale-teknologji automjetesh 2022, në listë-pagesë 7231.03- Elektroaut për automjete; (elektro mekanik, xhenerik,etj,) kontrata 02.09.2024;
- Për specialistin gomist A. Sh. 7231.04, nuk ka dokument për dëshmi.

Nga sa më sipër, konstatohet se mungon dëshmia e kualifikimit për specialistin gomist dhe gjithashtu nuk justifikohen tre specialistët e tjerë me dy certifikata dhe një diplomë profesionale për t'i zëvendësuar dëshmitë e kualifikimit. Kjo pasi dëshmia e kualifikimit është një dokument është dokument zyrtar që vërteton se personi ka fituar një kualifikim profesional të njohur zyrtarisht, ndërsa certifikatat janë dokument që vërteton ndjekjen dhe përfundimin e një kursi trajnimi/formimi profesional.

Bazuar në sa më sipër, OE D G/B.M P.F nuk e ka plotësuar pikën 8 të kritereve të veçanta të kualifikimit.

- Sipas pikës 10. të Kritereve të veçanta të kualifikimit, *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

Ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, servis i cili duhet të ketë:

- *Repart xhenerik*
- *Repart motorik*
- *Repart elektroaut*
- *Repart llamarine e bojatisjeje*

dhe duhet të disponojë pajisjet dhe instrumentet e mëposhtme:

a) Gropë riparimi, ku mund të qëndrojë një autoveturë ose sipas rastit një kamion , ose pajisje ngritëse (hidraulike ose elektrike), sipas standardeve teknike;

b) Elektrokompresor;

c) Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;

ç) Pajisje për kontrollin e gjeometrisë dhe të konvergjencës së gomave;

d) Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
dh) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave;
e) Instrument për matjen e thellësisë së luleve të gomave;
f) Vegla për heqjen dhe vendosjen e gomave;
g) Kompjuter për diagnostikimin e mjeteve
gj) Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit;
h) Vegla matëse dhe të kontrollit, për profesionin motorist, xhenerik etj.;
Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka dorëzuar fotografi, si dokumentacion provues për vetë-deklarimet në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.
Megjithëse, në pjesën B të Deklaratës, OE i kualifikuar i pari cilëson se: "*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor*".
Deklarata për makineritë dhe mjetet ka të përcaktuar: "Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me **të dhënat konkrete"** dhe në fakt nuk ka paraqitur asnjë lloj të dhëne konkrete.

Nga sa më sipër konstatohet se KVO ka kualifikuar OE kur nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Draft marrëveshja kuadër e lidhur më datë 09.07.2025, sipas kërkesës së ripërcaktimit të saktë të shërbimeve dhe afatit të lëvrimit të po kësaj date nga zyrtari i autorizuar, po në këtë datë përgjigjur A. M. .

Nga shqyrtimi i zbatimit te kontratës nr.452/28 prot, datë 14.07.2025 me vlerë 3,281,800 lekë, me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës, me njësi përgjegjëse për mbikëqyrjen A. A. dhe E. F., sipas shkresës nr.452/29 prot., datë 14.07.2025 të zyrtarit të autorizuar F. F., konstatohet se:
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 05.08.2025, fatura e po kësaj date në vlerën 959,100 lekë;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 11.09.2025, fatura e po kësaj date në vlerën 691,400 lekë, perfshirë ad blu 140 litra dhe vaj timoni 20 litra
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 09.10.2025, fatura e po kësaj date ne vlerën 474,000 lekë,;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 14.11.2025, fatura e po kësaj date në vlerën 390,200 lekë, për 4 mjete, si dhe lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse të datës 13.11.2025, fatura e po kësaj date ne vlerën 1,224,050 lekë për 22 mjete;
- sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit),

- Konstatohet se, sipas pohimeve të magazinieres së shoqërisë ky automjet Nisan Patrol me targë KU3xx7A, viti i prodhimit 1986 (Ersekë)nuk ka dokumente për të qarkulluar, çka do të thotë se edhe riparimet e shërbimet në vitin 2023 dhe 2024, janë bërë për një automjet që nuk plotëson kushtet ligjore për qarkullim, në vlerën 354,000 lekë, të cilat janë shpenzime pa efektivitet. Veç kësaj, sipas pohimeve të Drejtoreshës Teknike znj. M. K., automjeti ndodhet në pikën e servisit në Tiranë, pasi ka shfaqur defekt që nga muaji Nëntor 2025.

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje realizimin e kësaj kontrate nga marrëveshja kuadër dhe konstatohet se në zërin e shërbimeve periodike për automjetet dhe mjete e ndryshme, nuk është mbajtur në konsideratë kapaciteti mbajtës i tyre për ndërrimin e vajit dhe as veprimtaria e tyre në bazë të km të përshkuara/orëve të punës dhe afateve teknike të ndërrimit të artikujve të tjerë të shërbimeve periodike.

Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës dhe të dhënave të plotësuara për automjetet për periudhën 2023 - 2025 nga Drejtoria Ekonomike (Departamenti Tregtar), konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës 11.09.2025 deri më 13.11.2025 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe mosveprimet e autoritetit kontraktor janë shpenzuar në mënyrë të panevojshme 494,870 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shërbimet periodike të mjeteve dhe automjete të cilat, sipas km të përshkuara dhe/ose orëve të punës të punuara nuk kanë plotësuar afatet e nevojshme të kryerjes së shërbimeve periodike.

Gjithashtu, sipas procesverbalit të njësisë mbikëqyrëse A. A. dhe E. F. të datës 04.09.2024, shërbimet janë sipas specifikimeve teknike në kontratës dhe se fatura e po kësaj date përputhet me çmimet dhe vlerat e kontratës, shoqëruar me situacionin përkatës (tabelë me emërtimin e pajisjeve dhe shërbimeve sipas mjeteve njësi, sasi, çmim dhe vlerë pa TVSH, vetëm me vulën e kontraktorit). për 22 mjete. Në këtë situacion në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 265,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë. Kjo vlerë është paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar: "*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*".

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 3,995,000 lekë, zhvilluar më datë 23.06.2025 dhe zbatuar me kontratën me nr.452/28 prot., datë 14.07.2025 me vlerë 3,281,800 lekë me kontraktorin D G/B.M P.F dhe me afat 12 muaj, konstatohet se:
- Nga Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor znj. F. F.në këtë procedurë prokurimi është përfshirë në strukturën e posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në njësinë e prokurimit dhe në strukturën e ndjekjes së zbatimit të kontratës, Drejtori Ekonomik znj. E. F.- Nëpunësi zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;

- Në relacionin e llogaritjes së vlerës limit të kontratës, nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i saktë i nevojave për riparime dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Gjithashtu, ka 11 raste që është cilësuar: Mercedez Fugon, Mercedez Kamionçinë, Toyota Kamioncin Hilux (0.8 T) KO28xxA (pa vitin e prodhimit), Mercedes Furgon Severin, Toyota Rav4 (i ri), Automjeti Maliq, Automjeti Devoll, Automjeti Ersekë, Automjeti Sharrë prerje asfalti, Automjeti Bot i ri, duke mos pasur asnjë lloj mundësie për të dhënë oferta, në mungesë të specifikimeve teknike, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Njësia e prokurimi në kërkesat teknike për kualifikim në dokumentet e tenderit nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar që duhet të ketë operatori ekonomik, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat; si dhe është përfshirë kërkesa për punonjës të specializuar/të kualifikuar 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017;
- Konstatohet se, sipas pohimeve të magazinieres së shoqërisë automjeti me targë KU31xxA, viti i prodhimit 1986 (Ersekë) nuk ka dokumente për të qarkulluar, çka do të thotë se riparimet e shërbimet në vitin 2023 dhe 2024, janë bërë për një automjet që nuk plotëson kushtet ligjore për qarkullim, në vlerën 354,000 lekë, të cilat janë shpenzime pa efektivitet. Veç kësaj, sipas pohimeve të Drejtoreshës Teknike znj. M. K., automjeti ndodhet në pikën e servisit në Tiranë, pasi ka shfaqur defekt që nga muaji Nëntor 2025.
- Nga shqyrtimi i realizimit të kontratës dhe të dhënave të plotësuara për automjetet për periudhën 2023 - 2025 nga Drejtoria Ekonomike (Departamenti Tregtar), konstatohet se, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës 11.09.2025 deri më 13.11.2025 asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës nuk ka plotësuar kriteret teknike (km e përshkuara dhe/ose orët e punës) për kryerjen dy herë brenda kësaj periudhe të shërbimeve periodike vjetore. Në këtë mënyrë, nga veprimet dhe mosveprimet e autoritetit kontraktor janë shpenzuar në mënyrë të panevojshme 494,870 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shërbimet periodike të mjeteve dhe automjete të cilat, sipas km të përshkuara dhe/ose orëve të punës të punuara nuk kanë plotësuar afatet e nevojshme të kryerjes së shërbimeve periodike.
- Në situacionin përmbyllës në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi, çmim dhe vlerë sipas kontratës prej 265,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë. Kjo vlerë është paguar në mungesë të dokumentacionit justifikues, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Znj. F. F., me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar në cilësinë e zyrtarit të autorizuar të titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- Znj. E. F., në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP; në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës;
- Z. V. L. , në cilësinë e anëtarit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit; në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Znj. A. L. , në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Z.V. M. , në cilësinë e anëtarit të KVO;

- Z. M. G. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Znj. O. H. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Z. A. A. , në cilësinë e anëtarit të njësisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës.

7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit **"Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", 2024**

Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", me fond limit 76,338,689.55 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.05.2024 me kohëzgjatje 8 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Urdhri për ngritjen e strukturës së posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit nr.246 prot., datë 09.04.2024 me përbërje ing. Th. K. dhe ing. I. P..

Urdhri i prokurimit nr.246/3 prot., datë 15.04.2024, procedurë e hapur, me njësi prokurimi: K. D., I. P. dhe Th. K..

Sipas KVO të emëruar me Urdhrin e zyrtarit të autorizuar nr.246/8 prot., datë 16.04.2024 me përbërje M. K., V. C. dhe V. L. , në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me vlera përkatëse të ofruara:
1. BOE "Xh" SHPK & CSHPK, me ofertë 41,471,905 lekë;
2. BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK me ofertë 48,762,736.2 lekë;
3. "A K" SHPK, me ofertë 57,267,724.5 lekë.
4. "E A" SHPK me ofertë 59,473,922 lekë;
5. "A C" SHPK, me ofertë 61,598,522.3 lekë;
6. "N" SHPK, me ofertë 64,280,310 lekë;
7. "R" SHPK me ofertë 64,296,629.6 lekë;
8. BOE "I" SHPK &"V K" SHPK &"M G" SHPK, me ofertë 67,184,111.582 lekë.

Nga OE pjesëmarrës, KVO ka skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm, pas vendimit nr.1, datë 246/31 prot., me arsyetimin përkatës sipas:
1. "R" SHPK, pasi nuk ka paraqitur ofertën ekonomike të detajuar, sipas Shtojcës 2 "Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit", por vlerën totale pa TVSH, pa asnjë zë preventivi; periudha e vlefshmërisë së ofertës së paraqitur ishte 150 ditë, nga 180 ditë e kërkuar tek Seksioni 3, pika 3.2 e DT;
2. BOE "Xh" SHPK & CSHPK, sepse kjo ofertë është konstatuar anomalisht e ulët.
3. BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK është tërhequr nga procedura e prokurimit, sipas kërkesës për tërheqje të tij: "Për shkak të angazhimit në kontrata të tjera, si dhe ndërprerjes së kontratës së furnizimit nga një furnitor në lidhje me këtë tender, gjë që e bën të pamundur realizimin e objektit."

Nga shqyrtimi i dosjes së kësaj procedure prokurimi, konstatohet se KVO me Vendimin nr.2, datë 10.06.2024 për skualifikimin e BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK dhe rivlerësim të procedurës, ka vendosur skualfikimin e BOE-s së mësipërme, dhe në pikën 3 konfiskimin e sigurimit të ofertës. Gjithashtu, në dosje ndodhet shkresa nr.246/40, datë 10.06.2024, drejtuar kompanisë së sigurimeve A. SHA në të cilën kërkohet konfiskimi i sigurimit të ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK

në vlerën 1,526,773.7 lekë, bashkëlidhur së cilës janë kërkesa për tërheqje e BOE-s dhe Formulari i sigurimit të ofertës të A. me nr.240602074, datë 10.05.2024.

Nga komunikimi me Drejtorin ekonomik të SHRUK Korçë, konstatohet se nuk ka të ardhura hyrje nga kompanitë e sigurimit deri në periudhën aktuale të mbylljes së auditimit. Pra Autoriteti Kontraktor të SHRUK Korçë nuk ka konfiskuar/arkëtuar vlerën e sigurimit të ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK në vlerën 1,526,773.7 lekë, sipas formularit të sigurimit të ofertës të A. me nr.240602074, datë 10.05.2024, pasi është tërhequr nga procedura e prokurimit. Në formularin e sigurimit të ofertës është përcaktuar: "*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Shoqëria Rajonale e Ujësjellës kanalizime Korçë vlerën e siguruar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa e juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme: ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, në se është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit*."
Nga sa më sipër konstatohet se Autoriteti Kontraktor të SHRUK Korçë kundërshtim me kërkesat e pikës 3/a e nenit 83 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar: "*Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave.",* për më tepër që ka kaluar afati 180 ditë i vlefshmërisë së kësaj oferte (09.11.2024).

Për sa më sipër, fillimisht sipas KVO fitues paraprak i kësaj procedure ka qenë "A K" SHPK me vlerë të ofertës së paraqitur prej 57,267,724,5 lekë.

Brenda afatit të ankimit, "E A" SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Pas bërjes së këtij ankimi, Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr.246/48 prot., date 02.07.2024 për pezullimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit dhe caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesës (KSHA). KSHA të UKRK Korçë, me përbërje fillimisht A. M. , Ing. R Rr dhe E. F. me shkresën nr.246/48 prot., datë 02.07.2024, zëvendësuar me shkresën nr. 246/59 prot., datë 09.07.2024 me V. M. ka nxjerrë vendimin nr.1, nr. 246/53 prot., datë 11.07.2024, me të cilin është vendosur:
1- Pranimi pjesërisht i ankesës të "E A" SHPK. Pranimi i pretendimeve të ankuesit për punimet e mëparshme të ngjashme të "A K" SHPK sepse ky operator ekonomik rezulton se nuk ka paraqitur eksperienca për zërat e pus - shpimit të preventivit.
2- Refuzimin e ankesës të "E A" SHPK për objektin e veprimtarisë së "A K" SHPK si të pabazuar në prova e në ligj.
3- Refuzimin e ankesës të ankuesit "E A" SHPK për disponimin e disa mjeteve, makinerive të "A K" SHPK si të pabazuara në prova e në ligj.
4- T'i propozojë Zyrtarit të Autorizuar të AK UKRK Korçë përsëritjen e procedurës, duke u ri hedhur me të gjitha specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, pasi konstatohet se specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit përmbajnë mangësi të rëndësishme të specifikimeve teknike të pus-shpimit.
Në pikën 4, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka tejkaluar kompetencat e veta, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet: "*Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.*", e konstatuar kjo dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) me vendimin nr.1015/2024, nr. 1769/7 prot.. datë 09.08.2024.

Në vijim, pas shqyrtimit të ankimit nga AK, KPP me vendimin nr.1015/2024, datë 09.08.2024, ka vendosur:
1- Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës të OE "E A" SHPK.
2- Te mos pranoje ankesën e OE "E A" SHPK.
3- Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, duke skualifikuar OE "A K" SHPK në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
4- Të konstatojë absolutisht të pavlefshëm pikën 4 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës datë 11.07.2024 për anulimin e procedurës, të marre në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
5- Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

Pas këtij vendimi të KPP, KVO ka nxjerrë vendimin nr.3, nr.246/59 prot., datë 19.08.2024 "Për zbatimin e vendimit te KPP nr.1015/2024", me të cilin është vendosur:
1- Zbatimi i vendimit të KPP nr.1015/2024, nr.1769/7 prot., datë 09.08.2024, duke skualifikuar OE "A K" SHPK në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr. 246/53 prot., datë 11.07.2024 e të pikës 3 të dispozitivit të vendimit të KPP nr.1015/2024.
2- Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të vendimit të KPP nr.1015/2024, skualifikimin e "E A" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit.
3- Në zbatim të pikës 3 të dispozitivit të vendimit të KPP nr.1015/2024, skualifikimin e "N" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit.
4- Klasifikimi i ofertave në këtë procedurë prokurimi, është si më poshtë:
- Në vend të parë "A C", SHPK vlera 61,598,522.3 lekë;
- Në vend të dytë BOE "I" SHPK & "V K" SHPK & "M-G" SHPK me vlere 67,184,111.582 lekë.

Në fakt, KPP me vendimin nr.1015/2024, nr. 1769/7 prot.. date 09.08.2024, në pikën 3 të vendimit ka përcaktuar: "*Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik "A K" SHPK në zbatim të pikës 1 dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*". Nga sa më sipër konstatohet se, KVO me vendimin nr.3, nr.246/59 prot., datë 19.08.2024 "Për zbatimin e vendimit te KPP nr.1015/2024", në të cilin në pikën 2 dhe 3 është vendosur për skualifikimin e OE "E A" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit dhe OE "N" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit, nuk rezultojnë të jenë të bazuara në Vendimin e KPP nr.1015/2024, nr. 1769/7 prot.. datë 09.08.2024.

KVO ka arsyetuar dhe vendosur se në vijim duhet ndjekur i njëjti standard për vlerësimin e punimeve të mëparshme të ngjashme për të gjithë ofertuesit e kualifikuar sipas vendimit të KPP nr.1015/2024, nr. 1769/7 prot., datë 09.08.2024, duke skualifikuar OE "E A" SHPK dhe OE "N" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit. KVO në këtë rast nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 4, të nenit 75 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, në të cilën përcaktohet: "*Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*", për më tepër që është ezauruar edhe afati i vlerësimit të ofertave. Kështu, KVO ka kualifikuar fillimisht OE "E A" SHPK

dhe OE “N” SHPK dhe me vendimin nr.3, nr. 246/59 prot., datë 19.08.2024 ka skualifikuar OE “E A” SHPK dhe OE “N” SHPK.

KPP, pas marrjes së dokumentacionit nga AK dhe verifikimit në SPE, ka marrë vendimin nr.1104/2024, nr. 1769/13 prot., datë 22.08.2024, vënë në dispozicion më datë 26.08.2024 me të cilin është vendosur:
1- Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi.
2- Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomike “E A” SHPK dhe “N” SHPK sipas statusit që kanë patur në datën 10.05.2024, si dhe duke lënë të skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “A K” SHPK.
Bazuar në vendimin e mësipërm të KPP, Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin me nr.246/67 prot., datë 27.08.2024 për zbatimin e vendimit të mësipërm të KPP.

Si përfundim, KVO, ka nxjerrë vendimin nr.4, nr.246/69 prot., date 28.08.2024 “Për ndryshimin e vendimit të KVO nr.3, date 19.08.2024, me të cilin në zbatim të vendimit të KPP nr.1769/13 prot., nr.1104/2024, datë 22.08.2024, është vendosur rivlerësimi i kësaj procedure prokurimi, duke u kualifikuar ofertat e “E A” SHPK dhe “N” SHPK e duke u bërë klasifikimi i ofertave ashtu sikurse është pasqyruar ne SPE në datën 28.08.2024, ora 14.04, pra:
- “E A” SHPK me vlerë 59,473,922 lekë;
- “A C” SHPK me vlerë 61,598,522.3 leke;
- “N” SHPK me vlerë 64,280,310 lekë;
- BOE “I” SHPK & “V K” SHPK & “M-G” SHPK me vlerë 67,184,111.582 leke.

Komisioni i Prokurimit Publik ka disponuar me vendimin nr.1769/19 prot, datë 09.09.2024, nënshkruar elektronikisht në datën 10.09.2024, me të cilin është vendosur të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin e hapave të mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi.

Nga auditimi i kësaj procedure prokurimi në SPE dhe dosjes fizike, konstatohet se në DT, është përcaktuar në pikën 2.3.6, të Shtojcës 7 të DT- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

Mjetet	Statusi	Sasia
Fabrikë asfalti, me vendndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti.	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrikë betoni pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira	Copë 1

Sipas dokumentacionit në sistemin e prokurimit elektronik dhe të dosjes fizike të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues “E A” SHPK, konstatohet se:
I. Në plotësim të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, për - *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*
1. - Për “*Fabrikë asfalti, me vend-ndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*”, me status “*në pronësi ose me qira*”, në Shtojcën 8- Formulari përmbledhës i vetë deklarimit, kreu C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ka paraqitur kontratën e furnizimit nr.2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë “S” SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton.

Së pari, në DT nuk është përcaktuar që për fabrikë asfalti ose kontratë furnizimi por në pronësi ose me qira. Paraqitja e kontratës së furnizimit për asafaltobeton, në vend të fabrikës së asfaltit në pronësi ose me qira, nuk është në përputhje me përcaktimet e kriterit të mësipërm të kualifikimit;
Së dyti, kontrata e furnizimit për asfaltobeton është me një shoqëri me vend-ndodhje në Fier, që nga Korça është në distancë rrugore mbi 160 km, duke e bërë një distancë teknikisht të papranueshme për transport asfalti, pasi asfalti gjatë udhëtimit për një kohë të gjatë humbet temperaturë, punueshmëri dhe cenon cilësinë e shtrimit, pra humbet vetitë përkatëse.
2. Për "*Fabrikë betoni pajisur me leje mjedisore*" ka paraqitur kontratën e furnizimit me shoqërinë "Gj B" SHPK me adresë në Fier me nr.1220 repertori dhe nr. 392/1 koleksioni, datë 12.04.2022 me objekt furnizimi me beton. Megjithëse në DT fabrikë betoni me leje mjedisore në pronësi ose me qira, si dhe nuk është përcaktuar që të jetë në distancë teknikisht të pranueshme, OE "E A" SHPK ka paraqitur kontratë furnizimi, jo në përputhje me kriteret e kualifikimit, si dhe distanca është edhe më strikte dhe më e qartë se sa te asfalti. Kjo pasi fillon procesin e ngurtësimit (hidratimit) menjëherë pas përzierjes dhe ka kohë pune shumë të kufizuar. Standardet teknike të betonit kërkojnë hedhjen në objekt brenda një periudhe prej 90 - 120 min, gjë që është praktikisht e pamundur nga Fieri në Korçë (Kuç etj.,) Në këtë mënyrë kontrata e furnizimit me beton është praktikisht jo në përputhje me kriteret e kualifikimit, si dhe e pavlefshme nga vendi i furnizimit për në objektin që do të punohet.
Nga sa më sipër konstatohet se KVO me përbërje M. K., V. C. dhe V. L. nuk ka vepruar sipas kërkesave të paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*", pasi OE "E A" SHPK nuk ka plotësuar kriterin e kualifikimit për të pasur fabrikë asfalti në pronësi ose me qira, si dhe vend-ndodhja është në distancë teknikisht të papranueshme nga objekti për shkak të largësisë; kontrata e furnizimit me beton është në distancë të pamundur teknikisht për kryerjen e punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE, dokumentacionit të dosjes fizike dhe vendimeve të KPP konstatohet se, KVO, më datë 10.06.2024 ka skualifikuar OE "R" SHPK, pasi krahas paraqitjes së ofertës ekonomike të pa detajuar, sipas zërave të preventivit, ka rezultuar se periudha e vlefshmërisë së ofertës së paraqitur ishte 150 ditë, nga 180 ditë e kërkuar në DT.
Nga verifikimi në SPE konstatohet se edhe OE të kualifikuar nga KVO periudha e vlefshmërisë së ofertës së paraqitur ishte 150 ditë, nga 180 ditë e kërkuar në DT:
- BOE "I" SHPK & "V K" SHPK & "M-G" SHPK, Formulari i sigurimit të ofertës nga Sigal, me nr. serie 244101180, datë 10.05.2024, është me afat vlefshmërie 150 ditë;
- OE "N" SHPK Formulari i sigurimit të ofertës nga Sigal, me nr. serie 244101138, datë 10.05.2024, është me afat vlefshmërie 150 ditë;

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", me fond limit 76,338,689.55 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.05.2024 me kohëzgjatje 8 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, konstatohet se:
- Autoriteti Kontraktor nuk ka konfiskuar sigurimin e ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK në vlerën 1,526,773.7 lekë, sipas formularit të sigurimit të ofertës të A. me nr.240602074, datë 10.05.2024, pasi është tërhequr nga procedura e prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3/a e nenit 83 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar;

- Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës në vendimin nr.1, nr. 246/53 prot., datë 11.07.2024, me propozimin për përsëritjen e procedurës, duke ri hedhur me të gjitha specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, ka tejkaluar kompetencat e veta, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar;
- KVO me vendimin nr. 3, nr. 246/59 prot., datë 19.08.2024 "Për zbatimin e vendimit të KPP nr.1015/2024", ka vendosur për skualifikimin e OE "E A" SHPK dhe OE "N" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit pa u bazuar në Vendimin e mësipërm të KPP, në një kohë që OE të sipërcituar kanë qenë kualifikuar më parë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të nenit 75 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "E A" SHPK, në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, pasi për "*Fabrikë asfalti, me vend-ndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*", me status "*në pronësi ose me qira*", ka paraqitur kontratën e furnizimit nr. 2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë "S" SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton. Po kështu, për "*Fabrikë betoni pajisur me leje mjedisore*" ka paraqitur kontratën e furnizimit me shoqërinë "Gj B" SHPK me adresë në Fier me nr.1220 repertori dhe nr. 392/1 koleksioni, datë 12.04.2022 me objekt furnizimi me beton. Në këto kushte, kur fabrika e asfaltit dhe fabrika e betonit nuk kanë status as në pronësi dhe as me qira, si dhe janë në distancë teknikisht të papranueshme, KVO ka vepruara jo në përputhje me kërkesat e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar;
- KVO ka përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave, pasi ka s'kualifikuar OE "R" SHPK, midis të tjerave, se periudha e vlefshmërisë së ofertës së paraqitur ishte 150 ditë, nga 180 ditë e kërkuar në DT dhe ka kualifikuar BOE "I" SHPK & "V K" SHPK & "M G" SHPK dhe OE "N" SHPK, formulari i sigurimit të ofertës të të cilëve është 150 ditë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë;
- Z. A. M. , në cilësinë e anëtarit të shqyrtimit të ankesës;
- Z. R Rr, në cilësinë e anëtarit të shqyrtimit të ankesës;
- Z. V. M. , në cilësinë e anëtarit të shqyrtimit të ankesës;
- Znj. M. K., në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Znj. V. C. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Z. V. L. , në cilësinë e anëtarit të KVO.

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për procedurën e prokurimit **"Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq" 2025**

Tenderi për procedurën e prokurimit e hapur punë publike me objekt "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq" me fond limit 79,975,219,87 lekë është zhvilluar më datë 10.02.2025, me afat 8 (tetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Me urdhrin zyrtarit të autorizuar M. K. nr.44/1 prot., datë 16.01.2025 është caktuar struktura përgjegjëse që përgatit kërkesat teknike për kualifikim, kriteret e vlerësimit specifikimet teknike të DT, si dhe çdo informacion tjetër specifik.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “V -C” SHPK, 50,197,330 lekë. BOE “V -C” SHPK me 17% dhe “A A” SHPK me 83%;
2. “I” SHPK, 50,266,084,5 lekë. BOE “I” SHPK me 40% dhe “L C” SHPK me 60%;
3. “N” SHPK, 50,380,849 lekë. BOE “N” SHPK me 61.82% dhe “M” SHPK me 38.18;
4. “A” SHPK, 51,494,858.50 lekë;
5. “Xh” SHPK, 52,649,965 lekë. BOE “Xh” SHPK me 75.6% dhe “C” SHPK me 24%;
6. “M G” SHPK, 54,888,888 lekë. BOE “M G” SHPK me 20%, “V” SHPK me 35% dhe “V K” SHPK me 45 %;
7. “N” SHPK, 55,010,650 lekë;
8. “2 N” SHPK 57,652,741 lekë. BOE “2 N” SHPK me 45.3% dhe “B” SHPK me 54.7%;
9. “K” SHPK, 57,610,472.85 lekë;
10. “E A” SHPK, 58,657,043 lekë. BOE me Subjekt Mbështetës: “P V K” SHPK dhe L L P.F;
11. “F” SHPK, 60,210,458 lekë. BOE “F” SHPK me 30% “Sh” me 70%;
12. “A C” SHPK, 63,319,778 lekë;
13. “B I” SHPK, 69,069,243 lekë;
14. “R” SHPK, 73,317,754 lekë, dhe
15. “S” SHPK, 79.975.191 lekë.

Sipas KVO, të ngritur me Urdhrin e zyrtarit të autorizuar, nr.4/5 prot., datë 22.01.2025 me përbërje: V. L. , V. M. dhe E. B. janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm me arsyetimet përkatëse: 1. “A” SHPK; 2. “A C” SHPK; 3. “I”: 4. “M G” SHPK; 5. “R” SHPK; 6. “S” SHPK; 7. “Xh” SHPK; 8. “V -C” SHPK; 9. “N” SHPK; 10. “N” SHPK; 11. “K” SHPK; 12. “2 N” SHPK.

Nga KVO janë kualifikuar:
1. “E A” SHPK me ofertë 58,657,043 lekë;
2. “F” SHPK me ofertë 60,210,458 lekë. BOE “F” SHPK me 30% “SH” me 70%;
3. “B I” SHPK me ofertë 69,069,243 lekë, duke shpallur fitues OE “E A” SHPK me ofertën më të ulët pre OE të të kualifikuarve 58,657,043 lekë.

Nga sa më sipër konstatohet se, janë skualifikuar gjithsej 12 OE, 9 nga të cilët me vlerën më të ulët se OE i shpallur fitues.

Grupi i auditimit shqyrtoj me vëmendje këtë procedurë në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në dosjet fizike përkatëse për të gjithë OE të skualifikuar dhe konstatohet se:
- KVO ka skualifikuar BOE “V -C” SHPK me 17% dhe “A A” SHPK me 83%, me ofertë 50,197,330 lekë. Sipas KVO: *Nga operatori ekonomik “V -C” SHPK nuk është administruar asnjë kontratë lidhur me punët e ngjashme për ndërtim depo V= 150 m3 sikundër ka specifikuar në Kontratën e Bashkëpunimit datë 07.02.2025 lidhur ndërmjet BOE “V -C” SHPK & “A A” SHPK. Për pasojë nuk është plotësuar një nga kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga njësia e prokurimit ne Procesverbal tip i kontratës punë për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi dhe DST.*

Grupi i auditimit shqyrtoi zërat e punimeve për ndërtim depo V= 150 m³, që sipas Shtojcës 10 të DT përbëhet nga 17 zëra punimesh që kanë të bëjnë me gërmime, shtresë çakëlli, struktura betoni, hekur betoni etj.
Sipas dokumentacionit të BOE të mësipërm të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet se OE “V -C” SHPK, për punë të ngjashme për ndërtim depo ka hedhur tre kontrata: me nr. 6019 prot., datë 10.11.2023 me objekt: “Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra

dhe të pa favorizuara", me vlerë 27,655,518 lekë me TVSH, që sipas situacionit përfundimtar, zërat e punimeve kanë të bëjnë me punime prishje, murature, hidroizolim çatie, suvatimi, shtresa dhe elektrike; kontrata e datës 15.05.2023 me objekt "Godinë banimi 7 kate dhe një kat nën tokë" me vlerë 59,818,735 lekë, që sipas situacionit përfundimtar punimet kanë të bëjnë me punime prishjeje, dheu, betoni dhe betonarme, shtresa, suvatime, hidroizolime, sistemime, furnizimi me ujë etj.; kontrata me nr.6981/2 prot., datë 19.09.2023 me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Vithkuq" me vlerë 3,473,369 lekë, punime qe sipas situacionit përfundimtar kanë të bëjnë me punime gërmimi, betoni dhe betonarme, trotuare, sistemime etj. Nga sa më sipër konstatohet se OE "V -C" SHPK e ka plotësuar kriterin e kualifikimit me kontrata për punë të ngjashme për ndërtim depo V= 150 m³, pasi ka paraqitur tre kontrata me natyrë teknike të krahasueshme me objektin e prokurimit; të cilat kërkojnë teknologji, procese pune dhe specializime të ngjashme; paraqesin kompleksitet teknik të njëjtë ose të afërt si dhe janë realizuar në kushte funksionale të ngjashme. Për më tepër, që "Punimet e ngjashme" nuk mund të jenë identike, por të krahasueshme; kriteri lidhet drejtpërdrejt me aftësinë reale për të realizuar kontratën; si dhe mosnjohja e punëve të ngjashme në këtë rast nuk është e arsyetuar dhe proporcionale. Nga mangësitë e KVO në vlerësimin e kësaj oferte, është shkaktuar mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve të SHRUK Korçë në vlerën 8,459,713 lekë, si diferencë midis ofertës së shpallur fituese dhe kësaj oferte të skualifikuar nga KVO në kushtet e plotësimit të kritereve.

Sipas dokumentacionit në sistemin e prokurimit elektronik dhe të dosjes fizike të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "E A" SHPK, konstatohet se:
I. Në plotësim të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, për - *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*
1. - Për "*Fabrikë asfalti, me vendndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*", me status "*në pronësi ose me qira*", në Shtojcën 8- Formulari përmbledhës i vetë deklarimit, kreu C: Deklaratë "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" ka paraqitur kontratën e furnizimit nr.2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë "S" SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton.
Së pari, në DT nuk është përcaktuar që për fabrikë asfalti ose kontratë furnizimi por në pronësi ose me qira. Paraqitja e kontratës së furnizimit për asafaltobeton, në vend të fabrikës së asfaltit në pronësi ose me qira, nuk është në përputhje me përcaktimet e kriterit të mësipërm të kualifikimit;
Së dyti, kontrata e furnizimit për asfaltobeton është me një shoqëri me vend-ndodhje në Fier, që nga Korça është në distancë rrugore mbi 160 km, duke e bërë një distancë teknikisht të papranueshme për transport asfalti, pasi asfalti gjatë udhëtimit për një kohë të gjatë humbet temperaturë, punueshmëri dhe cenon cilësinë e shtrimit, pra humbet vetitë përkatëse.
2. Për "*Fabrikë betoni ose kontratë furnizimi*" ka paraqitur kontratën e furnizimit me shoqërinë "Gj B" SHPK me adresë në Fier me nr.1220 repertori dhe nr. 392/1 koleksioni, datë 12.04.2022 me objekt furnizimi me beton. Megjithëse në DT nuk është përcaktuar që të jetë në distancë teknikisht të pranueshme, në rastin e betonit, situata është edhe më strikte dhe më e qartë se sa te asfalti.

II. Lidhur me disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate, në DT është përcaktuar që: "*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë: a.4 (katër) Hidraulikë; b. 4 (katër) Karpentierë; c.4 (katër) Hekurkthyes; d. 2 (dy) Teknikë ndërtimi; e. 2 (dy) Manovratorë; f. 1 (një) Teknik mekanik; g. 1*

(një) Bojaxhi/Suvaxhi; h. 1 (një) Murator; i.1 (një) Hidroizolues; j. 1 (një) shofer; k. 10 (dhjetë) punëtorë krahu.
Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetë deklarimit sipas shtojcës nr.8.
Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetë deklarimet në formularin përmbledhës të vetë deklarimit.
Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentet provues: Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve/apo dëshmi aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve ne toke e lëshuar nga DPSHTRR, si dhe kontratat e punës të vlefshme. Sqarojmë se për 10 punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.
Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentet provues: *Listë pagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore: Tetor 2024 - Dhjetor 2024, për punësimin e mesatarisht 36 personave".*
Nga shqyrtimi i Shtojcës 8-Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, kreu B: Deklaratë "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate", si dhe listë - pagesat e punonjësve për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2024 konstatohet se ka mungesa të pjesëmarrjes në punë ose/dhe mospërputhje të kodit sipas Listës Kombëtare të Profesioneve, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar" në listë - pagesë dhe deklarimit të bërë si më poshtë:
- *N Xh, punëtor i thjeshtë, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e punëtorit të thjeshtë*, nuk është në listë - pagesat e muajit tetor dhe nëntor; në dhjetor 2024 është me kod 7119.01 për Mbërthyes për konstruksione;
- *H T, me profesion hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e hekurkthyesit*, është me kod 7212.09 Saldator;
- *A S, me profesion drejtues i mjeteve të rënda Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e manovratorit*, nuk është në listë - pagesat e muajit tetor dhe nëntor;
- *R N, me profesion teknik mekanik, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Teknik mekanik*, nuk është në listë - pagesat e muajit tetor; me kod 9622.01 punëtor krahu në nëntor; me kod 3119.15 teknik ndërtimi në dhjetor;
- *Nuk korrespondojnë kodet për punëtor të thjeshte për*:
    1. *A P,* me kod 7124.08-instalues izolimesh;
    2. *R K*, me kod 7214.06 -përgatitës strukturash metalike;
    3. *H H,* me kod 7114.01 - betonues;
    4. *D G,* me kod 7214.01, - mbërthyes konstruksionesh çeliku;
    5. *S K* me kod 7123.01 -specialist tavane gipsi;
    6. *L C,* me kod 7123.01, - specialist tavane gipsi.

Nga sa më sipër konstatohet se KVO me përbërje V. L. , V. M. dhe E. B. nuk ka vepruar sipas kërkesave të paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmBn kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*", pasi OE "E A" SHPK nuk ka plotësuar kriterin e kualifikimit për të pasur fabrikë asfalti në pronësi ose me qira, si dhe vend-ndodhja është në distancë teknikisht të papranueshme nga objekti për shkak të largësisë; kontrata e furnimit me beton është në distancë të pamundur teknikisht për kryerjen e punimeve; punonjësit e specializuar/ të kualifikuar në dy raste nuk janë në listë-pagesa për tre muaj, si dhe në 11 raste kodi i profesionit në listë – pagesë nuk përputhet me profesionin e deklaruar.
Veç sa më sipër, konstatohet se KVO ka skualifikuar *BOE "N" SHPK & "M" SHPK*, midis të tjerave, dhe për shkak se në formularin e vetë deklarimit ka deklaruar se disponon 4 hidraulike ndërkohë nga listë pagesa e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore rezulton qe 2 prej hidraulikëve të mos jenë më pjesë e stafit të tyre prej muajit Dhjetor.
Gjithashtu, është skualifikuar dhe OE "N" SHPK për shkak të mospërputhjeve për sa deklaruar tek formulari i vetë deklarimit dhe listë pagesës së sigurimeve shoqërore lidhur me punonjësit.
Pra KVO e përbërë nga V. L. , V. M. dhe E. B. ka përdorur standarde vlerësimi të ndryshme, duke skualifikuar OE pjesëmarrës për të njëjtën mangësi në plotësimin e kritereve që është kualifikuar dhe shpallur fitues një OE tjetër.
- Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit të SHRUK Korçë, konstatohet se më datë 16.10.2024 OE "E A" SHPK ka nënshkruar kontratën me objekt "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë" me vlerë 59,473,922 lekë, me afat zbatimi 8 muaj. Kjo do të thotë që në datën 10.02.2025 të zhvillimit të tenderit me objekt "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq", kontrata e mëparshme nuk ka arritur në gjysmën e afatit të zbatimit. Nga krahasimi i dokumentacionit të këtij OE në dy procedurat e prokurimit, konstatohet se ka paraqitur të njëjtët inxhinier ndërtimi, hidroteknik, mekanik dhe gjeolog, si dhe 13 specialistë dhe punonjës të thjeshtë që janë të njëjtë për dy kontratat. Po ashtu, konstatohet se janë 12 mjete dhe automjete që ndërkohë kanë qenë të angazhuara në kontratën e tetorit 2024. Pra, ka mbivendosje kapacitetesh njerëzore dhe makineri-pajisjeve, për më tepër që kontrata aktuale kërkon angazhim të plotë të personelit inxhiniero-teknik dhe nga ana e KVO nuk janë analizuar dhe vlerësuar kapacitetet reale të OE në funksion të realizimit të kontratës, duke mos përdorur mundësinë e përcaktuar në paragrafin e fundit të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 18.05.2021, i ndryshuar për të kërkuar sqarime nga ofertuesit.

Si konkluzion, nga auditimi i procedurës së prokurimit "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq" me fond limit 79,975,219,87 lekë, zhvilluar më datë 10.02.2025, konstatohet se:
- KVO ka skualifikuar BOE "V -C" SHPK dhe "A A" SHPK me ofertë 50,197,330 lekë, pasi sipas KVO *nga operatori ekonomik "V -C" SHPK nuk është administruar asnjë kontratë lidhur me punët e ngjashme për ndërtim depo V= 150 m³.*Sipas dokumentacionit të BOE të mësipërm të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet se OE "V -C" SHPK, për punë të ngjashme për ndërtim depo ka hedhur tre kontrata, që sipas situacionit përfundimtar kanë zëra punimesh të ngjashme me ndërtimin e depos. Nga mangësitë e KVO në vlerësimin e kësaj oferte, është shkaktuar mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve të SHRUK Korçë në vlerën 8,459,713 lekë, si diferencë midis ofertës së shpallur fituese dhe kësaj oferte të skualifikuar nga KVO në kushtet e plotësimit të kritereve.

- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “E A” SHPK, në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, pasi për “*Fabrikë asfalti, me vend-ndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*”, me status “*në pronësi ose me qira*”, ka paraqitur kontratën e furnizimit nr. 2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë “S” SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton. Në këto kushte, kur fabrika e asfaltit nuk ka status as në pronësi dhe as me qira por kontratë furnizimi, si së bashku me fabrikën e betonit nuk janë në distancë teknikisht të papranueshme.
Gjithashtu, nuk disponon punonjësit e specializuar për realizimin e punimeve objekt kontrate, pasi .në 3 raste nuk kanë pjesëmarrje të plotë në tre muajt e fundit, si dhe në 9 raste deklarimi nuk përputhet me kodin e listës së profesioneve në listë-pagesa. KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- KVO ka skualifikuar BOE “N” SHPK & “M” SHPK, midis të tjerave, dhe për shkak të mospërputhjes së deklarimit për hidraulikë me listë - pagesat e sigurimeve shoqërore, si dhe OE “N” SHPK për të njëjtën arsye. Ndërsa ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “E A” SHPK që paraqet të njëjtat mangësi në plotësimin e këtij kriteri. Pra KVO ka përdorur standarde vlerësimi të ndryshme, duke skualifikuar OE pjesëmarrës për të njëjtën mangësi në plotësimin e kritereve që është kualifikuar dhe shpallur fitues një OE tjetër;
- Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit të SHRUK Korçë, konstatohet se OE “E A” SHPK është afërsisht në gjysmën e afatit të zbatimit të një kontrate të tetorit 2024, dhe në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur të njëjtët inxhinier ndërtimi, hidroteknik, mekanik dhe gjeolog; 13 specialistë dhe 12 makineri - pajisje që ndërkohë kanë qenë të angazhuara në kontratë. Pra, ka mbivendosje të një pjese të kapaciteteve njerëzore dhe makineri-pajisjeve dhe nga ana e KVO nuk janë analizuar dhe vlerësuar kapacitetet reale të OE të shpallur fitues në funksion të realizimit të kontratës, duke mos përdorur mundësinë e përcaktuar në paragrafin e fundit të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 18.05.2021, i ndryshuar, për të kërkuar sqarime nga ofertuesit.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. V. L. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Z. V. M. , në cilësinë e anëtarit të KVO;
- Znj. E. B. , në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike për periudhën e auditimit, 01.01.2023 deri 30.09.2025 rezultoi si më poshtë.

Në total për periudhën e auditimit, janë lidhur **10 (dhjetë)** kontrata për punë publike në vlerën **379,809,821.13** lekë pa TVSH, e ndarë sipas viteve, si vijon:

Për vitin 2023 janë lidhur 4 (katër) kontrata për punë publike me vlerë 48,665,207.13 lekë pa TVSH, përkatësisht: 3 (tre) kontrata për punë publike me vlerë 22,695,207.13 lekë pa TVSH dhe 1 (një) kontratë mallra me vlerë 25,970,000 lekë pa TVSH.

Për vitin 2024 janë lidhur 6 (gjashtë) kontrata për punë publike me vlerë 239,800,528 lekë pa TVSH, përkatësisht: 3 (tre) kontrata për punë publike me vlerë 167,174,143 lekë pa TVSH dhe 3 (tre) kontratë mallra + shërbime me vlerë 72,626,385 lekë pa TVSH.

Për periudhën 01.01.2025 deri 30.09.2025 janë lidhur 1 (një) kontratë për punë publike me vlerë 58,657,043 lekë pa TVSH.

Nr.	Elementi i Regjistrit	Fondi Limit i Procedures (pa TVSH)	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit te lidhjes se kontrates	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlera kontratës (pa TVSH)
	VITI 2023					
1	Punime ndërtimi për rikonstruksionin e godinave të stacioneve të pompave në fshatrat Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj dhe Plasë.	3,473,577	3/20/2023	5/15/2023	"I" SHPK	2,989,634.00
2	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan	23,233,087	4/26/2023	9/12/2023	"N" SHPK	17,133,073.13
3	Asfaltim i rrugës hyrëse të Impjantit të Trajtimit të Ujrave të Përdorura (ITUN) pranë Impiantit Fotovoltaik Korçë	2,900,000	45,057	-	"S" SHPK	2,572,500.00
4	Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)	-	25/04/2023	03/07/2023	"M G" SHPK	25,970,000
	Viti 2024					
1	Meremetimi i stacioneve te pompave ne fshatrat Kakac, Bregas, Sovjan (per Sheqerasin), Plase Rajonal, Zvirine (per Vreshtasin), Shengjergj, Kishnik, Burimas, Proger dhe Trestenik.	12,683,850.91	02.03.2025	04.04.2025	"I G" SHPK	8,267,585.00
2	Ndërtim ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll.	87,699,294.79	7/9/2024	3/9/2025	"N" SHPK	67,036,536.00
3	Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Korçë.	76,338,689.55	10/16/2024	6/17/2025	"E A" SHPK	59,473,922.00
4	Furnizim dhe instalim pompa ne Njesite Devoll, Maliq dhe Korce. (Blerje, Furnizim dhe Instatil)	70,300,000.00	2/24/2025	12/24/2025	"M G" SHPK	55,888,800.00
5	Zhvillim i sistemit SCADA, stacioni i pompimit Turan.	8,900,000.00	12/20/2024	12/27/2024	"M G" SHPK	8,470,000.00
6	Investime ne ujësjellësa në fshatrat Sheqeras, Plasë, Libonik, Drithas, Symiz, Pirg dhe Kolanec , në Njësinë Maliq të	64,452,339.00	12/17/2024	6/30/2025	"N" SHPK	40,663,685.00

	Ujësjellës Kanalizime Rajoni Korçë.					
	Periudha 01.01.2025 - 30.09.2025					
1	Ndertim i ujesjellesit ne fshatin Zvezde, Bashkia Maliq.	79,975,219.87	5/8/2025	1/8/2026	"E A" SHPK	58,657,043.00

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit, në SHRUK Korçë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara, të kolauduar dhe të marra në dorëzim për periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelat nr. 1; nr. 2 dhe nr. 3.

Për vitin 2023 është përzgjedhur **1** (një) kontratë për punë publike me vlerë **17,133,073.13** lekë pa TVSH.

Për vitin 2024 janë përzgjedhur **4** (katër) kontrata për punë publike me vlerë **223,062,943** lekë pa TVSH.

Shënim:

1. Investimi me objekt: "Investime në ujësjellësa në fshatrat Sheqeras, Plasë, Libonik, Drithas, Symiz, Pirg dhe Kolanec, në Njësinë Maliq të Ujësjellës Kanalizime Rajoni Korçë" me vlerë 40,663,685 lekë pa TVSH, me sipërmarrës shoqërinë "N" SHPK, nuk u auditua nga grupi i auditimit, sepse nuk është mbyllur Situacioni Përfundimtar dhe nuk është lidhur aktualisht Kontrata e Kolaudimit.
2. Investimi me objekt: "Ndërtim i ujësjellësit ne fshatin Zvezde, Bashkia Maliq" me vlerë 58,657,043.00 lekë pa TVSH, me sipërmarrës shoqërinë "E A" SHPK, nuk u auditua nga grupi i auditimit, sepse punimet e ndërtimit janë ende në proces pune.

Mbështetur sa më sipër, janë zgjedhur për auditim ***5 (pesë)*** *kontrata (3-punë publike +2 mallra)e për periudhën e auditimit në vlerën totale* 270,216,797.35 lekë me TVSH, përkatësisht 3 (tre) kontrata për punë publike në vlerën 171,986,237.35 lekë me TVSH dhe 2 (dy) kontrata "Mallra dhe shërbime" në vlerën 98,230,560 lekë me TVSH, që mbulon **78.68 %** të vlerës totale të objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar SHRUK Korçë, po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**,** si vijon:

I**.** Kontrata për punë publike me objekt: "**Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll".		
14.Lidhja e kontratës. nr. 247/33, datë 09.07.2024	**15.Vlera e kontratës**	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 19,471,371 lekë me TVSH

OE “N” SHPK	Vl e prev ofertues 80,443,843.20 lekë me TVSH.	Sit. 2 në vlerën 49,435,152 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 11,513,157 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 80,419,680 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 17.07.2024 Përfundimi punimeve: 11.03.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “2 C” SHPK	Licenca MK. 4324	Kontratë me nr. 592/19, datë 09.07.2024
21. Kolaudatori i punimeve OE “R” SHPK	Licenca Nr: MK.1506/12	Kontratë me nr. 426/8 prot., datë 30.05.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 05.06.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “N” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “2 C” SHPK si dhe kolaudatori OE “R” SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. 193/12 prot., datë 05.06.2025 në SHRUK Korçë, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “N” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “2 C” SHPK si dhe kolaudatori OE “R” SHPK, si dhe grupi i marrjes në dorëzim I. P., Th. K., E.Sh dhe E. F..	

u konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara

si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të SHRUK Korçë, në vlerën **337,110 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Rezervuar uji V=150 m3 fshati Poloskë.

Zëri 7. Struktura monolite betoni me çakëll C 30/37. Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 146 m^3 beton. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 146 m^3 beton me çmim 13,000 lekë/ m^3 pa TVSH.

Libreza e masave pasqyron volumin 147.05 m^3 beton C 30/37 , ku trajtohet në mënyrë analitike.

Në fakt po t’i referohemi auditimit në vepër (depo V=150 m^3) (terren) konstatohet se punimet e betonit për murin rrethues dhe shpatullat jashtë derës nuk janë kryer sipas dimensioneve të pasqyruara në librezën e masave, dhe konkretisht volumet rezultojnë 11 m3 beton dhe jo 14 m^3 beton, si vijon:

Emërtimi	Njësia	Sasia	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Shuma
Muri rrethues	m^3	-	52	0.25	0.6	7.8
Muret (shpatulla) jashtë depos	m^3	2	3.6	0.25	1.8	3.24
Shuma						**11**

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 3 m^3 beton është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **39,000 lekë pa TVSH** [3 m^3 x 13,000 lekë].

Zëri 15. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 103 m² hidroizolim. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 103 m² rrethim me çmim 750 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 103.74 m² hidroizolim , ku trajtohet në mënyrë analitike, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Gjatësia	Lartësia	Shuma
1	Hidroizolim mbi soletë	m²	1	11.4	9.1	103.74
	Shuma					**103.74**

Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **77,250 lekë pa TVSH** [103 m² x 750 lekë].
Zëri 18. Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 6 ml ulluk vertikal. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 6 ml ulluk vertikal me çmim 1,100 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 6 ml ulluk shkarkimi vertikal.
Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **6,600 lekë pa TVSH** [6 ml x 1,100 lekë].
Zëri 19. Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 1 copë kasetë shkarkimi. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1 copë me çmim 2,500 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 1 copë kasetë shkarkimi.
Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **2,500 lekë pa TVSH** [1 copë x 2,500 lekë].

Rezervuar uji V=100 m3 fshati Kuç.
Zëri 7. Struktura monolite betoni me çakëll C 30/37.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 97 m^3 beton. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 97 m^3 beton me çmim 13,000 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 97.06 m^3 beton C 30/37 , ku trajtohet në mënyrë analitike.
Në fakt po t'i referohemi auditimit në vepër (depo) konstatohet se punimet e betonit për murin rrethues nuk janë kryer sipas dimensioneve të pasqyruara në librezën e masave, dhe konkretisht:

Emërtimi	Njësia	Sasia	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Shuma
Muri rrethues	m3	1	52	0.15	0.3	2.34
Shuma						**2.34**

Referuar faktit, nga rillogaritja rezulton rrethim i përkohshëm me beton 2.34 m3 dhe jo 9.76 m3 siç është situacionuar, pasi gjerësia e murit rrethues është 15 cm dhe nuk janë kryer punime betoni për themelin e murit rrethues..

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 7.42 m^3 beton është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **96,460 lekë pa TVSH** [7.42 m^3 x 13,000 lekë].

Zëri 10. Rrethim i përkohshëm me kollona b/a + rrjetë teli.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 160 m² rrethim. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 160 m² rrethim me çmim 1,200 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 160 m² rrethim , ku trajtohet në mënyrë analitike, si vijon: 72.75 ml gjatësia x 2.2 m lartësia = 160.05 m².
Nga auditimi në fakt u konstatua punë e kryer në volumin 109 m² [72.75 ml gjatësia x 1.5 m lartësia] dhe jo 160 m² rrethim siç është pasqyruar në librezën e masave.
Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 51 m² rrethim është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **61,200 lekë pa TVSH** [51 m² x 1,200 lekë].

Zëri 14. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 60 m² hidroizolim. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 60 m² hidroizolim me çmim 750 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 60.23 m² hidroizolim , ku trajtohet në mënyrë analitike, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Gjatësia	Lartësia	Shuma
1	Hidroizolim mbi soletë Akset 1-3 dhe A-C	m²	1	6.7	6.7	44.89
2	Hidroizolim mbi soletë Akset 1a-3 dhe D-C	m²	1	4.72	3.25	15.34
	Shuma					**60.23**

Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **45,000 lekë pa TVSH** [60 m² x 750 lekë].
Zëri 17. Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 6 ml ulluk vertikal. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 6 ml ulluk vertikal me çmim 1,100 lekë pa TVSH.
Libreza e masave pasqyron volumin 6 ml ulluk shkarkimi vertikal.
Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **6,600 lekë pa TVSH** [6 ml x 1,100 lekë].
Zëri 18. Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 1 cop kasetë shkarkimi. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1 copë me çmim 2,500 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 1 copë kasetë shkarkimi.
Në fakt nga auditimi në fakt, rezultoi se ku zë pune nuk është realizuar fare.
Sa më sipër trajtuar, është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **2,500 lekë pa TVSH** [1 copë x 2,500 lekë].

<u>Auditim në objekt mbi punimet për linjat e shpërndarjes Fshati Poloskë.</u>

Me datë 04.02.2026 u krye sondazh mbi punimet për linjat e shpërndarjes Fshati Poloskë.
Në kryerjen e sondazhit morën pjesë:
-Nga KLSH, përkatësisht nga Z. Gj. P. në cilësinë e përgjegjësit të grupit të auditimit dhe Z. S. M. auditues në cilësinë e anëtarit të grupit të auditimit.
-Nga SHRUK Korçë SHA Z. Th. K., në cilësinë e projektuesit të projektit të zbatimit me objekt "*Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll*", njëkohësisht dhe anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të objektit.
-Mbikëqyrësi i punimeve Z. I K, përfaqësues i shoqërisë mbikëqyrëse "2 C" SHPK.
Auditimi në objekt u krye në linjën e transmetimit fshati Poloskë në piketën ndërmjet seksioni 3-3 në progresivin 0+40 ml dhe seksioni 4-4 në progresivin 0+60 ml në gjatësinë 50 ml nga fillimi i linjës [Fig. nr. 12-9, Akt konstatimi nr. 20, datë 05.02.2026].
Nga auditimi rezultoi se thellësia e gërmimit nga baza e sipërme e kanalit deri në pikën e sipërme të tubit të ujësjellësit PE d=160 mm të jetë 140 cm. Po t'i shtojmë diametrin e tubit D=160 mm si dhe thellësinë e gërmimit poshtë tubit 10 cm, rezulton se thellësia totale e gërmimit të kanalit për linjën e shpërndarjes Fshati Ploskë të jetë **166** cm[140 cm + 16 cm + 10 cm]. [Fig nr. 12-9, Akt konstatimi nr. 20, datë 05.02.2026].
Bazuar nga auditimi në objekt rezultoi se traseja për linjën e sipërcituar është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit dhe dimensionet e seksionit tërthor të kanalit.
Sa më sipër, arrijmë në përfundimin se volumet për zërat gërmim dhe mbushje janë në përputhje me volumet e pasqyruara në librezën e masave [Akt konstatimi nr. 20, datë 05.02.2026] dhe situacionin përfundimtar.
Gjithashtu u konstatua se është realizuar "Shirit sinjalizimi" [Fig. nr. 2,3,7,8,9, Akt konstatimi nr. 20, datë 05.02.2026],
Zëri "FV Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=160 mm, t=118 mm Pn" është realizuar në përputhje me specifikimet teknik [Fig. nr. 9-13, Akt konstatimi nr. 20, datë 05.02.2026].
Nga auditimi në objekt (gropa e hapur) u konstatua se kishte rërë shtufi (rërë kuarcore) mbi dhe nën tubin e ujësjellësit PE d=160 mm [10 cm rërë nën tub dhe 10 cm rërë mbi tub].
-Referuar specifikimeve teknike (Tubacionet) theksohet: "*...Tubacioni duhet të jetë i instaluar nën tokë në një thellësi që varion nga 1.0 m në 1.2 m dhe do të jenë të mbuluar me rërë të butë në një lartësi deri 20 cm (kjo e detyrueshme për shkak dhe të terrenit shkëmbor të zonës)...Të gjitha tubat do të kenë të shënuara në trupin e tyre në mënyrë permanente karakteristikat e kërkuara: materialin e tubit, diametrin, presionin e punës, emrin e prodhuesit*".

Konkluzione:

1. Nga ana e **zbatuesit të punimeve** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- Ligjit nr. 8402*, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8. dhe* ***Udhëzimit Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "**2 C**" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [***- Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, dhe* ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.]*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. A M, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. Projekti i zbatimit administruar në dosjen teknike me objekt: "Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll", është hartuar më vitin 2024 nga Ing. I. P. dhe Th. K. me Liç. K. 26XX.
Projekti i zbatimit me objekt: "*Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll*", është hartuar në vitin 2024 nga Ing. I. P. dhe Th. K. me Liç. K. 26XX. Për objektin "Ndërtimi i rrugës pranë Vala Park Berat", është miratuar leje infrastrukturore me nr. 2524/1, datë 07.08.2024.
- Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e SHRUK Korçë, rezulton se Inxhinieri pjesë e grupit të punës (Ing. I. P.) për hartimin e projekt të zbatimit, ***nuk është pajisur me licencën e projektimit***. Ky veprim, është në kundërshtim me neni **5** të Ligjit Nr. **8402, datë 10.09.1998** "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, sipas të cilit "Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të ***pajisur me licencën përkatëse***. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit". Për sa më sipër, ***ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor të SHRUK Korçë.***

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "**Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë**".		
14.Lidhja e kontratës. nr. 246/87, datë 16.10.2024 OE "E A" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 70,982,706.40 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 19,983,354 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 37,411,416.4 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 13,587,902.40 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 70,982,672.80 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 17.10.2024 Përfundimi punimeve: 15.05.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " Xh M" SHPK	Licenca MK.13XX/9	Kontratë me nr. 587/22, datë 16.10.2024
21. Kolaudatori i punimeve PF "P P" SHPK	Licenca Nr: MK.19XX/1	Kontratë me nr. 487/6 prot., datë 01.07.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. 26/22 prot., datë 15.07.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E A" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "XH M" SHPK si dhe kolaudatori PF "P P" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. 26/23 prot., datë 16.07.2025 në SHRUK Korçë, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "E A" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve " Xh M" SHPK si dhe kolaudatori PF "P P" SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (Ing. S N, Ing. Th. K. dhe Ing. M. K.)	

II. Kontrata për punë publike me objekt: "***Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë***", SHRUK Korçë, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,
u konstatua si vijon:

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **SHRUK Korçë**, në vlerën **440,410 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Ndërtim godine për pusin.

Zëri 10 (2.197). Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama.

Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 16 m². Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 16 m² me çmim 1,200 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 16 m² [4 m x 4 m].

Në fakt nga auditimi në vepër rezultoi se ky zë punë është realizuar sipas zërit 2.196 "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama" me çmim 696 lekë dhe jo me çmim 1,200 lekë siç është situacionuar.

Sa më sipër trajtuar, diferenca në çmim prej 504 lekë (1,200 - 696) është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **8,064 lekë pa TVSH** [16 m² x 504 lekë].

Ndërtim i linjës së jashtme.

Zëri 5 (3.393). Ndërtim puseta betoni h=2.5-3 m, D=1 m + kapak gize.

Preventivi i rishikuar pasqyron 6 puseta. Situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 6 puseta me çmim 70,000 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 6 puseta.

Në fakt nga auditimi në vepër rezultoi se pusetat janë në thellësinë rreth 1.5 m jo 2 m.

Pra, pusetat janë realizuar në volumin 75 % në vlerën 315,000 lekë pa TVSH [70,000 lekë/copë x 6 copë puseta] dhe jo në vlerën 420,000 lekë.

Sa më sipër trajtuar, diferenca **105,000** lekë pa TVSH është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Rehabilitim segmentesh rrugore.

Zëri 4 (3.226/1). Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave 4 cm, me makineri.

Preventivi i rishikuar pasqyron pasqyron volumin 1,190.35 m² asfaltobeton. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1,190.35 m² asfaltobeton me çmim 1,100 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 1,190.35 m² asfaltobeton.

Në fakt nga auditimi në vepër rezultoi se është vendosur në trashësinë 2 cm dhe jo 4 cm siç është pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar. Pra, ky zë pune është për sipërfaqen prej 1,190.35 m² në trashësinë 3 cm në vlerën prej 982,038.75 lekë pa TVSH [75 % x 1,309,385 lekë] dhe jo në trashësinë 4 cm në vlerën prej 1,309,385 lekë pa TVSH.

Sa më sipër trajtuar, diferenca **327,346** lekë pa TVSH është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, për shkak të mos zbatimit KTZ, specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës.

Auditim në objekt mbi punimet për linjat e jashtme të furnizimit për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta.

Me datë 05.02.2026 u krye auditim mbi punimet për linjat e jashtme të furnizimit për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta.

Në kryerjen e sondazhit morën pjesë:

-Nga KLSH, përkatësisht nga Z. Gj. P. në cilësinë e përgjegjësit të grupit të auditimit dhe Z. S. M. auditues në cilësinë e anëtarit të grupit të auditimit.
-Nga SHRUK Korçë SHA Z. Th. K., në cilësinë e projektuesit të projektit të zbatimit me objekt "*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*", njëkohësisht dhe anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të objektit.
-Në mungesë të Mbikëqyrësit të punimeve Znj. Xh D për arsye objektive mori pjesë kolaudatori i punimeve Ing. P P.
Auditimi në objekt u krye në linjën e jashtme të furnizimit nga pusi i ujit në piketën ndërmjet seksioni 7-7 në progresivin 0+140 ml dhe seksioni 8-8 në progresivin 0+160 ml në gjatësinë 150 ml nga fillimi i linjës (pus uji i ri).
Nga auditimi rezultoi se thellësia e gërmimit nga baza e sipërme e kanalit deri në pikën e sipërme të tubit të ujësjellësit PE d=110 mm të jetë 110 cm. Po t'i shtojmë diametrin e tubit D=110 mm si dhe thellësinë e gërmimit poshtë tubit 10 cm, rezulton se thellësia totale e gërmimit të kanalit për linjën e shpërndarjes Fshati Ploskë të jetë **131** cm[110 cm + 11 cm + 10 cm].
Bazuar nga auditimi në objekt rezultoi se traseja për linjën e sipërcituar është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit dhe dimensionet e seksionit tërthor të kanalit.
Sa më sipër, arrijmë në përfundimin se volumet për zërat gërmim dhe mbushje janë në përputhje me volumet e pasqyruara në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar.
Gjithashtu u konstatua se është vendosur "Shirit sinjalizimi" sipas PZ.
Zëri "FV Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=110 mm, t=12.3 mm Pn 20" është realizuar në përputhje me specifikimet teknik të PZ. Trashësia e tubit me d=110 mm u verifikuara në certifikatat e cilësisë administruar në dosjen teknike.
Nga auditimi në objekt (gropa e hapur) u konstatua se kishte rërë guri mbi dhe nën tubin e ujësjellësit PE d=110 mm [10 cm rërë guri nën tub dhe 10 cm rërë guri mbi tub].
-Referuar specifikimeve teknike (Tubacionet) theksohet: "*...Tubacioni duhet të jetë i instaluar nën tokë në një thellësi që varion nga 1.0 m në 1.2 m dhe do të jenë të mbuluar me rërë të butë në një lartësi deri 20 cm (kjo e detyrueshme për shkak dhe të terrenit shkëmbor të zonës)...Të gjitha tubat do të kenë të shënuara në trupin e tyre në mënyrë permanente karakteristikat e kërkuara: materialin e tubit, diametrin, presionin e punës, emrin e prodhuesit*".
1. Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë **"E A" SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8, -* ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.].*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "X & M" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, -* ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.].*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Znj. Xh D, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. Projekti i zbatimit me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", është hartuar më vitin 2024 nga Ing. I. P. dhe Th. K. me Liç. K. 2639 dhe nga Kryetari Bashkisë Korçë Z. S. F. është miratuar e deklaratës për kryerje punimesh me nr. 3687/24, datë 07.05.2024 me fat. të fillimit të punimeve është deri 1 (një) vit nga data e lëshimit të lejes dhe vlefshmëri të lejes 8 (tetë) muaj.

Sa më sipër, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e SHRUK Korçë, rezulton se Inxhinieri pjesë e grupit të punës (Ing. I. P.) për hartimin e projekt të zbatimit, ***nuk është pajisur me licencën e projektimit***. Ky veprim, është në kundërshtim me neni **5** të Ligjit Nr. **8402, datë 10.09.1998** "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, sipas të cilit "Objektet e përkufizuara në nenin 3 ë këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të ***pajisur me licencën përkatëse***. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
Për sa më sipër, ***ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor të SHRUK Korçë.***

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan".		
14.Lidhja e kontratës: nr. 94/30, datë 26.04.2023 OE "N" SHPK	**15.Vlera e kontratës:** Vl e prev ofertues 20,559,687.75 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: ---
17- Situacioni Përfundimtar: Sit. përf në vlerën 20,556,315.10 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 20,556,315.10 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 27.04.2023 Përfundimi punimeve: 12.09.2023	**19. Zgjatja e kontratës:** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve: OE " P D " SHPK	Licenca: MK. 34xx/1	Kontratë me nr. 290/7 prot., datë 26.04.2023
21. Kolaudatori i punimeve: PF "P P" SHPK	Licenca Nr: MK.19xx/1	Kontratë me nr. 734/6 prot., datë 02.11.2023
22.Akt Kolaudimi: -Me akt kolaudimin me nr. 94/52 prot., datë 02.11.2023 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "N" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "P D" SHPK si dhe kolaudatori PF "P P" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me nr. 94/53 prot., datë 07.12.2023 në SHRUK Korçë, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "N" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "P D" SHPK si dhe kolaudatori PF "P P" SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (Ing. I. P., Ing. Th. K., Ing. V. C. , Ing. M. K., Znj. E. F., ekonomiste).	

III. Kontrata për punë publike me objekt: "***Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujërat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan***", SHRUK Korçë, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,
u konstatua si vijon:
Përshkrimi i situatës:
1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **SHRUK Korçë**, në vlerën **127,664 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:
Rrjeti i kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan.
Zëri 8 (2.261) "Shtresë rëre poshtë tubit dhe mbulimi i tubit me rërë (deri 20 cm mbi tub)".

Preventivi i ndryshuar pasqyron volumin 1071.6 m^3 rërë me çmim 1,200 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1071.6 m^3 rërë.
Libreza e masave pasqyron volumin 1071.6 m^3 rërë për vendosjen poshtë tubit dhe mbulimi i tubit me rërë (deri 20 cm mbi tub), tuba të korruguar HDPE SN8 DN (ID) 200 mm, HDPE SN8 DN (ID) 300 mm dhe HDPE SN8 DN (ID) 400 mm.
Në fakt nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt, si dhe i projekt preventivit rezulton se ky zë punimi është përfshirë si nën zë në analizën e zërit: "F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400 mm në gjatësinë prej 292.4 ml.

3.An/2t	F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm		
	Sp + p	op	
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	
	Tub HDPE SN8 d=400mm	ml	
	Rakorderi HDPE SN8 d=400mm	cope	
	Rere per mbrojtjen e tubit	m3	
	Materiale te ndryshme 2 %		

Prandaj sa më sipër zëri "Shtresë rëre poshtë tubit dhe mbulimi i tubit me rërë (deri 20 cm mbi tub)" nuk mund të paguhet dy herë, pra si zë më vete sipas zërit 8(2.261) dhe si nën zë në analizën e çmimit për zërin "FV Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 DN (ID) 400 mm". Pra, realizimi i zërit të rërës në volumin 87.72 m^3 rezulton i dubluar për HDPE SN8 DN (ID) 400 mm ,dhe duhet të zhdëmtohet nga përfituesi (zbatuesi i punimeve).
Likuidimi i volumit 87.72 m^3 [0.3 m^2 x 292.4 ml] rërë, do të konsiderohet si dëm ekonomik dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në shumën **105,264 lekë pa TVSH** [87.72 m^3 x 1,200 lekë].
Zëri 13 (3.158/5a). Transport dheu me auto deri 5.0 km.
Preventivi i rishikuar pasqyron volumin 1,424.10 m^3. Situacioni përfundimtar pasqyron 1,424.10 m3 me çmim 200 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 1,312.1 m3, i pa trajtuar në mënyrë analitike.
Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 112 m^3 [1,424.10 m^3 , sipas situacionit përfundimtar – 1,312.10 m^3, sipas librezës së masave] është pasqyruar jo saktë në librezën e masave dhe, është përfituar tepër në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **22,400 lekë pa TVSH** [112 m^3 x 200 lekë].
Nga ana e **zbatuesit të punimeve** "N" SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8, -* ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.].*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "**P D**" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, -* ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.].*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. S.T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

IV. Kontrata për mallra me objekt: "***Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)")***", SHRUK Korçë, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,
U konstatua si vijon:

<table>
<tr><td colspan="3">13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)".</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës.
nr. 61/24, datë 25.04.2023

OE "M G" SHPK</td><td>15.Vlera e kontratës
Vl e prev ofertues
31,164,000 lekë me TVSH.</td><td>16.Likuiduar:
-----</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
Sit. përf në vlerën 31,164,000 lekë me TVSH.
Furnizimet dhe instalimet kanë përfunduar në vlerën 31,164,000 lekë me TVSH.</td><td>18.Afati i kontratës në dite
Fillimi furnizim instalime: 27.04.2023
Përfundimi punimeve: 03.07.2023</td><td>19. Zgjatja e kontratës
---</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "U S" SHPK</td><td>Licenca MK. 14xx/8</td><td>Kontratë me nr. 240/8 prto., datë 25.04.2023 (SHRUK Korçë) dhe nr. 28 prot., datë 25.04.2023 (U S)</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
PF Ing. P P</td><td>Licenca Nr: MK.19xx/1</td><td>Kontratë me nr. 567/7 prot., datë 18.08.2023</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi.
-Me akt kolaudimin me nr. 61/39 prot., datë 04.09.2023 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "M G" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "U S" SHPK si dhe kolaudatori PF Ing. P P.</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim:
-Me me nr. 61/40 prot., datë 06.09.2023 në SHRUK Korçë, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "M G" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "U S" SHPK si dhe kolaudatori Z. P P, si dhe grupi i marrjes në dorëzim Ing. A. M. , Ing. Th. K., Ing. R Rr, E. F. (Ekonomiste).
-Me me nr. 857 prot., datë 25.10.2024 në SHRUK Korçë, dhe është hartuar certifikatë e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve, firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "M G" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "U S" SHPK si dhe kolaudatori PF Ing. P P, si dhe grupi i marrjes në dorëzim, Ing. Th. K., Ing. R Rr, E. F. (Ekonomiste).</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në objekt i zërave të furnizimit, lidhur me volumet e zërave të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan zëra shërbimi të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **me efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të **SHRUK Korçë**, në vlerën **48,000 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:
Nga shqyrtimi dhe analizimi i preventivit dhe situacionit përfundimtar dhe dokumentacionit pjesë e dosjes teknike të zbatimit, nga grupi i auditimit konstatohet se mungon dokumentacioni argumentues/provues/justifikues mbi realizimin e zërave të mëposhtëm:

- STP Plasë (për fshatin Pojan), për zërin e shërbimit nr. 20 (An) "Testim pusi" në vlerën **24,000** lekë (24 orë x 1,000 lekë).
- STP Bulgarec (për rajonin Lumalas Libonik), për zërin e shërbimit nr. 37 (An) "Testim pusi" në vlerën **24,000** lekë (24 op x 1,000 lekë).

Sa më sipër nga auditimi i zbatimit të zërit "Testim pusi" në vlerën **48,000** lekë pa TVSH, rezultuan shërbime të pakryera / argumentuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **48,000 lekë** pa TVSH.

Sa më sipër zërat "Larje pusi me ajër dhe solucion" dhe "Testim pusi" nga sipërmarrësi i punimeve dhe nga mbikëqyrësi i punimeve, nuk argumentohen me dokumentacionin provues/justifikues me fotografi apo video, siç kërkohet në VKM Nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.3 "**Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi** sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të **padukshme**, **që mund të jenë objekt diskutimi** në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë".
Në dosjen teknike administruar në SHRUK Korçë Sh.A, të vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton të ketë fotografi apo video regjistrues, për të krijuar idenë e realizmit të **zërave të sipërcituar**.
Sa më sipër pasqyrimi në librezën e masave si dhe në situacionin përfundimtar të zërit "Larje pusi me ajër dhe solucion", "Testim pusi" nuk është i saktë sepse realizimi i tij nuk vërtetohet.
Ky zë pune është librezuar në mënyrë të pasaktë duke mos pasqyruar faktin e realizimit në vepër dhe, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **48,000 lekë pa TVSH.**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "**M G**" SHPK Korçë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas: [- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8, -* ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.].*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "**U S**" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, - **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2. dhe kontratën e shërbimit me nr.].*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. L B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.



2. **Stacioni Plasë**



V. Kontrata për punë publike me objekt: "***Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë"***, SHRUK Korçë, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë".		
14.Lidhja e kontratës. nr. 1/17 prot., datë 24.02.2025 OE "M G" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 67,066,560 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: -----
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 67,066,560 lekë me TVSH. Furnizimet dhe instalimet kanë përfunduar në vlerën 67,066,560 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi furnizim instalime: 24.02.2025 Përfundimi punimeve: 24.12.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve -----	Licenca MK. ---	Kontratë me nr. --- prto., datë ---
21. Kolaudatori i punimeve ----	Licenca Nr: MK.---	Kontratë me nr. ----
22.Akt Kolaudimi.-----	**23.Akt i marrjes në dorëzim:**-----	

U konstatua si vijon:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se për disa zëra të preventivit pjesë e kontratës, nuk disponohet nga furnizuesi i kontratës dokumentacion argumentues/provues/justifikues mbi realizimin e tyre, dhe konkretisht:

- Për pusin e pompimit Sovjan për fshatin Sovjan, zëri i preventivit "Larja e pusit me ajër dhe solucion" në vlerën **12,000** lekë pa TVSH (4 x 3,000 lekë).
- Për pusin në Shengjergj, zëri i preventivit "Larja e pusit me ajër dhe solucion" në vlerën **12,000** lekë pa TVSH (4 x 3,000 lekë) si dhe zëri "Testim pusi" në vlerën **12,000** lekë (24 orë x 500 lekë).
- Për pusin Plase për Plasen, zëri i preventivit "Larja e pusit me ajër dhe solucion" në vlerën **12,000** lekë pa TVSH (4 x 3,000 lekë) si dhe zëri "Testim pusi" në vlerën **12,000** lekë (24 orë x 500 lekë).
- Për pusin Kishnik për Podgorien, zëri i preventivit "Larja e pusit me ajër dhe solucion" në vlerën **12,000** lekë pa TVSH (4 x 3,000 lekë) si dhe zëri "Testim pusi" në vlerën **12,000** lekë (24 orë x 500 lekë).

Sa më sipër, rezultuan zëra shërbimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Larja e pusit me ajër dhe solucion dhe Testim pusi", duke shkaktuar efekt financiar negativ (i pritshëm) në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **84,000 lekë** pa TVSH.

Nga ana e zbatuesit të kontratës së shërbimit "**M G**" SHPK nuk janë zbatuar specifikimet teknik sipas *nenit 5 të Kontratës së Furnizimit Nr. 1/17 Prot., date 24.02.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" (UKRK Sh.A) dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M G" SHPK.* Sa më sipër edhe pse njësia përgjegjëse për ndjekjen e kontratës së shërbimit nuk ka detyrimet e mbikëqyrësit, sjellim në vëmendje të personave: V. L. , V. M. , M. G. .

<u>Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:</u>

*Nga auditimi i **5 (pesë)** kontratave për periudhën e auditimit në vlerën totale* 270,216,797.35 lekë me TVSH, përkatësisht 3 (tre) kontrata për punë publike në vlerën 171,986,237.35 lekë me TVSH dhe 2 (dy) kontrata "Mallra dhe shërbime" në vlerën 98,230,560 lekë me TVSH*, u konstatuan problematikat si vijon:*

►*Në **3 (tre)** raste, <u>rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike,</u> në vlerën **905,184 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:***

***- Vlera 337,1100 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll" me nr. 247/33, datë 09.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit" Korçë dhe, sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive "N" SHPK.*

***- Vlera 440,410 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë" me nr. 246/87, datë 16.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" (UKRK Sh.A) dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "E A" SHPK Tiranë.*

***- Vlera 127,664 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: ""Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan" me nr. 94/30., datë 26.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" (UKRK Sh.A) dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "N" SHPK Shkodër.*

►*Në **2 (dy)** raste, <u>rezultuan zëra shërbimi të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike,</u> në vlerën **132,000 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të shërbimit + mallra, **respektivisht:***

***- Vlera 48,000 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për zëra shërbimi të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën "Mallra + shërbime" me objekt: : "Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe*

Bulgarec (Nj.A Libonik)" me nr. 61/24, datë 25.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" (UKRK Sh.A) dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M G" SHPK Korçë.
***- Vlera 84,000 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për zëra shërbimi të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën "Mallra + shërbime" me objekt: : "Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë" me nr. 1/17 prot., datë 24.02.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" (UKRK Sh.A) dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M G" SHPK, Korçë.*

*►Në **3 (tre)** raste, <u>rezultoi se projektet e zbatimit janë kryer nga inxhinierë pa licencën e projektimit, përkatësisht:</u>*

- "Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll",
- "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë",
- "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan",
*Rezultoi se, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimit në zyrat e SHRUK Korçë, disa prej inxhinierëve të SHRUK Korçë pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, **nuk janë pajisur me licencën e projektimit**. Miratimi i projektit të zbatimit nga Titullari i SHRUK Korçë hartuar nga inxhinier pa licencën e projektimit, është në kundërshtim me neni **5** të Ligjit Nr. **8402, datë 10.09.1998** "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", sipas të cilit "Objektet e përkufizuara në **nenin 3** të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të **pajisur me licencën përkatëse**. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në **kreun II** të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit.*

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.7 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së auditit të brendshëm.

Gjatë auditimit të sistemi të kontrollit të brendshëm financiar publik është analizuar tërësia e kontrolleve të vendosura nga njësia publike, me qëllim administrimin e suksesshëm për të garantuar se menaxhimi financiar e kontrolli dhe arritja e objektivave të saj janë në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën e kontrollit të brendshëm, kërkesat buxhetore, si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar me transparencë, efektivitet, eficencë dhe ekonomi, duke përfshirë edhe kontrollin, auditimin e brendshëm dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar e kontrollin.

Referuar kreut III, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, të ndryshuar, titullari i institucionit është përgjegjës për zbatimin e menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve:
Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi.

Komponenti "Mjedisi i kontrollit":
Referuar Vendimit Nr. 2, datë 11.04.2023, "Miratimin e strukturës të re të organizimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në këtë shoqëri është 278 punonjës.

Në zbatim të kërkesave të nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar rezultoi se:
Për periudhën e auditimit Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë ka funksionuar bazuar në Statutin e shoqërisë të miratuar nga Asambleja e Aksionarëve me vendimin nr. 1 prot., datë 28.06.2022.
Rregullorja e Brendshme e Shoqërisë, është miratuar me urdhrin e brendshëm nr. 49 me nr. 530 prot., datë 26.02.2025.
SHRUK Korçë për periudhën e auditimit ka funksionuar pa Rregullore të Brendshme veprim në mospërputhje me nenin 20 pika 2 germa (c) të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.
Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në lidhje me Rregulloren e Brendshme të miratuar me urdhrin e brendshëm nr. 49 datë 26.02.2025, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.
Rregullorja e Brendshme, ka përfshirë parimet kryesore për zbatim nga stafi i punonjësve të shoqërisë gjatë veprimtarisë në këtë shoqëri.
Kodi i Etikës është miratuar me urdhrin e brendshëm nr. 95, datë 15.12.2023. Për periudhën 01.01.2023 deri në 15.12.2023 rezulton se SHRUK Korçë ka funksionuar pa Kod Etik veprim në mospërputhje me nenin 20 pika 2 germa (a) të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
Në rregulloren e brendshme dhe kodin e etikës janë përcaktuar pengesat ligjore për punonjësit e shoqërisë, parimi i ligjshmërisë, i ndalimit të konfliktit të interesave, mbrojtjes së interesit publik, transparencës, i ndershmërisë dhe parimi i bashkëpunimit.
Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
SHRUK Korçë nuk kryen trajnime të dedikuara për integritetin dhe sjelljen etike.

Politikat Menaxheriale.
Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin administratori i shoqërisë ka për detyrë ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike.
Grupi për Menaxhimin Strategjik është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike.

Për vitin 2023 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Mos ngritja e GMS ka sjellë që SHRUK Korçë të funksionojë jo në përputhje me nuk Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

Për vitin 2024 Administratori i SHRUK Korçë ka ngritur GMS me Urdhrin nr . 100, datë 28.12.2023. GMS është ngritur sipas Udhëzim nr. 16 date 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyra lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike i përbërë nga 5 anëtarë.
Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 3 mbledhje të GMS, në të gjitha mbledhjet janë mbajtur minuta takimi dhe listë prezencë, çështjet kryesore që janë diskutuar janë: Strategjia e Menaxhimit të riskut, Analiza e Riskut nga Sulmet Kibernetikë, Shqyrtimi dhe analiza e planeve të veprimeve.
Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) 2024 nuk është mbledhur minimalisht 4 herë në vit dhe nuk ka zhvilluar takim për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

Për vitin 2025 Administratori i SHRUK Korçë ka ngritur GMS me Urdhrin nr . 41, datë 12.02.2023. GMS është ngritur sipas Udhëzim nr. 16 date 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyra lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike i përbërë nga 5 anëtarë.
Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 3 mbledhje të GMS, në të gjitha mbledhjet janë mbajtur minuta takimi dhe listë prezencë, çështjet kryesore që janë diskutuar janë: Prezantimi i detyrave të Grupit të Menaxhimit Strategjik, Shqyrtimi i çështjeve me rëndësi për eficencën operacionale dhe organizative të shoqërisë, Analiza e projekt buxhetit.
Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) 2025 nuk është mbledhur minimalisht 4 herë në vit, veprim në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 31.12.2024, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

Komponenti "Menaxhimi i Riskut":
Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.
Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar rezultoi se:

Për vitin 2023 dhe 2024 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin për Menaxhimin e Risqeve veprim në mospërputhje me 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3, nën pikat 1-3.

Koordinatori i Riskut për SHRUK Korçë është N/A znj. F. F., bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe urdhrit nr. 4 datë 04.01.2023

të Administratorit të SHRUK Korçë që ka caktuar Nëpunësin Autorizues (NA) znj. F. F.me detyrë Drejtori Tregtar në SHRUK Korçë SHA.

Për vitin 2024 Administratori SHRUK Korçë me urdhrin nr. 98 datë 15.12.2023 ka urdhëruar Hartimin e Strategjinë të Riskut dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut. Me urdhrin nr. 15 datë 28.02.2024 është miratuar Strategjia e Riskut dhe janë ngarkuar për ndjekjen dhe monitorimin e Strategjisë Drejtorët e Drejtorive, Përgjegjësit e Sektorëve dhe të gjithë punonjësit e SHRUK Korçë.

Për vitin 2025, Administratori i shoqërisë me urdhrin nr. 45, datë 21.02.2025 ka ngritur grupin për menaxhimin dhe koordinimin e riskut GRM të përbërë nga 5 anëtarë të SHRUK Korçë. Koordinatori i Riskut është caktuar N/A znj. F. F. me detyrë Drejtor, Departamenti Tregtar dhe anëtarë përfaqësues të sektorëve të SHRUK Korçë SHA
Administratori me urdhrin nr. 46 datë 24.02.2025 ka miratuar Rregulloren për funksionimin e grupit të menaxhimit të riskut në SHRUK Korçë.
SHRUK Korçë ka hartuar Planin e Veprimit për Menaxhimin e Riskut 2025 për menaxhimin e riskut. Ky regjistër është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për vitin 2025, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej tyre.
Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit. Për vitin 2025 janë zhvilluar vetëm 2 takime, konkretisht takim informues për GRM me shkresë nr. 191/1 prot., datë 25.02.2025 dhe takim për rishikimin e risqeve dhe hartimin e draftit të ri të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut me nr. 442 prot., datë 30.05.2025 të cilat janë të dokumentuara me minuta takimi. Për sa më sipër këto janë në mospërputhje me udhëzimin nr. 16, datë 31.12.2024 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Gjithashtu në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Komponenti: "Veprimtaritë e Kontrollit":
Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.
Në zbatim të kërkesave të nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar rezultoi se:
Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë e cila merr vendimet për përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë mbikëqyrës i shoqërisë dhe ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e veprimtarisë të administratorit sipas politikave të SHRUK Korçë. Ky organ siguron që shoqëria të veprojë në përputhje me objektivat e përcaktuara, si dhe me legjislacionin dhe aktet ligjore të aplikueshme. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme me një mandat 3 vjeçar në përfundim të së cilit kanë të drejtën e riemërimit. Administratori është organi i ekzekutivit dhe përgjegjës për drejtimin e përditshëm të shoqërisë, si dhe për realizimin e politikave dhe strategjive të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës. Ai është përgjegjës për menaxhimin operativ dhe administrativ të SHRUK Korçë.

Administratori i shoqërisë nuk ka miratuar veprimtaritë e kontrollit, që përfshin procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për delegimin e detyrave. Gjithashtu për çdo pozicion pune janë vendosur dhe përgjegjësitë duke ndarë detyrat dhe mos lejuar që i njëjti punonjës të jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin apo kontrollin.
Administratori i SHRUK Korçë me urdhrin nr.9 datë 17.01.2024 ka miratuar sistemin me dy nënshkrime në angazhimet Financiare të shoqërisë SHRUK Korçë SHA
Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.
Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.
Administratori i SHRUK Korçe me urdhrin nr. 1 datë 04.01.2023 ka caktuar Nëpunësin Zbatues (NZ) znj. E F me detyrë Menaxher i Drejtorisë Ekonomike në SHRUK Korçë SHA
Administratori i SHRUK Korçë me urdhrin nr. 4 datë 04.01.2023 ka caktuar Nëpunësin Autorizues (NA) znj. F. F.me detyrë Drejtori Tregtar në SHRUK Korçë SHA
Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues znj. F. F.me detyrë Drejtori Tregtar në SHRUK Korçë SHA dhe nëpunësi zbatues znj. F. F.me detyrë Drejtori Tregtar në SHRUK Korçë SHA
Mungojnë kontrollet pas faktit për të parë situatën e riskut që është konstatuar nga drejtuesit e njësive publike.

Komponenti: "Informimi dhe komunikimi":
Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar rezultoi se:

Në lidhje me informimin dhe komunikimin rezulton se një pjesë e punonjësve të shoqërisë përdorin email zyrtar për komunikime. Mos përdorimi i të gjithë stafit të shoqërisë të email zyrtarë dhe kanaleve të sigurta të komunikimit është një risk për të dhënat dhe informacionet që punonjësit shkëmbejnë.
Shoqëria nuk ka një faqe interneti për të shpërndarë informacionin dhe të bëjë transparencën me palët e interesuara.
Nuk ka një sistem për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

Raportimet janë në formë shkresore dhe tregojnë ecurinë mujore teknike dhe financiare që miratohet nga Administratori dhe shqyrtohet në Këshillin Mbikëqyrës. SHRUK Korçë SHA ka miratuar nga drejtoret raportet që do të hartohen nga punonjësit dhe sektorët.
Përgjegjësitë dhe raportimet janë të detajuara në përshkrimet e punës për secilin punonjës.
SHRUK Korçë ka një program të posaçëm kontabiliteti Financa 5 që bën regjistrimin te gjitha veprimet financiare, inventari i aseteve etj., duke monitoruar në kohe reale shpenzimet financiare, bazuar në parimet dhe rregullat e kontabilitetit. Shoqëria gjithashtu përdor edhe programin qeveritar SIFQ, për fondet e çelura nga buxheti i shtetit.

Komponenti: "Monitorimi":
Në zbatim të kërkesave të nenit 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar rezultoi se:

Administratori i SHRUK Korçë SHA ka nxjerrë urdhrin nr. 4 datë 26.01.2024 për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit MFK.
Me shkresë nr. 176/1 prot., datë 29.02.2024, SHRUK Korçë ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 "Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit".
Me shkresë nr. 195/1 prot., datë 28.02.2024, SHRUK Korçë ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK për vitin 2024 si dhe planin e veprimit për MFK për vitin 2025 në përputhje me Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 "Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit".
Administratori i SHRUK Korçë ka nxjerrë urdhrin nr.2 datë 03.01.2024 për ngritjen e komisionit të ekspertizës.
Administratori i SHRUK Korçë ka nxjerrë urdhrin nr. 48 datë 24.02.2025 për caktimin e personit përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve referuar angazhimeve të realizuara nga auditi i brendshëm i shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA
Administratori i SHRUK Korçë ka nxjerrë urdhrin nr. 47 datë 24.02.2025 për ngritjen e Ekipit Përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike.
Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit nga audititi i brendshëm behet nëpërmjet auditimeve që NjAB kryen dhe pasqyrohet në raportet e auditimit.

Auditi i Brendshëm
Auditi i Brendshëm për subjektin SHRUK Korçë SHA është në varësi të Këshillit Mbikëqyrës dhe është i përbërë nga 1 auditues. Organizimi i auditit të brendshëm është përcaktuar në organigramën e shoqërisë e miratuar me shkresën nr. 265/3 prot., datë 11.04.2023 me vendimin nr. 2 datë 11.04.2023 të Këshillit Mbikëqyrës.
Njësia e auditimit të brendshëm për periudhën e auditimit 01.01.2023- 31.12.2024 ka qenë e përbërë nga një punonjës konkretisht:

Znj. J.L Adituese e Auditit të Brendshëm
Organizimi i auditit të brendshëm vetëm me një punonjës është në mospërputhje me nenin 3 të VKM nr. 83,datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*".
Adituesja znj.L është e pajisur me certifikatën e "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik"
Auditi i Brendshëm ka bërë programet strategjike për periudhën e auditimit dhe Kartën e Auditimit të cilat janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
Për vitin 2023
Me shkresën nr. 408/7, datë 07.12.2022 Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 11 ka miratuar Kartën e Auditimit për shoqërinë SHRUK Korçë SHA
Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 10 datë 07.12.2022 ka miratuar planin vjetor për vitin 2023 dhe planin strategjik të auditimit për periudhën 2023-2025.
Për vitin 2023 Auditi i Brendshëm ka planifikuar të kryej 6 lloje auditimesh:
- Të kombinuara 1
- Të përputhshmërisë 2
- Të performancës 1
- Financiare 2

Në plan nuk janë përcaktuar subjektet (sektorët ose drejtoritë) që do të auditohen por vetëm lloji i auditimit.
Për vitin 2023 janë realizuar të 6 auditimet e planifikuara.
Auditimet e realizuara gjatë vitit 2023, janë si më poshtë:
1.Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga Auditi i Brendshëm, duke iu referuar angazhimit dhe rekomandimeve të lëna gjatë Auditimit të Prokurimeve Publike në Shoqëri gjatë vitit 2022.
2.Auditimi i implementimit dhe zbatimit të MFK në Shoqëri: "Auditimi i mjedisit, aktiviteteve, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të implementuara në SH.A UKRK".
3.Auditimi i të Ardhurave dhe Shpenzimeve Faktike ndaj atyre të Planifikuara, mbulimi i Kostove Operacionale për 6-mujorin I 2023.
4.Auditimi i Prokurimeve Publike të realizuara në UKRK SH.A gjatë vitit 2022-2023.
5.Auditimi i Procedurave, Dokumentacionit, Regjistrimeve, Drejtoria Tregtare – Shitje/Shërbim Klienti në SH.A UKRK.
6.Auditimi i sistemit të regjistrimit, përpunimit dhe ndjekjes së debitorëve, 6-mujori i 2023 në SH.A UKRK.
Nga realizimi i planit të auditimeve për vitin 2023 janë lënë 34 rekomandime nga të cilat 13 për përmirësimin e sistemeve, 16 rekomandime me karakter organizativ, 1 rekomandim për arkëtim si masë zhdëmtimi dhe 4 rekomandime të kategorisë "të tjera". Rekomandimet e lëna janë pranuar nga titullari i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë dhe u janë adresuar personave përgjegjës të marrin masat për zbatimin e rekomandimeve përkatëse.
Për vitin 2024
Me shkresën nr. 672/6, datë 27.09.2023 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar me vendim Nr. 8 datë 27.09.2023, planin vjetor për vitin 2024 dhe planin strategjik të auditimit për periudhën 2024-2026.
Për vitin 2024 Auditi i Brendshëm ka planifikuar të kryej 5 lloje auditimesh:
- Të kombinuara 1
- Të përputhshmërisë 2
- TIK informacioni 1

- Financiare 1

Në plan nuk janë përcaktuar subjektet (sektorët ose drejtoritë) që do të auditohen por vetëm lloji i auditimit.
Për vitin 2024 janë realizuar të 5 auditimet e planifikuara.
Auditimet e realizuara gjatë vitit 2024, janë si më poshtë:
1. Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm gjatë vitit 2023.
2. Mbi ndjekjen e procesit të Prioritizimit të Likuidimit të Pagesave të realizuara në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë.
3. Mbi auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë.
4. Auditimi i Prokurimeve me Vlera të Vogla të realizuara në UKRK SH.A gjatë vitit 2023.
5. Auditimi i procedurave, dokumentacionit, regjistrimeve, Drejtoria Tregtare – Shitje/Shërbim Klienti (ZMK) në SH.A UKRK.
Nga realizimi i planit të auditimeve për vitin 2024 janë lënë 19 rekomandime nga të cilat 11 për përmirësimin e sistemeve, 6 rekomandime me karakter organizativ dhe 2 rekomandime të kategorisë "të tjera". Rekomandimet e lëna janë pranuar nga titullari i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë dhe u janë adresuar personave përgjegjës të marrin masat për zbatimin e rekomandimeve përkatëse.
<u>Për vitin 2025</u>
Me shkresën nr. 962/5, datë 12.12.2024 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar me vendim Nr. 16 datë 12.12.2024, planin vjetor për vitin 2025 dhe planin strategjik të auditimit për periudhën 2025-2027.
Për vitin 2025 Auditi i Brendshëm ka planifikuar të kryej 5 lloje auditimesh:
- Të kombinuara 1
- Të përputhshmërisë 2
- Të performancës 1
- Financiare 1

Në plan nuk janë përcaktuar subjektet (sektorët ose drejtoritë) që do të auditohen por vetëm lloji i auditimit.
Për vitin 2025 është realizuar 1 auditim i planifikuara.
Auditimet e realizuara dhe në proces gjatë vitit 2025, janë si më poshtë:
1. Mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm (Auditim i kombinuar).
2. Auditimi në Drejtorinë e Shitjeve dhe Marrëdhënieve me Klientin (Auditim Përputhshmërie) në proces.
3. Auditimi pranë Drejtorisë Ekonomike (Auditim Financiar) në proces.

Auditimet e planifikuar për vitin 2025 që nuk janë realizuar:
1. Auditimi pranë Drejtorisë Tregtare (Auditim Performance).
2. Auditimi pranë Drejtorisë Tregtare (Auditim Përputhshmërie).

Gjatë kësaj periudhe janë lënë 11 rekomandime, nga të cilat 1 i nivelit të lartë dhe 10 të nivelit të mesëm. Kategorizimi i rekomandimeve sipas natyrës së tyre:
7 rekomandime për përmirësimin e sistemeve, 3 rekomandime me karakter organizativ dhe 1 rekomandim të kategorisë "të tjera".

***Si konkluzion*:** SHRUK Korçë për periudhën 01.01.2023 deri në datën 26.02.2025 ka funksionuar pa Rregullore të Brendshme veprim në mospërputhje me nenin 20 pika 2 germa (c) të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.
Për periudhën 01.01.2023 deri në 15.12.2023 rezulton se SHRUK Korçë ka funksionuar pa Kod Etik veprim në mospërputhje me nenin 20 pika 2 germa (a) të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i Shoqërisë.
Për vitin 2023 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Mos ngritja e GMS ka sjellë që SHRUK Korçë të funksionojë jo në përputhje me nuk Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.
Për vitit 2024 dhe 2025 janë zhvilluar 3 mbledhje të GMS, në të gjitha mbledhjet janë mbajtur minuta takimi dhe listë prezencë, çështjet kryesore që janë diskutuar janë: Strategjia e Menaxhimit të riskut, Analiza e Riskut nga Sulmet Kibernetikë, Shqyrtimi dhe analiza e planeve të veprimeve. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) nuk është mbledhur minimalisht 4 herë në vit dhe nuk ka zhvilluar takim për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

Për vitin 2023 dhe 2024 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin për Menaxhimin e Risqeve (GMR) veprim në mospërputhje me 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3, nën pikat 1-3.
Për vitin 2025 grupi për menaxhimin dhe koordinimin e riskut GRM, nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit. Për vitin 2025 janë zhvilluar vetëm 2 takime, konkretisht takim informues për GRM me shkresë nr. 191/1 prot., datë 25.02.2025 dhe takim për rishikimin e risqeve dhe hartimin e draftit të ri të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut me nr. 442 prot., datë 30.05.2025 të cilat janë të dokumentuara me minuta takimi. Këto janë në mospërputhje me udhëzimin nr. 16, datë 31.12.2024 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Gjithashtu në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
Grupi i auditimit ka konstatuar se Këshilli Mbikëqyrës i SHRUK Korçë SHA, nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, veprim në mospërputhje me nenin 13 të ligjin Nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar.
Për vitin 2023 dhe 2025 planet vjetore dhe strategjike nuk janë miratuar dhe dërguar në kohë në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm, veprime në mospërputhje me Kapitullin 3 pika 3.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Organizimi i auditit të brendshëm vetëm me një punonjës është në mospërputhje me nenin 3 të VKM nr. 83,datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*". Mos funksionimi i NjAB me numrin minimal të punonjësve sipas vendimit ka sjellë që nga auditimi i 5 dosjeve të auditimit që ka realizuar Auditi i Brendshëm u konstatua se autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit të auditimit është përpiluar nga administratori i shoqërisë kur kjo është një detyrë e drejtuesit të NjAB. Veprim ky në mospërputhje me pikën 4.1.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.8 Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit Nr.1007/1 prot., datë 17.10.2025 i ndryshuar, "Auditimi i Përputhshmërie", në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë: lidhur me "*Mbi zbatimin e standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe atë të ndotur*".

a) Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë për zbatimin e standardeve të ujit të pijshëm mbështetet në Vendimin Nr.379, datë 25.05.2016 *Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm",* e cila është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik" dhe të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave.

Zbatimi i standardeve të ujit të pijshëm për veprat e reja:

Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi SHRUK Korçë ka marrë në dorëzim 2 vepra të reja, ka në proces kolaudimi 7 të tjera dhe 1 vepër është në fazë zbatimi, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Fshatrat	Bashkia	Faza e veprës	Aktmiratimi nga ISHSH
1	Kuç i Zi - Belorta	Korçë	marrë në dorëzim	Nuk ka
2	Kuç - Poloskë	Devoll	marrë në dorëzim	Nuk ka
3	Sheqeras	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
4	Plasë	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
5	Libonik	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
6	Drithas	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
7	Symizë	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
8	Pirg	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
9	Kolanec	Maliq	fazë kolaudimi	Nuk ka
10	Zvezdë	Maliq	në proces	Nuk ka

SHRUK Korçë përpara fillimit të investimit të veprave të reja, në mënyrë që të shmangë rrezikun e investimit të gabuar duhet të njoftojë ISHSH-në për të kryer analizat e ujit të pijshëm që do të përfitohet nga këto vepra, dhe pas daljes së rezultateve pozitive të jepet akt-miratimi higjeno-sanitare nga ISHSH. Nga auditimi i dokumenteve rezulton se SHRUK Korçë nuk ka kryer analiza pranë ISHSH-së për investimet e veprave të reja e cila është në kundërshtim *"Rregulloren e cilësisë*

së ujit të pijshëm" me nenin nr.16 *"Kontrolle shëndetësore paraprake të instalimeve të reja" "...administratori njofton ISHSH-në, e cila kryen procedurën për lëshimin e akt-miratimit higjieno-sanitar, projekti i ndërtimit duhet të fillojnë vetëm pas dhënies së akt-miratimit higjieno-sanitar. Kur instalimi i ri fillon funksionimin, struktura rajonale e shëndetit publik përgatit një raport bazuar në kontrollin".*
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë dhe znj.M. K. me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik.

Për ujësjellësit e fshatrave Kuç i Zi - Belorta në bashkinë Korçë dhe Kuç - Poloskë në bashkinë Devoll të marra në dorëzim, SHRUK Korçë ka kryer procesin e dezinfektimit përpara vënies në funksionim të veprës sipas dokumenteve dhe procesverbaleve të paraqitura nga zyra teknike të bazuara në nenin nr.13 të rregullores.
Procesi i dezinfektimit të ujit të pijshëm:
Ujësjellësit e qyteteve Korçë dhe Bilisht të cilat janë investime të reja procesi i dezinfektimit të ujit të pijshëm injektohet në mënyrë të automatizuar me Hipoklorit Natriumi. Në ujësjellësit ekzistues dezinfektimi bëhet me hipoklorit natriumi me mënyrën fizike në rezervuarët e ujit. Konstatohet se Hipokloriti i Natriumi pasi bëhet dalje nga magazina dhe dërgohet nëpër vendet ku injektohet ose përdoret mënyra fizike, nuk ka një regjistër ku të dokumentohet sasia e përdorur për dezinfektim, orari i injektimit, punonjësi që ka kryer procesin dhe shënime të tjera mbi problematikat e ndryshme të shfaqura gjatë turnit në këto vende. Në qytetet Korçë dhe Bilisht kampionet merren çdo ditë në pikat e caktuara nga struktura rajonale e shëndetit publik që në vitet kur këto ujësjellësa kanë filluar funksionalitetin e tyre. Në ujësjellësit e tjerë të fshatrave kampionet merren 1 herë në jave, ndërsa për ujësjellësit e fshatrave ruralë kampionet merren në mënyrë të çrregullt në disa raste 1 herë në muaj, duke u bazuar në dokumente e vëna në dispozicion. Analizat mbi kampionet e marra bëhen në laboratorët e brendshëm të shoqërisë dhe rezultatet nxjerra hidhen në një regjistër, për periudhën e auditimit konstatohet se rezultatet e analizave kanë dalë gjithmonë brenda parametrave të përcaktuara në rregullore.
Konstatohet se laboratorët e brendshëm të shoqërisë janë të pa akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe rezultatet e nxjerra mbi analizat e kryera nga këta laboratorë mund të jenë të pasakta. Gjithashtu, konstatohet se shoqëria e re SHRUK Korçë nuk ka mbajtur një komunikim të rregullt me strukturën rajonale të shëndetit publik Korçë , nuk kanë një aktmarveshje midis tyre. Në kundërshtim më nenet nr.15*"Dezinfektimi i ujit të pijshëm*" dhe 20 *"Monitorimi i brendshëm"* të Rregullores së cilësisë të ujit të pijshëm.
Mirëmbajtja
SHRUK Korçë sipas dokumenteve të paraqitura rezulton se për periudhën e auditimit ka kryer procesin e mirëmbajtjes së ujit të pijshëm në rezervuarët dhe tubacionet e zonave me konsum më të lartë sipas rregullores, ndërsa për ujësjellësit ruralë rezulton se në periudhën e auditimit subjekti nuk ka kryer procesin pastrimit dhe larjes për rezervuarët dhe tubacionet.
Nga auditimi i faqes së defekteve u analizuan 7 procedura defekti që kanë përshkrimin në faqe *"Defekt në linjë"* për të parë se si është zbatuar rregullorja mbi procedurën e ndjekur për riparimin e defektit.

Nr.	Lloji i defektit	Data e konstatimit te defektit	Data e riparimit	Adresa	Dezinfektimi
1	Defekt në linjën kryesore të depos së ujit, bashfi 75 x 75	27.06.2023	27.06.2023	Pilur	Jo

2	Defekt në linjën kryesore kavallotë fi 90 x 1/2	21.02.2024	21.02.2024	Trestenik	Jo
3	Bllokim linje redutor fi 75 x 63	01.08.2024	01.08.2024	Tren	Jo
4	Tubi i linjës kryesore të depos fi 90, 7ml	31.01.2025	31.01.2025	Gracë	Jo
5	Bashkusa fi 75 x 75, 2 copë	22.04.2025	22..04.2025	Arzë	Jo
6	Defekt në linjën e transmetimit fi 200	17.06.2025	17.06.2025	Luadhet e Gjancit	Jo
7	U vendos kavallotë fi 63 x 1/2	27.08.2025	27.08.2025	Bracanj - Kurilë	Jo

Konstatohet se pas riparimit të defekteve në tubacionet e furnizimit me ujë të pijshëm nuk është kryer procesi i dezinfektimit e cila është në kundërshtim me *"Rregulloren e cilësisë së ujit të pijshëm"* Shtojca nr. X "Mirëmbajtja e veprave të ujit të pijshëm".

Një ndër elementët e rëndësishëm të zbatimit të standardeve të ujit të pijshëm janë dhe punonjësit që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me sistemet e ujit të pijshëm (rezervuarët, depot, puset etj.). Këta punonjës krahas rregullave të përcaktuara që duhet të zbatojnë, duhet të jenë të pajisur edhe me dëshmi të gjendjes shëndetësore të tyre. Për periudhën e auditimit konstatohet se jo të gjithë punonjësit që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm janë të pajisur me dëshmitë të gjendjes shëndetësore të tyre, ose këto dëshmi kanë përfunduar afatin e vlefshmërisë për disa punonjës, në kundërshtim *"Rregulloren e cilësisë së ujit të pijshëm"* me nenin nr.17 "*...personeli që punon në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm duhet të jetë i pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore*".

Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e ndotur.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë për zbatimin e standardeve të ujit të ndotur mbështetet në Vendimin Nr.177, datë 31.03.2005 "*Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse",* e cila është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, pika 2, e 16 të ligjit nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave.

Ujërat e ndotura të krijuara në territorin ku ushtron aktivitetin Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë përcaktohen në Kreun nr. IV *"kriteret për zonimin e mjediseve ujore pritëse"*, pika nr.6 "*Shkarkimet e lëngëta urbane aglomerat, me ngarkesë hyrëse në sistemin kolektor nga 10 000 pe-150 000 pe, përpara shkarkimit në ujërat bregdetare, dhe aglomeratet me ngarkesë nga 2 000 pe10 000 pe, përpara shkarkimit në estuare, të cilat u takojnë zonave të pandjeshme, mund të jenë subjekt i një trajtimi më pak rigoroz, vetëm nëse sigurohet se: a) shkarkime të tilla i janë nënshtruar, paraprakisht, trajtimit parësor; b) studime të plota vërtetojnë se shkarkime të tilla nuk ndikojnë negativisht në mjedis"* të VKM-së nr.177 datë 31.03.2005.
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë impiant për trajtimin e ujërave të ndotura ITUN ka vetëm në qytetin e Korçës. Qytetet e tjera që janë pjesë e kësaj shoqërie si Maliqi, Erseka, Bilishti, Pusteci dhe fshatrat e tyre nuk kanë impiante për trajtimin e ujërave të ndotura.
Ujërave të ndotura përpara se të futen në impiantin e trajtimit të tyre u largohen mbetjet ngurta nëpërmjet sistemit të impiantit ITUN. Më pas këto mbetje të grumbulluara largohen nëpërmjet shoqërisë së kontraktuar "K" SHPK, e cila për periudhën janar - shtator 2025 ka larguar 5 kosha

për çdo muaj në total 45 kosha me mbetje të ngurta me çmim 19,200 lekë me TVSH për kosh, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	**Nr. Fat.**	**Nr.i koshave të larguar**	**Cmimi për kosh**	**Vlera totale**
Janar	54/2025	5	19,200	96,000
Shkurt	104/2025	5	19,200	96,000
Mars	151/2025	5	19,200	96,000
Prill	203/2025	5	19,200	96,000
Maj	250/2025	5	19,200	96,000
Qershor	305/2025	5	19,200	96,000
Korrik	360/2025	5	19,200	96,000
Gusht	409/2025	5	19,200	96,000
Shtator	461/2025	5	19,200	96,000
Totali				**864,000**


Monitorimi i ujërave të ndotura në impiantin ITUN të qytetit të Korçës bazohet në Shtojcën nr.4 *"Kërkesa për ujërat e ndotura urbane"* shkronja b *"Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave në mjediset pritëse"*. Sipas numrit të popullatës dhe llojit të ujërave të ndotura të formuara në qytetin e Korçës, SHRUK Korçë është e detyruar të analizojë 24 mostra në një vit. Nga auditimi rezulton se procedura e monitorimit është realizuar sipas rregullores.
Dokumentet e analizave të audituara për muajt qershor 2023, qershor 2024, tetor 2024, shkurt 2025, gusht 2025 rezultojnë brenda parametrave të përcaktuara në këtë shtojcë, por konstatohet se laboratori i brendshëm i ITUN Korçë është i pa akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
Përgjatë një periudhe të caktuar të ushtrimit të aktivitetit impianti i ujërave të ndotura ITUN Korçë prodhon një sasi llumi në fundin e vaskave. Llumi i prodhuar nga ky impiant mund të përdoret për bujqësi nëse është brenda parametrave ose mund të jetë llum i dëmshëm dhe duhet të shkatërrohet në landfill. Për të përcaktuar cilësisë e llumit ITUN Korçë duhet të kryeje disa analiza, por këto analiza nuk mund të kryhen në laboratorin e brendshëm të ITUN. Në vitin 2024 ITUN Korçë ka kontraktuar laboratorin "U L D" për përcaktimin e parametrave të llumit dhe rezulton se ky llum është i përdorshëm për sektorin e bujqësisë. Konstatohet se nuk ka një regjistër ku të pasqyrohet sasia totale e llumit të prodhuar nga impianti, dhe sipas subjektit e gjithë sasia e prodhuar është dhuruar në bujqësi.
SHRUK Korçë nuk ka gjurmë mbi dhurimin, akt-marrëveshje ose ndonjë dokument tjetër me operatorët që kanë marrë dhe e përdorur këtë lloj lënde në bujqësi.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Administratori i SHRUK z. P. T., Drejtori i Zyrës Teknike znj. M. K., Përgjegjës Sektori i Monitorimit të Cilësisë së Ujit z. V. P , dhe Drejtori i Drejtorisë ITUN z. A. A. .

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.


9. Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit, për periudha jashtë periudhës së auditimit.

Organizimi i Departamentin Teknik në SHRUK Korçë SHA



(Kjo skemë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë.)

Për Bilancin e ujit Prodhim/Faturim në shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA kontrolli dhe raportimi është si mposhtë:
SHRUK Korçë për punët menaxheriale dhe operative drejtohet nga Administratori, i cili ka nën varësi Taks Forcën dhe Departamentin Teknik.
Taks Forca në organigramën e miratuar me vendimin nr. 2 datë 11.04.2023 është e përbërë nga një përgjegjës sektori dhe 3 punonjës. Kjo taksë forcë edhe pse e parashikuar në organigramë nuk ka funksionuar asnjëherë pasi vendet janë vakante.
Departamenti Teknik është i përbërë nga Njësitë e 5 qyteteve pas bashkimit në SHRUK dhe Drejtorinë e Projektimit, Drejtorinë e Prodhim Magazinimit, Drejtorinë e ITUN, Drejtorinë e Kanalizimeve dhe Sektori i monitorimit të cilësisë së ujit.
Drejtuesi i Departamentit Teknik menaxhon sasinë e ujit të pijshëm të prodhuar dhe faturuar për të gjithë shoqërinë duke e deleguar për çdo njësi kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit si më poshtë:



(Kjo skemë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë.)

Njësitë në SHRUK Korçë janë të përbëra nga Menaxheri i Njësisë, i cili ka nën varësi Shërbimin e Klientit i cili ka në varësi operator/magazinier dhe arkëtarët dhe përgjegjësi Teknik i cili na në varësi grupet operativ për Ujësjellësin dhe për Kanalizimet. Grupe Operative të ndara sipas zonave që SHRUK Korçë mbulon.
Secili grup operativ ka në përbërjen e vete:
1.Pergjegjes grupi (profili hidraulik)
2. Operator terreni (profili hidraulik)
3. Operator terreni (faturues/manovrator) numri personave në këtë pozicion përcaktohet sipas madhësisë së zonës që mbulon.
4. Operator terreni (punëtorë krahu).
Bazuar në Udhëzim Nr.3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm":
1. Përdoruesi i ujit të pijshëm nuk lejohet të bëjë shtesë të rrjetit të ujësjellësit që sjell harxhim të ujit pa marrë më parë leje nga SHA Ujësjellës-Kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve dhe njësia e qeverisjes vendore;
2. Shoqëritë ujësjellës-kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-Kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë periodike me anë të punonjësve ose teknikëve të autorizuar prej tyre, duhet të kontrollojnë rrjetin e ujësjellësve dhe kur vërejnë mangësi të instalimeve dhe ndërhyrje në rrjet, të marrin masa të menjëhershme për riparimin e tyre, duke vënë përpara përgjegjësisë subjektet të cilat kanë ndërhyrë në rrjet pa miratimin e strukturave përgjegjëse. Çmimi i ujit për periudhën 01.01.2023-31.07.2025 për SHRUK Korçë dhe secilën njësi sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Përdorimi	Monedha	Njësia Matëse	Uji i pijshëm
Korçë Qytet	Konsumator Familjare	Lekë	m³	72
	Konsumator Familjare	Lekë	m³	72
	Njësi Private	Lekë	m³	140
	Njësi Private	Lekë	m³	140
	Institucione Publike	Lekë	m³	117
	Institucione Publike	Lekë	m³	117
Korçë Rural	Konsumator Familjare	Lekë	m³	38
	Konsumator Familjare	Lekë	m³	28
	Njesi Private	Lekë	m³	100
	Institucione Publike	Lekë	m³	110
Maliq Qytet	Konsumator Familjare	Lekë	m³	45
	Njësi Private	Lekë	m³	105
	Institucione Publike	Lekë	m³	100
Maliq Rural	Konsumator Familjare	Lekë	m³	22.5
	Konsumator Familjare	Lekë	m³	45
	Njësi Private	Lekë	m³	105
	Institucione Publike	Lekë	m³	100
Devoll Qytet	Konsumator Familjare	Lekë	m³	38
	Njësi Private	Lekë	m³	110
	Institucione Publike	Lekë	m³	100
Devoll Rural	Konsumator Familjare	Lekë	m³	25
	Konsumator Familjare	Lekë	m³	29.17
	Njësi Private	Lekë	m³	25

	Njësi Private	Lekë	m³	29.17
	Institucione Publike	Lekë	m³	25
	Institucione Publike	Lekë	m³	29.17
Kolonje Qytet	Konsumator Familjare	Lekë	m³	38
	Njësi Private	Lekë	m³	110
	Institucione Publike	Lekë	m³	100
Kolonje Rural	Konsumator Familjare	Lekë	m³	38
	Njësi Private	Lekë	m³	110
	Institucione Publike	Lekë	m³	100
Pustec Rural	Konsumator Familjare	Lekë	m³	50
	Njësi Private	Lekë	m³	100
	Institucione Publike	Lekë	m³	100

(Kjo tabelë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë SHA)

Për vitin 2023, SHRUK Korçë SHA ka prodhuar dhe faturuar ujë si me poshtë:

Nr.	Rajoni	Njësia Bashkiake	Muaji	Vëllimi Prodhuar/ M3	Vëllimi Faturuar/ M3	Villimi i Humbjes/ M3	Humbje/%
				Totali prodhimit nga të gjitha burimet	Totali I faturimit për të gjithë klientët	Diferenca midis faturimit dhe prodhimit	
1	KORCE	KORCE	TOTAL 2023	3,745,397	2,784,789	960,608	25.6%
2		DEVOLL		1,440,126	929,185	510,941	35.5%
3		KOLONJE		373,976	279,884	94,092	25.2%
4		MALIQ		1,550,256	751,997	798,259	51.5%
5		PUSTEC		88,750	65,307	23,443	26.4%
TOTALI				**7,198,505**	**4,811,162**	**2,387,343**	**33%**

(Kjo tabelë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë.)

Për vitin 2023 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 7,198,505 m^3 ujë nga të gjitha burimet që kjo shoqëri disponon, ka faturuar 4,811,162 m^3 dhe ka humbje 2,387,343 m^3 ujë që nuk është faturuar. SHRUK Korçë për prodhimin e ujit për njësit që përdorin pompa me energji elektrike për vitin 2023 ka blerë **5,977,099 Kŵh me vlerë 68,874,692 lekë pa TVSH.**

Bazuar në Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" SHRUK Korçë për vitin 2023 ka dërguar 2 bilancet 6 mujor të ujit tek ERRU. Në bilancet për vitin 2023 SHRUK Korçë ka bërë edhe ndarjen e llojeve të humbjeve që klasifikohen si më poshtë i cili është ujë pa të ardhura pasi nuk faturohet.

Humbjet e ujit është volumi total i ujit që humbet në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë. Humbjet përfshijnë humbjet e dukshme dhe humbjet reale.

Humbjet reale janë humbjet fizike të ujit në sistemin e Furnizimit me ujë deri në pikën e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe në burimet e ujit. Për vitin 2023 humbjet reale janë 1,439,701 m^3 të cilat janë ndarë në 3 kategori:

1. Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes 659,171 m³.
2. Rrjedhjet nga depot dhe defekte 12,408 m³.

3. Rrjedhje në pikat e lidhjes (tub. Kryesor-puset-klient) 768,122 m^3.
Humbjet e dukshme konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe te gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori. Për vitin 2023 humbjet e dukshme janë 947,642 m^3 të cilat janë ndarë në 2 kategori:
1. Konsumi i pa autorizuar 587,717 m^3.
2. Gabimet në matje 359,925 m^3.
Për vitin 2023 SHRUK Korçë SHA nuk ka nxjerrë urdhra pune për verifikimin e sistemit të matjes dhe lidhjeve të paligjshme edhe pse në bilancet 6 mujore rezulton se 39.6% e sasisë së humbjes përbëhet nga humbje e dukshme.
SHRUK Korçë SHA për vitin 2023 ka konstatuar 1 rast për ndërhyrje të paligjshme në rrjet dhe është gjobitur abonenti me 5,000 lekë të cilat janë arkëtuar.
Në SHRUK Korçë SHA mungojnë plane pune për kontroll në teren në zonat me humbje me të larta dhe tek subjektet private si subjektet me konsum më të lartë të ujit dhe risk më të madh, në mos përputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim nr.3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm". Për vitin 2023 dy rajonet me humbjen me të larta në SHRUK Korçë janë Njësia Maliq dhe Njësia Devoll. SHRUK Korçë për këto dy njësi nuk ka nxjerrë urdhra pune për kontroll në terren për humbjet që janë të larta dhe nuk ka bërë një analizë për arsyet dhe shkaqet që sjellin këtë humbje të lartë të ujit. Departamenti Teknik, Drejtoria e planifikimit për vitin 2023 ka bërë planifikim dhe kanë investuar për përmirësimin e furnizimit me ujë konkretisht:
Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (nj.a. Pojan) dhe Bulgarec (nj.a. Libonik).
Për Njësinë Maliq dhe Njësinë Devoll nuk ka bërë asnjë planifikim për investim në këto 2 njësi për përmirësimin e rrjetit dhe uljen e humbjeve që janë në vlerën e 51.5% për njësinë Maliq dhe 35.5% për njësinë Devoll.

Për sa me sipër, bazuar nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se: Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 7,198,505 m^3 ujë, ka faturuar 4,811,162 m^3 dhe ka humbje 2,387,343 m^3 ujë që nuk është faturuar ose **33%** e ujit që SHRUK Korçë ka prodhuar për vitin 2023. Humbja e ujit të pa faturuar shkaktohet nga, *humbjet reale* në sasinë 1,439,701 m^3 që janë humbjet fizike te ujit në sistemin e Furnizimit me ujë deri në piken e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe ne burimet e ujit. Dhe *humbjet e dukshme* në sasinë 947,642 m^3 që konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe të gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori të përkufizuara sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit". Për humbjet që shkaktohet nga humbjet e dukshme për vitin 2023, SHRUK Korçë SHA sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion ka konstatuar një rast që është gjobitur me vlerën 5,000 lekë si mësipërm por nuk ka konstatuar sasi uji në m^3. Diferenca midis humbjes së dukshme dhe rasteve që kanë shkaktuar humbje të dukshme është shumë e lartë. **Sasia 947,642 m^3 që SHRUK Korçë SHA e ka klasifikuar si humbje e dukshme e llogaritur me tarifën 50 lekë më m^3 si vlera mesatare që SHRUK Korçë SHA operon duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 47,382,100 lekë për shoqërinë.** Konstatimi i vetëm një rasti që kanë sjell humbje të dukshme dhe mos nxjerrja e urdhrave për kontrolle sidomos në njësit me humbje më të lartë dhe subjektet private si subjekte

me risk dhe konsum më të lartë, është në mospërputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim nr.3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm".
SHRUK Korçë nuk ka bërë analiza dhe nuk ka nxjerrë plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme.
SHRUK Korçë nuk ka bërë bilancin e ujit 1 here në muaj sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" për të identifikuar dhe përmirësuar situatën me humbjet.

Si konkluzion: për vitin 2023 SHRUK Korçë ka blerë 5,977,099 Këh me vlerë 68,874,692 lekë pa TVSH për prodhimin e 7,198,505 m^3 ujë nga të cilat ka faturuar 4,811,162 m^3 ujë dhe nuk ka arkëtuar për shkak të humbjeve të dukshme (jo teknike) 947,642 m^3 ujë me vlerë **47,382,100 lekë si të ardhura të munguara.**

Për vitin 2024, SHRUK Korçë SHA ka prodhuar dhe faturuar ujë si me poshtë:

Nr.	Rajoni	Njësia Bashkiake	Muaji	Vëllimi Prodhuar/ M3	Vëllimi Faturuar/ M3	Villimi i Humbjes/ M3	Humbje/%
				Totali prodhimit nga të gjitha burimet	Totali i faturimit për të gjithë klientët	Diferenca midis faturimit dhe prodhimit	
1	KORCE	Korçë	TOTAL 2024	4,065,621	2,907,795	1,157,826	28.5%
2		Maliq		1,532,400	800,931	731,469	47.7%
3		Devoll		1,515,617	993,097	522,520	34.5%
4		Kolonje		481,362	335,733	145,629	30.3%
5		Pustec		95,729	74,735	20,994	21.9%
Totali				**7,690,729**	**5,112,291**	**2,578,438**	**33.5%**

(Kjo tabelë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë.)

Për vitin 2024 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 7,690,729 m^3 ujë nga të gjitha burimet që kjo shoqëri disponon, ka faturuar 5,112,291 m^3 dhe ka humbje 2,578,438 m^3 ujë që nuk është faturuar.
SHRUK Korçë për prodhimin e ujit për njësit që përdorin pompa me energji elektrike për vitin 2024 ka blerë **5,652,212 Këh me vlerë 69,776,348 lekë pa TVSH.**
Bazuar në Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" SHRUK Korçë për vitin 2024 ka dërguar 2 bilancet 6 mujor të ujit tek ERRU. Në bilancet për vitin 2024 SHRUK Korçë ka bërë edhe ndarjen e llojeve të humbjeve që klasifikohen si më poshtë i cili është ujë pa të ardhura pasi nuk faturohet.
Humbjet e ujit është volumi total i ujit që humbet në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë. Humbjet përfshijnë humbjet e dukshme dhe humbjet reale.
Humbjet reale janë humbjet fizike te ujit ne sistemin e Furnizimit me ujë deri në piken e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe ne burimet e ujit. Për vitin 2024 humbjet reale janë 1,726,553 m^3 të cilat janë të ndara në 3 kategori:
1. Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes 838,469 m^3.
2. Rrjedhjet nga depot dhe defekte 16,471 m^3.
3. Rrjedhje në pikat e lidhjes (tub. Kryesor-puset-klient) 871,613 m^3.

Humbjet e dukshme konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe te gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori. Për vitin 2024 humbjet e dukshme janë 851,885 m^3 të cilat janë të ndara në 2 kategori:
1. Konsumi i pa autorizuar 467,349 m^3.
2. Gabimet në matje 384,536 m^3.
Për vitin 2024 SHRUK Korçë SHA nuk ka nxjerrë urdhra pune për verifikimin e sistemit të matjes dhe lidhjeve të paligjshme edhe pse në bilancet 6 mujore rezulton se 33% e sasisë së humbjes përbëhet nga humbje e dukshme.
SHRUK Korçë SHA për vitin 2024 ka konstatuar 6 raste për ndërhyrje e paligjshme në rrjet dhe janë gjobitur 6 abonentë familjarë me vlerë totale 148,000 lekë të cilat janë arkëtuar 2 gjoba me vlerë 39,626 lekë.
Në SHRUK Korçë SHA mungojnë plane pune për kontroll në teren në zonat me humbje me të larta dhe tek subjektet private si subjektet me konsum më të lartë të ujit dhe risk më të madh, në mospërputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim Nr.3, Datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm". Për vitin 2024 dy rajonet me humbjen me të larta në SHRUK Korçë janë Njësia Maliq dhe Njësia Devoll. SHRUK Korçë për këto dy njësi nuk ka nxjerrë urdhra pune për kontroll në terren për humbjet që janë të larta dhe nuk ka bërë një analizë për arsyet dhe shkaqet që sjellin këtë humbje të lartë të ujit. Departamenti Teknik, Drejtoria e planifikimit për vitin 2024 ka bërë 3 projekte dhe investime si më poshtë:
"Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë në fshatrat Kuç i Zi- Belorta, bashkia Korçë" - 2024
"Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Kuç dhe Poloskë, bashkia Devoll" - 2024
"Investime në ujësjellësit në fshatrat, Sheqeras, Plasë, Libonik, Drithas, Symiz, Pirg dhe Kolanec në njësinë Maliq të ujësjellës-kanalizime rajoni Korçë" – 2024

Për sa me sipër, bazuar nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupit të auditimit konstatoi se: Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 7,690,729 m^3 ujë, ka faturuar 5,112,291 m^3 dhe ka humbje 2,578,438 m^3 ujë që nuk është faturuar ose **33.5%** e ujit që SHRUK Korçë ka prodhuar për vitin 2024. Humbja e ujit të pa faturuar shkaktohet nga, *humbjet reale* në sasinë 1,726,553 m^3 që janë humbjet fizike te ujit në sistemin e Furnizimit me ujë deri në piken e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe ne burimet e ujit. Dhe *humbjet e dukshme* në sasinë 851,885 m^3 që konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe të gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori të përkufizuara sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit". Për humbjet që shkaktohet nga humbjet e dukshme për vitin 2024, SHRUK Korçë SHA sipas informacionit të vendosur në dispozicion ka konstatuar 6 raste që është gjobitur me vlerën 148,000 lekë si mësipërm dhe ka faturuar për sasinë 869 m^3 të konstatuar 2 abonentë me vlerën 39,626 lekë nga të cilat të 2 pagesa janë bërë të plota. Diferenca midis humbjes të dukshme për periudhën Janar-Dhjetor 2024 me rastin që SHRUK Korçë ka konstatuar për ndërhyrje të paautorizuar është 851,885 m^3- 869 m^3= 851,016 m^3. Diferenca midis humbjes së dukshme dhe rasteve që kanë shkaktuar humbje të dukshme është shumë e lartë. **Sasia 851,016 m^3 që SHRUK Korçë SHA e ka klasifikuar si humbje e dukshme e llogaritur me tarifën 50 lekë më m^3 si vlera mesatare që SHRUK Korçë SHA operon sjell të ardhura të munguara në vlerën 42,550,800 lekë për shoqërinë.**

Konstatimi i vetëm 6 rasteve që kanë sjell humbje të dukshme dhe mos nxjerrja e urdhrave për kontrolle sidomos në njësit me humbje më të lartë dhe subjektet private si subjekte me risk dhe konsum më të lartë, është në mos përputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim nr.3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm".
SHRUK Korçë nuk ka bërë bilancin e ujit 1 here në muaj sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" për të identifikuar dhe përmirësuar situatën me humbjet.
SHRUK Korçë nuk ka bërë analiza dhe nuk ka nxjerrë plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme.

Si konkluzion, për vitin 2024 SHRUK Korçë ka blerë 5,652,212 Këh me vlerë 69,776,348 lekë pa TVSH për prodhimin e 7,690,729 m^3 ujë nga të cilat ka faturuar 5,112,291 m^3 ujë dhe nuk ka arkëtuar për shkak të humbjeve të dukshme (jo teknike) 851,016 m^3 ujë me vlerë **42,550,800 lekë si të ardhura të munguara.**

Për periudhën Janar-Qershor 2025, SHRUK Korçë SHA ka prodhuar dhe faturuar ujë si me poshtë:

Nr.	Rajoni	Njësia Bashkiake	Muaji	Vëllimi Prodhuar/ M3	Vëllimi Faturuar/ M3	Villimi i Humbjes/ M3	Humbje/%
				Totali prodhimit nga të gjitha burimet	Totali i faturimit për të gjithë klientët	Diferenca midis faturimit dhe prodhimit	
1	KORCE	Korçë	6-MUJORI I	1,933,220	1,362,331	570,889	29.5%
2		Maliq		690,579	357,243	333,336	48.3%
3		Devoll		656,642	437,969	218,673	33.3%
4		Kolonje		210,437	147,316	63,121	30.0%
5		Pustec		37,482	28,912	8,570	22.9%
Totali				**3,528,360**	**2,333,771**	**1,194,589**	**33.9%**

(Kjo tabelë është vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga SHRUK Korçë.)

Për periudhën Janar-Qershor 2025 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 3,528,360 m^3 ujë nga të gjitha burimet që kjo shoqëri disponon, ka faturuar 2,333,771 m^3 dhe ka humbje 1,194,589 m^3 ujë që nuk është faturuar. SHRUK Korçë për prodhimin e ujit për njësit që përdorin pompa me energji elektrike për gjashtë mujorin e parë ka blerë **2,512,090 Kwh me vlerë 27,484,211 lekë pa TVSH.**
Bazuar në Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" SHRUK Korçë për vitin 2025 ka dërguar bilancin 6 mujor të ujit tek ERRU. Në bilancet për gjashtë mujorin e parë të 2025 SHRUK Korçë ka bërë edhe ndarjen e llojeve të humbjeve që klasifikohen si më poshtë i cili është ujë pa të ardhura pasi nuk faturohet.
Humbjet e ujit është volumi total i ujit që humbet në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë. Humbjet përfshijnë humbjet e dukshme dhe humbjet reale.
Humbjet reale janë humbjet fizike te ujit ne sistemin e Furnizimit me ujë deri në piken e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe ne burimet e ujit. Për gjashtë mujorin e parë të 2025 humbjet reale janë 792,110 m^3 të cilat janë të ndara në 3 kategori:

1. Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes 384,674 m³.
2. Rrjedhjet nga depot dhe defekte 7,557 m³.
3. Rrjedhje në pikat e lidhjes (tub. Kryesor-puset-klient) 399,879 m^3.

Humbjet e dukshme konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe te gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori. Për gjashtë mujorin e parë të 2025 humbjet e dukshme janë 402,479 m^3 të cilat janë të ndara në 2 kategori:
1. Konsumi i pa autorizuar 226,061 m^3.
2. Gabimet në matje 176,418 m^3.

Për gjashtë mujorin e parë të 2025 SHRUK Korçë SHA nuk ka nxjerrë urdhra pune për verifikimin e sistemit të matjes dhe lidhjeve të paligjshme edhe pse në bilancet 6 mujore rezulton se 33.9% e sasisë së humbjes përbëhet nga humbje e dukshme.

SHRUK Korçë SHA për gjashtë mujorin e parë të 2025 ka konstatuar 6 raste për Ndërhyrje e paligjshme në rrjet dhe janë gjobitur 6 abonentë, 5 abonentë familjarë dhe 1 abonent biznes me vlerë totale 100,000 lekë të cilat janë arkëtuar dhe për sasinë e ujit të konstatuar prej 2,959 m^3 të faturuar me vlerë 506,743 lekë 2 pagesa janë bërë të plota dhe 2 abonentë po bëjnë pagës me këste.

Në SHRUK Korçë SHA mungojë plane pune për kontroll në teren në zonat me humbje me të larta dhe tek subjektet private si subjektet me konsum më të lartë të ujit dhe risk më të madh, në mos përputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim Nr.3, Datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm". Për gjashtë mujorin e parë të 2025 dy rajonet me humbjen me të larta në SHRUK Korçë janë Njësia Maliq dhe Njësia Devoll. SHRUK Korçë për këto dy njësi nuk ka nxjerrë urdhra pune për kontroll në terren për humbjet që janë të larta dhe nuk ka bërë një analizë për arsyet dhe shkaqet që sjellin këtë humbje të lartë të ujit.

Departamenti Teknik, Drejtoria e planifikimit për vitin 2025 ka bërë 2 projekte dhe investime si më poshtë:
"Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, bashkia Maliq" – 2025;
"Ndërtim ujësjellësit dhe nën objekte furnizimi me ujë, Rajoni Korçë" – 2025.

Edhe pse në vitin 2024 janë bërë 2 investime në njësitë me humbje më të larta Njësia Maliq për 6 mujori e parë prapë ka 48.3% humbje dhe Njësia Devoll 33.3% humbje.

Për sa me sipër, bazuar nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupit të auditimit konstatoi se: Për gjashtë mujorin e parë të 2025 SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 3,528,360 m^3 ujë nga të gjitha burimet që kjo shoqëri ka në pronësi, ka faturuar 2,333,771 m^3 dhe ka humbje 1,194,589 m^3 ujë që nuk është faturuar ose **33.9%** e ujit që SHRUK Korçë ka prodhuar për gjashtë mujorin e parë të 2025. Humbja e ujit të pa faturuar shkaktohet nga, <u>*humbjet reale*</u> në sasinë 792,110 m^3 që janë humbjet fizike te ujit në sistemin e Furnizimit me ujë deri në piken e matjes tek konsumatori. Në këto humbje përfshihen të gjitha llojet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, nga mbi rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, rrjedhjet në stacionin e pompave dhe ne burimet e ujit. Dhe <u>*humbjet e dukshme*</u> në sasinë 402,479 m^3 që konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe të gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori të përkufizuara sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit". Për humbjet që shkaktohet nga humbjet e dukshme për gjashtë mujorin e parë të 2025, SHRUK Korçë SHA sipas informacionit të vendosur në dispozicion ka konstatuar 6 raste dhe janë gjobitur me vlerën 100,000 lekë si mësipërm dhe ka faturuar për sasinë 2,959 m^3 të konstatuar 4 abonentë me vlerën 506,743 lekë nga të cilët 2 pagesa janë bërë të plota dhe 2 abonentë po bëjnë pagës me këste.

Diferenca midis humbjes të dukshme për gjashtë mujorin e parë të 2025 me rastet që SHRUK Korçë ka konstatuar për ndërhyrje të paautorizuar është 402,479 m^3- 2,959 m^3= 399,520 m^3. Diferenca midis humbjes së dukshme dhe rasteve që kanë shkaktuar humbje të dukshme është shumë e lartë. **Sasia 399,520 m^3 që SHRUK Korçë SHA e ka klasifikuar si humbje e dukshme e llogaritur me tarifën 50 lekë më m^3 si vlera mesatare që SHRUK Korçë SHA operon sjell të ardhura të munguara në vlerën 16,976,000 lekë për shoqërinë.**
Konstatimi i vetëm 6 rasteve që kanë sjell humbje të dukshme dhe mos nxjerrja e urdhrave për kontrolle sidomos në njësit me humbje më të lartë dhe subjektet private si subjekte me risk dhe konsum më të lartë, është në mos përputhje me kapitullin 3 pika 4 të Udhëzim Nr.3, Datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm".
SHRUK Korçë nuk ka bërë analiza dhe nuk ka nxjerrë plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme.
SHRUK Korçë nuk ka bërë bilancin e ujit 1 here në muaj sipas Vendim Nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit" për të identifikuar dhe përmirësuar situatën me humbjet.
Taks Forca në orgarnigramën e miratuar me vendimin nr. 2 datë 11.04.2023 është e përbërë nga një përgjegjës sektori dhe 3 punonjës. Kjo taksë forcë edhe pse e parashikuar në organigramë nuk ka funksionuar asnjëherë pasi vendet janë vakante.

Si konkluzion, për periudhën Janar-Qershor 2025 SHRUK Korçë ka blerë 2,512,090 Këh me vlerë 27,484,211 lekë pa TVSH për prodhimin e 3,528,360 m^3 ujë nga të cilat ka faturuar 2,333,771 m^3 ujë dhe nuk ka arkëtuar për shkak të humbjeve të dukshme (jo teknike) 399,520 m^3 ujë me vlerë **16,976,000 lekë si të ardhura të munguara.**

Për periudhën 01 Janar 2023 – 30 Qershor 2025 SHRUK Korçë SHA ka blerë 14,141,401 Këh energji me vlerë 166,135,251 lekë pa TVSH për prodhimin e ujit. Për këtë periudhë SHRUK Korçë SHA ka prodhuar 18,417,594 m^3 ujë nga të cilat ka faturuar 12,257,224 m^3 ujë dhe nuk janë faturuar dhe arkëtuar humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit në sasinë **2,198,178 m^3**.
Të ardhurat e munguara nga mos faturimi dhe arkëtimi i humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit për periudhën 01 Janar 2023 – 30 Qershor 2025 janë **106,908,900 lekë.**

Për situatën e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. P. T. me detyrë Administrator i shoqërisë, znj.M. K. me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik dhe z. V. L. me detyrë Drejtor Prodhim Magazinim Uji.

Per sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

IV. REKOMANDIME
Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, u konstatua se:
- Në statutin e shoqërisë, të miratuar më datë 12.07.2022 vijon të referohet Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i cili është shfuqizuar më datën 01.01.2019 me hyrjen në fuqi të ligjit 25/2018, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*". Gjithashtu, në pikën 6 të nenit 6 të statutit, njoftimi i anëtarëve për mbledhjen e asamblesë është përcaktuar të paktën 15 ditë përpara, ndryshe nga neni 137/1 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar, i cili e përcakton këtë afat jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë;
- Anëtarët e Asamblesë nuk janë pajisur me një autorizim specifik nga këshilli bashkiak për pjesëmarrje në mbledhje, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 6 të statutit;
- Nga 12 mbledhje të zhvilluara gjithsej nga asambleja, në 8 prej tyre nuk është respektuar afati i njoftimit të anëtarëve të asamblesë të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 6 të statutit të shoqërisë;
- Vendimi nr. 2, datë 19.02.2025 "*Për emërim në detyrë të Administratorit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë*" nuk ka përcaktuar pagën e administratorit në aktin e emërimit, si dhe nuk ka respektuar afatin 3 vjeçar të emërimit, në kundërshtim me pikën 3 dhe 2 të nenit 17 të statutit;
- Në vendimet nr. 9 dhe nr.11 të datës 28.12.2023, është miratuar përkatësisht Programi i Zhvillimit Ekonomik 2024 - 2026 dhe Plani i biznesit për vitin 2024 - 2028, pa i miratuar ato më parë në nivel vjetor, jo në përputhje me kërkesat e germës "a", të nenit 7/1 të statutit, si dhe Udhëzimin e MF nr. 18, datë 2.5.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", pika 2, kreu I;
- Në vendimin nr.4, datë 11.07.2025 "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë", konstatohet se 5 anëtarë nuk plotësojnë kriteret lidhur me profesionin dhe/ose të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 12 të statutit.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 16 - 28 të Raportit të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për ndryshimin e statutit të shoqërisë për të kryer rregullimet e nevojshme; pajisjen me autorizim specifik nga këshilli bashkiak të anëtarëve të asamblesë, si dhe të respektojë afatet e njoftimit të anëtarëve për mbledhje dhe për vendim-marrje specifike që mund të jenë periodike.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë në shqyrtim dhe të analizojë përbërjen e Këshillit mbikëqyrës për plotësimin nga anëtarët të kritereve të profesionit dhe të eksperiencës në punë të tyre me qëllim rritjen dhe forcimin e rolit mbikëqyrës të këtij organi.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, u konstatua se:
- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 12 të statutit;
- Këshilli Mbikëqyrës nuk ka ushtruar të drejtat e veta për të kryer verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij; nuk ka shqyrtuar e kontrolluar librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë, jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 dhe 3/d të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë nuk janë nënshkruar nga të gjithë e anëtarët, si dhe nuk ka bashkëlidhur një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar, për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, jo në përputhje me kërkesat e pikës 3/dh të nenit 13 të statutit të shoqërisë; si dhe nuk përmban mendimin për raportin e auditimit, jo në përputhje me pikën 3/e të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Plani i biznesit të shoqërisë për vitet 2024 dhe 2025, nuk është nënshkruar nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe i është përcjellë për miratim Asamblesë se Përgjithshme pa shqyrtimin e miratimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/f të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Nuk ka miratuar planin e investimeve kapitale për vitin 2025, për t'ia dërguar për miratim AKUM-it në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/gj të nenit 13 të statutit të shoqërisë;
- Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë thirrur nga Administratori i shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 11 të statutit;
- Njoftimi për thirrjen e mbledhjes nga ana e administratorit në 11 raste nga 34 gjithsej është bërë në më pak se 3 ditë, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 14 të statutit;
- Nga 34 mbledhje të zhvilluara gjithsej, në 17 prej tyre (50%) nuk janë marrë vendime, kanë qenë pa diskutime ose minimale, duke mos ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e veta në shqyrtimin e çështjeve të paraqitura, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 13 të statutit të shoqërisë. Kjo, së bashku me raportimin e vonuar të treguesve mujorë, ka bërë që mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të zhvillohen kryesisht në mënyrë formale, duke kufizuar efektivitetin e funksionit të tij mbikëqyrës;
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 16 - 28 të Raportit të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për të lidhur kontratat e punës me Asamblenë e Përgjithshme; të ushtrojë me korrektesë të drejtat e veta për kontroll dhe mbikëqyrje, shqyrtimin e pasqyrave financiare dhe të planit të biznesit; respektimin e kërkesave për dërgimin dhe miratimin e planit të investimeve në AKUM; thirrjen e mbledhjeve dhe respektimin e afatit të njoftimit, diskutimin dhe vendim-marrjen e duhur ligjore, për të rritur performancën kontrolluese dhe mbikëqyrëse të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Administratorit të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, në periudhën e audituar nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025 u konstatua se:
- Kontratat e rinovueshme me Asamblenë e përgjithshme nuk kanë qenë të gjitha mbi baza vjetore, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 17 të statutit;

- Ka hartuar me 36 muaj vonesë Rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë dhe e ka dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, sipas përcaktimeve të pikës 4/c, neni 17 i statutit;
- Nuk i ka paraqitur Këshillit mbikëqyrës brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli, në kundërshtim me kërkesat e pikës 4/d të nenit 17 të statutit;
- Nuk ka përfaqësuar dhe vepruar në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palët e treta për kontratat e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, megjithëse është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj, në kundërshtim me pikën 4/e, neni 17 i statutit.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 16 - 28 të Raportit të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për të lidhur kontrata me Asamblenë mbi baza vjetore, si dhe të respektojë afatet dhe detyrimet e përcaktuara në statut për hartimin e akteve të ndryshme dhe pasqyrave financiare, përfshirë përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me palët e treta.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit, marrëdhënieve të punës dhe administrimit të tyre në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në periudhën 01.01.2023 deri më 30.09.2025 u konstatua se:
- Struktura organizative paraqet mangësi në aspektin e klasifikimit, emërtimit dhe funksionalitetit të njësive organizative, duke përfshirë sektorë pa përcaktim të qartë funksional, për funksione që nuk menaxhohen nga shoqëria; mungesën e një njësie për shërbimet mbështetëse; struktura të pa plotësuara me personel; në Drejtorinë e shitjes dhe Drejtorinë juridike sektorët janë të plotësuar në numër me specialistë edhe për pozicionin e përgjegjësit të sektorit, në mospërputhje me Vendimin nr. 2, datë 11.04.2023 të Këshillit Mbikëqyrës; nuk ka një drejtues të dytë teknik në zbatim të kërkesave të nenit 18, pika 1, germa "c" e statutit etj.;
- Gjatë periudhës Janar 2023 - Prill 2024, janë lidhur kontrata pune vetëm për 276 punonjës nga 295 gjithsej të transferuar nga ish-shoqëritë dhe për pjesën tjetër janë nxjerrë urdhra ose vendime emërimi, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr.7691 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kontrata të cilat rezultojnë të pa protokolluara dhe të pa administruara në dosjet personale. Gjatë kësaj periudhe nuk janë lidhur kontrata për punonjësit e rekrutuar në periudhë prove në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, neni 11, 12 dhe neni 21, pika 4.
- Gjatë periudhës nën auditim numri i punonjësve ka pësuar luhatje të vazhdueshme mujore, ku në periudhën janar –korrik 2023 ka pasur mbi organikë nga 2 deri në 24 punonjës dhe në periudhën shtator 2023 –shtator 2025 ajo nuk është plotësuar për 4 deri në 34 punonjës, duke shfaqur mangësi planifikimi dhe/ose të performancës së shoqërisë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të analizojë skemën dhe funksionimin organizativ të shoqërisë dhe të marrë masa për hartimin, propozimin dhe miratimin e një strukture eficente, për kontrollin dhe rritjen e përgjegjësisë hierarkike, në funksion të rritjes së performancës individuale dhe të shoqërisë, të harmonizuar me kërkesat e statutit për Drejtuesin e Dytë Teknik, si dhe të një numri optimal të punonjësve.

Brenda 6-mujorit të dytë 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Rregullorja e Brendshme e shoqërisë në përbërjen e saj, përfshin dokumente të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar

anekse, pasi janë miratuar si akte nënligjore autonome, në periudha dhe kontekste të ndryshme. Përfshirja e tyre si pjesë përbërëse e një akti të mëvonshëm bie ndesh me parimet e hierarkisë së akteve dhe krijon paqartësi në zbatimin e kuadrit rregullator të brendshëm.
Veç sa më sipër, për pozicionet e punës: Audit i brendshëm, Përgjegjës i sektorit të kontabilitetit, Përgjegjës i sektorit të kontabilitetit për të ardhurat, Përgjegjës i sektorit të kontabilitetit për shpenzimet, Përgjegjës i sektorit të planifikimit buxhetor, Specialist për protokollin, Specialist për arkivin dhe Operator sistemi në ZKM nuk është përcaktuar rubrika "Kualifikimet e nevojshme". Gjithashtu, përshkrimet e punës janë të njëjta për pozicione punë të barabarta, duke pasqyruar objektiva dhe detyra të përgjithshme, pa reflektuar ndarje reale të detyrave dhe përgjegjësive.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të shqyrtojë dhe të analizojë strukturën dhe përmbajtje e Rregullores së brendshme, si dhe të marrë masa për rishikimin e saj në mënyrë që të përfshijë të gjitha proceset dhe përshkrimet e punës sipas pozicioneve në strukturë dhe kërkesave në statut, duke përcaktuar statusin juridik të secilit dokument, për të shmangur paqartësitë në zbatimin e kuadrit rregullator dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, megjithëse administratori ka miratuar rregulloren përkatëse dhe ka caktuar autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, personeli i shoqërisë, me përjashtim të administratorit, nuk ka plotësuar autorizimet e kërkuara për verifikimin e të dhënave, nëpërmjet të cilit t'i jepet mundësia institucionit që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin kudo ku ato janë regjistruar, në kundërshtim me nenin 5 të Rregullores "Për parandalimin e konfliktit të interesave", miratuar me urdhrin e administratorit nr. 8, datë 05.01.2023.
Gjithashtu, konstatohet se autoriteti përgjegjës nuk ka mbledhur të dhëna dhe nuk ka kryer verifikime për konfliktin e interesit, ekzistencën e tij në dukje apo faktik, në të gjitha nivelet e zyrtarëve të SHRUK Korçë, në kundërshtim me nenin 11 e 13 të Rregullores, si dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".*
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
6.1 Rekomandim: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për të vënë në funksion Autoritetin Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili të administroje dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme në lidhje më konfliktin e interesit në shoqëri, me qëllim garantimin e një vendim-marrjeje të paanshme, transparente dhe në interesin më të mirë të mundshëm të publikut.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së rekrutimit të punonjësve, u konstatua se procesi që nga shpallja e pozicioneve të lira, publikimi i tyre në faqen zyrtare të shoqërisë ose në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe administrimi i dokumentacionit të konkurrimit dhe vlerësimit deri në shpalljen e fituesit, nuk është kryer sipas kritereve përkatëse ligjore, në kundërshtim me parimin e transparencës të parashikuar në nenin 5 të Kodit të Procedurave Administrative.
Kërkesat për punësim rezultojnë të pa protokolluara dhe administrohen vetëm për kandidatët fitues, duke cenuar gjurmueshmërinë dhe transparencën e procesit të rekrutimit. Gjithashtu, gjatë

vitit 2024 janë konstatuar formularë interviste të paplotësuar, të panënshkruar, pa identifikim të intervistuesve dhe të pa protokolluar, duke vënë në dyshim rregullsinë dhe besueshmërinë e procesit të përzgjedhjes së personelit.
Në vitin 2023 janë rekrutuar 7 punonjës, për të cilët nga verifikimi rezulton se nuk janë lidhur kontrata individuale pune, por janë punësuar vetëm me urdhrin ose vendimin e administratorit për periudhën e provës dhe kontratat janë nënshkruar vetëm pas përfundimit të periudhës së provës. Gjithashtu gjatë vitit 2024, janë emëruar 3 punonjës në mënyrë definitive pa kaluar periudhën e provës.
- Gjatë auditimit të dosjeve të personelit u konstatuan mangësi të shumta në administrim, përfshirë mungesën e inventarit, dokumenteve bazë si certifikata familjare, kontratat, dëshmitë e penalitetit, si dhe dokumentet e shkëputjes dhe transferimit të punonjësve në shoqërinë e re apo dokumente të tjera që lidhen me pozicionin e punës. Në rastin e administratorit mungojnë dokumente si: diploma e pa noterizuar, lista e notave, certifikata personale dhe raporti mjekësor, në kundërshtim me VKM nr.833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit të regjistrit qendror të personelit", lidhja 2.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
7.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për analizimin e situatës, përcaktimin e përgjegjësive për mangësitë e konstatuara dhe të sigurojë që proceset e rekrutimit të realizohen përmes një procesi përzgjedhës, transparent dhe të drejtë, si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin, sistemimin dhe administrimin e rregullt të dosjeve të personelit për çdo punonjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të personelit dhe stafit të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë u konstatua se, nuk është hartuar një plan trajnimesh që të përfshijë të gjithë punonjësit, në kundërshtim më Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli II, pika 2.3.
- Punonjësit e kanalizimeve nuk janë trajnuar dhe testuar nga një komision i ngritur nga titullari në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të dytë të pikës 8- Rregullat e sigurisë teknike të punonjësve në sektorin e ujësjellësit, siguria në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, pjesë e Rregullores së brendshme të shoqërisë.
- Punonjësit e sektorit të prodhimit dhe magazinimit të ujit nuk disponojnë kualifikim të sigurimit teknik në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të dytë të pikës 8- Rregullat e sigurisë teknike të punonjësve në sektorin e ujësjellësit, siguria në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, pjesë e Rregullores së brendshme të shoqërisë.
- "Kontratat e Performancës" të lidhura nga administratori, në rastin e Drejtorëve të Drejtorive nuk përputhen me linjën e hierarkisë së shoqërisë dhe përshkrimet e punës të miratuara, duke krijuar mbivendosje të përgjegjësive dhe duke shkelur strukturën dhe rregulloren e brendshme, si dhe nuk është kryer vlerësimi periodik i performancës për Drejtorët.
- Nuk është kryer vlerësimi 6-mujor apo vjetor i punonjësve të shoqërisë, në kundërshtim me Parimin 2 të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Administratori, Departamenti Teknik dhe Sektori i burimeve njerëzore i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrin masa për hartimin e planit të trajnimit gjithëpërfshirës për punonjësit e shoqërisë, ngritjen e komisionit për trajnimin e punonjësve të kanalizimeve dhe të impiantit të ujërave të ndotura dhe

për certifikimin e punonjësve të sigurimit teknik.
8.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të rishikojë dhe të harmonizojë kontratat e performancës me linjën hierarkike sipas strukturës organizative, duke siguruar përputhshmëri me rregulloren e brendshme dhe përshkrimet e punës, si dhe për vlerësimin periodik të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës u konstatua se, në muajin shtator 2025:
- Janë 32 pozicione pune vakante, konkretisht 3 pozicione vakante në nivel Drejtori, 9 pozicione Përgjegjës sektori, 12 pozicione specialist, 3 pozicione të lira teknik, 4 pozicione Operator dhe 1 Sanitar. Mungesa të tilla veçanërisht ato të pozicioneve drejtuese mund të sjellin vështirësi në organizimin e punës dhe performancën e njësive strukturore të shoqërisë.
- Punonjësve që janë larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, nuk iu është ofruar një vend tjetër i barabartë apo i përafërt në të gjithë shoqërinë, por vetëm brenda njësisë ku ata ushtronin detyrën e tyre, megjithëse gjatë kësaj periudhe janë rekrutuar punonjës të rinj në pozicione të përafërta dhe më të njëjtin nivel arsimor, në kundërshtim me nenin 149/2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.
- Në përfundim të të gjitha procedurave disiplinore janë dhënë masa disiplinore të njëjta, duke mos ruajtur proporcionalitetin e shkeljes në raport me masën e dhënë, si dhe nuk janë të pasqyruara në një regjistër apo në librezën e punës së punonjësit. Kontrata individuale e punës në nenet 39, 40, 41 dhe 42 nuk parashikon një ndarje të qartë të shkeljes disiplinore dhe masës përkatëse për secilën prej tyre, duke krijuar mundësinë e trajtimit me subjektivitet.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrin masa për plotësimin e strukturës organike, miratimin dhe zbatimin e një procedure të unifikuar për dhënien e masave disiplinore proporcionale me shkeljen, si dhe dokumentimin e tyre, me qëllim rritjen e transparencës, llogaridhënien dhe trajtimit të barabartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të pagave, llogaritjes dhe kryerjes së pagesave të tyre u konstatua se:
- Nga krahasimi i kategorizimit të punonjësve sipas eksperiencës në punë me nivelin e pagës së caktuar rezultojnë mospërputhje, në kundërshtim me Vendimin nr. 2, datë 09.04.2024 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar. Konkretisht, nuk është zbatuar caktimi i nivelit të pagës në funksion të përvojës në punë, si dhe nuk është realizuar kalimi në nivelet përkatëse të pagës me përmbushjen e viteve të vjetërsisë së përcaktuara.
- Në periudhën janar 2023- prill 2024, janë miratuar rritjet e pagës për 7 punonjës, para hyrjes në fuqi të Vendimit nr.2 datë 09.04.2024 "Për miratimin e nivelit të paga të punonjësve të Shoqërisë" i Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Vendimin nr.3 të Këshillit Mbikëqyrës datë 27.09.2022 pika 3, ku përcaktohet se gjatë procesit të ristrukturimit do të jenë të pandryshuara pagat ekzistuese të punonjësve të ish shoqërive, me efekt financiar gjithsej 630,000 lekë.
- Në procedurat për rritjen e pagës, të nisura me kërkesë nga grup punonjësish brenda një dite, nuk ka kërkesa të refuzuara, janë protokolluar e miratuar brenda një afati një ditor, duke i dhënë procesit karakter formal për të justifikuar vendim- marrjen.

- Administrimi i dokumentacionit të listë-pagesave paraqet mangësi procedurale, përfshirë mosrespektimin e delegimit të kompetencave dhe mungesën e një liste-prezence mujore të unifikuar, duke dobësuar kontrollin e brendshëm dhe gjurmueshmërinë e procesit të administrimit të pagave.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore të analizojë pagat e punonjësve duke përputhur nivelin e tyre me eksperiencën në punë; të shqyrtojë me vëmendje kërkesat për rritjen e pagave bazuar në performancën e tyre rast pas rasti; si dhe të unifikojë në mënyrë të dokumentuar procedurën e kryerjes së pagesave për pagat e punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për kompensimin ushqimor është konstatuar se, pagesa për kompensim ushqimor gjatë periudhës janar 2023 – tetor 2024 ka rezultuar në trajtim jo të barabartë midis punonjësve. Kompensimi është dhënë vetëm për punonjësit e transferuar nga ish-shoqëria Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe për disa punonjës të rekrutuar, duke lënë jashtë të tjerë punonjës, pavarësisht statusit ose vendit të punës, në kundërshtim me parimet e barazisë në shpërblim dhe mos diskriminimit të parashikuara në nenin 115 të Kodit të Punës, nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 12 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*". Kjo mangësi është shoqëruar dhe me parregullsi në mënyrën e përllogaritjes së shtesës.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Drejtoria ekonomike të marrë masat e nevojshme për trajtimin korrekt të punonjësve me dietë ushqimore, si dhe në llogaritjen e drejtë, të saktë dhe të qartë të saj në periudhën e pushimeve vjetore.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve*", me fond limit 4,883,000 lekë, zhvilluar më datë 03.04.2023 dhe zbatuar me kontratën nr. 216/23 prot., datë 27.04.2023 me kontraktorin "E Th" SHPK, me vlerë 3,594,300 lekë, si dhe në procedurën e prokurimit "*Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve*", me fond limit 1,682,409 lekë, zhvilluar më datë 08.04.2024, dhe zbatuar me kontratën me nr. 167/21, datë 30.04.2024 me kontraktor "E Th", me vlerë 1,656,000 lekë u konstatoua se:

- Gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, nuk është argumentuar nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mungesën e një balance të saktë të një gjendjeje të mjaftueshme për realizimin e kërkesave operacionale me minimumin e riskut dhe të kostos për mbajtjen e këtyre aktiveve, jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar;
- Kryerja e procedurës së përllogaritjes së fondit limit nëpërmjet alternativës së tregut, në mungesë të specifikimeve teknike, si dhe mungesa e gjurmës se auditimit mbi mënyrën e marrjes së ofertave, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Mungesa e pasqyrimit të firmës prodhuese në mostrat e dorëzuara të tubave, sjell për pasojë mos plotësimin e specifikimeve teknike, që të kenë të shënuar në mënyrë permanente emrin e prodhuesit dhe klasën e tubit;

- KVO duke i kërkuar sqarime OE “E Th” SHPK, lidhur me tubot e brinjëzuara të ofruara se cilit katalog i përkasin, ka tejkaluar kompetencat e veta, pasi OE nuk ka përmbushur kërkesat e pikës 2.2.3 të kritereve të kualifikimit, pasi në katalogë nuk jepen qartë mallrat nëse janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara;
- KVO ka pranuar sqarime nga OE “E Th” SHPK lidhur me ofertën anomalisht të ulët, edhe pse bashkëlidhur përgjigjes gjendet një ofertë nga “K h ” e datës 17.03.2023 e vlefshme deri më datë 01.04.2023, në një kohë që tenderi është zhvilluar më datë 11.04.2023.
- KVO ka kualifikuar dhe vendosur në vend të parë OE “E Th” SHPK, në kushtet kur nuk gjenden në katalog “Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 315, me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë, si dhe katalogu për rakorderi nuk ka të përcaktuara standarde DIN EN 1610 ose SSH ekuivalent i këtij standardi;
- OE në vend të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit ka paraqitur Certifikatë Bilanci Fiskal, në kundërshtim me paragrafin e parë të pikës 2, të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, si dhe nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim;
- Në komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 43
- Faturat e mallrave nuk janë shoqëruar me certifikatën e prodhuesit, në kundërshtim me përcaktimet në Shtojca 5- Formulari i specifikimeve teknike të DT.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të përcaktohen saktë nevojat për mallra; në vlerësimin e drejtë të mostrave; shqyrtimin, vlerësimin dhe kualifikimin e OE që plotësojnë të gjitha kriteret e kualifikimit.

12.2 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe drejtori ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të marrin masat e nevojshme për përfshirjen e punonjësit me përgjegjësi materiale në komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave, si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave me dokumentacion e plotë që argumenton dhe justifikon kryerjen shërbimit të kontraktuar.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve”, me fond limit 3,904,860 lekë, zhvilluar më datë 07.02.2025, dhe zbatuar me kontratën me nr. 45/20, datë 10.03.2025 me kontraktorin “ A S G” SHPK, me vlerë 3,787,360 lekë me kohëzgjatje 30, u konstatua se:
- Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur sasitë për secilin lloj tubi, dhe elementi, por nuk janë argumentuar se nga ka lindur nevoja për këtë sasi, duke sjellë për pasojë mbingarkesën e stokut të mallrave dhe/ose prokurime të panevojshme, veprime jo në përputhje me pikën 2 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- Mungesa e gjurmës se auditimit, për mënyrën se si janë kërkuar dhe marrë ofertat në studimin e tregut, mungesa e specifikimeve teknike pasi janë hartuar më pas, si dhe mungesa e referimit në çmimet e kontratave të mëparshme nuk janë përputhje me pikën 1 të nenit 76 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, i ndryshuar.

- Mungesa e pasqyrimit të firmës prodhuese në mostrat e dorëzuara për dy artikuj PVC, për OE " A S G" SHPK, duhej të sillte automatikisht skualifikimin e tyre, pasi nuk plotësojnë specifikimet teknike, që çdo tub të ketë të shënuar në mënyrë permanente emrin e prodhuesit dhe klasën e tubit, si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është i shoqëruar me fotografi, si dhe as me procesverbalin e dorëzuesit nga personi i autorizuar i subjektit;
- OE i shpallur fitues " A S G" SHPK ka paraqitur katalogët HDPE Corugated OD Pipes të "P", në të cilët konstatohet se tre artikuj dhe elementë lidhës plastik (gominë) nuk mund të identifikohen në katalogë; Tubot HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 200 dhe HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m²) DN 250, me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë kanë devijime mbi përcaktimet e specifikimeve teknike.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)
13.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për përzgjedhjen dhe trajnimin e zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit, me qëllim që të respektohet radha e veprimtarisë dhe saktësia në llogaritjen e fondit limit dhe korrektesa në shqyrtimin e mostrave dhe vlerësimin e ofertave, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit: "*Riparim - shërbimi i automjeteve*", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 6,016,650 lekë, zhvilluar më datë 09.03.2023 dhe zbatuar me kontratën me nr100/23 prot., datë 23.03.2023 me vlerë 4,939,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F"; "*Riparim - shërbimi i automjeteve*", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 5,109,850 lekë, zhvilluar më datë 11.03.2024 dhe zbatuar me kontratën me nr. 119/23 prot., datë 26.03.2024, me vlerë 4,021,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F"; si dhe në procedurën e prokurimit "*Riparim - shërbimi i automjeteve*", Marrëveshje Kuadër, me fond limit 3,995,000 lekë, zhvilluar më datë 23.06.2025 dhe zbatuar me kontratën me nr.452/28 prot., datë 14.07.2025 me vlerë 3,281,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F" dhe me afat 12 muaj, u konstatua se:
- Në procedurën e prokurimit: në strukturën e posaçme për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, në njësinë e prokurimit dhe në strukturën e ndjekjes së zbatimit të kontratës është përfshirë Drejtori Ekonomik - Nëpunësi zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Në relacionin e llogaritjes së vlerës limit të kontratës, nuk rezulton të ketë të dhëna tekniko - ekonomike për secilin mjet që të bëhet përcaktimi i saktë i nevojave për riparime dhe shërbime periodike, referuar dokumentacionit teknik të mjetit, gjendjes së tij, riparimeve dhe shërbimeve të kryera më parë, vëllimit të punës së kryer vitin e mëparshëm etj., jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- Njësia e prokurimi në kërkesat teknike për kualifikim në dokumentet e tenderit nuk është përfshirë disponimi i një reparti gomist, megjithëse nga 11 instrumentet e kërkuar që duhet të ketë operatori ekonomik, 5 prej tyre kanë të bëjnë me gomat; si dhe është përfshirë kërkesa për punonjës të specializuar/të kualifikuar 1 një specialist motorist, i cili nuk përfshihet saktësisht ky emërtim në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me VKM nr. 514, datë 20.9.2017;
- OE i vetëm pjesëmarrës dhe i shpallur fitues "D G/B.M P.F" për personelin teknik të kualifikuar ka paraqitur certifikatë për dëshmi kualifikimi, dhe për gomist nuk ka paraqitur asnjë dokument për dëshmi; si dhe disponimin e mjeteve dhe pajisjeve nuk e ka shoqëruar me të dhëna konkrete

(faturë etj.) por vetëm me fotografi, është kualifikuar në kushtet e mos plotësimit të kritereve të kualifikimit, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar;
- Në situacionin përmbyllës në fund janë të shënuar lubrifikantë dhe antifriza për automjetet 5 zëra në sasi dhe çmim dhe paguar sipas kontratës në vlerën prej 290,500 lekë gjithsej, të pashoqëruara me dokument hyrje nga ana e SHRUK Korçë, në kundërshtim me pikën 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)
14.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën e këtij shërbimi duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masat e nevojshme që të mos përfshihen në strukturat e procedurave të prokurimit zyrtarë me konflikt të pozicionit; për llogaritjen reale të fondit limit bazuar në të dhënat tekniko – ekonomike për secilin mjet; argumentimin e specifikimeve teknike nga njësia e prokurimit; për kualifikimin e OE në plotësim të të gjitha kritereve të kualifikimit.
14.2 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe drejtori ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të marrin masat e nevojshme për marrjen në dorëzim të mallrave me dokumentacion e plotë që argumenton dhe justifikon kryerjen shërbimit të kontraktuar.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*", me fond limit 76,338,689.55 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.05.2024 me kohëzgjatje 8 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, u konstatua se:
- Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës në vendimin nr.1, nr. 246/53 prot., datë 11.07.2024, me propozimin për përsëritjen e procedurës, duke ri hedhur me të gjitha specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, ka tejkaluar kompetencat e veta, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar;
- KVO me vendimin nr. 3, nr. 246/59 prot., datë 19.08.2024 "Për zbatimin e vendimit të KPP nr.1015/2024", ka vendosur për s'kualifikimin e OE "E A" SHPK dhe OE "N" SHPK për mungesë të eksperiencave të ngjashme në zërin e pus-shpimit pa u bazuar në Vendimin e mësipërm të KPP, në një kohë që OE të sipërcituar kanë qenë kualifikuar më parë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të nenit 75 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "E A" SHPK, në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, pasi për "*Fabrikë asfalti, me vend-ndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*", me status "*në pronësi ose me qira*", ka paraqitur kontratën e furnizimit nr. 2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë "S" SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton. Po kështu, për "*Fabrikë betoni pajisur me leje mjedisore*" ka paraqitur kontratën e furnizimit me shoqërinë "Gj B" SHPK me adresë në Fier me nr.1220 repertori dhe nr. 392/1 koleksioni, datë 12.04.2022 me objekt furnizimi me beton. Në këto kushte, kur fabrika e asfaltit dhe fabrika e betonit nuk kanë status as në pronësi dhe as me qira, si dhe janë në distancë teknikisht të papranueshme, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar;
- KVO ka skualifikuar OE "R" SHPK, midis të tjerave, se periudha e vlefshmërisë së ofertës së paraqitur ishte 150 ditë, nga 180 ditë e kërkuar në DT dhe ka kualifikuar BOE "I" SHPK & "V

K" SHPK & "M G" SHPK dhe OE "N" SHPK formulari i sigurimit të ofertës të të cilëve ka qenë me afat150 ditë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos konfiskimin e sigurimin e ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK pasi është tërhequr nga procedura e prokurimit në vlerën 1,526,773.7 lekë.

15.2 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve me eksperiencë të përfshirë në procedurat e prokurimit me qëllim që të sigurohet shqyrtimi i drejtë i ankesave dhe zbatimi i drejtë i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik në plotësim të të gjitha kritereve të kualifikimit, duke siguruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave barazi në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq" me fond limit 79,975,219,87 lekë, zhvilluar më datë 10.02.2025, u konstatua se:

- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "E A" SHPK, në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, të pikës 2.3 – Kapaciteti teknik, të DT, pasi për "*Fabrikë asfalti, me vend-ndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti*", me status "*në pronësi ose me qira*", ka paraqitur kontratën e furnizimit nr. 2027 repertori, nr. 694/1 koleksioni, datë 30.04.2024 me shoqërinë "S" SHPK me adresë Fier me objekt furnizimin me asfaltobeton, pra nuk ka status as në pronësi dhe as me qira, si dhe nuk janë në distancë teknikisht të papranueshme, me pasojë mungesën e garantimit të cilësisë së materialit dhe parametrave teknologjik të tij. Gjithashtu, në 3 raste punonjësit nuk kanë pjesëmarrje të plotë në tre muajt e fundit, si dhe në 9 raste deklarimi nuk përputhet me kodin e listës së profesioneve në listë-pagesa. Për pasojë, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
- KVO ka s'kualifikuar BOE "N" SHPK & "M" SHPK, midis të tjerave, dhe për shkak të mospërputhjes së deklarimit për hidraulikë me listë - pagesat e sigurimeve shoqërore, si dhe OE "N" SHPK për të njëjtën arsye, ndërsa ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "E A" SHPK që paraqet të njëjtat mangësi në plotësimin e këtij kriteri. Pra KVO ka përdorur standarde vlerësimi të ndryshme, duke s'kualifikuar OE pjesëmarrës për të njëjtën mangësi në plotësimin e kritereve që është kualifikuar dhe shpallur fitues një OE tjetër;
- Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit të SHRUK Korçë, konstatohet se OE "E A" SHPK është afërsisht në gjysmën e afatit të zbatimit të një kontrate të tetorit 2024, dhe në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur të njëjtët inxhinier ndërtimi, hidroteknik, mekanik dhe gjeolog; 13 specialistë dhe 12 makineri - pajisje që ndërkohë kanë qenë të angazhuara në kontratë. Pra, ka mbivendosje të një pjese të kapaciteteve njerëzore dhe makineri-pajisjeve dhe nga ana e KVO nuk janë analizuar dhe vlerësuar kapacitetet reale të OE të shpallur fitues në funksion të realizimit të kontratës, duke mos përdorur mundësinë e përcaktuar në paragrafin e fundit të pikës 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 18.05.2021, i ndryshuar, për të kërkuar sqarime nga ofertuesit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të shqyrtojë, vlerësojë dhe kualifikojë OE në plotësim të të gjitha kritereve të kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe në situatën e përgjithshme kontraktuese të pjesëmarrësit të shpallur fitues.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë u konstatua se, regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) është bërë më datën 31.08.2022, pra me 2 muaj vonesë, në kundërshtim me nenin 22, pika 3 germa "b", pasi duhej bërë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por në çdo rast, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë, Ushtrimi efektiv i veprimtarisë ka nisur më 01.11.2022, pas kryerjes së regjistrimit në QKB, por pa marrë fuqinë ligjore Marrëveshja. Marrëveshja për krijimin e SHRUK Korçë nuk ka hyrë në fuqi, pasi nuk është marrë shprehja ligjore nga Prefekti.
- Marrëveshja për krijimin e SHRUK Korçë nuk ka hyrë në fuqi, pasi nuk është marrë shprehja ligjore nga Prefekti. SHRUK Korçë e krijuar sipas marrëveshjes së datës 28.06.2022 midis 5 bashkive (Korçë, Devoll, Ersekë, Maliq, Pustec) dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ekonomisë (MIE) nuk i ka plotësuar kriteret dhe detyrimet për të marrë shprehjen ligjore nga Prefekti në kundërshtim me nenin 10 "Hyrja në fuqi" lidhja 1 të Marrëveshjes së datës 28.06.2022.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 29 - 37 të Raportit të Auditimit)
17.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marri masa që të gjitha ndryshimet të bëhen në afat në Qendrën Kombëtare të Biznesi sipas procedurave ligjore, në mënyrë që të shmangen efektet financiare.
17.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marri masa dhe të ndjekë procedurat për marrjen dhe administrimin e shprehjes ligjore të Prefektit dhe marrjen e licencave, në përputhje me kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së SHRUK Korçë u konstatua se, planifikohen dhe kryhen shpenzime në blerjen e reagentëve të analizave për laboratorët e ujit të pijshëm, të cilat nuk janë të gjurmuara dhe pa vlerësim konformiteti. Kjo, pasi SHRUK Korçë nuk ka marrë akreditim për laboratorët e ujit ku pajisjet laboratorike për analizat e ujit të pijshëm në SHRUK janë të pa kalibruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo ndonjë subjekt i certifikuar nga DPM, në kundërshtim me ligjin nr.126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë" i ndryshuar neni 2, neni 3, neni 4 dhe nenin 17 për instrumentet bazë ligjërisht të kontrolluara, pasi rezultatet e analizave mbahen manualisht në regjistër të shkruar Gjithashtu fondet që prokurohen për reagentë nuk bazohen në nevojat reale pasi konsumi është i pamatshëm, dhe nuk është planifikuar shpenzimi për shërbimin e kalibrimit të pajisjeve. Kostot e trajnimit të stafit për certifikimin nuk janë planifikuar. Rezultatet nuk janë të besueshme lidhur me standard kombëtare apo ndërkombëtare të analizave për cilësinë e ujit të pijshëm.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 29 - 37 të Raportit të Auditimit)
18.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për fillimin e procedurave për akreditimin e laboratorëve të ujit të pijshëm dhe sigurimin e vlerësimit të konformitetit të analizave të kryera.
18.2 Rekomandimi: Drejtoria ekonomike e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për planifikimin e shpenzimeve për funksionimin e laboratorit, duke parashikuar edhe

shpenzimet për kalibrimin periodik të pajisjeve laboratorike, për të garantuar gjurmueshmërinë, integritetin, ruajtjen dhe besueshmërinë e të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së hartimit të programit ekonomik u konstatua se, nuk është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për vitin 2023 dhe për të gjithë periudhën objekt auditimi nga Ministria e Ekonomisë.
Programi ekonomiko financiar për vitin 2023 nuk është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë në kundërshtim me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të lidhjes 2 Për sa më sipër të gjitha shpenzimet quhen të paautorizuara për likuidim.
Konstatohet se ky program ekonomik nuk ka miratim as nga Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës dhe është në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli II, përkatësisht në pikat 2 pasi nuk është mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, në strategjitë sektoriale përkatëse, si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Gjatë vitit 2024 konstatohet se vendimet për investime nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Në buxhetin e vitit 2025 në kuadër të zbatimit të projekteve me fondet e Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit (IPA) nuk është marr vendimi që dy projektet nuk janë miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk është kërkuar ndryshim i programit ekonomik për buxhetin vjetor 2025 ashtu edhe për fondet e investimeve në buxhetin afatmesëm 2025-2027 .Këto ndryshime nuk janë bërë as në dokumentin e Plan biznesit për periudhën 2024-2028.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 29 - 37 të Raportit të Auditimit)
19.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për respektimin e afateve për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik dhe të ndryshimeve në strukturat përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore dhe statutore, duke reflektuar në mënyrë të plotë vendimet për investime, projektet e financuara me fonde të Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit, si dhe çdo ndryshim në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm (2025–2027). Paralelisht, të rishikohet dhe harmonizohet Plani i Biznesit 2024 - 2028 me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, me qëllim shmangien e kryerjes së shpenzimeve të paautorizuara dhe forcimin e disiplinës financiare dhe të qeverisjes së shoqërisë.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë ekonomiko - financiare të SHRUK Korçë u konstatua se për periudhën 2023 - 2025, ka lidhur kontrata me agjentë tatimorë për mbledhjen e të ardhurave për faturimet ndaj abonentëve familjarë dhe bizneseve *pa vlera* dhe nuk janë zhvilluar procedura prokurimi, pa i parashikuar ato në programet ekonomike apo planet strategjike të shoqërisë. Për këto kontrata nuk është hartuar relacion teknik, analizë risku apo vlerësim i ndikimit financiar, ndërsa kontratat janë zbatuar me efekt prapaveprues dhe pa parashikuar penalitete për vonesa në arkëtimet me SHRUK Korçë kur me Postën Shqiptare SHA janë të parashikuara. Të ardhurat e realizuara nga agjentët kanë shënuar një rënie të konsiderueshme në vitin 2025, pas një rritjeje nga **279.3 milionë lekë** në vitin 2023 në **311.7 milionë lekë** në vitin 2024. Ato janë ulur në **258.5 milionë lekë** në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, rënia është **53.2 milionë lekë** ose **17.1%**. Regresi i të ardhurave nga agjentët (**53.2 milionë lekë**) është më i lartë se kursimi i arritur nga reduktimi i kostove operative (**45.4 milionë lekë**) me rreth **7.8 milionë lekë**.

Kjo rënie në vitin 2025 konstatohet ndërkohë që të ardhurat totale të kompanisë janë rritur me rreth **82.3 milionë lekë**. Si pasojë, pesha e të ardhurave të realizuara nga agjentët kundrejt totalit të të të ardhurave ka një rënie nga **62.3%** në **44.4%**, duke humbur rreth **18 pikë të %**.
Regresi i të ardhurave të realizuara nga agjentët në vitin 2025, ka qenë më i lartë, sesa efekti pozitiv i kursimit nga kostot operative kundrejt planit. Mungon akti i brendshëm që justifikon nevojën për marrjen e shërbimit nga këto palë të treta, si dhe nuk ka miratim nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme, në kundërshtim me nenin 81 të Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008. dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligji nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, duke rritur riskun financiar dhe duke cenuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në administrimin e të ardhurave.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 29 - 37 të Raportit të Auditimit)
20.1 Rekomandimi Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrin masa për të rishikuar dhe formalizuar procesin e kontraktimit të shërbimeve për mbledhjen e të ardhurave, duke siguruar që çdo nevojë për angazhimin e agjentëve tatimorë të mbështetet me analizë të dokumentuar të kostos dhe përfitimit, të vlerësimit të riskut dhe të ndikimit financiar vetëm kur këto shërbime konsiderohen të nevojshme, në mënyrë që të planifikohen në programet ekonomike dhe dokumentet strategjike të shoqërisë, Nga organet kompetente drejtuese të sigurohet transparencë, konkurrencë në mënyrë që kontratat të përmbajnë tregues të matshëm performance, afate të qarta arkëtimi dhe penalitete për vonesat duke përcaktuar monitorim periodik për efektivitetin e tyre, me qëllim që përfitimet ekonomike të jenë më të larta se kostot dhe të shmanget ndikimi negativ në nivelin e arkëtimeve.Çdo kontraktim i ardhshëm të paraprihet nga një akt i brendshëm (urdhër/vendim) që justifikon nevojën për marrjen e shërbimit nga palë të treta, Të sigurohet përfshirja e kësaj nevoje në programet ekonomiko-financiare dhe me miratimin paraprak nga organet drejtuese përkatëse (Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme), sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë ekonomiko - financiare të SHRUK Korçë u konstatua se, për të gjitha pajisjet nën presion dhe për menaxhimin e karburantit ka mungesa të verifikimeve fillestare dhe periodike për përmbushjen e kritereve të konformitetit, e cila realizohet nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).Gjithashtu për pajisjet matëse nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për pompën e naftës nuk ka gjurmë dokumentare që të jetë verifikuar dhe kalibruar periodikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si autoriteti kompetent për kontrollin ligjor të mjeteve matëse. Kjo mënyrë e menaxhimit dhe e kontrollit sjell për pasojë një rritje të konsiderueshme të riskut, cenim të parimit të përgjegjshmërisë dhe transparencës së menaxhimit të fondeve publike. Për shkak të mungesës së gjurmueshmërisë së auditimit, veprimet dhe mosveprimet tuaja për administrimin e karburantit dhe të pajisjeve nën presion, janë në kundërshtim me ligjin nr. 32, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" i ndryshuar , të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë" i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010"Për menaxhimin e fondeve dhe kontrollin", i ndryshuar përkatësisht neni 2, neni 4 nenin 12 pika 3, germa a) për të cilat nuk janë *respektuar parimet e ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit të fondeve publike.*
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 54 - 66 të Raportit të Auditimit)
21.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për kryerjen e verifikimeve fillestare dhe periodike të të gjitha pajisjeve nën presion pranë

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, duke siguruar dokumentimin dhe arkivimin e plotë të certifikatave të konformitetit dhe akteve të kontrollit teknik.

21.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të hartojë dhe miratojë procedura të brendshme të formalizuara për administrimin e karburantit dhe monitorimin e pajisjeve nën presion, duke garantuar gjurmueshmëri të plotë auditimi, ndarje të qartë përgjegjësish dhe mekanizma kontrolli të brendshëm, në mënyrë që të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë në administrimin e aseteve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi veprimtarisë financiare, u konstatua se SHRUK Korçë për dy kreditë e marra nga BEI në vitin 2008 dhe nga KfŴ në vitin 2019 me vlerë totale 29,500,000 euro, nuk ka shlyer asnjë këst nga principali dhe nga interesat. Sipas komunikimeve shkresore të SHRUK Korçë me Ministrinë e Financave rezulton se për këto dy kredi deri në datën 30.09.2025 janë akumuluar dhe 4,469,365 euro interesa të papaguara, të cilat bien në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes midis tyre dhe kanë rënduar buxhetin e shtetit nga shlyerja e kryer nga Ministria e Financave.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë së bashku me Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për të hartuar një plan veprimi për mundësitë paguese të shoqërisë për shlyerjen e këtyre dy kredive dhe më pas të bëhet një marrëveshje me Ministrinë e Financave për caktimin e kësteve të favorshme të shlyerjes së pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi debitorëve u konstatua se, detyrimet e klientëve (debitorëve) ndaj SHRUK Korçë në datën 30.09.2025 paraqiten në vlerë 422,069,532 lekë, i ndarë në 3 kategori: familjarë me vlerë 368,596,417 lekë, biznese me vlerë 28,068,937 lekë dhe institucione me vlerë 25,404,179 lekë. Gjithashtu, nga periudha fillestare e auditimit e deri në periudhën përmbyllëse të tij detyrimet e debitorëve janë rritur me një vlerë prej 39,549,757 lekë ose me 9 %, gjë që tregon për punën e pamjaftueshme të strukturave përkatëse të shoqërisë në këtë drejtim. Për sa më sipër është në mospërputhje me ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", Neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" dhe neni 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues", si dhe Kodin Civil i Republikës të Shqipërisë, nenet 450, 455 dhe 481.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë së bashku me Drejtorinë Ekonomike të marrin masa që përveç mënyrës së ndërprerjes të furnizimit me ujë të pijshëm që aplikohet për klientët debitorë, të hartojnë një plan konkret për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, duke ju dhënë debitorëve mundësinë e pagesës me këste, si dhe të marrin masa të tjera administrative dhe ligjore deri në shkallët e gjyqësorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i furnitorëve (kreditorëve) u konstatua se, në datën 30.09.2025 rezultojnë 26 subjekte me vlerë totale 134,962,273 lekë që i ka kaluar afati i pagesës. Gjithashtu, konstatohet se janë bërë shkëmbime mallrash midis SHRUK Korçës dhe UK

Pogradecit sipas marrëveshjes midis tyre dhe sipas faturave tatimore me vlerë 1,314,000 lekë, por nuk kanë bërë cedimin e llogarive kontabël.
Konstatohet se, ish-njësitë e ujësjellësve në momentin e transferimit në SHRUK Korçë, kanë sjellë dhe detyrimet e furnitorëve të pa likuiduar nga ana e tyre të cilët janë në shumën 129,490,994 lekë: detyrime të ish-njësisë Maliq 124,232,840 lekë, nga e cila 123,712,840 lekë është detyrim për OSHEE; të ish-njësisë Pustec në vlerën 3,903,477 lekë dhe detyrimet e furnitorëve të ish-njësisë Korçë në vlerë 40,677 lekë.
Sipas rakordimit të mëvonshëm që Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Korçë ka bërë me OSHEE-në për detyrimin e ish-njësisë Maliq rezulton se detyrimi real është 113,360,845 lekë dhe jo 123,712,840 lekë sa është transferuar dhe kjo gjë jep një pasqyrim jo të drejtë të pasqyrave financiare. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Kreu III "Përbërësit e pasqyrave financiare", neni 11 "Qëllimi i pasqyrave financiare" pika 1 dhe ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 1 "Objekti i ligjit", neni 2 "Qëllimi i ligjit", neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" dhe neni 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
24.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë së bashku me Drejtorin Ekonomik të marrin masa për të shlyer detyrimet e prapambetura të furnitorëve, midis të tjerave edhe nëpërmjet një akt-marrëveshjeje me OSHE-në për likuidimin me këste. Drejtori Ekonomik të bëjë cedimin (klient/furnitor) sipas marrëveshjes së shkëmbimit të mallrave që ka bërë me Ujësjellës Pogradecin, si dhe të marrë masa që të sistemojë pasqyrat financiare për detyrimin e OSHEE-së të transferuar nga ish-njësia e Ujësjellësit Maliq në mënyrë që ato të pasqyrojnë gjendjen financiare reale të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi veprimtarisë ekonomiko-financiare të SHRUK Korçë u konstatua se, Agjencia e Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) ka dhënë një subvencion me vlerë 30,000,000 lekë për "dhënie ndihme me rastin e krijimit të Shoqërive Rajonale të Ujësjellësve" përdorimi i të cilit i referohet zbatimit të Udhëzimit të MIE nr.20, datë 14.10.2022. Sipas udhëzimit ka prioritet likuidimi i detyrimeve të prapambetura të ish-njësive të ujësjellësve (paga, taksa, energji elektrike) dhe nëse shoqëria nuk ka detyrime të tilla atëherë mund ta përdorë subvencionin për investime. Nga ish-njësia e Ujësjellësit Maliq janë transferuar 29 kontrata me OSHEE-në me detyrim total në vlerë 113,360,845 lekë dhe konstatohet se SHRUK Korçë e ka përdorur subvencionin për investime, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 20 të MIE datë 14.10.2022, pikat 3 dhe 4 germa "d".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
25.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për përdorimin e subvencionit për investime, në kushtet e detyrimeve për OSHE për konsumin e energjisë elektrike, si dhe Administratori së bashku me Drejtorin Ekonomik të marrin masa që të mos lejojnë në të ardhmen përdorimin e subvencionit në kundërshtim me udhëzimin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi librave të shitjes dhe atyre të blerjeve u konstatua se, SHRUK Korçë është debitore për TVSH-në në vlerën 332,533 lekë, por nga auditimi i faqes së tatimeve (e-filling) nuk rezulton të ketë detyrime të prapambetura për TVSH-në.
- Konstatohet se kur është bërë transferimi i ish-njësive të ujësjellësve në SHRUK Korçë nuk është bërë rakordim me Drejtorinë e Tatimeve Korçë për TVSH-në, e cila rezulton me diferencë nga Ujësjellës Kanalizime Kolonjë, pasi në pasqyrat financiare të vitit 2023 është transferuar vlera kreditore 31,656,888 lekë, ndërsa gjendja kreditore në sistemin e tatimeve rezulton 33,975,147 lekë. Pra në pasqyrat financiare të vitit 2023 të SHRUK Korçë është transferuar si gjendje kreditore TVSH-ja në vlerë 2,318,259 lekë më pak se sa vlera reale në sistemin e tatimeve, e cila jep një pasqyrim jo të drejtë të pozicionit financiar të shoqërisë.
- Konstatohet se të gjitha kështet e likuidimit të TVSH-së janë bërë në mënyrën të çrregullt dhe jo sipas datave të caktuara, është bërë parapagim pa ndonjë arsye ose marrëveshje përkatëse me Drejtorinë e Tatimeve Korçë përpara se të bëhet deklarimi i periudhës tatimore. Për sa më lart është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Kreu III "Përbërësit e pasqyrave financiare" neni 11 "Qëllimi i pasqyrave financiare", pika 1.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
26.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për rakordimin me Drejtorinë e Tatimeve Korçë në mënyrë që llogaritë e kontabilitetit të brendshëm të jenë të barabarta me ato të sistemit të tatimeve (e-filling) dhe pas rakordimit të bëhet dhe sistemimi i pasqyrave financiare, duke ndaluar veprimin e parapagimit të TVSH-së, por pagesa e saj të bëhet pasi të jenë deklaruar FDP-të përkatëse.

Menjëherë dhe në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të inventarizimit dhe nga verifikimi fizik me përzgjedhje, në magazinën e materialeve u konstatuan 32 lloje materialesh me qarkullim të ngadaltë dhe me vlerë 4,009,494 lekë të cilat datojnë që në vitet 2002-2003 kur është investuar për ujësjellësin e ri të qytetit të Korçës.
- Nga auditimi konstatohet se komisioni i inventarizimit i vitit 2023 dhe ai i vitit 2024 nuk kanë mbajtur një raport mbi gjendjen e aktiveve ku të përshkruhet verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve, një raport lidhur me inventarizimin fizik të tyre dhe kushtet e ruajtjes.
- Konstatohet se komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit ka asgjësuar me shkatërrim fizik aktive "Pajisje zyre dhe informatike" dhe aktivet si "Vegla pune, makineri dhe pajisje" të cilat janë demontuar, por vijojnë të jenë ende gjendje. Për sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2018 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pika 85, germa "c"; pika 107, 108 dhe 109, si dhe VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" Kreu III "Grumbullimi i diferencuar".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
27.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për artikuj të cilët janë stok në magazinë prej shumë vitesh, që të mos e humbin vlerën e funksionalitetit të tyre, të shiten ose të bëhen shkëmbime me shoqëritë e ujësjellësve të tjerë. Komisionet përkatëse të përfshirë në procesin e inventarizimit të raportojnë mbi gjendjen fizike dhe për kushtet e ruajtjes së tyre, të respektojnë kushtet e asgjësimit dhe/ose klasifikimin e tyre si aktive jashtë funksionit dhe që janë të riciklueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë disponon 176 asete të pa luajtshme. Konstatohet se nga totali i aseteve, vetëm 5 prej tyre në qytetin e Korçës janë të pajisura me certifikata pronësie, por në emrin e ish-njësisë Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe 25 asete të tjera në rrethin e Devollit janë të pajisura me certifikata pronësie në emrin e Bashkisë, pjesa tjetër prej 146 asetesh nuk janë të pajisura me certifikata pronësie dhe nuk janë bërë aplikime nga SHRUK Korçë për regjistrimin e tyre.
Gjithashtu, konstatohet se 32 asete në rrethin e Korçës dhe 31 në rrethin e Kolonjës janë të pa kontabilizuara në pasqyrat financiare në llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione".
Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur", ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Kreu III, Neni 11, pika 1.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
28.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Nëpunësi zbatues të marrin të gjitha masat e nevojshme për aplikimin për regjistrim në Agjencia Shtetërore e Kadastrës në emër të SHRUK Korçë të 176 aseteve të llojit ndërtesa, si zyra, stacione pompimi, toka etj., me qëllim pajisjen e këtyre aseteve me certifikatë pronësie. Gjithashtu, të merren masa që të inventarizohen dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare 63 asetet që nuk janë në librat e kontabilitetit.

Brenda vitit 2026

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rregullores për ujin e pijshëm u konstatua se:
- SHRUK Korçë nuk ka kryer analiza pranë Inspektoratit të Shërbimit Shëndetësor përpara fillimit të investimit në veprat e reja që ka investuar.
- Për përdorimin e Hipokloritit të Natriumi (klori), të dhënat nuk regjistrohen në një regjistër ku të dokumentohet sasia e përdorur për dezinfektim, orari i injektimit, punonjësi që ka kryer procesin dhe shënime të tjera mbi problematikat e ndryshme të shfaqura gjatë turnit në këto vende.
- Kampionet e ujit për të analizuar cilësinë e tij në ujësjellësit e fshatrave merren në mënyrë të çrregullt, si dhe analizat mbi kampionet e marra bëhen nga laboratorët e brendshëm të SHRUK Korçë, të cilët janë të pa akreditуar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
- SHRUK Korçë nuk ka komunikim të rregullt me strukturën rajonale të shëndetit publik, si dhe nuk ka një aktmarrëveshje midis tyre, me qëllim bashkërendimin e punës për marrjen dhe kryerjen e analizave të cilësisë së ujit.
- Nga analizimi i 7 procedurave të defekteve me përshkrimin "Defekt në linjë" u konstatua se pas riparimit të defekteve në tubacionet e furnizimit me ujë të pijshëm nuk është kryer procesi i dezinfektimit.
- Nga auditimi i dëshmive të gjendjes shëndetësore të punonjësve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me sistemet e ujit të pijshëm (rezervuarët, depot, puset etj.), u audituan 8 raste dhe rezulton se 7 punonjësve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë.
Për sa më lart është në kundërshtim me nenet nr. 15, 16, 17 dhe 20, Shtojcën nr. X "Mirëmbajtja e veprave të ujit të pijshëm" të VKM nr.379, datë 25.05.2016 "Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.8, faqe 155 - 159 të Raportit të Auditimit)
29.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të sigurojë akreditimin e laboratorëve, si

dhe të marrë masa për të kryer analiza për projektet e investimeve; dokumentimin e përdorimit të klorit, të merren dhe analizohen në mënyrë të rregullt kampionet e ujit të pijshëm, komunikimin dhe hartimin e një akt marrëveshje me strukturën rajonale të shëndetit publik, duke ripërcaktuar vendet e marrjes së kampioneve të ujit të pijshëm, kryerjen e dezinfektimit pas riparimit të defekteve, si dhe pajisjen me dëshmitë shëndetësore të të gjithë punonjëseve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 615 "Mirëmbajtje dhe riparime" në Pasqyrat e Performancës të viteve 2023/2024 u konstatua se, vlera 2,726,900 lekë (vlerë neto) është investim për mjetet e transportit dhe jo shpenzim mirëmbajtje siç është paraqitur në pasqyrat financiare, në mos përputhje me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Kreu III, neni 11, pika 1, neni 51, pika nr.10. Pra kjo vlerë për të dy vitet e raportimit ka ndryshuar rezultatet, duk rritur shpenzimet dhe ulur fitimin para tatimit, me pasojë për buxhetin e shtetit në mungesën e të ardhurave nga "Tatimi mbi fitimin" në vlerën 409,035 lekë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit
30.1 Rekomandimi: Nëpunësi zbatues i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa që të bëjë ndryshimet në pasqyrat financiare për vitin 2023 dhe vitin 2024 dhe më pas të ndryshojë deklaratat e periudhave tatimore 23-A dhe 24-A në sistemin e tatimeve (e-filling).

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen teknike të zbatimit, mbi hartimin e projektit të zbatimit, përkatësisht:
- "*Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll*",
- "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë",
- "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujërat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan",
u konstatua se, nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimit në zyrat e SHRUK Korçë, disa prej inxhinierëve të SHRUK Korçë, pjesë e grupit të punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk janë pajisur me licencën e projektimit. Miratimi i projektit të zbatimit nga Titullari i SHRUK Korçë hartuar nga inxhinier pa licencën e projektimit, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", pasi këto objekte ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
31.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa që në të ardhmen projektet e zbatimit të hartohen nga inxhinierë të pajisur me licencën përkatëse për projektim ose, në mungesë të tyre, të realizohen nga shoqëri projektuese të licencuara, me qëllim garantimin e cilësisë së projekteve dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe destinacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, për periudhën 01.01.2023–26.02.2025 SHRUK Korçë ka funksionuar pa Rregullore të Brendshme, në kundërshtim me nenin 20 pika 2 germa (c) të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin

financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Gjithashtu, për periudhën 01.01.2023–15.12.2023 është konstatuar mungesa e Kodit të Etikës, në kundërshtim me nenin 20 pika 2 germa (a) të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.
Për vitin 2023 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) duke sjellë funksionim jo në përputhje me nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.
Për vitet 2024 dhe 2025 janë zhvilluar 3 mbledhje të GMS, ku janë mbajtur minuta takimi dhe listë prezencë.
Konstatohet se GMS nuk është mbledhur minimalisht 4 herë në vit dhe nuk ka zhvilluar takim për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 10296/2010, i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, pika 2.2.4, nën pikat 1-5.
Për vitin 2023 dhe 2024 SHRUK Korçë nuk ka ngritur Grupin për Menaxhimin e Risqeve (GMR) veprim në mospërputhje me nenin 21 të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, pika 3, nën pikat 1-3.
Për vitin 2025 për GRM, nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit. Për vitin 2025 janë zhvilluar vetëm 2 takime, në mospërputhje me udhëzimin nr. 16, datë 31.12.2024 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Gjithashtu në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, duke kufizuar funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.7, faqe 147 -155 të Raportit të Auditimit).
32.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për funksionimin e plotë të Grupit të Menaxhimit Strategjik, duke u mbledhur minimalisht 4 herë në vit dhe duke mbajtur raporte periodike mbi mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe, mbi këtë bazë, të miratohet dhe zbatohet një plan menaxhimi për veprime korrigjuese.
32.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat e nevojshme për funksionimin e rregullt të Grupit për Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut, si dhe titullari i institucionit të përfshijë në rregulloren e brendshme të institucionit detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut duke ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e auditit të brendshëm u konstatua se, Këshilli Mbikëqyrës i SHRUK Korçë, nuk ka ngritur Komitetin e Auditimit të Brendshëm, në mospërputhje me nenin 13 të ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar.
Për vitin 2023 dhe 2025 planet vjetore dhe strategjike nuk janë miratuar dhe dërguar në kohë në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm, në mospërputhje me Kapitullin 3 pika 3.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
Organizimi i auditit të brendshëm vetëm me një punonjës është në mospërputhje me nenin 3 të VKM nr. 83,datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të

Brendshëm në sektorin publik". Mos funksionimi i NjAB me numrin minimal të punonjësve sipas vendimit ka sjellë që nga auditimi i 5 dosjeve të auditimit që ka realizuar Auditi i Brendshëm u konstatua se autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit të auditimit është përpiluar nga administratori i shoqërisë kur kjo është detyrë e drejtuesit të NjAB, veprim ky në mospërputhje me pikën 4.1.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.7, faqe 147 - 155 të Raportit të Auditimit).
33.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat për ngritjen e menjëhershme të Komitetit të Auditit të Brendshëm, si një organ monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.
33.2 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masat për ngritjen e strukturës të Auditit të Brendshëm me minimumi 3 punonjës dhe funksionimin e saj si një strukturë e pavarur nga administratori i shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi bilancin e ujit të pijshëm u konstatua se, SHRUK Korçë nuk ka bërë analiza dhe nuk ka hartuar plane masash për parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme të ujit.
SHRUK Korçë nuk ka bërë bilancin e ujit një herë në muaj sipas Vendimit nr. 46, datë 27.12.2013 "Për miratimin e bilancit të ujit", për të identifikuar dhe përmirësuar situatën me humbjet.
Taks Forca e parashikuar në organigramën e miratuar me vendimin nr. 2, datë 11.04.2023, e përbërë nga një përgjegjës sektori dhe 3 punonjës, nuk është plotësuar me personelin përkatës dhe për pasojë nuk ka funksionuar asnjëherë, duke ndikuar negativisht në parandalimin e humbjeve të dukshme të ujit të pijshëm.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.9, faqe 159 - 168 të Raportit të Auditimit).
34.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Departamenti Teknik të marrin masat për të bërë bilancet mujore të ujit dhe analiza duke pasur në fokus parandalimin dhe uljen e humbjeve reale dhe të dukshme.
34.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në Task Forcë dhe vënien e saj në funksion për kryerjen e kontrolleve dhe parandalimin e rasteve që shkaktojnë humbje të dukshme të ujit, duke pasur në fokus subjektet private dhe zonat industriale si subjekte me risk më të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 98-102, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 93, nga Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimit e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,563,958 lekë pa TVSH,** sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Ndërtim Ujësjellësi për fshatin Poloskë dhe Kuç, Bashkia Devoll*" me nr. 247/33, datë 09.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "N" SHPK Korçë me vlerë të objektit 80,443.843.20 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Struktura monolite betoni me çakëll C 30/37; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama; Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm; Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **337,110 lekë** pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **337,110 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "N" SHPK për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 247/33, datë 09.07.2024.

Brenda muajit tetor 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*" me nr. 246/87, datë 16.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "E A" SHPK Tiranë, me vlerë të objektit 70,982,706.40 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj nga data e nesërme e nënshkrimit të kontratës, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve: "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama; Ndërtim puseta betoni h=2.5-3 m, D=1 m + kapak gize; Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave 4 cm, me makineri", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **440,410 lekë** pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **440,410 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "E A" SHPK për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 246/87, datë 16.10.2024 me objekt "*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*".

Brenda muajit tetor 2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujrat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan"* me nr. 94/30., datë 26.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "N" SHPK Shkodër, me vlerë të objektit 20,559,687.75 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 140 ditë

kalendarike, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Shtresë rëre poshtë tubit dhe mbulimi i tubit me rërë (deri 20 cm mbi tub); Shtresë çakulli gurore 10, 15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri; Transport dheu me auto deri 5.0 km", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **127,664** lekë pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **127,664 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "N" SHPK për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 94/30., datë 26.04.2023 me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për ujërat e përdorura në fshatin Turan dhe Melçan*".

Brenda muajit tetor 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit me objekt: "*Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)*" me nr. 61/24, datë 25.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M G" SHPK Korçë, me vlerë 31,164,000 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 70 (shtatëdhjetë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan zëri shërbimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e shërbimeve "Larje pusi me ajër dhe solucion; Testim pusi", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **48,000 lekë** pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **48,000 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "M G" SHPK për shërbime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 61/24, datë 25.04.2023 me objekt "*Furnizim dhe instalim pompash dhe pajisjesh elektro-mekanike, në stacionet e fshatrave Vreshtas, Velitërnë, Kishnik (Podgorie), Shëngjergj, Plasë, si dhe në stacionet rajonale Plasë (Nj. A Pojan) dhe Bulgarec (Nj.A Libonik)*".

Brenda muajit tetor 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së shërbimit + mallra me objekt: "Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë" me nr. 1/17 prot., datë 24.02.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë" dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M G" SHPK, Korçë me vlerë të objektit 67,066,560 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 10 (dhjetë) muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, rezultuan zëra pune shërbimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar, konkretisht për: "Larja e pusit me ajër dhe solucion; Testim pusi", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e SHRUK Korçë, në vlerën **84,000 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme

janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe, kontratën e sipërmarrjes të sipërcituar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **84,000 lekë pa TVSH** pasqyruar padrejtësisht në situacionin përfundimtar nga shoqëria "M G" SHPK për shërbime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 1/17 prot., datë 24.02.2025 me objekt "Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë".

Brenda muajit tetor 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", me fond limit 76,338,689.55 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.05.2024 konstatohet se, KVO me Vendimin nr.2, datë 10.06.2024 për s'kualifikimin e BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK dhe rivlerësim të procedurës, ka vendosur s'kualifikimin e BOE-s së mësipërme dhe në pikën 3 konfiskimin e sigurimit të ofertës. Gjithashtu, në dosje ndodhet shkresa nr.246/40 prot., datë 10.06.2024, drejtuar kompanisë së sigurimeve, në të cilën kërkohet konfiskimi i sigurimit të ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK në vlerën 1,526,773.7 lekë, bashkëlidhur së cilës janë kërkesa për tërheqje e BOE-s dhe Formulari i sigurimit të ofertës me nr.240602074, datë 10.05.2024. Sipas Drejtorit ekonomik të SHRUK Korçë, nuk ka të ardhura hyrje nga kompanitë e sigurimit deri në periudhën aktuale të mbylljes së auditimit. Pra Autoriteti Kontraktor të SHRUK Korçë nuk ka konfiskuar/arkëtuar vlerën e sigurimit të ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK **në shumën 1,526,773.7 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3/a e nenit 83 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, për më tepër që ka kaluar afati 180 ditë i vlefshmërisë së kësaj oferte që ka qenë data 09.11.2024.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës së ofertës së konfiskuar prej **1,526,773.7 lekë**.

Brenda gjashtëmujorit të dytë 2026

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr.100/23 prot., datë 23.03.2023 me vlerë 4,939,800 lekë me kontraktorin "D G/B.M P.F" me afat 12 muaj; kontratën me nr. 119/23 prot., datë 26.03.2024, me vlerë 4,021,800 lekë dhe kontratës me nr.452/28 prot., datë 14.07.2025 me vlerë 3,281,800 lekë, është analizuar kryerja e shërbimeve periodike të mjeteve dhe automjeteve në plotësim të kritereve teknike të funksionimit të këtyre shërbimeve. U konstatua se gjatë periudhës së zbatimit të kontratave asnjë prej automjeteve dhe mjeteve të punës objekt kontrate nuk ka plotësuar kriteret teknike lidhur me km e përshkuara dhe/ose orët e punës të punuara për kryerjen shërbimeve periodike vjetore dy herë brenda vitit (ndërrim vaji; ndërrim filtra vaji, nafte, ajri, kondicioneri) dhe/ose shpenzime sasi vaji mbi kapacitetin teknik të mjetit, duke sjellë për pasojë efekte negative në administrimin e fondeve të shoqërisë pa eficiencë, ekonomicitet

dhe efektivitet përkatësisht në vlerat 638,200 lekë, 326,500 lekë dhe 494,870 lekë, gjithsej për periudhën 1.01.2023 deri më 30.09.2025 **shuma prej 1,459,570 lekë.**
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën në lidhje me procedurën e kryerjes së këtij shërbimi dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masat e nevojshme që të sigurohet llogaritja reale e fondit limit bazuar në të dhënat tekniko – ekonomike për secilin mjet objekt i procedurës së prokurimit, me qëllim parandalimin rasteve të tilla në të ardhmen, duke rritur eficiencën, ekonomicitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq*" me fond limit 79,975,219,87 lekë, zhvilluar më datë 10.02.2025, u konstatua se, KVO ka s'kualifikuar BOE "V -C" SHPK dhe "A A" SHPK me ofertë 50,197,330 lekë, për mungesë të punëve të ngjashme për ndërtim depo V= 150 m³.
Grupi i auditimit shqyrtoi zërat e punimeve për ndërtim depo V= 150 m³, që sipas Shtojcës 10 të DT përbëhet nga 17 zëra punimesh që kanë të bëjnë me gërmime, shtresë çakëlli, struktura betoni, hekur betoni etj. Sipas dokumentacionit të BOE të mësipërm të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet se OE "V -C" SHPK, për punë të ngjashme për ndërtim depo ka hedhur tre kontrata: me nr. 6019 prot., datë 10.11.2023 me objekt: "Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", me vlerë 27,655,518 lekë me TVSH, që sipas situacionit përfundimtar, zërat e punimeve kanë të bëjnë me punime prishje, murature, hidroizolim çatie, suvatimi, shtresa dhe elektrike; kontrata e datës 15.05.2023 me objekt "Godinë banimi 7 kate dhe një kat nën tokë" me vlerë 59,818,735 lekë, që sipas situacionit përfundimtar punimet kanë të bëjnë me punime prishjeje, dheu, betoni dhe betonarme, shtresa, suvatime, hidroizolime, sistemime, furnizimi me ujë etj.; kontrata me nr.6981/2 prot., datë 19.09.2023 me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Vithkuq" me vlerë 3,473,369 lekë, punime qe sipas situacionit përfundimtar kanë të bëjnë me punime gërmimi, betoni dhe betonarme, trotuare, sistemime etj. Nga sa më sipër konstatohet se OE "V -C" SHPK e ka plotësuar kriterin e kualifikimit me kontrata për punë të ngjashme për ndërtim depo V= 150 m³, pasi ka paraqitur tre kontrata me natyrë teknike të krahasueshme me objektin e prokurimit; të cilat kërkojnë teknologji, procese pune dhe specializime të ngjashme; paraqesin kompleksitet teknik të njëjtë ose të afërt si dhe janë realizuar në kushte funksionale të ngjashme. Për më tepër, që "Punimet e ngjashme" nuk mund të jenë identike, por të krahasueshme; kriteri lidhet drejtpërdrejt me aftësinë reale për të realizuar kontratën; si dhe mosnjohja e punëve të ngjashme në këtë rast nuk është e arsyetuar dhe proporcionale. Nga mangësitë e KVO në vlerësimin e kësaj oferte, është shkaktuar mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve të SHRUK Korçë në **vlerën 8,459,713 lekë**, si diferencë midis ofertës së shpallur fituese dhe kësaj oferte të skualifikuar nga KVO në kushtet e plotësimit të kritereve.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 87 - 147 të Raportit të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën në lidhje me këtë procedurë prokurimi dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të marrë masat e nevojshme që KVO të shqyrtojë dhe vlerësojë në mënyrë të gjithanshme plotësimin e kritereve për kualifikim të OE, me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shtesave mbi pagë të punonjësve, u konstatua se trajtohen me antidotë 19 punonjës të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime, konkretisht punonjësit e Drejtorisë së kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, gjë që nuk është në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 11.04.2024 (lidhja 2), sipas së cilës sektorë të kanalizimeve kanë edhe njësitë Devoll, Maliq, Kolonjë dhe Pustec.
Gjithashtu, referuar dokumentacionit të kërkuar dhe vënë në dispozicion konstatohet se llogaritja e pagesës për antidotë për punonjësit e mësipërm është llogaritur edhe për ditët e lejeve, në kundërshtim me pikën 1 të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 28.10.2022 në 108 raste në **vlerën gjithsej 75,740 lekë.**
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për dokumentimin e ndarjes së detyrave me qëllim analizimin dhe identifikimin të gjithë punonjësve të cilët kanë kontakt me substanca të dëmshme për shëndetin, duke saktësuar dhe pagesat përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditim rezulton se SHRUK Korçë i ka pajisur të gjithë punonjësit e saj me numra telefoni celular. Për periudhën e auditimit 2023 – 30.09.2025 shoqëria ka paguar shumën totale 3,213,713 lekë për numrat e telefonit celular që kanë përdorur punonjësit e saj, e cila është në kundërshtim VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë", pikat 12 dhe 3 të lidhjes nr. 5, duke rënduar padrejtësisht koston e operimit të shoqërisë. Në këtë mënyrë vlera prej **3,213,713 lekë** përbën efekt financiar negativ në përdorimin e fondeve të shoqërisë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë së bashku me Drejtorin Ekonomik të marrin masa për rimbursimin e shpenzimeve telefonike vetëm për funksionarët sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor përkatës, duke ndërprerë kontratën e pajisjes dhe pagesës së shpenzimeve telefonike me stafin që nuk përfiton, qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e karburantit për automjetet në funksion të veprimtarisë së SHRUK Korçë, u konstatua se është vepruar në kundërshtim me kërkesat e kontrollit të brendshëm dhe parimet e menaxhimit financiar. Kjo pasi, janë konstatuar raste të furnizimit me karburant që nuk përputhet me specifikimet teknike të automjeteve (automjete me benzinë ose benzinë + elektrike janë furnizuar me naftë), si dhe mungesë e kuponëve tatimorë dhe dokumentacionit justifikues për tërheqjen dhe konsumin e karburantit nga magazina dhe Sektori i Financës. Për disa automjete janë evidentuar mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet kapacitetit të rezervuarit dhe sasisë së tërhequr, duke rezultuar në sasi të pajustifikuara mbi normën teknike, trajtuar në mënyrë analitike në projekt raportin e auditimit. Gjithashtu, janë konstatuar fletë-udhëtime të panënshkruara, mungesë e kundërfirmimeve dhe raste përdorimi të automjeteve pa leje qarkullimi dhe pa kontroll teknik, ndërkohë që janë regjistruar konsumime të konsiderueshme karburanti.
Në total, sasia e karburantit e pa dokumentuar dhe e konsumuar pa ekonomicitet dhe efikasitet llogaritet rreth 12,924.4 litra, **me një vlerë prej 3,818,862.2 lekë**, duke ekspozuar shoqërinë ndaj

riskut të lartë financiar dhe duke cenuar parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me kërkesat e Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 54 - 66 të Raportit të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për rishikimin dhe forcimin e sistemit të administrimit dhe kontrollit, duke hartuar dhe miratuar rregullore për menaxhimin e lëvizjeve të automjeteve dhe të tërheqjes së karburantit (regjistër elektronik/manual, rakordime periodike mes magazinës dhe financës, monitorim të normave të konsumit vjetor), me ndarje të qartë përgjegjësish dhe kontroll periodik nga strukturat drejtuese të karburantit, duke garantuar që furnizimi i çdo automjeti të kryhet në përputhje me specifikimet teknike të tij dhe me dokumentacion të rregullt tatimor autorizues dhe justifikues, çdo tërheqje karburanti e radhës, të jetë me kupon tatimor dhe me fletë-udhëtimi të plotësuara, të nënshkruara nga përdoruesi dhe kundërfirmuesi përkatës, si dhe të vendoset kontroll paraprak për të shmangur furnizimin mbi kapacitetin e rezervuarit të automjeteve. Të kryhet verifikimi i statusit ligjor (leje qarkullimi, kontroll teknik) dhe të pezullohet përdorimi i mjeteve që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
5.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë administrative për rastet e konstatuara, si dhe të merren masa për rikuperimin e vlerës prej 3,818,862.2 lekë dhe për çdo vlere tjetër të pajustifikuar me qëllim garantimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi llogarisë 657 "Gjoba dhe dëmshpërblime" u konstatua se, në vitin 2023 është me vlerë 5,743,224 lekë dhe në vitin 2024 është me vlerë 353,055 lekë pra gjithsej **6,096,279 lekë** të cilat janë efekte negative në administrimin e fondeve publike, me pasoja në eficencën, efektivitetin dhe ekonomicitetin e buxhetit të shoqërisë.
Në këtë vlerë përfshihet një proces gjyqësor lidhur me mosnjohjen e vjetërsisë për një punonjës, për të cilin sipas vendimit përkatës ka krijuar një efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë në vlerën gjithsej prej 92,060 lekë.
Pra, paraqitja e shpenzimeve të mësipërme për gjoba dhe dëmshpërblime në Pasqyrat financiare në shpenzimet e "zbritshme" sipas periudhave përkatëse ka deformuar rezultatin financiar të shoqërisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Kreu III, neni 11, pika 1.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për parandalimin e shpenzimeve të tilla në të ardhmen, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2026 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave shtesë për kompensimin ushqimor u konstatuar se, gjatë periudhës së aauditimit 2023 – 30.09.2025 ka parregullsi në mënyrën e përllogaritjes të shtesës, duke paguar kështu kompensimin e ushqimit edhe në ditët kur nuk kanë qenë prezent në punë, ku kanë rezultuar 700 raste, në të cilat është përllogaritur më tepër **vlera prej 957,000 lekë** gjithsej, në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 68 datë 07.12.2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e*

përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37 - 54 të Raportit të Auditimit)
7.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për parandalimin e pagesave shtesë për kompensim ushqimor në mënyrë të parregullt, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë ekonomiko - financiare të SHRUK Korçë u konstatua se, është lidhur kontratë qiramarrje ambientesh pa penalitete me efekt prapaveprues prej 15 muaj pra pas faktit për të cilat janë kryer pagesa para lidhjes së saj duke llogaritur një efekt financiar **prej 690,000 lekë** në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin e fondeve dhe kontrollin*", i ndryshuar përkatësisht neni 2, neni 4 nenin 12 pika 3, germa a) për të cilat nuk janë *respektuar parimet e ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit të fondeve publike.*
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 54 - 66 të Raportit të Auditimit)
8.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë, të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për parandalimin e nënshkrimit të kontratave me fuqi prapavepruese, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sponsorizimeve u konstatua se, në vitin 2023 dhe në vitin 2024 SHRUK Korçë ka dhënë dy sponsorizime me vlerë totale **2,000,000 lekë** për subjekte tregtare, me kërkesën e Bashkisë Korçë në kuadër të festës të birrës për ato vite, e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.7892 datë 21.12.1994 "*Për sponsorizimet*" i ndryshuar, neni 3, duke rënduar padrejtësisht koston e operimit të shoqërisë.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 66 - 87 të Raportit të Auditimit)
9.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të marrë masa për të nxjerrë përgjegjësitë për dhënien e dy sponsorizimeve, si dhe Administratori së bashku me Drejtorin Ekonomik të mos propozojnë dhënien e sponsorizimeve, pasi shoqëria është subjekt që përfiton nga financimet buxhetore.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për dieta për shërbim brenda dhe jashtë vendit, jashtë qendrës së punës, është konstatuar se, dokumentacioni justifikues nuk përmbush kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për të qenë i argumentuar dhe i bazuar, pasi mungon një dokument standard (Urdhër / autorizim, plan pune, ftesë për pjesëmarrje, urdhër për inspektim etj.) i posaçëm për lëvizjet jashtë qendrës së punës, Efekti financiar total i llogaritur është 262,316 lekë përkatësisht: në vitin 2023 është 65,000 lekë, për vitin 2024 llogaritet 158,500 lekë dhe në vitin 2025 është 38,816 lekë në kundërshtim me pikën 35, germa "a", pikën 36 të UMF 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar; në kundërshtim me pikën 2, nenin 2 të Statutit dhe në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*", i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 54 - 66 të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë ekonomik të analizojnë situatën për të marrë masa e nevojshme për shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë në vlerën totale **262,316** lekë dhe të marrë masa në hartimin e kuadrit të nevojshëm të dokumentacionit standard, për shpenzimet e shërbimeve dhe dietave brenda dhe jashtë vendit dhe të sigurohet që miratimi dhe likuidimi i shpenzimeve për dieta të kryhet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të plotë, të argumentuar dhe të verifikueshëm, duke shmangur përsëritjen e rasteve të konstatuara pa dokumentacionin e nevojshëm justifikues.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bilancit të ujit për vitin 2023 u konstatua se nuk është faturuar 33% e ujit që SHRUK Korçë ka prodhuar, në të cilën *humbjet e dukshme* që konsistojnë në konsumin e paautorizuar (vjedhje dhe lidhje ilegale) si dhe të gjitha llojet e pasaktësive në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori janë në vlerën 47,382,100 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për shoqërinë.
Për vitin 2024 SHRUK Korçë vëllimi i ujit të pijshëm që nuk është faturuar është 33.5% e ujit të prodhuar, ndërsa *humbjet e dukshme,* si pjesë e *humbjeve reale* (të gjitha llojet e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes), ka rezultuar në vlerën 42,550,800 lekë, duke shkaktuar të ardhura të munguara për shoqërinë.
Për gjashtë mujorin e parë të 2025 SHRUK Korçë vëllimi i ujit që nuk është faturuar është në masën 33.9%. *Humbjet e dukshme* u konstatuan në vlerën 16,976,000 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për shoqërinë.
Të ardhurat e munguara nga mos faturimi dhe arkëtimi i humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit për periudhën 01 Janar 2023 – 30 Qershor 2025 janë gjithsej në vlerën **106,908,900 lekë.**
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.9, faqe 159 - 168 të Raportit të Auditimit).
1.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa duke nxjerrë urdhra pune për të ushtruar kontrolle më të shpeshta dhe të vazhdueshme në të gjithë territorin ku shoqëria SHRUK Korçë operon për evidentimin dhe parandalimin e rasteve që kryejnë ndërhyrje të paligjshme dhe shkaktojnë humbje të dukshme, me pasojë mungesë të ardhurash për shoqërinë.
1.2 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Departamenti Teknik i tij, të marrin masa që në projektet dhe investimet që do të realizojnë në të ardhmen të kenë në fokus optimizimin e rrjetit për të përmirësuar eficencën, duke ulur humbjet e dukshme dhe sasinë e energjisë të blerë për mbulimin e humbjeve, si dhe duke ndikuar në rritjen e të ardhurave të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 germa "c"; ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 37, si dhe në statutin e shoqërisë neni 7/1, germa "b", neni 17/2 dhe neni 21/1, **i rekomandojmë Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë** shkarkimin e Administratorit z. P. T. në bazë të

vlerësimit negativ të performancës së tij nga shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, si më poshtë:
- Nuk ka kryer të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, për të zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 95, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- Ka hartuar me 36 muaj vonesë Rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë dhe e ka dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, sipas përcaktimeve të pikës 4/c, neni 17 i statutit, si dhe për vitin 2023 SHRUK Korçë ka funksionuar pa Kod Etik, në mospërputhje me nenin 20 pika 2 germa (a) të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Ka regjistruar shoqërinë me 2 muaj vonesë në QKB, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, neni 22, pika 3 germa "b", si dhe jo në përputhje me nenin 17, pika 4, germa "m" të statutit të shoqërisë;
- Nuk i ka paraqitur Këshillit mbikëqyrës brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli, në kundërshtim me kërkesat e pikës 4/d të nenit 17 të statutit;
- Nuk ka përfaqësuar dhe vepruar në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palët e treta për kontratat e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, megjithëse është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj, në kundërshtim me pikën 4/e, neni 17 i statutit;
- Nuk ka paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës planet e biznesit të shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e Lidhjes 2 të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" dhe të nenit 17, pika 4, germa "b" të Statutit të SHRUK Korçë, si dhe nuk ka paraqitur as në Asamble, në kundërshtim me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të Lidhjes 2 të VKM-së të mësipërme;
- Programi ekonomik i shoqërisë në asnjë vit për periudhën 2023 - 2025 nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli II, "pika 2;
- Janë konstatuar mangësi të planifikimit të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, nga diferencat e krahasuara me realizimin; si dhe për vitin 2023 nuk ka qenë i ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik; nuk janë detajuar dhe analizuar detyrimet debitore dhe kreditore, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e pikës 4/a të nenit 17 të statutit;
- Nuk ka miratuar programin paraprak vjetor të shërbimeve jashtë vendit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 22 10.07.2013 "Mbi zbatimin e Vendimit nr.870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", pika 2;
- Nuk ka marrë masa për akreditimin e laboratorëve të analizave të ujit, për pasojë janë pa vlerësim konformiteti, duke vijuar me shpenzimet për kostot operative të tyre, si dhe nuk ka marrë masa për përditësimin e licencave përkatëse në kushtet e riorganizimit të shoqërisë, jo në përputhje me pikën 4, germa "a" të Statutit të shoqërisë;
- Në strukturën organizative nuk ka ngritur njësinë e auditit të brendshëm; nuk ka plotësuar me 4 punonjës Sektorin e task-forcës; janë dy drejtori (shitja dhe juridike) të cilat nuk janë të organizuar në sektorë brenda tyre; kontratat e punës kanë mangësi administrimi; ka zgjedhur drejtues të departamentit teknik në kushtet e mosplotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 18, pika 1, germa "a"; nuk ka marrë masa për vënien në funksion të plotë të autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave; nuk janë kryer procedura për rekrutimin e stafit,

specialistëve dhe punonjësve të shoqërisë; nuk është kryer vlerësimi i performancës së punonjësve; në strukturën organizative të shoqërisë janë 32 pozicione pune vakante: 3 në nivel Drejtori, 9 Përgjegjës sektori, 12 Specialistë, 3 Teknikë, 4 Operatorë dhe 1 sanitarë;
- Në kontratën për sigurimin e aksidenteve në punë janë përfshirë dhe punonjësit e administratës, të cilët nuk janë në kushtet e rrezikut nga aksidentet;
- Për vitet 2023 dhe 2024 nuk janë ngritur komisione për përcaktimin e normave të konsumit të karburantit, si dhe në vitin 2025 nuk janë përfshirë mjete dhe makineritë e punës për të llogaritur shpenzimin orar të karburantit;
- Pompa furnizuese dhe depozita e karburantit nuk kanë dokumentacion të veçantë për lëvizjen e karburantit, si dhe mungon verifikimi dhe kalibrimi i tyre e inspektimi periodik nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; mungojnë pajisjet kundra zjarrit si dhe nuk ka mirëmbajtje të tyre;
- Detyrimi total për 4 kredi të pashlyer në datën 30.09.2025 është në vlerën 36,285,727 euro, shlyer në total vetëm 8 % e cila i përket dy prej tyre, ndërsa për dy të tjerat janë akumuluar kamatë vonesa totale në vlerën prej 4,469,365 euro, me pasoja në buxhetin e shtetit;
- Veprimtari e pamjaftueshme në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, pasi ka rritje të tyre në shtator 2025 në krahasim me fillim vitin 2023 në tre kategoritë: Familjarë, Biznese dhe Institucione.
- Subvencioni i akorduar nga AKUM në vitin 2022 për likuidimin e detyrimeve emergjente për pagesat e prapambetura ndaj OSHEE-së të shoqërive ujësjellës-kanalizime të përthithura, janë përdorur në dy kontrata për blerje pajisje pompash, panele elektrike dhe ristrukturimin e stacioneve të pompimit, në kundërshtim me pikën 3 dhe 4/d të Udhëzimit nr. 20 të MIE datë 14.10.2022 "Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve për vitin buxhetor 2022", pasi konstatohet se nga ish-njësia Maliq janë transferuar 29 kontrata me OSHEE-në, me detyrime të prapambetura në vlerën totale neto 113,360,845 lekë;
- Nga 176 pasuri (prona) gjithsej të SHRUK Korçë, 146 prej tyre nuk janë pajisur me certifikata pronësie dhe nuk janë bërë aplikime nga ana e shoqërisë, ndërkohë që pronat me certifikatë pronësie vijojnë të mos jenë në emër të shoqërisë, si dhe 63 prona vijojnë të jenë të pa kontabilizuara, në kundërshtim me VKM 302 datë 11.05.2022 dhe ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- Në cilësinë e titullarit të Autoriteti Kontraktor nuk ka konfiskuar sigurimin e ofertës së BOE "Nd" SHPK & "M" SHPK në vlerën 1,526,773.7 lekë, për shkak të tërheqjes së operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3/a të nenit 83 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar;
- SHRUK Korçë nuk ka kryer analizat e ujit të pijshëm pranë ISHSH-së përpara fillimit të investimit të veprave të reja, në mënyrë që të shmangë rrezikun e investimit të gabuar, në kundërshtim "Rregulloren e cilësisë së ujit të pijshëm", neni 16;
- Nga veprimet dhe mosveprimet drejtuese të shoqërisë, janë evidentuar të ardhura të munguara nga mos faturimi dhe arkëtimi i humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit për periudhën 01 Janar 2023 – 30 Qershor 2025 gjithsej në vlerën 106,909 mijë lekë;
- Nga mangësitë e drejtimit dhe administrimit të shoqërisë janë evidentuar probleme në çështjet organizative, të shkaktimit të dëmit ekonomik dhe financiar për buxhetin e shoqërisë dhe buxhetin e shtetit, përdorim të fondeve publike pa efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet dhe të ardhura të munguara në vlera të konsiderueshme.

II. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 germa "c"; ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 37 "*Masa disiplinore*" dhe në Kontratën individuale të punës, neni 39/2, 40, 41 dhe 42 **i rekomandojmë Administratorit të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Korçë** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për punonjësit e atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

"Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët", neni 40, germa "g" e Kontratës individuale të punës:

1. Për **znj. F. F.** me detyrë Drejtor i Departamentit Tregtar:
- Për mosparaqitjen për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të planeve të biznesit të shoqërisë, jo në përputhje me përcaktimet e Lidhjes 2 të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe nuk ka paraqitur as në Asamble, në kundërshtim me pikën 1, germa "a" të nenit 7 të Lidhjes 2 të VKM-së të mësipërme, si dhe të nenit 19, pika 2 të statutit;
- Programi ekonomik i shoqërisë në asnjë vit për periudhën 2023 - 2025 nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli II, "pika 2, si dhe të nenit 19, pika 2 të statutit;
- Për mangësitë e konstatuara të planifikimit të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, rezultuar nga diferencat e krahasuara me realizimin, si dhe për mos detajimin dhe analizimin e detyrimeve debitore dhe kreditore, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 19, pika 2, germa "a" të statutit të shoqërisë;
- Për mos zhvillimin e analizave lidhur me përmbushjen e kritereve dhe kategorinë e pagës që duhet të ketë gjithsecili punonjës, si dhe për miratimin e 7 rasteve të rritjes së pagës së punonjësve, para daljes së vendimit përkatës të këshillit mbikëqyrës;
- Për moskryerjen e analizave të riskut dhe të ndikimit financiar në marrjen e shërbimeve nga të tretë, si dhe mungesën e miratimeve përkatëse të kontratave, të cilat nuk parashikojnë penalitete për vonesa në arkëtime;
- Për kryerjen e pagesave për qiramarrje për 15 muaj para datës së protokollimit të një kontrate;
- Për njësinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës së sigurimit të aksidenteve në punë në vitin 2023 janë caktuar dy anëtarë, në kundërshtim me UMF 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar; si dhe nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim për zbatimin e kontratës për zhvillimit e faturimit "Al-Billing" 2023;
- Për mangësi të theksuara të evidentuara në administrimin e mjeteve dhe automjeteve, pasi nuk evidentohet lloji i karburantit që përdorin, regjistrimi i lëvizjes së automjeteve dhe as orët e punës së mjeteve; mangësi të plotësimit të fletë-udhëtimeve; nuk është përcaktuar qartë periudha e kryerjes së shërbimeve, mangësi në procedurën e dokumentacionit të konsumit të karburantit etj.
- Për mungesën e dokumentacion të veçantë për lëvizjen e karburantit; verifikimit, kalibrimit e inspektimi periodik nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të pompës furnizuese dhe depozitës së karburantit; si dhe mungesën e pajisjeve kundra zjarrit si dhe mirëmbajtjes tyre;

- Për veprimtari e pamjaftueshme në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, pasi ka rritje të tyre në shtator 2025 në krahasim me fillim vitin 2023 në tre kategoritë: Familjarë, Biznese dhe Institucione;
- Për mungesën e rakordimit me sistemin e tatimeve, në momentin e transferimit të ish-njësive, pasi konstatohet se në pasqyrat financiare të vitit 2023 të SHRUK Korçë është transferuar si gjendje kreditore TVSH-ja në vlerë 2,318,259 lekë më pak se sa është vlera reale në sistemin e tatimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11;
- Për përfshirjen në llogarinë 615 "Mirëmbajtje dhe riparime" të pasqyrave e performancës të vitit 2023 e 2024 edhe të investimeve të bëra për automjete me pjesë ndërrimi, e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.29/2023 i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 51, pika nr.10; si dhe përfshirja e sponsorizimeve dhe vlerës së gjobave në shpenzime në mënyrë të padrejtë, me pasojë në uljen e tatimi mbi fitimin;
- Për mos aplikimin dhe mungesën e pajisjes me certifikata pronësie të 146 pronave nga 176 pasuri (prona) gjithsej të SHRUK Korçë; ndërkohë pronat me certifikatë pronësie vijojnë të mos jenë në emër të shoqërisë, si dhe 63 prona vijojnë të jenë të pa kontabilizuara, në kundërshtim me VKM 302 datë 11.05.2022 dhe ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- Në cilësinë e zyrtarit të Autorizuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka përfshirë në procedurat e prokurimit dhe të zbatimit të kontratave Drejtorin Ekonomik - Nëpunësin zbatues, në kundërshtim me germën "dh" dhe "e" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Mos përmbushjen e detyrave të përcaktuara në kreun VII- Departamenti Tregtar, të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime lidhur me mangësitë në mbikëqyrjen e zhvillimit të veprimtarisë ekonomiko - financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe mangësitë në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave sipas nenit 19, pika 2 të statutit të shoqërisë për mbarëvajtjen e gjithë veprimtarisë ekonomike financiare të shoqërisë, pasi janë evidentuar dëme ekonomike dhe financiare, si dhe përdorim të fondeve publike pa efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet dhe të ardhura të munguara në vlera të konsiderueshme.

2. Për **znj. E. F.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike:
- Për kryerjen e shpenzimeve për themelimin e shoqërisë së re me burimet e veta të shoqërisë, në një kohë që sipas VKM 302, datë 11.05.2022, neni 7, pika 5 duhej të përballoheshin nga buxheti i shtetit;
- Për parregullsitë në dokumentet e shpenzimeve për karburant, pasi janë konstatuar raste të mospërputhjes së llojit të karburantit me specifikimet teknike të mjetit; konsum karburanti nga automjete që nuk kanë dokumentacionin përkatës ligjor; furnizime të njëhershme me sasi mbi kapacitetin teknik të mbajtjes së mjetit; mungesë e pajisjeve për matjen e sasisë së karburantit në depozitë etj.;
- Për mungesën e rakordimit me sistemin e tatimeve, në momentin e transferimit të ish-njësive, konstatohet se në pasqyrat financiare të vitit 2023 të SHRUK Korçë është transferuar si gjendje kreditore TVSH-ja në vlerë 2,318,259 lekë më pak se sa është reale në sistemin e tatimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11;
- Për përfshirjen në llogarinë 615 "Mirëmbajtje dhe riparime" të pasqyrave e performancës të vitit 2023 e 2024 edhe të investimeve të bëra për automjete me pjesë ndërrimi, e cila është në kundërshtim me Ligjin nr.29/2023 i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat" neni 51, pika nr.10;

si dhe përfshirja e sponsorizimeve dhe vlerës së gjobave në shpenzime në mënyrë të padrejtë, me pasojë në uljen e tatimi mbi fitimin;
- Për parregullsitë në dokumentacionin e procedurave të inventarizimit, pasi komisioni i inventarizimit për vitin 2023 dhe 2024 nuk ka mbajtur një raport mbi gjendjen e aktiveve ku të përshkruheshin verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve, si dhe të përpilohej një raport lidhur me inventarizimin fizik të tyre, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 të MFE datë 27.12.2011, të ndryshuar, pika 85;
- Për parregullsitë e konstatuar në mënyrën e përllogaritjes së kompensimit të ushqimit dhe pagesës për antidote, pasi janë përfshirë edhe ditët kur punonjësit mund të kenë qenë me leje;
- Për periudhën e 4 mujorit të parë, viti 2023 konstatohet se transfertat e kryera në tre banka të nivelit të dytë të realizuara vetëm me nënshkrimin nga nëpunësi autorizues (Administratori) në kundërshtim me nenin 22 germa "ç" të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Për kryerjen pagesave për qiramarrje për 15 muaj para datës së protokollimit të një kontrate;
- Për mungesën e rregullave procedurale për lëvizjen e mallrave nga magazina, si dhe mangësive në plotësimin e dokumentacionit përkatës;
- Për mos aplikimin dhe mungesën e pajisjes me certifikata pronësie të 146 pronave nga 176 pasuri (prona) gjithsej të SHRUK Korçë; ndërkohë pronat me certifikatë pronësie vijojnë të mos jenë në emër të shoqërisë, si dhe 63 prona vijojnë të jenë të pa kontabilizuara, në kundërshtim me VKM 302 datë 11.05.2022 dhe ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- Për mangësitë në përllogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2023; "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2024 dhe "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës;
- Për mangësitë në përcaktimin e kërkesave teknike për kualifikim në procedurën e prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2023; "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2024 dhe "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025, në cilësinë e anëtarit të NJP;
- Për mangësitë e evidentuara gjatë marrjes në dorëzim të shërbimit sipas kontratës "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2023; "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2024 dhe "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës të.
- Për mangësitë në menaxhimin e aktivitetit ekonomiko-financiar të shoqërisë dhe në mbikëqyrjen e kryerjes së veprimeve financiare dhe kontabile, detyra të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 26.09.2025, neni 27/a dhe 27/e;
- Për mangësitë e evidentuara në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë, jo në përputhje me kërkesat e nenit 4/24 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", neni 40, germa "d" e Kontratës individuale të punës
1. Për **znj. M. K.,** me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik:
- Për moszbatimin e plotë të rregullores së ujit të pijshëm, sipas përcaktimeve në Vendimin nr.379, datë 25.05.2016 "Rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm" nenet 15, 16, 17 dhe 20, Shtojca nr. X;
- Për mangësitë në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023 dhe "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", 2024, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit;

- Për mangësitë në vendim-marrje gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë” 2024, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- Për moskryerjen e analizave ujit të pijshëm në ISHSH, përpara fillimit të investimit të veprave të reja, në mënyrë që të shmanget rreziku i investimit të gabuara, në kundërshtim me “Rregulloren e cilësisë së ujit të pijshëm” neni 16.
- Nga veprimet dhe mosveprimet në detyrën e Drejtorit Teknik të shoqërisë, janë evidentuar të ardhura të munguara nga mos faturimi dhe arkëtimi i humbjeve të dukshme (jo teknikë) të ujit për periudhën 01 Janar 2023 – 30 Qershor 2025 gjithsej në vlerën 106,909 mijë lekë, duke shfaqur mangësi në zbatimin e nenit 18, pika 2/c të statutit, lidhur me kontrollin e rrjetit shpërndarës; si dhe mangësitë në zbatimin e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e brendshme të shoqërisë kreu VI – Departamenti teknik.

“Vërejtje”, neni 40, germa “c” e Kontratës individuale të punës

1. Për **z. A. A. ,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë ITUN:
- Në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2023; “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2024;
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës të marrjes në dorëzim të shërbimit sipas kontratës “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2023; “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2024 dhe “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2025.
2. Për **znj. V. C.** , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kanalizimeve:
- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve” 2023; “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve”, 2024; “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve” 2025 dhe “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë” 2024;
- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave në zbatim të kontratës “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve” 2023.
3. Për **z. V. L.** , me detyrë Drejtor i Prodhim Magazinim Ujit:
- Në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2023; “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2024; “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë” 2024 dhe “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq” 2025;
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës, për mangësitë në përllogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2025;
- Në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësitë në përcaktimin e kërkesave teknike për kualifikim në procedurën e prokurimit “Riparim - shërbimi i automjeteve” 2025.
4. Për **znj. E. B.** , me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit:
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit, për mangësitë në procedurën e prokurimit “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve”, 2024 dhe “Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve” 2025;
- Në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq” 2025.
5. Për **z. I. P.,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projektim, Zhvillim Standarde:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023; "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", 2024; "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2025; "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2023;dhe "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2024;
- në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave në zbatim të kontratës "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023.

6. Për **z. Th. K.,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Humbjeve:
- Në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023; "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve", 2024;
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit, për mangësitë në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2025.

7. Për **znj. O. H. ,** me detyrë Specialit i I në Sektorin e Planifikimit të Buxhetit:
- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për mangësitë në përllogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023;
- në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave për mangësitë në zbatim të kontratës "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2023;
- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit "Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve" 2025 dhe "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025.

8. Për **znj.A. K.,** me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore/Arkivës:
- Dosjet e personelit rezultojnë me mangësi të shumta në administrim, përfshirë mungesën e inventarit, dokumenteve bazë si certifikata familjare, aktet e emërimit në detyrë, kontratat punës, dëshmitë e penalitetit, si dhe dokumentet e shkëputjes dhe transferimit të punonjësve në shoqërinë e re apo dokumente të tjera që lidhen me pozicionin e punës;
- Nuk është kryer vlerësimi 6-mujor apo vjetor i punonjësve të shoqërisë gjë që në kundërshtim me Parimin 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit;
- Mungon e nënshkrimi dhe e protokollimi i kontratave të punës për punonjësit e transferuar nga ish-shoqëritë dhe ata të rekrutuar rishtazi në periudhë prove, si dhe hartimi i tyre shfaq mangësi në lidhje me përputhjen me Rregulloren e Brendshme.

9. Për **znj. A. L.** , me detyrë Jurist në Sektorin e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësitë në përcaktimin e kërkesave teknike për kualifikim në procedurën e prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025;

10. Për **z. V. M.** , me detyrë Menaxher operativ i njësisë Devoll, në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025 dhe "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq" 2025.

11. Për **z. M. G.** , me detyrë Menaxher operativ i njësisë Maliq, në cilësinë e anëtarit të KVO për mangësitë në vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit "Riparim - shërbimi i automjeteve" 2025.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT